

*101 tregime  
për të arritur kulminacionin e mirësisë dhe  
përsosmërinë e devotshmërisë*

*Autor:*

**Muhamed Eminë Xhundi**

*Titulli:*

**101 TREGIME PËR TË ARRITUR  
KULMINACIONIN E MIRËSISË DHE  
PËRSOSMËRINË E DEVOTSHMËRISË**

*Përktheu:*

**Dr. Musli VËRBANI**

*Korrektura:*

**Daut Shehu**

*Radhitja kompjuterike,  
kopertina dhe dizajni grafik:*

**Mumin Shehu**

**Shkup, 2008**

*Të drejtën e ribotimit e rezervon autori*

**Muhamed Eminë Xhundi**

**101 TREGIME**

**PËR TË ARRITUR KULMINACIONIN E  
MIRËSISË DHE PËRSOSMËRINË E  
DEVOTSHMËRISË**

**Kaçanik, 2008**



بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Falënderojmë Allahun, i Cili i ka bërë tregimet shembull për shembullorët, kuptim për kuptuesit dhe ushqim për ushqyesit. Përshëndetjet dhe selamet qofshin për treguesin më të vërtetë të tregimeve dhe zotërinë e të parëve e të fundit për familjen e tij, shokët e tij të mirë e të pastër dhe për ata, të cilët i pasojnë ata deri në Ditën e Kijametit. (amin).

Dhe ...

Shpirtrat ushqehen siç ushqehen trupat, ashtu mbushen siç mbushen trupat, forcohen ashtu siç forcohet hekuri. Për këtë arsye patjetër duhet mësuar kuriozitate dhe ngjarje interesante me urtësi, por, kuptohet, ato tregime të jenë tregime të vërteta.

Ibn Mes'udi r.a. ka thënë: *“Zemrat mbushen siç mbushen trupat, kërkoni ushqim në urtësi.”*

Tregon Zehra: *“Një njeri ulej me shokët e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s., mësonte me ta dhe pasi lodhej thoshte: “Veshi është lodhur, ejani pra na tregoni ndonjë ngjarje ose recitoni ndonjë poezi.”*

Kam dëshiruar që të shëroj një pjesë prej pjesëve të dobëta duke ofruar bar (ilaç) të mirë. Po ashtu kam dëshiruar që të sjell disa tregime të dëshirueshme. Për këtë arsye kam tubuar njëqind tregime, prej tyre disa, të cilat i ka treguar Pejgamberi s.a.v.s., disa tregime, të cilat i kanë treguar të mirët, por edhe të këqijtë, mbretërit dhe kam tubuar edhe tregime të lashta.

Nga këto tregime përfiton shumë besimtari, i cili dëshiron të jetë shëmbëlltyrë, i udhëzuar dhe njëherit të jenë këshillë për të devotshmit. Kam harxhuar kohë dhe kam shpenzuar mund që t'i tuboj, t'i rendis e t'i përgatis, duke sqaruar fjalët e panjohura dhe i kam zgjedhur ato tregime që janë të vërteta dhe të besueshme, të cilat dijetarët i kanë pranuar apo përgënjeshtuar.

Kam treguar burimin dhe bazën e tregimit, ashtu që lexuesi i nderuar të jetë i sigurt. Nëse në këto tregime ka të mira dhe dobi kjo është begati e Allahut dhe pajtueshmëri e Tij, ndërsa nëse nuk është ashtu, atëherë këto janë prej vetes sime dhe shejtanit. E Allahu dhe i Dërguar i Tij janë të pastër nga kjo.

Librin e kam shkruar pa renditje të posaçme që hulumtuesi të angazhohet, mendja të jetë më kurioze, shpirti të tërhiqet më shumë në to dhe kam titulluar *“Njëqind e një tregime për shoqërinë e të mirëve dhe shkëlqimin e të devotshmëve”*.

Lus Allahun që ta bëjë vepër të pastër për Allahun, të dobishme për krijesat e Tij. Vërtet Ai i dëgjon lutjet.

*Muhamed Eminë Xhundi*

## [1] - TREGIMI I TË ZGJEBOSURIT, TË VERBËTIT DHE QELIT

Atë, i cili duron në vështirësi dhe në probleme, të cilat i paraqiten, Zoti e shpërblen me të mira. Kush e falënderon për të mirat që ia jep Zoti, ia shumëfishon ato të mira.

Kur dëshiron Allahu që të dënojë ndokënd, i cili punon punë të këqija, dërgon melaqe për t'i dënuar. Ose nëse një popull vepron me padrejtësi, Zoti dërgon melaqet për ta shkatërruar atë popull. Kështu ka ndodhur me popullin e Lutit a.s. Ai i këshillonte, i udhëzonte në punë të mira, mirëpo populli i tij nuk e dëgjoi. Për këtë arsye Zoti i Madhëruar dërgoi melaqet, të cilat shkatërruan këtë popull. Po me të njëjtën mënyrë, nëse dikush punon punë të mira, Zoti dërgon melaqe për t'i dhënë atij të mira të shumta.

Të shohim çfarë ka ndodhur me tre persona të një vendi, ku njëri e kishte zgjebën, i dyti ishte pa flokë (qel) dhe i treti i verbër. Që të tre kishin të meta, që të tre ishin të vetmuar, nuk u ndihmonte askush, por vetëm largoheshin prej tyre për shkak të sëmundjeve neveritëse të tyre dhe për shkak të papastërtisë së tyre.

Allahu dërgoi një melaqe te ata për t'i sprovuar, duke u dhënë atyre pasuri dhe duke ua larguar sëmundjet.

Melaqja shkoi te njeriu i parë me sëmundjen e zgjebes:

- Çka dëshiron, i tha?

“Nuk dua asgjë, pos të më shërojë Zoti nga kjo sëmundje dhe të kem pasuri sa për ekzistencë.”

Melaqja e preki dhe ai u shërua nga zgjebja, pastaj i tha se Allahu ia ka dhënë këto dy dele dhe prej tyre do të pasurohet.

Pastaj melaqja shkoi te njeriu i dytë dhe i tha:

- Çka dëshiron?



Njeriu pa flokë, qeli, i tha: “Nuk dua asgjë tjetër, pos të më shërojë Zoti nga kjo sëmundje dhe të kem pasuri sa për ekzistencë.”

Melaqja e preki dhe ai u shërua nga sëmundja, pastaj i tha se Allahu ia ka dhënë këto dy dele dhe prej tyre do të pasurohet. Në fund melaqja shkoi te njeriu i tretë dhe i tha:

- Çka dëshiron?

I verbëri tha: “Nuk dua asgjë tjetër, pos të më kthejë shikimin Zoti dhe të kem pasuri sa për ekzistencë.”

Melaqja e preki dhe atij i erdhi shikimi, pastaj i tha se Allahu ia ka dhënë këto dy dele dhe prej tyre do të pasurohet.

Kaluan shumë vite e ata u forcuan dhe u pasuruan, pasi që Allahu i Madhëruar i kishte frymëzuar delet të shumohen. Pas atyre viteve të shumta, Allahu e dërgoi melaqen dhe e urdhëroi që të shndërrohet në formën e një njeriu të varfër, me rroba të vjetra që t’i sprovonjë ata se a janë bamirës, a e falënderojnë Zotin dhe a u ndihmojnë nevojtarëve.

Në atë formë, si i varfër, melaqja kërkoi ndihmë prej njeriut të parë, i cili kishte pasur zgjebën, e i tha: “Jam udhëtarë, kam nevojë për ndihmë, më jep diç prej asaj që të ka dhënë Allahu!!”

Ai e refuzoi dhe filloi t’i bërtas, duke e qortuar. Në atë moment, befasisht, prej formës së njeriut të varfër u shndërruar në formën e melaqes së vërtetë dhe i tha: “Pasi ti nuk i njeh të mirat e Allahut dhe njerëzit nuk kanë dobi prej teje, kthehu zgjebkan siç ishe më parë.” Dhe menjëherë iu kthye sëmundja e mëparshme.

Melaqja vazhdoi dhe shkoi te njeriu i dytë, si i varfër dhe kërkoi ndihmë prej tij. Ai u tregua më koprrac. Filloi t’i bërtas, ta ofendojë dhe ta largojë me forcë. Melaqja me shpejtësi u shndërrua në formën e vërtetë dhe i tha: “Kthehu në sëmundjen e më parme, pa flokë (qel)” dhe me urdhrin e Allahut u sëmur. Ai filloi të qajë dhe u pendua, por pendimi i tij nuk pati efekt.

Vazhdoi melaqja për ta provuar njeriun e tretë. Kur shkoi te ai, kërkoi ndihmë dhe u paraqit si i varfër, i gjorë dhe me rroba të vjetra, dhe i tha: “A keni diçka të më ushqeni se jam i uritur?”

Ai me zemërgjerësi i tha: “O vëlla, ti je i varfër dhe nevojtar. Por tërë kjo pasuri është begati prej Allahut, merr sa të duash dhe sa të kesh nevojë, vetëm se për këtë falënderoje Allahun, e jo mua”. Melaqja prej të varfërit u shndërrua në formën e vërtetë e tha:

“Ti je bamirës, falënderues dhe i dobishëm për shoqërinë, për këtë arsye Allahu do ta shtojë pasurinë dhe do të të japë shëndet të fortë përgjithmonë.”

## [2] - TREGIMI I ROBIT XHUREJXH

Ebu Hurejre r.a. transmeton se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Xhurejxhi ka qenë rob i devotshëm. Ai është vetmuar në një faltore vetëm për adhurim. Deri sa ishte duke u falur, i shkon nëna dhe e thërret: “O xhurejxh!” E ai në namaz thotë: “O Zoti im, nëna ime dhe namazi im, në të njëjtën kohë.” Kështu ai vendos ta falë namazin, e nëna kthehet (pa përgjigje). Të nesërmen, prapë, deri sa ai ishte duke u falur, i vjen nëna dhe e thërret: O Xhurejxh! E ai i thotë: “O Zoti im, nëna ime dhe namazi im, në të njëjtën kohë (cilës t’i përgjigjem dhe çka është më së miri?)” dhe vazhdon namazin, e nëna prapë kthehet pa përgjigje. Po ashtu prapë të nesërmen, deri sa ishte duke u falur, i shkon nëna dhe e thërret: “O Xhurejxh!” E ai prapë thotë: “O Zoti im! Nëna ime dhe namazi im, dhe e vazhdon namazin. Nëna tha: *“Mos vdeksh, derisa të shohësh fytyrat e lavireve!”* Bëni israilët e përmendin shumë me nam Xhurejxhin dhe ibadetin e tij. Në mesin e tyre ka qenë një grua lavire, e cila shquhej me bukurinë e saj. Ajo u thotë atyre: “Nëse doni, unë do ta lajkatoj dhe ta mashtroj.” Pastaj ajo shkon dhe i paraqitet atij,

por ai as që ia vuri veshin. Atëherë atypari kalon një bari me një tufë delesh, i cili vendstrehohet në faltoren e tij, e ajo bën marrëdhënie intime me bariun dhe mbetet shtatzënë. Kur e lind fëmijën ajo tha: “Këtë fëmijë e kam me Xhurejxhin”. Pastaj shkojnë njerëzit, e largojnë prej faltores së tij, ia prishin faltoren dhe e rrahin. Ai pyet: “Çka është puna me ju?” Ata i thonë: “Ti ke bërë prostitucion me këtë lavire dhe ajo ka lind fëmijë prej kontaktimit tënd.” Ai pyet: “Ku është foshnja?” Kur ja sjellin foshnjën përpara tha: “Më lejoni vetëm deri sa të falem” dhe falet. Pasi e përfundon namazin shkon te fëmija, e prek në stomak dhe i thotë: “Oj foshnje e porsalindur, cili është babai i yt?” Foshnja përgjigjet: “Filani, i cili është bari”. (Kur e dëgjuan njerëzit) shkuan dhe filluan ta puthin dhe ta përqafojnë Xhurejxhin dhe i thanë: “Do ta ndërtojmë faltoren tënde prej arit.” Ndërsa ai u tha: “Jo, ndërtojeni me aso materiali siç ka qenë më parë, prej balte.” Dhe ashtu edhe ia ndërtouan.”

*(Transmeton Buhariu dhe Muslimi)*

### **[3] - EMANETU FERIDETUN**

Muhamed s.a.v.s. ka thënë: “Një njeri e bleu nga një njeri tjetër një pronë të tokës, dhe në atë pronë, më vonë, gjen një qese me ari. Shkon e i thotë pronarit të mëhershëm: “Merre arin, se unë nga ti kam blerë tokën, e jo arin.” Pronari i tokës i thotë: “Unë ta kam shitur token tërë atë që është në të”. Shkuan te një njeri, gjykatës, për të gjykuar mes tyre. Gjykatësi i tyre u thotë: “A keni fëmijë?” Njëri thotë: “Kam një djalë”, e tjetri thotë: “Kam një vajzë.” Pastaj ai u thotë: “Martoni fëmijët tuaj mes veti, pra djalin me vajzën, kështu që arin e trashëguan ata të dy.”

*(Transmeton Buhariu dhe Muslimi)*

## [4] – SADAKAJA E PRANUAR

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: “Një njeri tha: “Do të jap sadaka.” Doli dhe e dha sadakanë në dorë të një hajni. Të nesërmen të tjerët thoshin: “Dje ky njeri i ka dhënë sadaka hajnit.” Ai tha në vetvete: “O Zoti im! Vetëm Ty të takon falënderimi! Unë prapë do të jap sadaka.” Del nga shtëpia dhe i jep sadaka një prostitute. Të nesërmen njerëzit thoshin se ky njeri i ka dhënë sadaka prostitutës!” Ai tha në vetvete: “O Zoti im! Vetëm Ty të takon falënderimi! Unë prapë do të jap sadaka.” Kështu që del nga shtëpia dhe i jep sadaka një të pasuri. Të nesërmen njerëzit thoshin se ai i ka dhënë sadaka një të pasuri. Ai tha në vetvete: “O Zoti im! Vetëm Ty të takon falënderimi, për atë që i kam dhënë sadaka: hajnit, prostitutës dhe të pasurit!” Atij pastaj i paraqitet (në ëndërr) një zë duke i thënë: “Sadakaja e jote e dhënë hajnit ndikoi që ai të largohet nga vjedhja; sadakaja e jote e dhënë prostitutës ndikoi që ajo të largohet nga prostitucioni; sadakaja e jote e dhënë të pasurit ndikoi që ai të ketë në konsideratë, dhe të shpenzojë (t’u japë të tjerëve) prej asaj çka i ka dhënë Allahu.”

*(Transmeton Buhariu dhe Muslimi)*

## [5] – KUSH ËSHTË I VARFËR E KUSH I PASUR

Tregohet se një ditë, një njeri me bashkëshorten e tij ulen duke ngrënë një pulë të pjekur. Një lypës shkon te dera e tyre dhe kërkon lëmshë. Ai njeri del te dera dhe me tërbim dhe britmë e dëbon. Kalon ditë të shumta dhe ky njeri varfërohet,

dhe nga varfëria detyrohet që ta lëshojë gruan e tij. Pastaj kjo grua martohet me një njeri tjetër. Kjo grua ulet me bashkëshortin e saj dhe hante pulë të pjekur. Në atë moment një lypës troket në derë. Burri i thotë bashkëshortes: “Merre këtë pulë dhe jepja lypësit.” Kure e hap derën e sheh se lypësi ishte burri i saj i parë. Ia jep pulën dhe kthehet brenda në shtëpi duke qarë. Burri e pyet se përse po qante, e ajo i tregon se lypësi ishte burri i saj i parë. Pastaj ia tregon rastin se si e njëjta gjë i kishte ndodhur me burrin e saj të parë dhe derisa kishte qenë duke ngrënë pulë, kishte ardhur një lypës, por ai e kishte dëbuar me britmë. Burri i thotë asaj: “Po pse po habitesh? Për Zotin unë jam ai lypësi i parë (i cili më ka dëbuar)!”

## [6] – GJYKIMI I DREJTË

I dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: “Dy gra (kunata) me fëmijët e tyre dalin në një ambient. Aty një ujk e han njërin fëmijë. Pastaj këta dy gra ngatërrohen në mes vete për fëmijën e mbetur (secila nga ato thoshte se fëmija i mbetur është fëmija i saj). Shkojnë për t’u gjykuar te Davudi a.s. Davudi a.s. gjykon që fëmija t’i takojë kunatës së madhe. Ata prapë nuk pajtohen mes vete, kështu që shkojnë për t’u gjykuar te Sulejmani a.s. Sulejmani a.s. u thotë: “Më sillni një thikë që ta pres fëmijën për gjysmë dhe secilës prej jush t’jua jap nga një pjesë.” Kunata e vogël thotë: “Po dëshiron ta presësh, o i Dërguar i Allahut?!” Thotë: “Po.” Atëherë i thotë (kunata e vogël): “Mos e bën këtë, sepse pjesën time do t’ia jap kunatës së madhe.” Atëherë Sulejmani a.s. i thotë: “Merre se ky fëmijë është i yti”, kështu gjykoi në dobi të saj.

*(Transmeton Buhariu dhe Muslimi)*

## [7] - TREGIMI I DHULKIFLIT

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. tregon se: “Ka qenë Dhul Kifli, njeri prej beni israilëve, i cili bënte mëkate. I vjen një grua, së cilës ia jep gjashtëdhjetë dinarë vetëm për të fjetur njëherë me të. Kur të hipë mbi të, sikurse kur hip burri mbi gruan, fillon ajo të dridhet dhe të qajë. E pyet: “Përse po qanë, a nuk je në gjendje të mire?” Ajo thotë: “Jo, por këtë vepër nuk e kam bërë asnjëherë gjer më tani, dhe për ta bërë këtë më ka detyruar nevoja e jetës”. Ai i thotë: “Këtë po e bënë, ndërsa deri më tani asnjëherë nuk e keni bërë!?! Merri të hollat dhe shko.” Dhe thotë: “Për Zotin, më kurrë nuk do të kthehem në mëkate”, dhe po në atë natë vdes. Të nesërmen, në derën e shtëpisë së tij ishte shkruar: “Nuk ka dyshim se Allahu ia ka falë Kiflit”, ndërsa njerëzit u habiten kur e panë të shkruar ashtu.

*(Transmeton Tirimidhiu, Hakimi thotë se është hadithi sahih ismal)*

## [8] - PËRFUNDIMI I KEQ

Në Egjipt ishte një muezin, ishte njeri i mirë. Një ditë hip në minare për ta thirrur ezanin. Nga aty sheh një krishtere, e cila i pëlqeu dhe u mashtrua në të. Shkon te ajo, mirëpo ajo e refuzon. Muezini i thotë: “Apo martohesh me mua?” Ajo i thotë: “Ti je musliman, e unë krishtere, e për këtë arsye prindërit nuk më lejojnë të bëj një gjë të tillë.” Ai i thotë: “Po nëse unë bëhem i krishterë?” Ajo i thotë: “Atëherë prindi do të jetë i kënaqur dhe do të pranojë.”

Zoti na ruajt! Ai u bë i krishterë, atëherë ajo pranoi dhe të nesërmen duhej të bëhej kurorëzimi. Gjatë asaj ditë, ai hipi në

një kulm, aty i rrëshqet këmba, rrezohet dhe mbytet. Kështu as ajo, as ai nuk realizuan dëshirën e tyre për fenë e tyre. Zoti na ruajt nga përfundimi i keq!

\* \* \*

Tregohet se kanë qenë dy vëllezër, njëri i devotshëm e tjetri i zhytur në mëkate. Pasi që një kohë të gjatë kishte bërë ibadet, një ditë i devotshmi ia lejon vetes të pasojë epshet, e pastaj të përcaktohej përsëri në ibadet, sepse e dinte se Allahu është Falës e i Mëshirshëm. I devotshmi mendoi në vete: “Do të zbres poshtë te shtëpia e vëllait tim dhe t’i bashkëngjitem në dëfrim e aheng dhe në pasim të epshit përkohësisht. E pastaj të pendohem dhe ta adhuroj Allahun në pjesën tjetër të jetës sime.” Kështu që shkon te shtëpia e vëllait të tij me këtë qëllim. Ndërsa e kundërta, vëllai i tij mëkatar, i cili tërë jetën e kishte kaluar me mëkate, mendon se vëllait i tij do të shkojë në xhenet, e vetë në xhehenem dhe thotë: “Për Zotin, do të pendohem dhe do të shkoj në shtëpinë e vëllait, që së bashku me të, të bëj ibadet, në pjesën tjetër të jetës sime, e ndoshta Allahu do të më falë.”

Dhe me këtë qëllim shkon te vëllai, ndërsa vëllai i tij kishte shkuar me nijet mëkatimi. Dhe kur hyn në shtëpi, i rrëshqet këmba dhe bie mbi vëllanë, kështu që aksidentalisht mbyten që të dy. Në ditën e Kijamett i devotshmi ringjallet me nijet të mëkatimit, e mëkatarin me nijet të pendimit.

\* \* \*

Tregohet se një musliman është zënë rob. Në robëri ai u shërbente dy priftërinjve. Ai ishte *hafidh i Kur’anit*, e kur e lexonte Kur’anin, me zërin e tij të bukur, ua zbuste zemrat priftërinjve dhe ata qanin. Kështu një ditë prej ditëve, priftërinjtë e pranuan islamin, ndërsa ai u bë i krishterë. Ata i thanë: “Kthehu ne fenë tënde të mëparshme, se është më mirë për ty!”

Ai nuk u kthye dhe vdiq si i krishterë. Lusim Allahun për përfundimin e mirë të jetës!

\* \* \*

Sufjan ETH-THERVRIU rrëfen: “E kam parë një njeri, i cili ishte i varur për mbështjellësen e Qabesë, duke thënë: “O Zoti im, me shpëto, me shpëto!” Shkova dhe e pyeta: “Çka është puna me ty që po thua kështu?” Ai me tha: “Kemi qenë katër vëllezër musliman, tre prej tyre kane vdekur dhe kanë qenë të sprovuar me sprovë të madhe, e kam mbetur vetëm unë. E unë nuk e di si do ta kem përfundimin (çastin e vdekjes)!”

\* \* \*

Një mëkatar ishte i shtrirë në shtratin e vdekjes. Dhe çdo here kur i thuhej: “Thuaj: *“La i lahe il-lallah”*, ai recitonte vargjet: “U lodha duke pritur ditën, kur ajo do të vijë për të më pyetur: “Ku është rruga për te Hamami Munxhab?”

Shkak i kësaj ka qenë se një grua e ndershme dhe e bukur ka dashur të shkonte te hamami i njohur, hamami i Munxhabit. Mirëpo, ajo nuk e ka ditur rrugën dhe duke shkuar andej e këndeje lodhet. E sheh një njeri pranë derës së shtëpisë së tij dhe e pyet për hamamin. E ai i thotë: “Ky është hamami”, duke sinjalizuar me gisht kah dera e shtëpisë së tij. Dera e shtëpisë së tij i ngjasonte derës së Hamamit.

Kur hyn brenda, ai ia mbyll derën. Kur ajo e kupton se është brenda shtëpisë së tij, e jo në hamam, dhe se ai e ka tradhtuar, paraqitet e lumtur dhe e gëzuar për takimin me të, duke u shtirë se e do një gjë të tillë. Duke e lajkatur për të shpëtuar prej kurthit të tij dhe prej frikës se mos po e torturon, i thotë: “Është mirë, para se të bëjmë dashuri, të kemi ambient të



bukur, prandaj shko e bli parfum dhe ushqim, e kthehu sa më shpejtë”. Ai i thotë: “Do të shkojë dhe do të sjell çka të dëshirosh, dhe del. Atë e lë në shtëpi dhe nuk e mbyll derën, sepse ai kishte besim te plotë tek ajo për dëshirën e saj për të çuar dashuri me të. Shkoi dhe bleu çka ishte e nevojshme dhe kthehet në shtëpi, mirëpo e sheh se ajo veç më kishte shkuar. Ky njeri aq ishte pasionuar në të saqë vazhdimisht e kujtonte dhe shkante si i çmendur nëpër rrugë duke recituar vargjet: “*U lodha duke pritur ditën, kur ajo ndoshta vjen prapë, e më pyet: “Ku është rruga për te Hamami Munxhab.”*”

Kur ai i thoshte këto vargje, ajo gruaja në heshtje i thoshte vargjet e saj: “A mos hezitove dhe atë e përvetësove, që në shtëpi nuk e ruajte, e as derën nuk ia mbylle”.

Pasionet shtoheshin dhe kjo shtëpi veç e kishte marrë emrin “*Ku është rruga e Hamamit Munxhab*”.

E kjo ka qenë fjala e fundit e jetës së tij. Dhe çdo herë kur i thuhej: “Thuaj: ‘La ilahe il-lallah’”, ai recitonte këto vargje!

Shikoni se si ky mëkat e ka penguar dhe e ka bllokuar të mos e deklarojë shahadetin para vdekjes, edhe pse nuk ka qenë asgjë tjetër, pos atë që e ka shti në shtëpinë e tij.

## **[9] – PENDIMI I RREJSHËM**

Më ka treguar Mensur bin Amari, i cili ka thënë:

E kam pasur një shok me edukatë të keqe, i cili pastaj u pendua dhe e shihja duke bërë ibadet e duke u falur.

Pas një kohe nuk e kam parë, e më thanë se është i sëmurë. Shkova te shtëpia e tij dhe në derë doli vajza e tij, e cila më tha: “Kë po e kërkon?” I thashë: “Filanin ...”. Më dha leje dhe hyra.

Në mes të shtëpisë ishte i shtrirë në shtrat, fytyra iu kishte nxirë, sytë iu kishin zverdhur, e buzët iu kishin trashur. Unë, duke u frikësuar për të, i thashë:

- O vëllai im, thuaj *“La ilahe il-lall-llah”*. I hapi sytë dhe shikoi jorganin, me të cilin ishte mbuluar. I thashë për së dyti:

- O vëlla, thuaje shpesh fjalën *“La ilahe il-lall-llah”*. Pastaj i thashë për të tretën herë. I hapi sytë dhe më tha: - O vëlla Mensur, kjo fjalë është larguar prej meje. I thashë *“La havle ve la kuvete il-la bil-lahil alijil adhimë”*.

Pastaj i thashë: *“O vëllai im! Po ku është ai namazi, agjërimi dhe namazi yt i natës?!”* E ai më tha: *“Të gjitha ato nuk kanë qenë për Allahun, pendimi im ka qenë i rrejshëm. Ato i kam vepruar vetëm para njerëzve, që ata të thonë se unë po agjëroj dhe po falem; ndërsa kur kam qenë larg tyre e i vetmuar, kur e kam mbyllur derën dhe kam qenë pas perdeve, kam pirë alkool dhe kam bërë mëkate para Allahut. Kam vazhduar ashtu deri sa më ka kapluar sëmundja, e cila gati më shkatërroi. E i kam thënë kësaj bijës sime: - Më jep mus-hafin. E kam marrë mus-hafin dhe jam lutur:*

*“O Zoti im, për nder të Kur’anit fisnik, nëse më shëron unë nuk do të vazhdoj me mëkate asnjëherë!”*. E Zoti ma tejkaloi sëmundjen. E kur u shërova përsëri kam vazhduar me avazin e vjetër, në lojëra e dëfrime, e shejtani më bëri të harroj premtimin mes meje dhe Zotit tim. Kështu kam vazhduar një kohë. E pastaj prapë jam sëmurë rëndë me sëmundje të vdekjes. Pastaj i kam thënë familjes sime të më vendosin në mes të oborrit të shtëpisë, pastaj kam kërkuar mus-hafin, e kam lexuar, e kam ngritur lart dhe jam lutur:

*“O Zot, për nder të shenjtërisë së këtij mus-hafi fisnik, për nder të fjalës Tënde, më tejkaloi këtë vështirësi dhe më shëro!”*.

Zoti ma pranoi dhe më shëroi, mirëpo pastaj prapë vazhdova siç kam qenë më parë me lojë, zbavitje, dëfrim e mëkate, deri sa prapë më kaploi kjo sëmundje.

I kam thënë familjes të më vendosin në mes të oborrit të shtëpisë, siç po më sheh, pastaj kërkova mus-hafin për ta lexuar, mirëpo nuk munda t'i shoh shkronjat fare, atëherë kuptova se Allahu i Lartmadhëruar është i hidhëruar në mua dhe e kam ngritur kokën lart në qiell dhe jam lutur: “O Zoti im, për nder të këtij mus-hafi më tejkallo këtë sëmundje dhe më shëro, o Sundues i qiellit dhe i tokës!”. Pastaj kam dëgjuar sikur dikush më pëshpëriti në vesh:

***“Pendolesh për mëkate atëherë kur sëmuresh.***

***E kthehesh prapë në mëkate kur të shërohesh.***

***Prej sa e sa fatkeqësive ke shpëtuar.***

***A nuk kishe frikë se të vjen fundi i shpresave e ti duke qenë në mëkatet e tua të vazhdueshme?!”***

Thotë Mensur bin Amari: Për Zotin, porsa dola nga shtëpia e tij duke i kujtuar vargjet që m’i tha, dhe kam arritur te dera, kur thanë: “Ai vdiq!”

## **[10] – KARAKTERI I JEHUDËVE**

Tregon Vehbi bin Munbeli:

Isa a.s. del të shëtisë nëpër tokë, atë e shoqëron një jehudi. Ai i kishte dy bukë me vete, ndërsa Isa a.s. vetëm një. Isa a.s. i thotë jehudisë: “T’i bashkojmë ushqimet tona?” Po, - tha jehudija. Mirëpo, më vonë, kur e kuptoi se Isa a.s. e kishte vetëm një bukë, u pendua.

Isa a.s. u ngrit dhe filloi të falej.

Jehudia, i cili ishte bashkudhëtar, e ha njëren bukë.

Pasi që e përfundon Isa a.s. të falurit, fillojnë ta shtrojnë ushqimin në tryezë. Isa a.s. i thotë: “Ku është buka tjetër?”

- Jo, ka qenë (e kam pasur) vetëm një bukë.

Isa a.s. e ha njërën bukë, shoku i tij bukën tjetër dhe e vazhdojnë rrugën.

Gjatë rrugës ndalen nën hijen e një lisi. Isa a.s. i thotë: “Ta kalojmë natën dhe të flemë sonte nën këtë lis”. Jehudia pranoi. Dhe ranë në gjumë. Në mëngjes jehudia, kur u zgjua, ishte verbëruar. Isa a.s. i tha: “Çka mendon sikur të ta kthejë shikimin, a do të më falënderojë?” Po, - i tha jehudia. Atëherë Isa a.s. ia lëmoi sytë e tij dhe i erdhi shikimi. Atëherë Isa a.s. i tha: “Pashë Atë që ta ktheu shikimin! A e ke pasur edhe një bukë? Jahudia i përgjigjet: - Beto hem në Zotin se e kam pasur vetëm një bukë. Isa a.s. hesht. Duke udhëtuar e sheh një Dhabij (kaproll) duke kullotur. Isa a.s. e thërret, e ai vjen. E prenë, e përgatisin dhe e hanë. Pastaj Isa a.s. i thotë kaprollit: “Me emrin e Allahut ngjallu!”. Dhe kaprolli ngjallet. Atëherë ai thotë: “Subëhanallah!”. Isa a.s. i thotë: “Pashë këtë argument që po e sheh! Kush e hëngri bukën e tretë. Ai u përgjigj se nuk ka qenë, pos një bukë! Vazhdojnë rrugën dhe gjatë rrugës nevojitej të kalohet një lumë i madh, i cili nuk e kishte urën. Isa a.s. e merr për dore jehudinë dhe e kalon lumin pa u lagur. Atëherë ai thotë: “Subhanallah!” Isa a.s. i thotë: “Pash këtë argument që po e sheh, kush e hëngri bukën e tretë?” Ai thotë: “Për Zotin nuk ka qenë, pos një bukë”. Vazhdojnë rrugën, derisa arrijnë në një fshat të madh, ku në periferi të atij fshati i gjejnë tre topa të mëdhenj të mbushur me ar. Isa a.s. tha: “Një top ari më takon mua, një ty dhe një i takon atij, i cili e ka ngrënë bukën e tretë. Atëherë jehudia thotë: “Po unë e kam ngrënë bukën e tretë derisa ti flije”. Isa a.s. i thotë: “Po t’i jap që të tre topat e arit”, dhe largohet e ndahet prej tij. Pasi që topat e arit ishin të rëndë, ai nuk mundi t’i barte. Aty pranë kalojnë tre njerëz dhe e mbytin

atë, dhe ia marrin topat e arit. Dy prej tyre i thonë të tretit: “Shko në qytet dhe na sill ushqim”. Ai u nis për në qytet. Ata dy që mbetën merren vesh, që kur ai të kthehet, ta mbysin dhe t’ia marrin arin. Ai, i cili kishte shkuar të merrte ushqim në qytet thotë në vetvete: “Ushqimin do ta helmoj dhe do t’i mbys që të dy, kështu do t’i marr që të tre topat e arit”. Dhe ashtu veproi, siç e kishte mësuar shejtani.

Kur u kthye me ushqim të helmuar, ata e hanë pasi që e mbysin, ndërsa, pastaj, edhe vetë vdesin pranë topave të arit. Isa a.s. shkon aty dhe kur i sheh që të katërt të mbytur pranë arit. Sinjalizoi me gisht dhe iu tha havarijunëve, të cilët ishin me të: “Kështu lakmia e kësaj bote ju bën juve, andaj kini kujdes dhe ruajuni!”.

## [11] - DITA E PENDIMTARËVE

Xhamia, edhe pse ishte e madhe, u ngushtua për së tepërmi prej muslimanëve, të cilët i kishin drejtuar sytë te dijetari i tyre me famë - Malik bin Dinari. Ai u ul në vendin e tij, për një moment heshti, e pastaj e ngriti kokën, kur pa turmën e madhe të njerëzve, sa që më herët as që kishte parë një turmë të tillë, duke dëgjuar fikihun e Irakut dhe ligjëruesin e xhamisë së Kufes. Sytë iu kishin përlotur. Lotët i kishin arritur deri në mjekër, kur e pa atë turmë, e cila kishte ardhur sot për ta dëgjuar, pasi që një ditë më pare iu kishte lajmëruar për një çështje, të cilën kurrë nuk e kishin dëgjuar më parë, dhe ishte mirë që ta dëgjonin.

Imam Maliku fillon ligjëratën, ndërsa zëri i tij depërtonte thellë në zemrat e dëgjuesve dhe të dashurve të tij, sa që mendonin se zëri është duke iu ardhur nga një largësi e madhe. Ai e falënderoi Allahun, dërgoi salavate për Pejgamberin s.a.v.s., pastaj i ftoi dëgjuesit dhe xhematin për *mirësi dhe falje*

*gabimesh*, sepse ata kanë mendim të mirë, dhe tha: “Dje ju kam thënë se sot do t’ju tregoj, me lejen e Allahut, për robin e varfër të Allahu i Lartmadhëruar, të cilin e dëgjoni, pra për veten time - Malikun. Unë di për veten time atë që ju nuk e dini, ndërsa ju keni mendim të mirë ndaj meje. Zoti jua shpërbleftë me të mira.

Unë si i ri kam qen polic kriminel, detyra ime ka qenë mbajtës i rendit në treg, dhe askush nuk ka mundur t’i ikë padrejtësisë sime, askush nuk ka shpëtuar pa e rrahur; sa e sa njerëz i kam keqpërdor, i kam maltretuar. Zoti më faltë! Dhe sa herë që i kujtoj, zemra më këputet, shpirti më dobësohet dhe po të mos kisha besim te mëshira e Allahut, do të isha tjetër njeri.

O vëllezër të mi, nuk ka të keqe që nuk e kam pas bërë. Kam pirë alkool, i kam maltretuar njerëzit, kam hyrë në punët e brendshme të tyre, edhe në shit-blerje; i kam ndihmuar edhe të padrejtët, vetëm pse kam dashur të tregoj se unë mund të bëj çka të dua.

Një dit prej ditësh isha në treg, kur i pash dy njerëz që nuk pajtoheshin për një çështje: njëri ishte shitësi, e tjetri ishte blerësi. Shitësi e donte çmimin e caktuar, blerësi dëshironte ta blinte me çmim më të ulët. I bërtita blerësit, dëshirova t’i bija me shkop, deri sa diçka më pengoi. E çka ishte nuk e di, dhe u shmanga anash, kur pashë një njeri plak e të thinjur. Në fytyrën e tij shiheshin shenja të një njeriu të mirë, i cili ma tërhoqi vërejtjen me dorë, se para se të gjykoj, të mendoj mirë, dhe ma tregoi mënyrën e zgjedhjes së problemit. Kjo ishte hera e parë në jetën time që të hesht kur dikush tjetër flet. Ai e përfundoi bisedën me një hadithë të të Dërguarit të Allahut s.a.v.s., i cili ka thënë:

***“Kur ndokush nga ju shkon në treg dhe blen gjëra për t’i gëzuar bijat e tij, Zoti e shikon me mirësi atë njeri”.*** Prandaj unë jam duke u kthyer nga një udhëtim dhe dëshirova që para se të shkoj në shtëpinë time të blej diçka e t’i gëzoj tri bijat e mija,

e që Allahu të më shikojë me mirësi. - Tregon Maliku: Biseda e tij më impresionoi dhe ia bleva gjërat që dëshironte ai dhe ia dhashë, njëherazi e porosita që vajzat e tij të luten për mua.

Kaluan ditë e ditë dhe biseda e tij zhurmonte në veshin tim, deri sa e pashë një robëreshë të bukur, e cila shitej në treg. Ajo më hyri në zemër, u dashurova në të, për këtë arsye e bleva dhe u martova me të. Pastaj me të kalova jetë të lumtur, pasi që ajo ishte bashkëshorte ideale, fillova të jem i devotshëm. Allahu më fali një vajzë të bukur, ndërsa, disa ditë pas lindjes së vajzës, gruaja ime (nëna e saj) vdiq, dhe vajza mbeti jetime. Disa vite jetova me të e nuk u martova, dhe nuk interesohesha për asgjë tjetër, pos që të përkujdesesha për bijën time, e cila ishte gjithçka në jetën time.

Një ditë, deri sa po kthehesha nga puna, pash se bija ime ndiente dhimbje e vuajtje, dhe fillova të kërkoja shërim te mjekët. Mirëpo, ishte caktim i Zotit që ajo të vdesë në gjoksin tim. E kam marrë dhe e kam shtrënguar në gjoksin tim, me shpresë se do të mbijetoj; e laga me lotët e mi dhe u luta për të, me frikë e me pikëllim dhe çështjen time përfundimisht ia lashë Allahut. E varrosa me duart e mia. Fillova të ikën nga vetvetja ime, jeta ime, realiteti im dhe fillova prapë me alkool të dehem, e ta mbizotëroj pikëllimin tim. E ndieja veten se nuk më ka mbetur asgjë dhe se çdo kush më ka fyer, andaj fillova t'i urreja njerëzit, sillesha ashpër me ta si hakmarrje ndaj tyre, thua se ata ma kanë grabitur gruan, vajzën time dhe ma kanë marrë lumturinë e jetës sime.

Deri sa një ditë kontrolloja tregun, e pashë një grua me ushqim në dorë, e dhunova aty për aty dhe as që mërzhitesha se pse qante e bërtiste, e as pse kishte fëmijë të vegjël. Atë natë shkova herët në mbrëmje dhe ishte mesi i muajit Shaban. Kam rënë në një gjumë të thellë, dhe deri sa isha në gjumë pashë një ëndërr, sikurse ndodhi Kijamet. *Iu fry surit*, u tubuan të gjitha krijesat dhe unë gjendesha në mesin e tyre. Pastaj dëgjova një zë

trishtues, u ktheva në drejtim të atij zëri, kur pashë një gjarpër të madh e të zi, me gojë të hapur, i cili frynte flakë, me sy trishtues dhe më sulmoi me ashpërsi. Ika prej tij me të katërtat nga frika, sa që arrita te një plak i dobët dhe i thashë: “Më mbroj nga ky gjarpër, Zoti të mbroj edhe ty! Ai qajti dhe më tha: “Vrapo, ik, ndoshta Allahu të gjen zgjidhje e të shpëton.” Vrapova me të shpejtë deri sa arrita në maje të kodrës, ishte fundi i Ditës e Kijamett dhe gati sa nuk më zuri, dhe thirri me një zë duke thënë: “Kthehu se nuk e ke vendin këtu.” U ktheva nga aty prej frikës se mos më zë gjarpri dhe përsëri shkova te ai plaku dhe kërkova mëshirë dhe mbrojtje prej tij. E ai u arsyetua se është i dobët dhe nuk mund të më ndihmojë. Pastaj më tha: “Shko te ajo kodër, sepse aty janë fëmijët e muslimanëve. Nëse ke aty ndonjë fëmijë do të të ndihmojë”. Shikova në kodër, e cila shkëlqente prej argjendit, ndërsa perdet ishin të varura në çdo anë, të cilat ishin prej arit. Çdo perde ishte prej mëndafshi, e cila t’i merrte sytë dhe vrapova në atë drejtim. Ndërsa gjarpri më vinte pas, kur u afrova në atë vend, një melaqe tha: “Ngritni perdet dhe hapni dyert”. Pastaj pashë fëmijët si yje, ndërsa gjarpri mu afrova dhe më kërkonte mua. Disa fëmijë thanë, ngrituni që të gjithë së bashku se është afruar armiku, dhe filluan të vijnë fëmijët grupe-grupe, e në mesin e tyre ishte vajza ime, e cila më kishte vdekur e vogël. E shikova atë, e ajo qajti dhe tha: “Për Zotin, babai im! Pastaj mu mbështet në krah si shigjetë dhe e zgjati dorën e saj të majtë në krahun tim të djathtë dhe u mbështet në mua, ndërsa me dorën e saj të djathtë e largoi gjarpurin nga unë. Pastaj më uli, deri sa unë isha i lodhur e i rraskapitur, më përqafoi përzemërsisht, ndërsa mua lotët më shkonin për toke nga frika se mos do ta humbi edhe një herë. E zgjati dorën te mjekra ime dhe lozte me mua dhe më shikoi me dy sytë e saj të bukur dhe me ledhatim e dashuri, si dhe me mirësi e me sinqeritet më tha (ajetin kur’anor):



**“A nuk ka ardhur koha për besimtarët, që t’i zbutin zemrat e tyre me përkujtim ndaj Allahut, dhe me atë që e ka zbritur me të vërtetë”.**

Kur dëgjova këtë ajet fillova të qaja pandërprerë, dhe thuaja se për të parën herë e dëgjoja. E pyeta atë: Ju e dini Kuranin? Ajo mu përgjigj: “Më mirë se ju”. E pyeta: “Më trego çka ishte ai gjarpër, i cili donte të më gëlltiste?” Ajo mu përgjigj: “Ai është vepra jote e keqe, të cilën e ke zmadhuar dhe është ngritur kundër teje dhe dëshiron të të shpie në xhehenem”. Pastaj e pyeta: “Po ai plaku, kush ishte?” Mu përgjigj: “Ai është puna jote e mirë, të cilën aq shumë e ke dobësuar dhe nuk mundi të të ndihmonte. Unë i thashë: “Oj bija ime, po çka bëni në këtë kodër?” Më tha: “Këtu janë të vendosur fëmijët e muslimanëve, që të qëndrojnë deri në Ditën e Kijametit, ju presim që kur të vini, të ndërmetësojmë për ju”.

U tmerrova nga trishtimi dhe u zgjova nga gjumi. Isha bërë ujë nga djersitja, thuaj se kishte rënë shi mbi mua. E mora një thupër, i theva gotat e alkoolit dhe u pendova singerisht dhe me zemër te Allahu. Dhe disa ditë mbeta në shtrat. Nuk mund të lëvizja, dhe kësaj radhe kërkova falje prej Allahut. U pendova dhe kërkova mëshirë nga ai. Dhe që nga ajo ditë vendosa singerisht ta trasoj rrugën e Allahut, dhe në ditët e para e adhuroja Allahun dhe pendohesha vazhdimisht. Më dukej se në çdo moment do të më dalë gjarpri dhe do të më gëlltisë.

Në atë gjendje përplot frikë e trishtim jam izoluar nga njerëzit, dhe isha në një fazë kritike. Mirëpo atë vit ishte një thatësi e madhe, nuk binte shi. Edhe pse falmim namaz për shi, shiu nuk binte. Bimët u thanë, ishte uri e madhe. Një ditë mbeta i vetëm në xhami, dhe pasi të gjithë shkuan, iu luta Allahut. Kur papritmas hyri në xhami një njeri me këmbë të holla, bark të madh dhe e ngrit kokën lartë në qiell, dhe iu lut Allahut: “O Zoti im, deri kur robërve të tu nuk ua pranon lutjen, *për deri sa Ti je Ai që nëse jep, nuk pakësohet asgjë te ti?!*” Të përбетohem Ty,

me dashurinë Tënde ndaj meje, na zbrit shi tani, dhe posa e përfundoi lutjen filloi të binte shi me të madhe. Ai njeri deshi të dalë nga xhamia, e unë shkova e i thashë: “A nuk po ke turp të thuash: ‘Për dashurin Tënde ndaj meje, po ku e di ti se Allahu të do?!’”.

Ai mu përgjigj: “O ti, shiko punën tënde, po ku ke qenë ti kur Allahu më ka zgjedhur për ta adhuruar vetëm Atë, a nuk po e sheh që për dashurin e Tij për mua tani po bie ky shi. A nuk e di ti se Allahu është Falës i Madh dhe i do robërit e tij. A nuk e ke dëgjuar fjalën e Zotit të Lartmadhëruar: **“Ai (Allahu) është, i Cili ju jep të mira juve dhe melaqet e tija, për t’iu nxjerrë juve nga errësira në dritë. Ai është i mëshirshëm ndaj robërve të Tij”**. Ai shkoi e unë mbeta i habitur, dhe prej atij momenti unë i lutem Allahut pa e ndier frikën e atij gjarpri.

Për një çast Malik bin Dinari heshti, pastaj me forcë dhe përkushtim tha: “O ju njerëz, vërtet Allahu është i mëshirshëm, përgëzohuni me mëshirën e tij, dhe përgëzoni të tjerët se Allahu ju do juve. Ah sikur ta dini, ah sikur ta dinit nuk do të bënit mëkate. O ju njerëz, a e doni Allahun? Atëherë ta dini se prej shenjave të dashurisë së Allahut është përkujtimi ndaj tij, sepse ai, i cili e do dikë, e kujton shpesh. Dhe kush nuk bisedon me Allahun dhe nuk i lidh raportet Allah-krijesë ai nuk ka dituri, dhe jeta e tij është e pavlefshme.

Pendohuni te Allahu o ju njerëz! U ngrit Maliku në këmbë, atëherë edhe tjerët u ngritën në këmbë, duke u penduar te Allahu me pendim të sinqertë. Kështu ajo ditë u quajt *Dita e Pendimit*.

## **[12] - XHIBRILI DHE MEKAILI**

Semrete bin Xhendeb transmeton: i Dërguari i Allahut s.a.v.s. kur e falte namazin, kthehej në drejtim tonin dhe na thoshte: “Kush prej jush sonte ka parë ndonjë ëndërr?” Pastaj, nëse ndonjëri prej nesh kishte parë e tregonte, e Muhamedi s.a.v.s. thoshte: “Mashallah”. Një ditë na pyeti: “A ka parë ndonjëri prej jush ëndërr?”.

(Pasi që askush nuk tregoi, Pejgamberi a.s. rrëfen) Mbrëmë në ëndërr erdhën tek unë dy njerëz. Më morën për dore dhe më dërguan te vendi (toka) e shenjtë. Aty pashë një njeri ulur dhe një njeri tjetër në këmbë, i cili kishte shufër hekuri, ia fuste shufrat prej faqes e i arrinte deri në kafkë, kështu vepronte pa ndërprerë. Pasi që koka i qahej, i formohej përsëri dhe përsëri i veprohej ashtu. Pyeta: “Çka është kjo?” Më thanë: “Vazhdo”.

Pastaj vazhduam deri sa arritëm te një njeri i shtrirë me kokë për toke, dhe një njeri tjetër në këmbë, i cili ia troshiste kokën me gur. Pra, sa herë që i binte, koka i troshitej. (Guri rrokullisej) Ai shkonte për ta marrë, deri sa ai shkonte për ta marrë gurin, koka e tij riformohej, e ai kthehej dhe përsëri i binte. Pyeta: “Çka është kjo?” Më thanë: “Vazhdo”.

Vazhduam derisa kemi arritur në një vend ku ishte një gropë e thellë, e cila në krye ishte e ngushte, në thellësi e gjerë, ndërsa nën të një zjarr i ndezur. Ndërsa në atë gropë, si kazan, përvëloheshin burra dhe gra të zhveshura. Kur ata ziheshin e shkrumboheshin, prapë riktheheshin në format e tyre. Pyeta: “Ç’është kjo?” Më thanë: “Vazhdo tutje”. Vazhduam deri sa arritëm në një lumë gjaku, ku qëndronte një njeri, ndërsa në mes një njeri tjetër, i cili para vete kishte gurë. Dhe ai njeriu tjetër, sa herë që dëshironte të dilte nga lumi, njeriu në mes e gjuante me gurë në buzët e tij, dhe e kthente ku ka qenë dhe çdo here që tentonte të dilte, ai i binte me gurë në buzë dhe e kthente në

pozitën e tij të mëparshëm. Pyeta: “Ç’është kjo?” Më thanë: “Vazhdo tutje”. Vazhduam derisa arritëm në një kopsht të gjelbër, në mesin e të cilit ishte një lis i madh, në rrënjë të lisit një plak dhe fëmijë përreth. Afër atij lisi ishte njëri, i cili kishte në dorë mjet e zjarr dhe e ndizte zjarrin. Më hipën lart në lis më futën në një *qytet të bukur*, aq i bukur, sa kurrë më parë nuk kisha parë, në të cilën shtëpi kishte pleq e të rinj. Pastaj më hipën edhe më lart dhe më futën në një shtëpi, e cila ishte edhe më e mirë. U thashë atyre: “Sonte më shëtitët, a më lajmëroni çka kam parë?” Ata më thanë: “Po”.

Atij që i qahej koka, ai është njeriu gënjeshtar, i cili ka folur gënjeshtër, dhe iu është qarë koka, dhe vazhdimisht do t’i qahet deri në Ditën e Kijametit.

Atij, të cilit i troshitej koka, është njeriu, të cilit Allahu ia ka mësuar Kuranin, e ai natën ka fjetur, e nuk ka punuar me të, ashtu do të veprohet me të deri në ditën e Kijametit.

Ato, të cilët i ke parë në gropë janë prostitutat, ndërsa ai, i cili ka qenë në lumin me gjak është shfrytëzuesi i kamatës. Plaku në rrënjë të lisit është Ibrahimimi, ndërsa fëmijët për rreth janë pasardhësit e tij të njerëzimit. Ai, i cili e ndizte zjarrin është roja e xhehenemit; shtëpia e parë është shtëpia e besimtarëve, ndërsa kjo shtëpi është shtëpia e dëshmorëve; ndërsa unë jam Xhibrili e ky Mikjaili. Ngrite kokën. Kur e ngrita kokën, kur pash një kështjellë të lartë sa retë. Kjo tha është shtëpia jote. I thash: “Më lejo të hyjë në të”. Më tha: “Ke ende jetë për të jetuar, pasi të të përfundojë jeta në botën tënde do të hysh në shtëpinë tënde”.

## **[13] – TREGIMI I PENDIMTARIT, I CILI I KA MBYTUR 100 NJERËZ**

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: “Para jush ka qenë një njeri, i cili i ka mbytur nëntëdhjetë e nëntë njerëz. Ai pyet më të diturin e atij vendi për mëkatin e tij, e ai e shpie te një mistik. Shkon te mistiku, e i thotë: “Kam vrarë nëntëdhjetë e nëntë njerëz, a ka shpresë që të më pranohet pendimi?” Ai i përgjigjet: “Jo”. Nga mllefi e mbyt edhe këtë dhe i bën njëqind. Pastaj pyet: “Cili është dietari më i njohur në botë?” Ia tregojnë dietarin më të njohur. Shkon te ai dhe i thotë: “Kam vrarë njëqind njerëz. A kam shpresë që të pendohem e të më pranohet pendimi?” Ai i përgjigjet: “Po”. Pastaj i thotë: “Ajo çka është pengesë mes teje dhe pendimit është se ti duhet të shkosh në një vend, sepse në atë vend ka njerëz, të cilët e adhurojnë Allahun. Edhe ti adhuroje së bashku me ta dhe mos u kthe më në vendin tënd, sepse është vend i keq”. Kështu që nisët për të shkuar në atë vend. Kur arrin në mes të rrugës e takon vdekja. Atëherë bisedojnë Meleku i mëshirës me Melekun e dënimit. Meleku i mëshirës thotë: “Ka ardhur i penduar, me zemër të orientuar te Allahu i Lartmadhëruar”. Meleku i dënimit thotë: “Ai kurrë nuk ka bërë ndonjëherë ndonjë punë të mirë”. Një melek në formë njeriu u afrohet atyre. Atëherë vendosin që ai të gjykojë me drejtësi. Ai u thotë: “Mateni gjatësinë në mes dy vendeve dhe shikoni se nga cili vend vendvdekja e tij është më afër”. Kur e masin gjatësinë shohin se ai është më afër vendit, për të cilin ishte nisur. Për këtë arsye e merr me vete meleku i mëshirës”.

*(Muttefekun alejhi)*

Në një rivajet tjetër, i cili po ashtu është sahihë thuhet:

“Ka qenë më afër se vendi i mirë për një pëllëmbë, kështu që e regjistroi në mesin e banoreëve të tyre.

Në një rivajet tjetër sahihë thuhet se Allahu i Lartmadhëruar e ka frymëzuar që të afrohet te vendbanimi i të mirëve dhe të largohet nga vendbanimi i keq dhe ka thënë: Mateni gjatësinë në mes dy vendeve dhe kur e matën, e panë se ishte për një pëllëmbë më afër vendbanimit të të mirëve dhe e fali.

### **Nga hadithi përfitohet:**

1. Adhuresi pa dituri e dëmton veten dhe të tjerët;
2. Pranimi i pendimit të vrasësit me qëllim. Ky është medhhebi i shumicës absolute të dijetarëve. Dhe kjo është e ligjësuar, sepse Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: **“Dhe ata, të cilët nuk i bëjnë shok Allahut dhe nuk i lutën të tjerëve përpos Allahut dhe nuk vrasin”**, deri te pjesa e ajteit **“përpos atyre, të cilët pendohen”**. Ndërsa sa i përket ajteti **“Dhe ai, i cili e vret besimtarin me qëllim, dënimi i tij është xhehenemi ku gjithmonë do të jetë në të”**, ka kuptimin se dënimi i tij është xhehenemi, ndërsa prej xhehenemit mund të shpëtojë, e shpëtimi i tij mund të bëhet me formë tjetër kur Allahu e fal.
3. Ndërprerja e raporteve shoqërore me shokët e këqij, përderisa vazhdojnë të jenë të këqij dhe shoqërimi me të mirët, sepse përfitohet prej tyre.
4. Gjykimi ndaj të ngatërruarve dhe sqarimi i çështjeve për të mos u thelluar armiqësia në mes tyre.
5. Mëkatet, sa do të mëdha të jenë, mëshira dhe falja e Zotit është edhe më e madhe, nëse njeriu pendohet sinqerisht.

## [14] - DUAJA NË BAZË TË PUNËVE TË MIRA

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Prej gjeneratave para jush, tre persona janë nisur për një udhëtim, deri sa i zë nata para një shpelle, në të cilën vendosen për ta kaluar natën. Nga kodra rrokulliset një shkëmb dhe e bllokoi tërësisht hyrjen dhe daljen e shpellës. (Ata duke biseduar mes vete) thonë: Ne nuk mund të shpëtojmë gjallë nga kjo shpellë ndryshe, vetëm se duke i bërë lutje Allahut të Lartmadhëruar, në bazë të punëve tona të mira.

**Personi i parë** prej tyre lutet: “O Zoti im! I kam pasur prindërit shume pleq dhe asnjëherë ujë nuk kam pirë para tyre, as nuk i kam dhënë familjes sime, po edhe punëtorëve të mi. Një ditë u vonova për shkak të kërkimit të kullës sa më të mirë, e kur u ktheva ata veç kishin fjetur. Pasi e mola bagëtinë, qumështin ua dërgova para tyre, por ata ishin fjetur. Unë nuk desha t’ua prish gjumin atyre, por edhe nuk e kam pirë qumështin para tyre, e as nuk i dhashë të pinë familjes dhe punëtorëve të mi. Qëndrova në këmbë zgjuar me qumështin në dorë, duke i pritur deri sa të zgjoheshin. (Kështu prita) përderisa agoi dita, e fëmijët e mi qanin për qumësht para këmbëve të mia, e unë u dhashë të pinë qumësht, tek atëherë, pasi u zgjuan prindërit e mi dhe pinë para tyre. O Zoti im! Nëse këtë e kam bërë vetëm për të fituar kënaqësinë Tënde, na tejkalo këtë fatkeqësi, dhe lëvizte këtë shkëmb ( e të dalim në dritë)!” Shkëmbi lëvizti, por jo edhe aq sa mund të dilnin jashtë.

**I dyti u lut:** “O Zoti im, kam pasur një kushërirë të afërm, të cilën e kam dashur më shumë se tërë botën (në një transmetim tjetër: Kam qenë aq fortë i dashuruar në të, ashtu siç

*i donë së tepërmi burrat gratë*), andaj kërkova prej saj (siç kërkojnë meshkujt prej femrave), por ajo më refuzoi. Një vit prej viteve mbretëronte uri e madhe, e ajo u paraqit tek unë. E unë ia dhashë asaj 120 dinarë ari, me qëllim që të pranojë të vetmohej me mua. Pasi i mori të hollat dhe e kisha në disponim (që të veproj me të çka të dua), ajo më tha: “Frikësoju Allahut, e mos ma prish virgjërinë padrejtësisht!”. Atëherë u largova prej saj dhe nuk kontaktova me të, edhe pse e doja më shume se çdokënd tjetër, kurse të hollat, të cilat ia pata dhënë, nuk ia mora. O Zoti im, nëse këtë e kam bërë vetëm për ta fituar *Kënaqësinë tënde*, na shpëto nga kjo vështirësi, në të cilën gjendemi.” Shkëmbi prapë lëvizti (nga hyrja e shpellës), por jo në tërësi për të dalë nga aty.

**Personi i tretë** u lut: “O Zoti im, unë kam pasur punëtorë dhe të gjithëve ua kam dhënë pagën e fitimit menjëherë, përpos një punëtori, i cili ka shkuar pa e marrë pagën (e fundit). Pastaj pagën e tij e kam vendosur në qarkullim dhe pasuria e tij u shtua. Pas një kohë me erdhi e më tha : “O rob i Allahut, më jep pagën!” I thashë: “Krejt çka sheh prej kësaj pasurie, si: këto dele, këto lopë, këto deve dhe ky rob, të gjithë janë shtuar prej pagës tënde.” Ai më tha: “O rob i Allahut, mos u tall me mua!” Unë i thashë: “Nuk jam duke u tallur me ty.” Pastaj e mori tërë pasurinë e tij dhe nuk la asgjë prej tyre. “O Zot im, këtë e kam bërë vetëm e vetëm për ta fituar kënaqësinë Tënde; na shpëto nga kjo fatkeqësi!” Atëherë shkëmbi lëvizti i tëri, dhe që të tre dolën nga aty e shpëtuan.

(BUHARI DHE MUSLIMI)



## [15] – AS-HABUL UHDUD

Transmeton Suhejbi se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: “Para jush ka qenë një mbret, i cili e kishte një magjistar. Kur magjistari e arrin pleqërinë, i thotë mbretit: ‘Vërtet unë jam tepër në moshë, jam plakur shumë, andaj më dërgo një djalosh (të ushtrisë tënde) që t’ia mësoj magjinë’. Ai ia dërgon një djalosh për t’ia mësuar magjinë.

Djaloshi kur shkante te magjistari, në mes të rrugës, e takon një mistik. Ulet pranë tij, bisedon për pak kohë dhe i pëlqejnë fjalët e tij. Kështu që ai e bën rregull, që çdo herë kur të shkojë te magjistari, të ndalet te mistiku. Kështu që ai vazhdimisht vonohej. Kur shkante i vonuar te magjistari, magjistari e rrihte. Ai ankohet te mistiku. Mistiku i thotë, pasi që frikësohesh se do të të rrahë magjistari, thuaj atij se më ka vonuar familja ime, e nëse frikësohesh prej familjes tënde, thuaj se më ka vonuar magjistari.

Derisa ai vazhdonte mësimin, një shtazë e madhe i kishte bllokuar njerëzit. Ai thotë: ‘Sot do ta kuptoj se a më i vlefshëm është mistiku apo magjistari!’ E merr një gur dhe thotë: ‘O Zoti im, nëse veprimet dhe qëllimet e mistikut janë më të mira dhe më të dashura tek Ti se të magjistarit, mbyte këtë shtazë prej duarve të mia dhe le të lirohen njerëzit’. E gjuan gurin dhe shtaza mbytet dhe njerëzit lirohen.

Pas kësaj ngjarjeje shkon te mistiku dhe ia tregon ngjarjen. Mistiku i thotë: ‘O djalosh, prej tani e tutje ti je më i vlefshëm dhe më i ditur se unë’. Por, unë kam një ndjenjë për ty se ti do të sprovohesh me një sprovë të madhe. E nëse sprovohesh mos më trego’. Djaloshi i shëronte njerëzit me lloje të barnave të ndryshme prej sëmundjeve, siç ishin: lepra, verbëria dhe prej çdo sëmundjeje tjetër. Një shok i mbretit ishte verbëruar.

I verbëti kishte marrë shumë e shumë shpërblime dhe i thotë djaloshtit: ‘Të gjitha këto shpërblime janë për ty, vetëm e vetëm nëse më shëron dhe të më kthehet shikimi’. Djaloshi i thotë: ‘Unë nuk e shëroj askënd, por Zoti është Ai, i Cili shëron. Nëse ti beson në Zotin dhe i lutesh Atij, Allahu do të të shërojë’. Ai besoi në Zotin dhe Allahu e shëroi.

Ai shkon te mbreti ulet pranë tij, e mbreti e pyet: ‘Kush të shëroi dhe t’u rikthye shikimi?!’ - Ai i përgjigjet: ‘Zoti im!!’ - Mbreti i thotë: ‘A ka zot tjetër pos meje?!’ – Ai i përgjigjet: ‘Zoti im dhe i yti është Allahu’. Mbreti e urdhëron parinë e tij për ta dënuar dhe maltretuar, derisa detyrohet të tregojë për djaloshin. Shkojnë dhe e marrin djaloshin, e sjellin para mbretit, dhe mbreti i thotë:

‘O djalosh, ti ke arritur në shkallë të lartë të aftësisë si magjisttar, sa që po i shëron të verbrit dhe të zgjebosurit, dhe shëron e shëron ...’.

- Djaloshi i thotë: “Unë nuk e shëroj askënd, por Allahu shëron”. Pastaj mbreti e prangosë dhe e dënon, e maltreton, derisa i tregon për mistikun. Shkojnë dhe e sjellin mistikun para mbretit dhe mbreti i thotë: “Largohu nga feja jote dhe kthehu në fenë tënde të mëparshme, idhujtar”. Ai refuzon. Mbreti urdhëron të marrin një sharrë dhe ia aktivizojnë sharrën në qafë, dhe e ndajnë në dysh. Pastaj e marrin ish shokun e mbretit dhe i thonë: “Largohu nga feja jote dhe kthehu në fenë tonë”. Ai refuzon. Ia vendosin sharrën në qafë, kështu që edhe atë e ndajnë në dysh. Pastaj e marrin djaloshin dhe i thonë: “Largoju nga feja jote”. Ai refuzon. Mbreti u thotë disa shokëve: “Merreni dhe dërgojeni në një kodrinë të lartë, dhe nëse largohet nga feja e tij kthejeni të shpëtuar, e nëse jo, hidheni”. Kur arrin në lartësinë më të madhe, ai thotë: “O Zoti im! Vepro si të duash!”. E hodhën prej lartësisë më të madhe të kepit, ndërsa ai pa kurrfarë lëndimi, në këmbët e tij shkon te mbreti. Mbreti i

thotë: “Si kanë vepruar shokët?” - Ai i thotë: “Më ka mjaftuar Allahu, i Cili më ka shpëtuar”. Pastaj u thotë disa të tjerëve: “Merreni, hipeni me një anije dhe kur të arrini në mes të detit pyeteni, - nëse largohet prej fesë së tij kthejeni, e nëse jo, hidheni në det”. Ata shkuan. Ai prapë (para se të hidhej në det) thotë: “O Zoti im, vepro si të duash!”. E hedhin prej anijes për ta fundosur. Ai në këmbët e tij, pa kurrfarë lëndimi shkon te mbreti, ndërsa mbreti i thotë: “Si kanë vepruar shokët e tu me ty?” - Ai i përgjigjet: “Më ka mjaftuar Allahu”. - Djaloshi i thotë mbretit: “Ti nuk mund të më mbytësh, derisa të veprosh çka të urdhëroj unë”. – Mbreti i thotë: “Po çka është ajo?” – Djaloshi i thotë: “T’i tubosh njerëzit në një vend, të më kryqëzosh, të më lidhësh për një lis, pastaj ta marrësh një shtizë, ta vendosësh në hark, e pastaj ta tërheqësh shtizën duke thënë: “Në emër të Allahut, i Cili është Zot i djaloshit”, pastaj të gjuash. Nëse vepron kështu, ke për të më mbytur”.

Mbreti i tuboi njerëzit në një vend dhe e lidhi djaloshin për një trup të një lisi, e mori shtizën, e vendosi në hark dhe tha: “Në emër të Allahut, Zotit të djaloshit”, dhe e hodhi shtizën. Shtiza i bie në kraharor, e ai e vendosi dorën në shtizë dhe vdiq.

Për këtë arsye njerëzit thanë: “Besojmë në Zotin e djaloshit! Besojmë në Zotin e djaloshit! Besojmë në Zotin e djaloshit!”

Shkojnë dhe i thonë mbretit: “A po e sheh çka po thonë? – “Prej Zotit po të tërhiqet vërejtja”. Njerëzit, populli veç ka besuar”. Mbreti urdhëroi të hapej një hendek dhe në mes të hendekut të ndizej një zjarr i madh, dhe thotë: “Kush nuk kthehet prej fesë së tij hidheni”, dhe ashtu ndodhi. Derisa i vjen radha një gruaje, e cila e kishte fëmijën e saj në gj. Asaj i vjen shumë vështirë për shkak të foshnjës së saj. Foshnja: I thotë nënës: “Oj nëna ime, duro se, nuk ka dyshim, ti je në rrugë të drejtë”.

*(Sahihul Muslim, 5327)*

## [16] - DËNIMI I TË PADREJTIT

Në një mëngjes, një peshkatar del të kërkojë furnizimin e tij hallall. E hedh shportën (rrjetën) dhe nuk zë asgjë. Ai filloi t'i lutet Allahut, se fëmijët e tij klithnin të uritur në shtëpinë e tij. Pak para se të perëndon dielli, Zoti ia mundëson atij që të zë një peshk të madh. E falënderon Allahun dhe i gëzuar e merr ta dërgojë në shtëpi. Rastësisht atë pasdite mbreti kishte dalë në shëtitje dhe e sheh atë se çka kishte zënë. I pëlqeu peshku i zënë dhe me të fortë ia merr, e pastaj shkon në kështjellën e tij. Ai dëshironte që ta gëzonte mbretëreshën, dhe ia tregon peshkun duke sjellë në të djathtë dhe në të majtë në dorën e tij, me ç'rast i hyn një therë dhe ia lëndon gishtin e tij. Nuk mundi të flinte i qetë atë natë, prandaj i ftoi mjekët. Ata i thanë se duhet të bëhet amputimi i gishtit. Edhe pas amputimit të gishtit, ai nuk mund të flinte i qetë, sepse helmi i kishte kaluar në dorën e tij. I ftoi mjekët dhe ata ia amputojnë edhe dorën. Mirëpo edhe pas kësaj nuk mund të flinte i qetë, por ndiente dhimbje edhe më të madhe, e klithte pandërprerë. Dhe prapë kërkon mjekim. I thonë së duhet të amputohet dora deri në bërryl. Pasi që u shërua nga dhembja trupore nuk ishte i qetë shpirtërisht dhe i dhembte zemra. Atëherë filloi ta kuptojë seriozitetin dhe shkakun e sëmundjes. E drejtuan të shkojë te mjeku i zemrës. Shkon dhe ia tregon atij rastin me peshkun. Mjeku i zemrës i thotë: “Nuk do të jesh i qetë, përderisa nuk ta falë peshkatarin”. Mbreti filloi të pyes se ku është peshkatarin, deri sa e takon atë. Filloi t'i ankohej dhe kërkon falje prej tij dhe peshkatarin ia fali, e ai u shërua. Mbreti tha: “A ke mundësi të më tregosh çfarë lutje (ankese) ke bërë kundër meje?” Peshkatarin i thotë: “Nuk kam thënë asgjë, pos një fjalie, e ajo ka qenë: ‘O Zoti im! Ai e tregoi forcën e tij ndaj meje. Të lutem tregoj edhe Ti forcën Tënde, e le ta shohë’”.

## [17] - TREGIMI i UVEJS KARENIJUT

Muhamed s.a.v.s. ka treguar për Uvejs Karenijun pa e parë fare. Ka thënë: “(Ai është) prej Jemenit, nga qyteti Karen, nga fisi Murad. Babai i ka vdekur, jeton vetëm me nënën dhe sillet shumë mirë me të. Ka qenë i sëmurë nga lepra, por e ka lut Allahun për shërim dhe e ka shëruar. Nën kraharor i kanë mbetur shenjat sikur të ishin monedha dërhemit. Ai është i pari më i miri i tabiinëve”. Pastaj i ka thënë Omer bin Hatabit r.a: “Nëse të vjen rasti dhe ke mundësi ta shohësh, lute që ai të lutet për faljen e mëkateve tua”. Kur Omeri r.a. është emëruar Emir i besimtarëve, haxhilerët nga Jemeni, në sezonin e haxhit, i pyeste: “A ka në mesin e tyre ndonjë me emrin Uvejs Karenij? I përgjigjeshin: “Jo”. Ai u thoshte: “Po pse nuk e merrni me vete?” Ata i përgjigjeshin se nuk dinin për vendbanimin e tij. “E ne kemi pak ushqim dhe vetëm një palë rroba.” Omeri u thoshte atyre: “Mjerë për ju, po për ta ka folur i Dërguari i Allahut i s.a.v.s., dhe ka thënë: “Nëse ju jepet rasti të takoheni me të, luteni që të bëjë dua për ju (se lutja e tij pranohet). Kështu Omeri për çdo vit e priste Uvejsin.

Dhe ndodh që një vit ai vjen me haxhilerët e Jemenit. Omeri e takon dhe dëshiroi për ta vërtetuar atë dhe e pyet:

- Si quheni?
- Uvejs.
- Nga cili vend i Jemenit?
- Nga Karni
- Nga cili fis jeni?
- Nga fisi Mural.
- Si e ke babanë?
- Babai më ka vdekur, dhe jetoj vetëm me nënën.

- Si i ka marrëdhëniet me ty?
- Mendohem të sillem shumë mirë me të?
- A ke qenë i sëmurë?
- Po, Kam qenë i sëmurë prej leprës, po e kam lutur Allahun të më shërojë dhe më ka shëruar.
- A mos të ka mbetur ndonjë gjurmë e asaj sëmundje?
- Po, nën kraharonin tim kam një shenjë sa monedha e dërhemit, pastaj ia zbuloi nënkraharonin. Omeri pasi ia sheh atë vend, ia puth. Dhe i thotë: “Ti je ai, për cilin ka thënë Pejgamberi s.a.v.s. të lutesh për mua”.
- Po, unë të lutem për ty o Emir i besimtarëve?!
- Po gjithsesi.
- Omeri vazhdimisht kërkonte prej tij, deri sa u lut për të.  
Pastaj Omeri e pyet, se ku do të shkojë dhe çka do të punojë pas sezonit të haxhit.
- Unë do të shkoj te fisi Murad i Jemenit dhe në Irak.
- Unë do t’i shkruaj mëkëmbësit të Irakut për ty?
- Të përбетohem o Emir i besimtarëve, mos vepro ashtu. Më lerë të eci në mesin e njerëzve i panjohur dhe pa ngarkesë prej tyre.

## [18] – MOSRESPEKTIMI I NËNËS

Tregohet se Avam bin Havsheb r.a. ka thënë:

“Njëherë zbrita në një vendbanim, ku përreth atij vendbanimi ishin varrezat. Ishte koha e pasdites, kur pashë se një varr u hap. Një njeri i vdekur doli nga varri me kokë të gomarit, ndërsa me trup të njeriut dhe palli tri herë. Pastaj hyri në varr dhe u mbyll varri.

Në anën tjetër pashë një grua plakë, e cila thurte rroba. Një grua tjetër më tha: “A po e sheh atë grua plakë?” - I thashë:

“Po çka ka lidhje kjo me atë plakë?!”. - Më tha: “Ajo është nëna e këtij të vdekuri”. “Po si kanë qenë raportet mes tyre?” - Tha: “Pinte alkool dhe dehej. Kur i kalonte dehja, nëna i thoshte: “O biri im! Ruaju Zotit e mos pi alkool!” - Ndërsa ai i thoshte: “Ti nënë po pallë siç pallë gomari”. Pastaj ai ka vdekur pas dite dhe është varrosur pasdite. Për këtë arsye çdo pasdite ngritet nga varri, pall tri herë dhe prapë kthehet në varr”.

## **[19] - TREGIMI I DËMTUESIT DHE TË DËMTUARIT NË DITËN E KIJAMETT**

Nga Enesi r.a transmetohet: “Deri sa ishim ulur me të Dërguarin e Allahut s.a.v.s., e pamë duke qeshur, sa që ia pamë edhe dhëmbët. E Omeri i tha: “Për çka po qesh, o i Dërguari i Allahut?” - Ai tha: “Dy pjesëtarë të umetit tim, deri sa qëndrojnë së bashku para Zotit të Gjithëfuqishëm, njëri thotë: “O Zoti im, ky vëllai im, le të ma kthejë padrejtësinë që më ka bërë. Allahu i thotë: “Po çka të bëj me vëllanë tënd kur ai nuk ka asnjë të mirë?”. Pastaj tregon se i Dërguari ka vazhduar: “Atë ditë njerëzit kanë nevojë që t’u lirohet barra e mëkateve”, ndërsa Allahu i thotë akuzuesit: “Ngrite kokën dhe trego çka po sheh”. Ai e ngrit kokën dhe thotë: “O Zoti im, po shoh vendbanime prej ari, kështjella prej ari dhe diamante; por, për cilët pejgamberë janë ato, për cilin njeri të mirë janë ato, apo për cilin dëshmor janë ato?! Allahu i Thotë: “Të atij, i cili i paguan”. Ai e pyet: “Po kush e posedon atë pasuri që t’i paguajë gjithë ato?!” Allahu i thotë: “Ti i posedon”. Ai i thotë: “Po me çka?” Allahu i tregon se duke ia falur vëllait tënd. Ai thotë: “O Zoti im! Unë ia kam falur atij”. Allahu pastaj i thotë: “Merre vëllanë për dore dhe shkoni së bashku në xhenet”. Në lidhje me këtë i Dërguari i

Allahut s.a.v.s. ka thënë: “Frikësojuni Allahut dhe pajtohuni mes vete, vërtet Allahu bën që muslimanët të pajtohen”.

*(TRANSMETON HAKIMI DHE BEJHEKIU NË LIBRIN E TIJ “BEATH”,  
DHE KA THËNË SE E KA ISNADIN SAHIHË)*

## **[20] - TREGIMI I ADHURUESIT PESËQIND VJEÇAR**

Transmetohet nga Xhabiri r.a. të ketë thënë: “Dolëm me të Dërguarin e Allahut s.a.v.s., (e ai më tha): “Ishte më parë dashamiri im – Xhibrili dhe më tha: “O Muhamed! Për atë i Cili të ka zgjedhur që ti të jesh Pejgamber! - Një njeri e ka adhuruar Allahun 500 vjet pandërprerë, në maje të kodrës, ku gjerësia dhe gjatësia ka qenë tridhjetë nyje, dhe në lartësi tridhjetë nyje, në mes të oqeanit, ku largësia prej toke ishte 4000 fersah nga çdo anë. Pranë tij ishte një burim i ujit me madhësi të gishtit, i cili kishte ujë të ëmbël. Ai burim ishte në rrënjë të vendit ku qëndronte, e pranë tij ishte një shegë, e cila jepte fruta të pjekura për çdo natë. Gjatë ditës e adhuronte Allahun, e kur bëhej natë, shkonte aty, merrte abdest dhe hante shega. E pastaj vazhdonte namazin dhe lutjet e tij.

Allahu ka dhënë urdhër që atij t’i merrej shpirti përderisa të jetë në sexhde, dhe që as toka e asgjë tjetër të mos ia prishin rrugën e tij, me qëllim që edhe në Ditën e Kijamet të ngritet prej sexhdeje. Dhe ashtu ka ndodhur. Dhe derisa ne shkonim lart e poshtë më tregoi:

“Ai do të ringjallet në Ditën e Kijametit, do të qëndrojë para Allahut. Allahu do të thotë: “Qojeni robin tim në xhenet me mëshirën Time. Ai thotë: “O Zoti im, me veprën time”. Allahu thotë: “Qojeni robin tim në xhenet me mëshirën Time”. Ai thotë:



“O Zoti im, me veprën time”. Atëherë Zoti thotë: “Peshojani robin tim të mirat e Mia ndaj tij me veprat e tij. Dhe vendoset (në peshojë) begatia e shikimit, e cila peshon me rëndë se 500 vjet, ndërsa të gjitha të mirat e tjera trupore tepruan. Pastaj thotë: Kthejeni dhe ai qëndron para Zotit. Zoti thotë: “Kush të krijoi kur ishe asgjë?” Thotë: “Ti o Zoti im”. - Kush të ka forcuar në adhurim 500 vjet? Thotë: “Ti o Zoti im”. I thotë: “Kush të vendosi në kodrën, ku në mes të saj buroi uji i ëmbël, e jo i njelmët, dhe për çdo natë piqeshin shegat, përderisa ata piqen një here në vit, dhe kam urdhëruar që shpirtin të ta marrin kur ti të jesh në sexhde dhe ashtu ndodhi?” Ai Thotë: “Ti o Zoti im”. Pra të gjitha kanë qenë me mëshirën Time. Prandaj edhe po të qoj në xhenet me mëshirën Time”. - Qojeni robin tim në xhenet, sepse ka qenë robi Im i mirë, dhe vendoset në xhenet”.

*( Transmeton Hakim me isnad Sahihë )*

## **[21] - E KEQJA E PËRGOJUESIT(SHTISIT)**

Tregohet se një njeri e ka parë se si një rob shitej dhe tek ai rob nuk vërejt asnjë të metë, përpos që ishte përgojues. Ai nuk e konsideroi si ndonjë të metë të madhe, dhe e bleu. Pas shumë e shumë ditësh, sa qëndroi robi përgojues, i thotë bashkëshortes së zotërisë të tij: “Zotëria im, pra burri yt, dëshiron të të martojë me një burrë tjetër, sepse ai nuk të dashuron. Nëse dëshiron që të të dashurojë, të ketë simpati ndaj teje dhe të mos e bëjë një gjë të tillë, atëherë kur të jetë fjetur, hiqja disa qime nën mjekër dhe mbaji ato qime me vete. Ajo thotë: “Unë do ta bëjë atë që po më thua, kështu që vendos për t’ia hequr qimet kur ai të bjenë të flejë. Pastaj ai - përgojuesi shkon te burri i saj dhe i thotë: “Zotëria im, bashkëshortja jote ka një dashnor, dhe ka vendosur për të të hequr qafesh. Nëse nuk më beson, sonte bëhu sikurse je duke fjetur dhe vërtetoje. Ajo

vjen sonte me zhilet për të të prerë në qafë”. Zotëria i besoi fjalëve të tij. Kur u bë natë, ai bëhet sikur po fle, kurse gruaja e tij e merr zhiletin dhe shkon për t’ia heqë qimet nën mjekër, pra në qafë. Ai e vëren dhe thotë me vetvete se robi paska pasur të drejtë. Kur ajo ia vendos zhiletin në qafë për t’ia heqë qimet, ai ngritet, ia merr zhiletin dhe e pret në fyt bashkëshorten e vet. Kur familja e saj shkon dhe e shohin të mbytur, e mbysin bashkëshortin dhe për këtë shkak filloi lufta mes dy familjeve.

Kështu ka ndodhur prej robit përgojues!

## **[22] - TREGIMI I NJERIUT TË DEVOTSHËM, GABIMIT TË TIJ DHE SADAKASË**

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: “Një rob i devotshëm prej beni israilëve e ka adhuruar Allahun 60 vjet në një faltore të tij, pa dalë fare. Pas atyre viteve, prej faltores sheh një ditë të bukur, kur pas shiut ishte gjelbëruar dhe kishte lulëzuar gjithçka. Mistiku mendoi: “Të dal jashtë dhe ta kujtoj Allahun, dhe t’i përjetoj të mirat e Tij”. Doli jashtë dhe mori me vete një bukë apo dy. Deri sa qëndronte në natyrë e takon një grua dhe duke komunikuar me të (erdhi në atë gjendje) deri sa edhe kontaktoi me të dhe bëri mëkat. Pastaj zbriti në një liqe të vogël për tu larë. Deri sa lahej, i vjen një lypës dhe kërkon prej tij diçka. Ai i tregoi me shenjë që t’i merrte dy bukët, e pastaj vdiq. Atij iu vendosën në peshojë 60 vjet të adhurimit me mëkatin e prostitucionit, e u rëndua ana e mëkatit të prostitucionit. E pastaj në peshore u vendos e mira e bukës apo e dy bukëve, atëherë u rëndua ana e peshores së punëve të mira, dhe iu falen gabimet”.

*(Transmetoi Ibn Habani, hadithë Sahihë)*

## **[23] - SHEMBULLI I ATIJ, I CILI I PËRMBAHET LIGJIT TË ALLAHUT DHE TË ATIJ, I CILI NUK I PËRMBAHET**

Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: “Shembulli i atyre, të cilët i përmbahen ligjit të Allahut, dhe i atyre, të cilët nuk i përmbahen ligjit të Allahut i ngjason shembullit të një populli, i cili është në një anije, e ajo anija është dy kate. Disa banojnë lart, të tjerët poshtë. Ata, të cilët ishin poshtë ngjiteshin lart dhe mbushnin ujë pasi kalonin në katin e epërm. Një ditë thanë: “Sikur të bironim anijen, do të mbushnim ujë nga këtu, dhe nuk do ti pengonim ata lart fare”. Nëse lejohen ata të veprojnë ashtu siç dëshirojnë, do të përmbysen të gjithë, por nëse nuk i lejojnë, shpëtojnë që të gjithë”.

## **[24] - SHËRIMI I SHPIRTIT**

Një njeri shkon te Ibrahim ibn Ed-hemi, i cili ishte mjek i zemrave dhe i thotë: “Unë po e teproj me veten time, më trego si të shërohem. Ibrahim i thotë: Nëse i përvetëson katër cilësi, nuk do të jesh mëkatar i madh. Njeriu, i cili kishte nevojë për *këshilla tha*: “*Më këshillo cilat janë, o Ibrahim. I Thotë: “Nëse dëshiron për të mos e dëgjuar (respektuar) Allahun, atëherë mos ha prej furnizimeve të Tij”. Ai njeriu u habit dhe tha me hamendje: “Po çka po thua kështu o Ibrahim, po të gjitha furnizimet janë prej Allahut!? – “Pasi që është ashtu e ti po e di, atëherë nuk është e drejtë ta shijosh furnizimin e Tij e të mos e dëgjosh, pra të mëkatosh?!” - (Ai përgjigjet) Jo.*

- *O Ibrahim a më jep këshillën e dytë?*

Ibrahimi i thotë: “Nëse nuk dëshiron ta dëgjosh Allahun, mos jeto në vendbanimin e Tij”. Ai njeriu u habit më shumë se herën e parë, e tha: Çka po thua kështu o Ibrahim?! Të gjitha vendbanimet janë të Allahut. Ai i thotë: “Pasi që është ashtu, e ti po e di, - a është e drejtë edhe të jetosh në *vendbanimit* e Tij edhe të mos e dëgjosh, pra mos të mos mëkatosh?!”. - Jo.

- ***O Ibrahim më jep këshillën e tretë:***

Ibrahimi i thotë: Nëse dëshiron të bësh mëkat, shko në ndonjë vend ku nuk të sheh askush.

- Po si po thua kështu o Ibrahim?! Po Allahu i di të gjitha të fshehtat (e sheh të fshehtën e të hapurën), e dëgjon të ecurit e buburrecit në mes të shkretëtirës, në errësirën më të thellë të natës!

Ibrahimi i thotë: “Pasi që është ashtu, atëherë pse bën mëkat?” Ai thotë: “Nuk do të bëj”.

- ***O Ibrahim më jep këshillën e katërt:***

Ibrahimi i thotë: “Kur të vijë meleku i vdekjes për të ta marrë shpirtin thuaj: “Më jep edhe më afat”.

Njeriu i thotë: “Po çka po thua kështu o Ibrahim, kurse Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: **“Dhe kur ti vjen (njeriut) çasti i vdekjes, nuk mund ta shtyjë fare, e as nuk mund ta shpejtojë fare”**. Atëherë i thotë: “Pasi puna është ashtu, atëherë si shpreson për të shpëtuar?!”. Thotë: “Po”.

- ***Më jep këshillën e pestë, o Ibrahim .***

Ibrahimi i thotë: “Kur të vijnë melekët e xhehenemit të quajtur Zebanije, për të të marrë dhe për të të dërguar në xhehenem, ti mos shko”. Deri sa njeriu dëgjoi këtë të fundit filloi të qajë dhe t'i thotë: “Mjaftë më o Ibrahim, unë kërkoj falje prej Allahut dhe pendohem te Ai, dhe do ta adhuroj deri ne vdekje”.

## [25] – TREGIMI I KOPSHTARIT

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Përderisa një njeri kalonte në periferi të një vendbanimi, dëgjon një zë mbi re: “Ujite bahçen (arën) e filanit”. Kur nga ai moment retë e ndryshuan drejtimin dhe shkuan mbi atë arë dhe zbrazën shi, e cila ishte një kodër me rrasa. Kur e sheh se, në atë vend ku binte shiu mbliidhej uji dhe formohej përroskë, ai e përcolli ujin. Kur e sheh se një njeri qëndronte në atë arë, e cila kishte ujë të mjaftueshëm nga çdo anë. E pyet: “O rob i Allahut! Po si e keni emrin?” I përgjigjet – “Filan ... . (E tha) emrin, të cilën e kishte dëgjuar nga zëri mbi re. Pastaj ky e pyet: “Po, pse po më pyet për emrin tim?” Ai i thotë: “Kam dëgjuar një zë mbi re, i cili thoshte: Ujite bahçen (arën) e filanit, - emrin, të cilin e paskeni ju”. – “Pasi është puna kështu po të tregoj: Unë 1/3 e produkteve e jap sadaka, me 1/3 e ushqej veten dhe familjen, ndërsa 1/3 e kthej prapë për punimin (mbjelljen) e arës”.

*(Transmeton Muslimi)*

## [26] - TRIMËRIA E DJALOSHIT

Haxhaxh bin Jusuf eth-thekafiju ka qenë i njohur për padrejtësi, egërsi dhe kryeneçësi. Deri sa ishte ulur në njërën nga kështjellat e bukura të tij, në atë kështjellë shkonin banorët e Irakut, ku pranë tij shkon edhe një fëmijë i Havarixhëve, që i kishte mbushur dhjetë vjet e më tepër. Dhe kur hyn në pallat (kështjellë) as që i bën përshtypje pallati, e as Haxhaxh bin Jusufi. Por e shikon rreth e rrotull, në të majtë e në të djathtë pallatin dhe e lexon ajetin: ***“A në çdo bregore ngreni ndonjë shtëpi (ndërtesë) sa për lojë? Dhe a i ndërtoni pallatet e fortifikuara që të jeni përgjithmonë?”***

*(Esh-Shuaraë, 128-129)*

Haxhaxhi ishte i mbështetur, ngritet e i thotë: “O djalosh, po e shoh se qenke i zgjuar dhe i mençur! A mos e ke mësuar Kur’anin përmendësh dhe e ke të ruajtur në mendje?” Djaloshi thotë: “Pse, a mos je frikësuar, e po frikësohesh se do të humb e që unë ta ruaj? Por, jo, atë Allahu e ka ruajtur dhe e ruan.

Haxhaxhi: Apo, e ke tubuar në mendje?

Djaloshi: Pse, a mos ka qenë i shpërndarë e që unë ta tuboj?

Haxhaxhi: A mos e ke përsosur?

Djaloshi: Pse, Allahu, a nuk e ka zbritur të përsosur?

Haxhaxhi: A mos e ke (Kur’anin) shpinë (mbështetës)?

Djaloshi : Zoti më ruajt, që unë ta lë Kur’anin pas shpine!

Haxhaxhi : (Me hidhërim), mjerë për ty, Allahu të mallkoftë për atë që thua!

Djaloshi: Mjerë për ty dhe për popullin tënd! Mos pyet ashtu si më parë, por thuaj: “A mos e ke Kuranin në zemër?”

Haxhaxhi: Na lexo pra diçka nga Kurani.

Djaloshi: Filloi ta lexojë suretu Nasr (“Fitorja”). Në emër të Allahut Bamirësit të përgjithshëm, Mëshiruesit. Kur të vjen ndihma e Allahut dhe fitorja, do t’i shohësh njerëzit (duke dalë) nga feja e Allahut turma-turma”.

Haxhaxhi : Mjerë për ty thuaj: **“duke hyrë në fenë e Allahut”**.

Djaloshi: Më parë kanë hyrë, mirëpo tani po dalin.

Haxhaxhi: Po pse?

Djaloshi: Sepse ti po sillesh shumë keq me ta.

Haxhaxhi: Mjerë për ty! O djalosh, a po e di me kë po flet?!

Djaloshi: Po me shejtanin e quajtur Haxhaxh Thekafiu.

Haxhaxhi: Mjerë për ty! Po cili është kujdestari yt?

Djaloshi: Ai, i cili më ka mbjell, më ka dhënë shpirtin.

Haxhaxhi: Po nëna jote?

Djaloshi: Ajo, e cila më ka lindur.

Haxhaxhi: Ku keni lindur?

Djaloshi: Në tokën e humbur (që do të zhduket).

Haxhaxhi: Mos jeni i çmendur, të të shëroj?!

Djaloshi: Po të kisha qenë i çmendur, nuk do të kisha ardhur të qëndroj pranë teje.

Haxhaxhi: Çka mendon për emirin e besimtarëve.

Djaloshi: Zoti e mëshiroftë babën e Hasanit r.a. dhe e dërgoftë në xhenetin e përgjithmonshëm.

Haxhaxhi: Nuk mendova për atë (të mëparshmin), por për Abdul Melik bin Mervanin.

Djaloshi: Për mëkatën e mbrapshtë, Zoti e mallkoftë!

Haxhaxhi: Mjerë për ty, por pse po thua ashtu.

Djaloshi: Ka bërë një mëkat të madh, të cilin nuk e mbulon as toka e qielli.

Haxhaxhi: Cili është ai mëkat!

Djaloshi: Pse të ka emëruar ty në post, e ti ua han pasurinë e ua thith gjakun njerëzve.

Haxhaxhi: I shikoi këshilltarët për rreth dhe i pyeti? Çka më këshilloni, si të veprojmë me këtë djalosh?

Këshilltarët: Ekzekutoje (dënoje) me vdekje, sepse kundërshton kryetarin dhe është ndarë nga shoqëria (xhemati).

Djaloshi: O Haxhaxh, këshilltarët e vëllait tënd firaun kanë qenë më të mirë se këshilltarët e tu, sepse firaunin e kanë këshilluar që *Musa a.s. dhe vëllai i tij të ktheheshin nga kishin ardhur: “Ktheje prapë atë dhe vëllanë e tij”*, ndërsa këta të urdhërojnë të më mbysësh! Pra, po e sheh, Allahu të ka sjellë argument pranë vetes. Allahu është Zot mbi kriminelët dhe i përlulë kryelartët.

Haxhaxhi i tha: Mbylle gojën dhe ndale gjuhën, dhe dua të të shpejtoj, dhe nuk do të marrë atë vendim, por, përkundrazi, e kam paraparë të të shpërblej me 4000 dërhëm.

Djaloshi: Nuk kam nevojë për ato të holla, Zoti ta zbardhtë fytyrën, i *ngrittë këmbët tua*.

Haxhaxhi shikoi këshilltarët dhe u tha: A kuptuat se çfarë pati për qëllim? Zoti ta zbardhtë fytyrën dhe i *ngrittë këmbët tua?!*

Këshilltarët: Emiri e di më së miri.

Haxhaxhi: Me fjalët “Zoti ta zbardhtë fytyrën” ka pasur për qëllim verbërimin tim dhe lëngimin tim me sëmundjen e leprës, ndërsa me fjalën “i ngrittë këmbët tua” ai ka për qëllim “gozhdëzim dhe varje për mua”. Pastaj u kthye në drejtim të djaloshit dhe e pyeti: Çka pate për qëllim me atë që e the?

Djaloshi: Zoti të mallkoftë, po sa mirë e keni kuptuar!

I Shpërtheu hidhërimi Haxhaxhit dhe dha urdhër për ta dënuar me vdekje. Në prezencë ishte Ruhashiu, i cili tha: “O emir, ma dhuro këtë mua si rob, Zoti ti dhuroftë të mirat!

Haxhaxhi: I yti është, Zoti të bekoftë ty me gjithë të.

Djaloshi: Për Zotin, nuk po e kuptoj se cili nga ju është më i çmendur: ai i cili ishte prezent më herët e i cili po më dhuron mua si rob, apo ai, i cili erdhi më vonë e po e merr dhuratën - robërimin tim?!

Ruhashiu: Unë të shpëtova nga dënimi me vdekje, ndërsa ti me këto fjalë po më shpërblen.

Djaloshi: Përgëzimi për mua është arritja e dëshmorisë (shehidllëkut), kënaqësinë e Allahut. Të vritem në rrugën e Allahut është më e dashur për mua se sa të kthehem në shtëpinë time duarthatë.

Haxhaxhi (Urdhëroi ti jepej një shpërblim dhe i tha djaloshit): O djalosh, do t’i japim 100.000 dërhëm dhe po të të falim se je shumë i vogël, e qenke i zgjuar, dhe paske mbështetje të forte në Allahu, por ke kujdes në të ardhmen se mos po takohesh me dikë tjetër, e i cili nuk ta falë.

Djaloshi tha: Falja është në dorën e Allahut, e jo në dorën tënde, e falënderimi i takon Allahut, e jo ty. E kurrë mos na takoftë Allahu mua dhe ty, dhe u nis kah dera. Dy roje i dolën përpara për ta ndaluar, por Haxhaxhi u tha: “Lëreni të dalë, se për Zotin asnjëherë nuk kam parë më të guximshëm se ky, dhe më orator. Dhe pasha jetën time, asnjëherë nuk kam takuar njeri si ky, e



ndoshta nuk do të takojë njeri si unë; e nëse ky djalosh jeton, do të jetë mrekulli e këtij shekulli”.

Thuhet se (Haxhaxhi) i ka urdhëruar disa njerëz të tij, për ta helmuar, të cilët i kanë vendosur helm dhe ka vdekur.

## [27] - GRAMATIKANËT

Një leksikolog i thotë birit të tij: “Kur dëshiron të flasësh diçka, në rend të parë analizoji fjalët dhe mendoji mirë, deri sa t’i perceptosh në vetvete, pastaj fol bindshëm”.

Dhe përderisa njëherë ishin ulur, në kohë të dimrit, e zjarri ngrohte, i *bie në gacë në xhybe*, mirëpo ai (leksikologu) nuk e pa, ndërsa i biri e pa. Por, për një moment heshti, e pastaj i tha: “O baba im! Dëshiroj të të them diç, nëse më lejon?” Babai i thotë: “Nëse është fjalë e drejtë fole”. – “Unë mendoj se është e mirë dhe drejtë”. I Tha: “Thuaje”. Djali i tha: “Unë po shoh diçka të kuqe në xhyben tënde”. - I tha: “Po çka është ajo e kuqe?” – Djali i tha: “Një gacë, e cila ka rënë në xhyben tënde.” Baba e shikon xhyben e tij, e cila veç ishte djegur një cope e madhe. E i tha të birit: “Përse nuk më tregove menjëherë?!” Djali i tha: “Veprova ashtu siç më the; fillova t’i mendoj fjalët e t’i analizoj, e pastaj të flas bindshëm dhe sigurt. Atëherë babai i tha: “Asnjëherë mos fol me gramatikë!”

\* \* \*

Edul Esved Deuli i thotë të birit: “O biri im! Vërtetë djali axhës tënd dëshiron të martohet, por ka një dëshirë që ti ta fejosh, e ta mbash një ligjëratë. Djali dy ditë rresht e mësoi një hutbe (ligjëratë). E kur erdhi dita e tretë, i tha babai: “A e mësove?” – “Po, e kam mësuar përmendësh”. – (Babai) i tha: “Më trego”. I tha: Dëgjo! “Falënderimet dhe lavdërimet i takojnë Allahut, Atë e falënderojmë, në Atë mbështetemi, prej Tij ndihmë kërkojmë.

Dëshmojmë se nuk ka Zot pos Allahut dhe Muhamedi është i Dërguari i Allahut. Ejani në namaz, Ejani në shpëtim”. Babai i tha: “Ndal! Mos e thuaj ikametin se jam pa abdest”.

\* \* \*

Një i varfër ndalet pranë derës së një gjuhëtari dhe troket në derë.

Gjuhëtari pyeti: Kush është në derë?

I tha: lypësi.

I tha: A lakohet (emri yt)?

I tha: Emrin e kam Ahmed (I pa lakuar).

Gjuhëtari i tha djaloshit: Jepja *vokalin* e kesres.

\* \* \*

Një gjuhëtar bie në nevojto, pastruesit shkojnë për ta nxjerrë, dhe e pyesin se a është gjallë apo ndoshta mos ka vdekur. Gjuhëtari tha: “*Më sillni një litar të hollë, lidheni fortë dhe më tërhiqni me shkathtësi dhe lehtësi*”.

Pastruesi i tha: “Pasha nënën time, po kurrë nuk do të mund të të nxjerrë nga aty”.

\* \* \*

Ebu Alkame i njohur si gjuhëtar shkon te mjeku e i thotë: “Kam ngrënë mish XHEVAZIJE dhe TAISTU TAESSETUN dhe më është bërë një plagë në mes VABILETIT deri në qafë dhe ende vazhdon të rritet, deri sa përzihet me SHARASIFË. A ka ndonjë ilaç për mua?” - Mjeku i thotë: “Po. Merr HUNIKAN DHE SERBEKAN DHE VERKERKAN pastrohu me ta dhe pije atë ujë”. Ebu Alkamete i thotë: “Nuk po të kuptoj fare se çka po thua!” - Mjeku i thotë: “Po edhe unë nuk të kam kuptuar çka the!”

\* \* \*

Një njeri i thotë Hasanit: “Çka thua për njeriun, të cilit i vdes babai dhe vëllai (EBIJHI dhe EHIHI)?” Hasani i Thotë: *Thuaj: e halën* – “babai dhe vëllai”. Njeriu i thotë: “*E çka i takon babait dhe vëllait?*” Ebu Hasani i thotë: “Thuaj: Çka i takon babait dhe vëllait”. Atëherë njeriu i thotë Ebu Hasanit: “Po shoh se çdo herë kur po flas, ti po më kundërshton!”

Ibn Alkame - gjuhëtari shkon te djali i vëllait dhe i thotë: “Si është babai?! - I Thotë: “Vdiq”. E pyet: “Prej çfarë sëmundjeje?” - I përgjigjet: “*Prej veremit këmbët*”. I thotë: “Thuaj: Të këmbëve”. - I thotë: “Veremi u përhap deri te nyja”. - I thotë: “Thuaj: Nyjave”. Në fund i thotë: “O axhë më lerë të qetë, se më e vështirë po më vjen gramatika se sa vdekja e xhaxhait!”

\* \* \*

Një njeri e takon një letrar dhe dëshironte ta pyeste për vëllanë e tij, mirëpo frikësohej se mos po gabonte gjuhësisht, e i thotë: “Vëllai yt, vëllait tënd, vëllait a është këtu?” Ai i thotë: “Jo, unë ndoshta, është prezent”.

\* \* \*

Një njeri i thotë një njeriu tjetër: “E di gramatikën, por nuk e di një çështje, kur thonë: EBU i FILANIT, EBA FILANI DHE EBI FULANE (babai i filanit, babës së filanit dhe babës së filanit). Ai i thotë: Kjo është çështja më e lehta, sepse EBU FULANE për të mesmit dhe EBI FILANE për të poshtrit.

\* \* \*

Një gjuhëtar shkon te një pronar i shalqirit dhe e pyet: “Sa është kjo e ajo ...”. Ai shikon djathtas e majtas, e i thotë: “Më falni por unë nuk kam çka të rregulloj!

\* \* \*

Një gjuhëtarë shkon në treg dhe i thotë një shitësi: “Kërkoj një gomar, as shumë të ulët, as shumë të madh; nëse i jap pak ushqim, duron e nuk shqelmon; e nëse i jap shumë falënderon; nuk hyn në baltë e në vende me gjemba të vështira; nëse është rruga e lirë ec drejtë, e nëse është turmë nuk ngatërrohet”. Shitësi pasi e shikoi dhe e dëgjoi një çast, i thotë: “Më jep pak kohë, se ndoshta Allahu e shndërron gjykatësin në gomarë, e të ta shes!”

\* \* \*

Një njeri viziton një gjuhëtar të sëmure, e i thotë: “Prej çka ankohesh?” E ai i thotë: “Trupin e kam të shtrënguar dhe më digjet flake; pjesët më vlojnë dhe eshtrat më përcëllojnë”. Ai i thotë: “Zoti mos të shëroftë. Ah, mjerë për mua po të kishe vdekur!”

\* \* \*

Njëri e kishte një djalë gjuhëtar, e i cili me fjalë i shëronte të sëmuret. Baba i tij sëmuret rëndë dhe ishte në shtrat të vdekjes. Vëllezërit kuvendojnë, e i thonë babait: “Ta thërrasim vëllanë tonë – filanin, i cili është gjuhëtar. Baba i thotë: “Jo, se më mbyt me fjalë”. - I thonë: “Do ti themi që të mos flasë”. Kur erdhi ai dhe hyri në shtëpi i thotë babait: “O baba im! Ajo çka më ka larguar nga ti është, ....., i cili më thirri dje dhe EHRESE, VE ADESE, VESTEBREXHE, VE SEBKEXHE, VE TAHEXHE, VE EFREXHE, VE DEXHEXHE, VE EBSALE, VE EMDARE, VE LUDHIXHE VE EFLUZIXHE”. Baba thirri: “Më mbuloni, sepse më i vështirë se Meleku i marrjes së shpirtrave është ky!”

## [28] - KURIOZITETE

1. Një ditë Umran bin Hatani shkon te bashkëshortja e tij. Umrani kishte pamje të keqe, të trishtueshme, ishte i shkurtër, ndërsa bashkëshortja e tij ishte shumë e bukur. Kur ai e shikoi, në sytë e tij bukuria e saj iu shtua edhe më shumë, kështu që ai nuk mund t'ia hiqte shikimin. Ajo i tha: “Çka ke?” - Ai iu përgjigj: “E falënderoj Allahun, për Zotin je shumë e bukur”. - Ajo ia ktheu: “Përgëzim, se edhe unë edhe ti, së bashku, do të jemi në xhenet”. - Ai tha: “Po ku e mësove këtë, nga e di ti këtë?” Ajo i tha: “Sepse jam fati yt e po e falënderon (Zotin), ndërsa unë jam e sprovuar me ty. E durimtari dhe falënderuesi, që të dy, janë xhenetlinj”.

\* \* \*

2. I është thënë Shaebit: “Je plakur shumë dhe ke arritur këtë moshë, por a ke mësuar ndonjë hadithë?” - Ai tha: “Për Zotin, askush nuk ka mësuar nga Ikreme atë çka e kam dëgjuar unë prej tij”. - I thanë: “Po na trego pra”.

- “Kam dëgjuar Ikremen, e ai e kishte dëgjuar nga Ibn Abasi, e ai nga i Dërguari i Allahut s.a.v.s. se ka thënë: “*Dy çështje nuk bashkohen në personalitetin e muslimanit*”. Njërin e kishte harruar Ikreme, ndërsa të dytën e kam harruar unë”.

\* \* \*

3. E kanë pyetur një grua për mjetet e zbukurimit të saj, e ajo është përgjigjur: “Mjetin e vërtetësisë e përdori për buzët e mira, Kur’anin për zërin tim, mëshirën dhe butësinë për sytë e mi, mirësinë për duart e mia, përqendrueshmërinë për këmbët e mia dhe sinqeritetin e çiltërsinë për zemrën time.

\* \* \*

4. Harun Rashidi i thotë Kadiut: “Ebi Jusuf! Çka mendon, cila pemë është me e shijshme dhe më e ëmbël: Faluxhi apo Luzunuxhi? Kadiu i përgjigjet: “O emir i besimtarëve, unë nuk mund të gjykoj në mosprezencën e tyre”. Reshidi urdhëroi për sjelljen e atyre pemëve: Jusufi filloi të hajë herë në njërën, herë në tjetrën, derisa arriti në gjysmat e tyre, e pastaj tha: “O emir i besimtarëve, nuk kam parë kundërshtarë më të rreptë mes vete se këta dy. Çdo herë kur isha i gatshëm për të vendosur për njërën, tjetra më sillte argumente edhe më të fuqishme”.

\* \* \*

5. Një njeri banonte në një shtëpi me qira. Dërrasat e kulmit ishin shumë të vjetra, të cilat kërcisnin shumë. Kur qiradhënësi shkoi për t’ia kërkuar qiranë i thotë: “Meremetoje këtë kulm se po kërcet”. Ai i thotë: “Mos u friko se kulmi edhe shtëpia janë duke i bërë TESBIH Allahut. Qiramarrësi i thotë: “Po kam frikë se duke i bërë tesbih aq shumë, një ditë do të bie në sexhde”.

\* \* \*

6. Një beduin takohet me një turmë njerëzish dhe i pyet për emrat e tyre. Njëri tha e kam emrin Besnik, tjetri Pengim, tjetri Stabil, e tjetri i Rreptë. Atëherë Beduini tha: “Besoj se edhe në bazë të emrave tuaj janë edhe veprat tuaja”.

\* \* \*

7. Esmeiju thotë: “Hyra në qytet, kur pashë një grua shumë të bukur, e cila kishte burrin jo të pashëm, e i thashë: “Si po e ndien veten të lumtur të jesh nën kurorë të këtij burri jo të pashëm?!” E ajo më tha: “Dëgjo ti! Ndoshta çështja më e mira është në mes tij dhe Allahut: të sillem mirë e të fitoj shpërblim, ose të sillem keq e të dënohem”.

\* \* \*

8. Ibn Semak Zahid i ka thënë Harun Rashidit, derisa ai ishte duke pirë një gotë ujë: “O emir i besimtarëve, nëse do të ishe etur dhe nuk do të të lejohej për ta pirë këtë gotë ujë, - sa do të kishe paguar për të?” - Rashidi i thotë: “Me tërë pasurinë time”. Ibn Semaki ia parashtron pyetjen tjetër: “Po nëse do të ishte zënë në kanalin e urinës (dhe nuk do të dilte), - sa do të kishe paguar për t’u liruar nga ai ujë (pasi të jetë shndërruar në urinë)?” – “Me tërë pasurinë time!” – u përgjigj.

Atëherë Ibn Semaki i thotë: “O emir i besimtarëve! Nuk ka dobi prej pasurisë, e cila nuk vlen më shumë se një gotë ujë dhe një lirim urinimi”.

\* \* \*

9. Një beduin shkon në një lagje të qytetit ku fëmijët loznin dhe e gjuanin njëri-tjetrin me gurë. Fatkeqësisht atij i bie një gurë në kokë dhe lëndohet shumë. Ai shkon te prijësi i qyteti dhe ankohet. Prijësi e pyet: “Në çfarë dite ke ardhur?”

- “Në ditën e vështirë dhe të rrezikshme” – u përgjigj.  
“Në cilin vend?”

- “Në vendin e shkretë, të thatë, pa bimë”.

Prijësi qeshi dhe ia kompensoi me të holla.

\* \* \*

10. Një njeri, i cili kishte përvetësuar me përpikëri një lojë zbavitëse, kërkon nga Emiri i besimtarëve – Ebi Xhafer El-Mensuri ta lejojë për ta demonstruar para mase. E ai ia lejoi. Ai mori disa letra, pastaj i hidhte në ajër në mënyrë të çuditshme, pa ra asnjë prej tyre në tokë.

Pastaj Xhaferi tha: “Vazhdo.” Ai i nxori disa shkopinj të gdhendur si shigjetë në maje. E gjuajti të parën ngulitet për muri, pastaj të dytën afër mbi të. Kështu ai i hodhi 100 shkopinj të

gjitha u ngulitën në mur dhe asnjë nuk ra për tokë. Kur e përfundoi demonstrimin, shpresoi se emiri do t'i jepte ndonjë shpërblim, mirëpo Mensuri i thirri xhelatët dhe u tha: “Merreni këtë njeri dhe mëshojani me njëqind shkopinj. Ai bërtiti: “Po pse o emir i besimtarëve?! Ai u përgjigj: “Sepse e humbe kohën e muslimanëve me gjëra të padobishme.”

\* \* \*

11. E kanë pyetur një të urtë:

- Cila është gjëja më e mirë për njeriun?
- (Ai i përgjigj) Mendja me të cilin jeton.
- Po nëse atë nuk e ka?
- Vëllezërit, të cilët përkujdesen për të.
- Po nëse ata nuk i ka?
- Pasurinë për shkak të së cilës e duan njerëzit.
- Po nëse nuk e ka?
- Edukatën prej të cilës ruhet prej çdo të keqe.
- Po nëse nuk e ka?
- Heshtjen, e cila e shpëton.
- Po nëse nuk e ka?
- Vdekjen, e cila i shpëton njerëzit prej tij.

\* \* \*

12. Haxhaxh bin Jusuf Thekafiu, i cili ishte i njohur për barbarizëm, derisa lahej në një liqe, ai desh u fundos, por njëri prej muslimanëve e shpëton. Kur e nxjerr në tokë, Haxhaxhi i thotë: “Kërko çka të duash se do të plotësohet”. - Ai i tha: “Po kush jeni ju që të më jepni çka të kërkoj”. - Ai i thotë: Unë jam Haxhaxh Eth-thekafiju”. - Ai njeriu i thotë: “Kam vetëm një kërkesë. Pash Allahun, mos i thuaj askujt se të kam shpëtuar”.

\* \* \*



13. Tregohet se Basra-janët i ka pyetur një njeri: “Kush është zotëria juaj (zotëria e Basrajanëve)?” Ata i thonë: “Husejni”. – “Po me çfarë është bërë zotëria i juaj (me çfarë veprash)?” - Ata i përgjigjen: “Sepse njerëzit (e Basrës) kanë pasur nevojë për diturinë e tij, e ai nuk ka pasur nevojë për ta”.

\* \* \*

14. Është pyetur një njeri i mirë: “Unë vuaj nga sëmundja e largimit prej Allahut. Si të shërohem?”  
Ai i thotë pyetësit: “O pyetës! Merri rrënjët e sinqeritetit, gjethet e durimit dhe lëngun e modestisë. Të gjitha këto vendosi në enën e devotshmërisë. Pastaj hedh mbi të ujin e frikës ndaj Allahut. Dhe vloji këto me zjarrin e pikëllimit dhe vendosi në tryezën e inspektimit, e pastaj përdori me dorën e drejtësisë, e pije me gotën e *istigfarit*, e përtypi me gojën e përkushtimit, dhe largoje veten nga lakmia dhe pangopësia. Atëherë me lejen e Allahut do të shërohesh.

\* \* \*

15. Ibrahim bin Ethem i r.a. pasi që e sheh një njeri të pikëlluar e pyet: “O njeri, po t’i bëj tri pyetje, e ti përgjigju”. Ai i thotë: “Urdhëro”.

A mund të qarkullojë diçka në këtë botë e që nuk dëshiron Allahu?

- Jo, - u përgjigj.
- A mund ta zvogëlojë rizkun diçka prej asaj çka e ka caktuar Allahu?
- Jo.
- A mund të zvogëlohet një sekond çasti nga momenti që Allahu e ka caktuar që të vdesësh, e të mos jetosh më shumë?
- Jo.
- Atëherë, për çka brengosesh, e je i pikëlluar?!

\* \* \*

16. Muaviju i thotë një njeriu prej Jemenit: “Sa injorant është populli yt që e ka emëruar femrën sundimtare?” Ai ia kthen Muavijës: “Më injorant se populli im është populli yt, sepse kur I Dërguari i Allahut i ka ftuar për ta adhuruar të Gjithëmëshirshmin, ata kanë thënë: “O Zot, nëse është kjo e vërtetë prej Teje, zbritna gurë në kokat tona në vend të shiut ose na dëno me dënim të dhimbshëm”. E nuk kanë thënë: “O Zot nëse kjo është e vërtetë prej Teje, na udhëzo në rrugë të drejtë”.

\* \* \*

17. Një dijetar, derisa ishte në minber, i bëhet një pyetje. E ai përgjigjet: “Jo nuk e di”. Atëherë i thonë: “Po minberi nuk është vend i të paditurve”. E ai u thotë: “Unë këtu jam ngritur në bazë të diturisë sime, sepse po të ngritesha në bazë të paditurisë sime do të arrija në qiell”.

\* \* \*

18. Një njeri shkon te Hasan El-Basriju r.a. dhe i thotë: “Cili është çelësi (sekreti) i devotshmërisë tënde. E ai u përgjigj: “Katër gjëra”:

1. E kam ditur se rizkun nuk e ka përsipër askush, pos unë vetë, dhe jam angazhuar vetë.
2. E kam ditur se punën time nuk e kryen askush, për atë jam angazhuar vetë.
3. E kam ditur se Allahu më sheh dhe do t’i paraqesë veprat e mia, e jam turpëruar të më shohë në mëkate.
4. E kam ditur se vdekja më pret, andaj kam përgatitur material për t’u takuar me Zotin tim.

\* \* \*

19. Një As'hab hyn në një vend ku një grup njerëzish hanin ushqim, mirëpo ai nuk i njihte. E u tha: “Es-selamu alejkum, o ju grup njerëzish jofisnik”. Ata e ngrenë kokën lart e i thonë atij: “Jo, për Zotin jemi fisnik”. Ai eci përpara dhe u ul në mesin e tyre dhe u lut: “O Zot, le të jenë ata të drejtët, ndërsa unë le të jem rrenacak”. Dhe e zgjati dorën në pjtatën e tyre duke thënë: “Po çka jeni duke ngrënë?” Ata i thanë: “Ishim duke ngrënë helm”. Ata i thanë: “Po a e njohe ndonjërin prej nesh?” As'habi sinjalizoi te ushqimi dhe tha: “E njoh këtë”.

\* \* \*

20. Një i varfër e lut një arab që t'i japë diçka. Ai i thotë: “Unë nuk kam asgjë për t'i dhënë dikujt tjetër. Krejt atë çka e kam është ajo, për të cilën jam më i nevojshëm unë për të se të tjerët”. Lypësi i tha: “Po ku janë ata që veten e lënë keq, edhe pse kanë nevojë (e u japin të tjerëve)? Arabi ia ktheu: “Kam shkuar (kanë vdekur) ma ata, të cilët nuk lypin prej tjerëve”.

\* \* \*

21. Kur është pyetur një njeri i çmendur, i cili nuk fliste shumë dhe nuk i përgojonte të tjerët: “Çka mendon për Iblisin (shejtanin)? Ai është përgjigjur: “Për të kam dëgjuar fjalë shumë, e të fshehtën e tij e di Allahu më së miri”.

\* \* \*

22. Një njeri shkon në luftë në rrugën e Allahut dhe e lë në shtëpi bashkëshorten me fëmijë. Disa prej grave, të cilat e kishin imanin e dobët, i thonë: “Oj nënë e gjorë, po kush do të përkujdeset për familjen e të t'i ushqejë fëmijët nëse e ka caktuar Allahu të bie dëshmor? Mirëpo, kjo grua besimtare nuk kishte tjetër të thoshte, pos me bindje dhe iman të fortë u thotë: “Unë

burrin tim e di se ka qenë i përkujdesur, i ushqyer; ndërsa nuk e di se ka qenë ushqyes apo përkujdesës. E nëse vdes i ushqyeri mbetet ushqyesi – FURNIZUESI (Allahu i Lartmadhëruar).

\* \* \*

23. Një ditë Ebu Dardai qëndroi pranë Qabesë dhe u tha shokëve të tij: “A është e vërtetë se çdonjëri prej jush, i cili merr një udhëtim, përgatitet me mjete dhe material për rrugë: - I thonë: “Po”. Atëherë u thotë Ebu Dardai: Rruga e ahiretit është më e gjata”. Ata i thonë: “Na trego mjetet dhe materialin (përgatitjen) për atë rrugë”. Ai u thotë: “Kryejeni haxhin për çështjet madhështore, falni dy rekate në errësirë të natës, për ta tejkaluar errësirën e natës së varrit dhe agjëroni ditë të vështira për t’u liruar Ditën e gjatë të Ringjalljes”.

\* \* \*

24. Xhahidhi ka qenë shkrimtar dhe poet arab i njohur, me fytyrë të shëmtuar, mirëpo ka qenë komik, dhe ka përdorur komedi, bile edhe me vetë pamjen e tij. Xhahidhi tregon një rast për veten e tij, duke thënë: “Isha ulur pranë shtëpisë sime, m’u afrua një grua dhe më tha: “Kam nevojë për ty, që të vish me mua në një vend! Xhahidhi thotë: “Shkova me të derisa shkuam te një dyqan ku pronari merrej me pikturim. E ajo i tha: ‘Sikurse ky, bëri me shenjë nga unë dhe shkoi’. Pastaj e pyeta piktorin: ‘Çka po thotë ajo?’ E piktori m’u përgjigj: ‘Ma ka sjellë një unazë dhe kërkoi nga unë që ta pikturoj në të fytyrën e shejtanit. E i kam thënë asaj: Oj zonjushë! Po unë asnjëherë nuk kam parë fytyrën e shejtanit. Për këtë arsye të solli ty tek unë dhe tha atë që e dëgjove”.

\* \* \*

25. Asam bin Jusufi kalon pranë Hatem El-Esmit dhe e pyet: “A falesh?” I thotë: “Po”. Më trego si e fal namazin. Ai përgjigjet: “Ngritem me urdhrin e Allahut, eci me frikë të Allahut. Hyj në namaz me nijet të pastër, marr “tekbir” me madhërinë e Tij. Lexoj Kur’an me përpikëri dhe vëmendje të plotë. Bie në ruku i përlulur, bie në sexhde i nënshtruar, ulem plotësisht në ulësen e fundit, jap selam me nijet, dhe e përfundoj namazin me sinqeritet të pastër ndaj Allahut. Pastaj i kthehem vetvetes me frikë se *a thua Allahu - a më ka pranuar namazin tim*. Dhe i ruaj kohët e namazit deri në vdekje”. Pastaj ai i thotë: “Vazhdo se ti namazin e fal të plotë”.

\* \* \*

26. Një hatibit, derisa mbante ligjëratë para njerëzve, i shpëton një erë. E u thotë: “O ju njerëz! Allahu ka krijuar trupat tanë dhe në ta ka vendosur shpirtrat. E kur ka mundësi njeriu që t’i ndalë që të mos dalin prej tyre? Njëri, i cili ishte prezent, tha: “Dhe . . . dalja e shpirtrave në nevojtoare është sunet, ndërsa në minbere bid’at. Zoti na faltë neve dhe juve!”

\* \* \*

29. Nasrudini del në treg për të blerë një gomar dhe aty takon një shok të tij, i cili e pyet: “Po ku po shkon? – “Po shkoj të blejë një gomar”. Shoku i thotë: “Thuaj: (Insha Allah) Nëse do Allahu”. Nasrudini ia kthen: “Jo nuk është ashtu si thua, se dërhëmët i kam në xhep, ndërsa gomari në treg”. Derisa ishte në treg duke kërkuar (gomar) ia vjedhin dërhëmët, e ai kthehet i dëshpëruar. E shoku i tij i thotë: “Ku është gomari o Nasrudin? I thotë: Dërhëmët u vodhën “ (Insha Allah) nëse do Allahu”.

\* \* \*

30. Një mendjelehtë shikon në pusin e bunarit dhe sheh aty veten si në pasqyrë, e pastaj shkon te nëna e tij dhe i thotë: “Oj nënën, në bunar është një hajdut.” Nëna shkon deri te bunari, shikon në pus dhe thotë: “Po, për Zotin, me të qenka edhe një hajdute.”

\* \* \*

31. Një njeri e pyet Hashim Kutbin:

- Sa i ke numëruar?
- Prej një deri njëmijë apo një mijë e më tepër.
- Nuk kisha atë qëllim.
- Po çfarë qëllimi kishe?
- Sa i numëron prej sinëve (dhëmbëve)?
- 26 dhëmbë: Dhjetë lart, e gjashtëmbëdhjetë poshtë.
- Nuk e kisha për qëllim atë.
- Po çka kishe për qëllim?
- Sa vjet i ke?
- Nuk kam të miat asnjë, të gjitha janë të Allahut.
- Sa vite?
- Shumë!
- Ti djalë i sa (viteve) je?
- Djalë i dyve: i nënës dhe i babait.
- Sa të kanë ardhur ty?
- Po të më kishte ardhur diçka do të isha i vdekur.
- Po si të them pra?
- Thuaj: “Sa vite të jetës të kanë kaluar?”.

32. Tregohet se një njeri shkon në xhami për t’u falur me xhemat, një njeri hyn në shtëpinë e tij për të bërë imoralitet, por qeni i heton dhe i mbytë që të dy. Kur kthehet në shtëpi i sheh që të dy të mbytur: Ende shtëpia dhe prona ime është e mbrojtur. E ruan pasurinë, e shoku dëshiron të më tradhtojë?! Habi! Shoku e

thyen besën e moralit tim. Por, më habitshme është se si atë e ruan qeni!

33. Omer Ibnul Hatabi e pyet një djalosh:

- Si e ke emrin?
- Gacë.
- Biri i kujt je?
- I flakës.
- Prej nga je?
- Nga zjarri.
- Ku e ke shtëpinë?
- Në një lagje të zjarrit.
- Po në cilën anë?
- Nga ajo e cila digjet më së tepërmi.
- Shko sa më shpejtë te shtëpia jote (familja jote) se ata janë djegur.

Djaloshi shkon me shpejtësi te shtëpia e tij kur sheh se i ka ndodhur ashtu siç i ka thënë Omeri r.a.

\* \* \*

34. Tregon Esmeiju: E kam pyetur një djalë arab: “A kishe dashur që t’i kesh njëqind dërrhem, por të ishe i çmendur? E ai më është përgjigjur: “Jo”. Kur e kam pyetur: “Por, pse?” - Frikohem se çmenduria bën aso gabime, me të cilat i humbi të gjitha të hollat e mbetet vetëm çmenduria”.

35. I urti ka thënë:

“Largohu nga shtatë cilësi, do ta kesh trupin, mendjen dhe zemrën e shëndosh, ndërsa pasurinë e fenë tënde të siguruar:

1. Mos u pikëllo për të kaluarën;
2. Mos u brengos për të ardhmen;
3. Mos i ofendo njerëzit siç të ofendojnë ty;
4. Mos kërko shpërblim për atë që nuk e ke punuar;

5. Mos e shiko atë që nuk e posedon;
6. Mos u hidhëro ndaj atij, të cilit hidhërimi yt nuk i bën dëm;
7. Mos u krekos – lavdëro për atë që nuk e ke punuar dhe që nuk është prej teje.

36. Omeri r.a. ka thënë: “Prej çdo fatkeqësie që më ka ndodhur i kam parë tri dobi prej saj, prej të cilave më ka begatuar Allahu:

**E para:** Se ajo fatkeqësi nuk ka cenuar fenë time, se po të kishte qenë ajo fatkeqësi në fenë time, do të kishte qenë fatkeqësi e madhe, prej së cilës njeriu e humb edhe këtë botë edhe botën tjetër.

**E Dyta:** Se ajo fatkeqësi ka mund të jetë më e madhe, sepse çdo fatkeqësi mund të ketë diçka më fatkeqe se ajo fatkeqësi.

**E Treta:** Zoti më ka dhënë durimin, e durimi dhe llogaria në atë fatkeqësi janë baza të sigurisë, me të cilat Allahu lehtëson fatkeqësinë pasi që të ndodhë.

37. Tregon Ibn Halkani: Kam qenë me disa shokë të besueshëm nga një fshat i quajtur Ebi Selamet. Në atë fshat ka qenë një njeri injorant dhe mendjelehtë. Një ditë bisedohej për vlerën e pastrimit të dhëmbëve me misvak. E ai tha: “Për Zotin, nuk i laj dhëmbët me misvak, por me të kam për ta larë anusin”. E ka marrë misvakin dhe me të e ka larë anusin. Pastaj atë natë ka ndier dhimbje, e pas nëntë muajsh është ankuar nga dhimbja e barkut dhe anusit, njëherit ka ndier dhimbje si gruaja shtatzënë kur të lindë. Kështu që ka lindur një gjallesë në formë të “Xherdhunit”, e kokën sikur koka e peshkut, me katër dhëmbë (si të vampirit) të dukshëm nga të tjerët, me bisht të gjatë dhe 4 gishta, e anusi i tij si anusi i lepurit. E kur ka lindur ajo gjallesë ka klithur tri herë, bija e tij i ka mëshuar në kokë asaj gjallese



dhe e ka mbytur. Ai njeri pastaj ka jetuar vetëm edhe dy ditë dhe vazhdimisht duke thënë: Më mbyti ajo gjallesë dhe ma shkatërroi lukthin. Atë gjallesë e kanë parë një grup njerëzish nga ai vend si dhe hatibi i atij vendi, në vitin 665 hixhrij.

38. Një njeri me emrin Tufejl, i sheh disa njerëz duke shkuar në një vend, ai mendoi se ata janë duke shkuar në ndonjë gazmend dasme dhe iu bashkëngjit. Mirëpo ata kishin qenë poet, të cilët i kishin përgatitur sulltanit vargje lavdëruese. Kur secili e recitoi poezinë e tij dhe secili merr shpërblim, i vjen radha Tufejlit, i cili heshte. I thonë: “Thuaje poezinë tënde”. Ai thotë: “Po unë nuk jam poet”. Po kush jeni ju atëherë? Ai u përgjigj: “Unë jam ai, për të cilin Allahu ka thënë: ***‘Dhe poetët, të cilët enden aty e këtu, e në çdo vend’***”. Sulltani qeshi dhe urdhëroi që edhe atij t’i jep dhuratë.

39. Ekrea bin Habisi hyn te emiri i besimtarëve, Omer bin Hatabi, dhe sheh se si fëmijët loznin mbi supet dhe mbi shpinën e tij. E thotë: “Çka është kjo, o Emir i besimtarëve? A kështu i lejoni fëmijët tuaj të lozin me ju?”

Omeri pastaj e pyet: “O Ekrea, po ti si sillesh me fëmijët e tu në shtëpinë tënde?”

Ai i thotë: “Kur të hyjë në shtëpi, secili qëndron në vendin e vet, askush nuk flet dhe kush nuk bën zë. Unë i kam dhjetë fëmijë dhe asnjërin prej tyre nuk e kam puthur”. - Omeri i thotë: “Atëherë ti nuk e meriton të jesh në ndonjë pozitë të lartë për të qeverisur muslimanët”. Dhe jep urdhër për t’u shkarkuar nga detyra.

## [29] – SHAFIIJU ME ZILIQARËT

Tregohet se disa dijetarë të njohur nga Iraku ia kanë pasur zili Shafiijut r.a.. Kështu që dëshironin ta lajkatojnë, sepse ai ia tejkalonte atyre me dituri dhe urtësi. Një pjesë e madhe e studentëve kishin dro prej tij dhe prej diturisë së tij, të cilët prezantonin vetëm në vendkuvendimet e tij; pajtoheshin vetëm me mendimet e tij, me mësimet e tij. Për këtë arsye, këta dijetarë ziliqarë u morën vesh mes vete, që t'i tubojnë disa pyetje enigmatike, për ta sprovuar diturinë dhe mendjemprehtësinë e Shafiijut, kapacitetin e memories së tij, aftësinë e tij dhe atë mu në prezencën e Halifes Reshidë, i cili e donte dhe kishte respekt të veçantë për të. Pasi që i kishin përmbledhur pyetjet i lajmëruan Halifes për të prezantuar në debat që të përgjigjet pyetjeve, të cilat iu parashtrohen Shafiijut r.a., e për ta shikuar se sa me të vërtetë është i ditur dhe i mençur.

Debati filloi kështu:

**Pyetja e parë:** Çka mendon për njeriun, i cili ka prerë një dele në shtëpi, për nevojat e shtëpisë, e pastaj ka dalë në treg, e kur është kthyer i ka thënë familjes së tij: “Hajeni ju mishin e deles, se për mua është e ndaluar”. E familja i është përgjigjur: “Po, edhe për ne është e ndaluar!”

**Përgjigja:** Ky njeri ka qenë idhujtar, e ka pre delen në emër të idhujve, e ka dalë në treg për disa detyra dhe nevoja të veta. Aty Allahu e ka ndriçuar dhe e ka udhëzuar në islam. E kur e ka pranuar islamin, automatikisht mishi i asaj deleje është bërë e ndaluar për të. Kur familja kanë dëgjuar se e ka pranuar islamin edhe ata janë bërë muslimanë, e edhe atyre mishi i deles i është bërë e ndaluar për shkak të pranimit të fesë islame.

**Pyetja e dytë:** Dy muslimanë të mençur kanë pirë birrë (alkool), njëri dënohet e tjetri jo?

**Përgjigja:** Njëri ka qenë i mençur, por i moshës madhore, ndërsa tjetri i mençur fëmijë.

**Pyetja e tretë:** Pesë persona kanë bërë prostitucion me një grua, kështu që i pari dënohet me vdekje, i dyti me gurëzim, i treti me 100 të rëna, i katërti sa gjysma e 100 të rënave, ndërsa i pesti nuk dënohet fare?

**Përgjigja:** I pari e ka lejuar prostitucionin, me fjalë tjera ka thënë se “nuk është haram”, e me këtë ka dalë nga feja, për këtë duhet të ekzekutohet. Pra, e ka mohuar dhe ka vepruar.

- i dyti nuk e ka mohuar prostitucionin, por ka bërë prostitucion duke qenë i martuar, e ai gurëzohet.

- i treti dënohet me 100 të rëna ngase ka qenë i pamartuar.

- i katërti dënohet me gjysmën e 100 të rënave, sepse ka qenë rob.

- i pesti nuk dënohet fare, sepse ka qenë i çmendur.

**Pyetja e katërt:** Një njeri përderisa falet, duke dhënë selam në të djathtë gruaja e tij automatikisht shkurorëzohet; duke dhënë selam në të majtë i priset namazi, e kur të shikojë lart në qiell e sheh se i është bërë obligim të paguaj 100 dërrhem?

**Përgjigja:** - Ky njeri kur ka dhënë selam në të djathtë e sheh personin i cili ka qenë i zhdukur, me gruan e të cilit pastaj është martuar, e kur të shihet i zhdukuri, kurorëzimi me gruan e tij (me gruan e personit të zhdukur) zhvleftësohet.

- Kur sheh në të majtë vëren se rroba e tij është përlyer me papastërti të madhe, për këtë i priset namazi.

- Kur shikon në qiell e sheh se është paraqitur hëna e plotë, e kjo ia ka bërë të ditur se ka hyrë koha për t'i paguar 100 dërrhem, të cilat i ka pasur obligim, me fillimin e muajit tjetër, për ta paguar borxhin.

**Pyetja e pestë:** Imami falej me 4 persona (xhematë), atij i bashkëngjitet i pesti në anën e djathtë të tij. Kur ka dhënë imami selam në anën e djathtë, e ka parë se është e patjetërsueshme që imami të ekzekutohet, 4 falësit e tjerë duhet të dënohen me të rëna (xhild), dhe xhamia të prishet me themel?

**Përgjigjja:** Njeriu i cili u është bashkëngjitur në namaz ka qenë në udhëtim, ndërsa në shtëpi të vëllait ka lënë bashkëshorten. Imami ia ka mbytur vëllanë, e ka martuar bashkëshorten e këtij (udhëtarit), duke dëshmuar se ajo grua ka qenë grua e të vdekurit (të mbyturit), për këtë kanë dëshmuar 4 falësit, ndërsa xhamia ka qenë shtëpia e të mbyturit, të cilën shtëpi imami ia ka shndërruar në xhami.

**Pyetja e gjashtë:** Çka mendon për njeriun, të cilit i ka ikur robi, e ai ka thënë: Nëse ha bukë, ai është i lirë, deri sa ta gjejë. Si të dalë ai nga kjo enigmë?

**Përgjigjja:** Robi u dhurohet fëmijëve të tij, e ai pastaj han, dhurata e dhënë djemve i kthehet babait të tyre.

**Pyetja e shtatë:** Dy gra i kanë takuar dy djem dhe i kanë përshëndetur: “Mirë se keni ardhur o burra tanë, o fëmijë tanë, o bijtë e burrave tanë”.

**Përgjigjja:** Dy djemtë kanë qenë djemtë e atyre dy grave, dhe janë martuar me djemtë e njëra-tjetrës. Kështu djemtë e tyre

janë bërë burra të tyre (të njëra-tjetrës), djemtë e tyre dhe djemtë e burrave të tyre (të mëparshëm).

**Pyetja e tetë:** Një njeri e ka marrë një gotë me ujë për ta pirë; e pi gjysmën, e cila ka qenë hallall, ndërsa gjysma tjetër e sasisë e ka haram për ta pirë?

**Përgjigja:** Njeriu e ka pirë gjysmën e gotës dhe ka vjellë gjak në pjesën e mbetur të ujit. Kështu është përzier sasia tjetër e ujit me gjak, prandaj i është bërë haram për ta pirë.

**Pyetja e nëntë:** Një njeri ia jep gruas së tij një najlon të mbyllur tërësisht, dhe kërkon nga ajo për ta zbratur, por pa e hapur, pa e thyer dhe pa e shqyer; e nëse e bën një gjë të tillë (e thyen, e shqyen apo e hapë) do të jetë e shkurorëzuar.

**Përgjigja:** Najloni ka qenë i mbushur me krip ose me sheqer, ndërsa gruaja nuk bën asgjë tjetër, pos që do ta vendosë najlonin në ujë dhe sasia shkrihet në brendësi.

**Pyetja e dhjetë:** Një njeri në rrugë takon një grua, një burrë dhe dy djem, dhe pyet: “Kush janë ata djem?” - Burri përgjigjet: “Babagyshi është axha i tyre, bashkëshortja ime është gruaja e babës së tyre”. Gruaja thotë: “Nëna ime është gjyshja e tyre, ndërsa motra ime te zja e tyre”.

**Përgjigja:** Burri ka qenë baba i atyre dy djemve, ndërsa gruaja nëna e tyre.

**Pyetja e njëmbëdhjetë:** Dy njerëz janë mbi kulmin e shtëpisë, njëri bie dhe mbytet, e tjetri e ka të ndaluar martesën me gruan e tij?

**Përgjigja:** Njeriu i cili ka qenë mbi kulm, i cili është rrëzuar dhe ka vdekur është ai i cili ka qenë i martuar me vajzën e robit, i cili ka qenë mbi kulm së bashku me të. E kur ka vdekur prej rrëzimit, vajza është bërë pronësuese e robit, të cilën e ka pasur burri i saj me të cilin e ka të ndaluar të martohet.

Nga ai moment, Rashidi i cili prezantonte në atë debat nuk ka pasur mundësi ta fshehtë interesimin e tij për mendjemprehtësinë e Shafijut dhe inteligjencën e tij në të kuptuar dhe në përgjigje dhe tha: Allahu e ka nderuar fisin e Abdul Menafit. Ti sqarove, shpjegove, ia qëlllove. Shafiju r.a. tha: “Allahu ia zgjattë jetën emirit të besimtarëve, por për këta dijetarë kam vetëm një pyetje, nëse përgjigjen elhamdulillah, e nëse jo, atëherë lus emirin e besimtarëve që të ndikojë te ata e të mos më bëjnë keq. Emiri tha: Ashtu edhe do të jetë. Pra, o Shafij, parashtroje pyetjen tënde.

**Ai filloi pyetjen:** Një njeri ka vdekur, pas vetes ka lënë 600 dërhëm, nga pasuria e lënë motrës nuk i ka takuar më shumë se një dërhëm. Në çfarë kushtesh bëhet shpërndarja, e cila i takon kështu trashëgimia një dërhëm?

Kaloi një kohë e gjatë, dijetarët e shikuan njëri-tjetrin dhe asnjëri nuk mundi t’i përgjigjej; djersët u shkonin nëpër faqet e tyre. Pas një heshtje të gjatë, Halifja tha: “Jepua përgjigjen”. Pasi që ata kishin dashur që Shafijut t’ia humbnin respektin te Halifja, të cilën me meritë e kishte fituar dhe pasi që ata dështuan në planin e tyre, Shafijju tha: Ky njeri ka vdekur dhe pas vetes ka lënë: dy vajza, nënën, gruan, dymbëdhjetë vëllezër dhe një motër.

Dy vajzave u takon  $\frac{2}{3}$ , që do të thotë 400 dërhëm; nënës  $\frac{1}{6}$ , që do të thotë 100 dërhëm; gruas  $\frac{1}{8}$ , që do të thotë 75 dërhëm; 12 vëllezërve u takon 24 dërhëm dhe 1 dërhëm për motrën.

Rashidi qeshi dhe tha: “Ti i ke dhuratë prej meje 2000 dërhëm, prej meje dhe familjes sime”. Shafiiju pranoi dhe ua shpërndaui shërbëtorëve dhe rojtarëve të kështjellës.

## **[30] – ALLAHU TË TEJKALON RREZIKUN**

Tregohet se Hatem El-Esami u ka thënë djemve të tij: “Dëshiroj të shkoj në haxh”. Ata filluan të pikëllohen e të qajnë, duke i thënë: “Ti po shkon në haxh, mirëpo në dorë të kujt po na lë, kush do të na ushqejë?”. Ai e kishte vetëm një vajzë, e cila tha: “Lëreni të shkojë, sepse ai nuk është furnizues. Ai shkoi në haxh, ndërsa familjen e tij e kaploi uria, e ata filluan ta akuzojnë vajzën e tij (motrën e tyre). Ajo bëri lutje: “O Zoti im, mos më turpëro para tyre”. Emiri i qytetit kaloi pranë shtëpisë së tyre, duke shëtitur nëpër qytet dhe u thotë shokëve të tij: “Shkoni kërkoni ujë nga ndonjë shtëpi nga këtu. Ata shkuan kërkuan, kur familja e Hatemit e mbushi një ibrik të ri me ujë të ftohtë, prej ku ai piu ujë. Ai pastaj pyeti: Shtëpia e kujt është kjo: “Shtëpia e Hatem El-Esami. Ai e gjuajti një qese me ari në oborr të tyre dhe tha: Kush më do mua, do ta dua, dhe ai pajtohet me udhëheqjen time. Ushtarët, të cilët kishin pasuri i hodhën të hollat e tyre në enën e cila kishte qenë me ujë dhe e dërguan nga kishte ardhur. Vajza filloi të qajë. Nëna e pyet: “Pse po qanë, kur Zoti na lehtësoi gjendjen dhe na solli pasuri. Ajo iu përgjigj: “Sepse krijesa në shikoi kujdes për ne dhe na u lehtësua gjendja, po si do të kishte qenë po të na shikonte Krijuesi?!”. ”

## **[31] - OMER BIN ABDUL AZIZI DHE DËSHIRA E TIJ SHPIRTËRORE**

Rexha bin Hajuhi (minister i sinqertë i Omer bin Abdul Azizit) tregon: “Isha me Omer Ibnu Abdul Azizin kur ishte valij i Medinës. Më dërgoi t’ia blej një rrobë. Dhe ia kam blerë për pesëqind mijë dërhëm. Kur e shikoi më tha: “Është e mirë, po mos të kishte qenë e lirë”.

Kur u bë Halife e muslimanëve, prapë më ka dërguar për t’ia blerë një rrobë, dhe ia kam blerë për pesë dërhëm. Kur e ka shikuar më tha: Është e mirë, por çmimi i shtrenjtë. Tregon Rexhai: Kur e kam dëgjuar këtë kam filluar të qajë. Më pyeti Omeri: Për çka po qan o Rexhai. I thashë: “M’u kujtua blerja e rrobës para disa viteve dhe atë që ma pate thënë.” Omeri ia tregoi fshehtësinë Rexhait dhe qëndrimin e tij duke i thënë: O Rexha, unë kam shpirt, i cili çdo herë kur kam arritur diçka, ka dashur diçka më shumë: shpirti ka dëshiruar të marthohem me Fatimen - bijën e Abdul Melikut dhe jam martuar. Shpirti ka dëshiruar të jem në postin e Valij dhe e kam arritur atë post. Pastaj shpirti ka dëshiruar të jem Halife dhe kam arritur të bëhem Halife. Por tani o Rexhai, shpirti dëshiron xhenetin dhe shpresoj të jem njëri prej banorëve të tij.

Omer Bin Abdul Azizi ka dëgjuar se njëri prej bijve të tij ka blerë unazë me vlerë të 1000 dërhëmëve dhe ia shkruan një shkresë: “Kam dëgjuar se ke blerë unazë me vlerë të 1000 dërhëmëve, shite atë unazë dhe me ato të holla ushqeji 1000 të uritur. Dhe blej një unazë të hekurit dhe në të shkruaje: “Zoti e mëshiroftë atë, i cili e di fuqinë dhe mundësinë e tij”.



## **[32] - BLERJA E UDHËHEQËSVE DHE KRENARIA E DIJETARËVE**

Shejhu i njohur Izudin Abdu Selami ka marrë postin e prokurorit Suprem (Kadi Kudat). Kur u emërua në këtë post ai vërejti se kryetarët e komunave dhe oficerët ushtarak nuk ishin prej vendit, të cilët nuk ishin të lirë absolutisht, por ishin të robëruar. Sulltani i kishte blerë prej arkës shtetërore kur kishin qenë të vegjël, e kishin mësuar gjuhën arabe, shkencat fetare, kalorësinë dhe teknikën luftarake, e kur janë rritur janë emëruar në postet e tyre të larta. Mirëpo, ata ishin të udhëhequr dhe të blerë prej sulltanit. Me fjalë të tjera robër të tij, pra ata nuk kishin të drejtë lirie. Për këtë arsye ata nuk kishin të drejtë të martoheshin me gra të lira - jorobëresha, nuk kishin të drejtë tregtie të lirë, por vetëm të jenë robër. Kur udhëheqësit dëgjuan për këtë, kjo çështje u alarmua aq tepër, por shejhu ishte i vendosur në vendimin e tij, që ata të mos kenë të drejtë shitblerje e as martesë. Kështu interesat e tyre ishin në rrezik. Njëri prej tyre, i cili ishte zëvendës i sulltanit u hidhërua aq shumë, i tuboi udhëheqësit dhe shkuan e i thanë: “Çka po do?” Shejhu i tha: “Të thërrasim një seancë gjyqësore ose të mbahet një kuvend dhe të apelojmë që ju të bliheni prej arkës shtetërore të muslimaneve, dhe atëherë ju jeni të lirë me justifikim ligjorë të sheriatit. Këtë çështje e ngritën te sulltani, e sulltani i tha që të hiqte dorë nga ai vendim. Mirëpo ai nuk hoqi dorë. Atëherë sulltani u hidhërua pa masë, kështu që edhe shejhu u hidhërua dhe i mblodhi plaçkat, hipi mbi gomarë, ndërsa familjen e tij e hipi mbi një gomarë tjetër. Dhe doli nga Egjipti për në drejtim të Sirisë, deri sa arriti në mes të rrugës, kur pas tij u bashkëngjitën pjesa më e madhe e muslimanëve. Në atë vend nuk dëshironte të jetonte as një grua, asnjë fëmijë, e posaçërisht dijetarët, njerëzit e mirë dhe tregtarët. Kjo çështje arriti deri te sulltani dhe i thanë:

“Kur shkoi shejhu të gjithë shkuan pas tij”. Atëherë sulltani mori rrugën dhe i arriti në mes të rrugës. Sulltani i tha shejhut se pajtohet me mendimin e tij, kështu që shejhu u kthye dhe u pajtuan që t’i qesë në tenderim udhëheqësit për ti blerë. Zëvendësi i sulltanit pastaj shkon të shejhu dhe e lut më të mirë, mirëpo pa dobi. Atëherë zëvendësi i sulltanit tronditet dhe thotë se do t’ia heqë kokën, duke i thënë: “Po si të na blejë shejhu, përderisa na jemi udhëheqës të këtij vendi?!” E merr shpatën në dorë dhe shkon te shtëpia e shejhut, troket në derë. Në derë del i biri i shejhut dhe e sheh se zëvendësi i sulltanit gjendet me shpatë në dorë. Kthehet dhe i tregon babait për atë që ka parë. Shejhu as që u brengos fare, por i thotë të birit: “O Biri im, baba yt është i vogël që të vritet në rrugë të Allahut, dhe doli para zëvendës-sulltanit për dorëzim. Kur ia lëshon një shikim zëvendës sulltanit, dora e tij filloi t’i dridhej. I bie shpata prej dore, ndërsa i tërë trupi dridhej dhe filloi të qajë. E luti Shejhun të bëjë dua për të dhe i thotë: “O Shejh im, çka dëshiron ashtu do të bëhet”. I thotë: “Ju thërras të gjithë ju për t’ju shitur”. - Po me të hollat çka do të bëni? “Do ti shpenzoj në dobi të muslimanëve” – tha shejhu. - Po kush do t’i merr ato të holla kur të shitemi. “Unë” – iu përgjigj shejhu.

Pastaj u bë ashtu siç dëshiroi shejhu, i thirri udhëheqësit një nga një dhe e ngriti çmimin e tyre. I mbledhi të hollat dhe i shpenzoi në të mirë të përgjithshme. Kjo ishte diçka çka kurrë nuk kemi dëgjuar prej askujt më herët. Zoti e mëshiroftë Shejhun!

## **[33] - TREGIMI I ATIJ I CILI KA HYRË NË XHENET PA E FAL ASNJË NAMAZ APO PA BËRË ASNJËHERË RUKU DHE ASNJË SEXHDE TË NAMAZIT**

Derisa i Dërguari i Allahut s.a.v.s. e kishte rrethuar kështjellën e Hajberit. i afrohet një rob i zi, i cili ishte bari i një Jehudiu, që kishte qenë duke ruajtur bagëtinë, dhe thotë: “O i Dërguari i Allahut, më propozo islamin. Muhamedi s.a.v.s ia propozoi islamin dhe ai u bë musliman. Pasi e pranoi islamin tha: “O i Dërguari i Allahut, kam qenë bari (me qira) i pronarit të kësaj bagëtie, dhe këtë (kope) e kam amanet. Si të veproj me të?” Muhamedi s.a.v.s i tha: “Bjeri me shkop dhe ato do të shkojnë te pronari i tyre”. Bariu zezak e mori një shkop i ra bagëtisë dhe i tha: “Shkoni te pronari juaj se më nuk jam bari juaj”. Dhe ato dele së bashku, sikur të kishin pasur prijës një bari, që të gjithë shkuan drejt te një kështjellë. Pastaj bariu iu bashkëngjiti radhëve të luftëtarëve musliman dhe printe i pari në ballë të radhëve. I bie një gurë mbi të, dhe ai bie shëhid pa e falur asnjë mëkat të namazit!! Pastaj shkon i Dërguari i Allahut dhe e merr në kraharorin e tij, disa prej shokëve e hetuan këtë, e pastaj Muhamedi s.a.v.s u largua nga ai. E pyetën: “O i Dërguari i Allahut, përse u largove prej tij?” Ai Tha: “Tani me të është bashkëshortja e tij, hyria e xhenetit, e cila është duke ia hequr preh fytyrës se tij dheun, dhe është duke ia pastruar fytyrën”.

### [34] – HAPAT E SHEJTANIT

Ka qenë një beni israil, i cili ishte ndër më të devotshmit në kohën e tij. Në atë kohë kanë qenë tre vëllezër, të cilët e kishin një motër virgjëreshë dhe nuk kishin motër tjetër, pos saj.

Që të tre vëllezërit ishin emëruar vullnetarë në luftë në rrugën e Allahut. Nuk dinin se në përkujdesjen e kujt ta linin motrën e tyre nuk kishin besim te askush dhe nuk dinin se ku ta vendosnin. Të gjithë së bashku u pajtuan që ta dërgojnë dhe ta lënë te mistiku beni israil, sepse tek ai u pushonte zemra dhe në të ishin të sigurt.

Shkuan dhe e pyetën që motrën e tyre ta lënë te ai, që të jetë pranë tij, derisa të kthehen nga udhëtimi. Mirëpo ai tha: “Më ruaj o Zot prej tyre dhe prej motrës së tyre! Unë kurrë nuk mund ta pranoj”. Ata vazhdimisht insistonin derisa e bindën, dhe pranoi. Por u tha atyre: “Le të banojë në një shtëpi përballë faltores sime”. Ata e dërguan motrën e tyre te ajo shtëpi dhe shkuan.

Një kohë të gjatë, derisa ajo banonte aty, ai ia përgatiste ushqimin, zbriste te dera e faltores, pastaj e thërriste; ajo dilte nga shtëpia e saj dhe e merrte ushqimin që ia përgatiste.

Shejtani i shkon me butësi dhe e këshillon mistikun, se ai duhet të punojë punë të mirë, ai duhet të fitojë shpërblim më të madh, dhe se nëse ajo vajza del nga shtëpia e saj ditën, e shohin të tjerët dhe mund të keqkuptojnë, por më mirë është që ti të shkosh me ushqim te shtëpia e saj dhe ta vendosësh ushqimin në pragun e shtëpisë, e kështu do të fitosh shpërblim më të madh. Ai edhe ashtu vazhdon t’ia përgatis ushqimin dhe t’ia dërgonte te pragu i shtëpisë së saj, dhe nuk fliste me të fare.

Kaloi një kohë, pastaj i shkon Iblisi e i thotë në vesh: “Ti duhet të fitosh shpërblim edhe më të madh”, dhe e nxiste

vazhdimisht duke i thënë: “Sikur të flisje më të do të çmallet, sepse ajo është e përmalluar për vëllezërit e saj”. Kështu Iblisi vazhdimisht e këshillonte, derisa filloi të bisedojë me të prej faltrores së tij.

Pastaj i shkon Iblisi e i thotë: “Sikur të shkoje te dera, të ulesh ti pranë faltrores, e ajo pranë shtëpisë së saj e të bisedonit, do të kishte qenë më mirë për të”. Kështu ai nuk ndalej, derisa zbret dhe ulet para faltrores, e ajo vajza ulej para derës së shtëpisë së saj dhe bisedonin nga larg.

Një kohë vazhdoi kështu, e pastaj i shkon Iblisi e i thotë: “Ti duhet të fitosh shpërblim më të madh, duke u sjellë më mirë me të. Pra, shko prej faltrores tënde dhe ulu në prag të shtëpisë së saj e bisedo me të, sepse më mirë është për të”. Ai vazhdimisht e këshillonte kështu, derisa edhe ashtu veprroi për një kohë.

Pastaj shkon Iblisi e i thotë: “Nëse dëshiron shpërblim më të madh, shko dhe hyr në shtëpinë e saj, bisedo më të brenda që mos t’ia shohin të tjerët fytyrën, se kjo është më mirë për ty dhe shpërblim më i madh”. Kështu vazhdimisht e këshillonte Iblisi, derisa filloi të hyjë në shtëpinë e saj, bisedonte me të ditën, e kur kalonte dita shkonte në faltoren e tij.

Pastaj i shkon Iblisi, ia zbukuron fytyrën e asaj vajze para tij, derisa ai e prekë në kofsh dhe e puthë. Dhe Iblisi vazhdimisht ia zbukuronte fytyrën e saj, derisa e shtyn të kontaktojë seksualisht me të, e lë shtatzënë, e ajo pastaj lind fëmijë.

E pastaj i shkon Iblisi e i thotë: “Çka mendon nëse vijnë vëllezërit e saj e ta shohin se ajo ka fëmijë me ty, si do të vepronin me ty? Nuk ka shpëtim prej tyre, andaj shko, merrja fëmijën, mbyte dhe varrose, se ajo frikësohet prej vëllezërve të saj, e do ta mbajë sekret atë se ti ke kontaktuar seksualisht me të”. Ai edhe ashtu veprroi dhe e mbyti foshnjën.

Pastaj i thotë Iblisi: “Mbyte edhe vajzën dhe varrose me birin e saj, sepse a mendon dhe a ke besim se ajo mund ta mbajë sekretin?” Kështu ai e mbyt edhe vajzën edhe fëmijën dhe i dërgon në një vend gremine, i varrosë aty dhe mbi varr vendos një guri të madh. Shkon te faltarja e tij dhe fillon të lutet një kohë të gjatë, deri sa kthehen vëllezërit e saj nga lufta. Vëllezërit e pyesin për motrën e tyre. Ai i ngushëllon dhe u thotë: “Zoti e mëshiroftë” dhe fillon të qajë para tyre, e u thotë: - Nuk ka pasur vajzë më të mirë, por ajo ka vdekur, ja ku e ka varrin. Vëllezërit shkojnë dhe e shohin varrin, aty qajnë për motrën e tyre, qëndrojnë disa ditë te varri i saj dhe kthehen në shtëpi të tyre.

Kur bien vëllezërit për të fjetur u paraqitet shejtani në ëndërr në formë të një njeriu udhëtar dhe fillon prej vëllait më të madh, duke e pyetur për motrën e tyre, e ai i tregon ashtu siç ka treguar mistiku për vdekjen e motrës së tyre, se si kanë shkuar tek varri i saj ... Mirëpo shejtani i thotë: “Kjo është gënjeshtër”, dhe u thotë që të mos i besojnë fjalëve të tij, sepse ai e ka lënë shtatzënë motrën e tyre, pastaj ajo ka lindur djalë, kurse ai e ka mbytur motrën tuaj së bashku me fëmijën e saj, ngase është frikësuar nga ju; e ka futur në një gropë, të cilën e ka çelur vetë pas shtëpisë në anën e djathë, në të cilën ka qenë e vendosur. Shkoni te shtëpia në të cilën ka qenë e vendosur, dhe kur të hyni do ta shihni se është ashtu si po u them juve. Pastaj i paraqitet Iblisi në ëndërr vëllait të dytë dhe ia tregon të njëjtat gjëra, pastaj i shkon edhe vëllait të vogël, duke iu paraqitur në ëndërr gjithashtu.

Në mëngjes kur u zgjuan u ulën të bisedonin mes vete. Njëri tha: “Mbrëmë kam parë një ëndërr të çuditshme” dhe ua tregoi. Edhe tjetri thotë se kishte parë po të njëjtën ëndërr! Vëllai i madh thotë: “Po ajo është vetëm ëndërr e asgjë tjetër, lëreni këtë punë, harrojeni.” Më i vogli tha: “Për Zotin, nuk e lë

pa shkuar te ai vend dhe të shikoj se çka ka.” Shkojnë te shtëpia ku ka banuar motra e tyre, e hapin derën dhe kërkojnë vendin, të cilin ua kishte treguar njeriu (shejtani) në ëndërr, dhe e gjejnë motrën e tyre dhe fëmijën e saj të mbytur.

E pyesin mistikun, ndërsa ai u thotë se kjo është e vërtetë. Atëherë ata e padisin te sunduesi i asaj kohe. E marrin mistikun prej faltores së tij dhe e dërgojnë për ta dënuar me vdekje.

Kur ia lidhin duart për ta ekzekutuar, shkon Iblisi e i thotë: “Unë jam shoku yt, i cili të ka sprovuar me atë vajzë, të cilën e ke lënë shtatzënë, pastaj e ke mbytur me fëmijën e saj. Nëse sot më dëgjon dhe e mohon Allahun, i Cili të ka krijuar dhe të ka dhënë formën, atëherë unë do të shpëtoj prej vdekjes.” Ai e dëgjon dhe e mohon Allahun. Kur e mohon Allahun shejtani largohet prej tij dhe atë e ekzekutojnë.

Për këtë ka zbritur ajeti:

***“Njësoj, sikurse shejtani kur t’i thotë njeriut: “moho”, e ai kur të mohojë thotë (shejtani): Unë largohem prej teje, unë i frikohem Allahut – Zotit të botëve. Dhe përfundimi i të dyve është se ata do të jenë në zjarr përgjithmonë. Ky është dënimi i kriminelëve”.***

## [35] - ALEGORI TË RRALLA DHE SIMBOLIZIME INTERESANTE

Tregohet se një mbret, deri sa ishte në majë të kështjellës, e sheh në ballkon të një shtëpie një grua shumë të bukur. Pastaj mbreti pyet këshilltarët se e kujt është ajo grua. I tregojnë se është e një punëtori të kështjellës, i cili e ka emrin Fijruz. Mbreti pasi që kishte ra në dashuri me atë grua, e thirr punëtorin e i thotë: “O Fijruz!” Ai i thotë: “Urdhëro i nderuar”. I thotë: “Merre këtë letër dhe shko në filan vendin dhe pastaj më sill përgjigjen nga atje.” Djaloshi e merr letrën dhe shkon në shtëpi, e vendos letrën nën jastëkun e tij, flen atë natë dhe të nesërmen nisët për udhëtim. Përsëndetet me gruan dhe nisët për ta kryer detyrën e mbretit, duke mos ditur se çka i kishte përgatitur mbreti. Pasi që ai nisët, mbreti shkon te shtëpia e tij, troket në derë me lehtësi. Gruaja e djaloshit thotë: “Kush është në derë?” Mbreti i thotë: “Unë jam zotëria i burrit tënd”. Ajo ia hapë derën, e ai hyn brenda. Gruaja i thotë: “Sot po e shoh se zotëria ynë na erdhi në shtëpi!” I thotë: “Kam ardhur për t’ju vizituar. Ajo i thotë: “Kërkoj mbështetje tek Allahu nga kjo vizitë, nuk mendoj se është (vizitë) e mirë!”. I thotë mjerë për ty, po unë jam mbreti dhe zotëria i burrit tënd, dhe nuk ma merr mendja se nuk më njeh!” I thotë: “Përkundrazi të njoh, o zotëria ynë, por para teje të tjerët kanë thurur përgjigje:

Po e le ujin tuaj burim.

E kjo për shkak se burimi ka shumë ujë.

Kur mickoja bie në ushqim.

I ngre duart (nuk e ha) edhe pse ma ka ëndja.”

E luajt largohen nga burimi i ujit,

Pasi që kanë lëpi në të.



Pastaj i thotë: “O mbret, në vendin e ujit vjen qeni yt e pi ujë.

Mbreti turpërohet nga fjalët e saj dhe me të shpejt del nga shtëpia, mirëpo e harron këpucën në oborr. Në anën tjetër, djaloshi duke shkuar për ta kryer detyrën e tij, e sheh se me vete nuk e ka letrën. I kujtohet se e ka lënë nën jastëkun e tij dhe kthehet në shtëpi për ta marrë. Posa kishte dal mbreti nga shtëpia ai hyn aty dhe e gjen këpucën e mbretit. Fillon të mendojë dhe menjëherë e kupton se mbreti nuk e kishte ngarkuar me atë udhëtim, pos për një qëllim të caktuar. Mirëpo, heshtë dhe nuk flet fare. E merr letrën, e dërgon në vendin e duhur dhe kthehet. Kur kthehet, për punën e kryer mbreti e shpërblen me njëqind dinarë. Ai shkon në treg, blen dhuratë për gruan e tij, pastaj shkon në shtëpi, ia jep dhuratën gruas dhe i thotë: “Ngritu se do të shkojmë për ta vizituar familjen tënde”. Gruaja i thotë: “Pse?” I thotë: “Për shkak se mbreti më ka shpërblyer, e dëshiroj t’ia tregoj familjes tënde për këtë bagëti. Shkojnë te shtëpia e gruas së tij, e ata gëzohen pa masë për suksesin e arritur në punë. Dhe ai kthehet në shtëpinë e tij, ndërsa gruaja i kërkon leje që të rri në familjen e saj. Kalon një muaj ai nuk pyet dhe nuk interesohet për gruan e vet, shkon vëllai i saj e i thotë: “Duhet të na tregosh se për çfarë je i hidhëruar me motrën tonë, se përndryshe do të padisim në gjyq te mbreti”. Firuzi i thotë: “Nëse dëshironi më padisni, nëse i kam bë ndonjë padrejtësi”. Kështu e padisin dhe dalin në gjyq. Në gjyq gjykatësi e pyet vëllanë e gruas, e ai i thotë: “I nderuari gjykatës, unë ia kam dhënë këtij djali një arë, në të cilën çdo gjë ka qenë në rregull, bunari me ujë plotë të pastër dhe të kthjellët, pemë me fruta, e ky i ka ngrënë frutat, e ka prish arën dhe e ka shkatërruar bunarin. Gjykatësi pastaj i kthehet djaloshit dhe i thotë: “Po ti djalosh çka ke për të thënë?” Fijruzi thotë: “E kam pranuar arën dhe e kam dorëzuar në gjendje edhe më të mire se ka qenë më parë”. Gjykatësi e pyet vëllanë e gruas se a ta ka kthyer arën ashtu siç ka qenë. I

përgjigjet: “Po, por dëshiroj ta di arsyen?” Gjykatësi e pyet Fijruzin. Fijruzi përgjigjet: “I nderuari gjykatës, nuk e kam kthyer se nuk e dua. Por një dit kur shkova te ara pashë gjurmët e luanit (këpucën e mbretit). E jam frikuar se luani mund të kafshojë, e ia kam ndaluar vetes për të hyrë në arë për nderin ndaj luanit”. Derisa mbreti ishte mbështetur, drejtohet ulur dhe tha: “O djalosh kthehu në arën tënde, i qetë e i sigurt. Se për zotin, vërtet luani ka shkuar te ara, mirëpo nuk ka prek asgjë, e nuk ka këputë asnjë lapë dushku, e asnjë frutë, dhe nuk ka qëndruar vetëm se një çast, dhe ka dalë pa shkaktuar asnjë të keqe. Se për zotin, luani nuk ka parë kurrë si arën tënde dhe më rojtare për pemët e tij. Djaloshi u kthye në shtëpinë e tij, e riktheu gruan e tij, ndërsa as gjykatësi e as të tjerët nuk e kuptuan se çka ka ndodhur dhe si ka qenë puna, e kjo u bë me simbole dhe alegori të çuditshme.

### [36] - DIJETARËT BEFASOJNË UDHËHEQËSIT

Tregohet se Hisham bin Abdul Meliku shkon në haxh në Qabe, e kur hyn në Qabe thotë: “Me sillni ndonjërin prej sahabëve” I thonë: “O Emir i besimtarëve, ata kanë vdekur”. Po prej tabi’inëve. Dhe ia sjellin Tavus el Jamanijun. Kur hyn Tavusi, i heq papuçet dhe e përshëndet Emirin e besimtarëve, duke mos e thirr me titull, si dhe ulet pranë tij pa i kërkuar leje. E i thotë: “Si je o Hishan?” Hishani hidhërohet aq fortë sa që dëshiron ta mbysë. I thonë: “O emir i besimtarëve, ti je në Qabe, e i dërguari i Allahut s.a.v.s. i ka ndaluar trazirat dhe vrasjet në Qabe”. Atëherë i thotë: “O Tavus, çka të shtyri të sillesh kështu?” I thotë: “Po si u solla?” I thotë: “I hoqe papuçet, nuk m’u drejtove me “O emir i besimtarëve”. Nuk më thirre me titull, u ule pranë

meje pa kërkuar leje dhe the: “O Hisham, si je?” Tavusi i thotë: “Sa i përket heqjes së papuçeve para se të ulem, po them se unë nuk po i heq papuçet për Zotin e Gjithëfuqishëm për çdo ditë nga pesë herë, e Ai as nuk po më dënon, e as nuk po hidhërohet. Ndërsa, nuk të kam thirrur “o Emirë i besimtarëve”, ngase çdo besimtar nuk është i kënaqur me qeverisjen tënde, e u frikësova se mos po bëhem rrenacak. Sa i përket asaj se pse nuk të kam thirrur me titull. Zoti i Lartmadhëruar i ka thirrur pejgamberët: O Davud, O Jahja, O Isa, ndërsa armiqtë i ka thirrur me titull: “*Iu thafshin duart Ebi Lehebit, ashtu siq ju kanë tharë*”. Ndërsa sa i përket asaj se pse jam ulur pranë teje, unë kam dëgjuar Ali bin Ebi Talibin duke thënë: “Nëse dëshiron për ta parë banorin e xhehenemit shiko njeriun, i cili rri ulur, përderisa pranë tij të tjerët qëndrojnë në këmbë”. Pastaj ai thotë: “Më jep një këshillë”. Tavusi i thotë: “Kam dëgjuar Ali bin Ebi Talibin r.a. duke thënë: “Në xhehenem ka gjarpërinj të mëdhenj dhe akrepa të mëdhenj sa mushkat, të cilët kafshojnë çdo udhëheqës, i cili nuk është i drejtë me popullin e tij”.

\* \* \*

Tregohet se Eba Gujath, i njohur si mistik, jetonte pranë varrezave të Buharës. Shkon në qytet për ta vizituar një vëlla. Dy djemtë të Emirit - Naser bin Muhamedit dhe me ta *edukatorët e emëruar* dilnin nga shtëpia e tij. Kur i sheh thotë në vetvete: “Oh, çka më ndodhi, po nëse tani heshti unë jam bashkëfajtor me ta”. E ngrit kokën në qiell, kërkon mbështetje prej Allahut, e merr një shkop dhe u mëshon njëherë, ndërsa ata ia mbathin me të katërtat në shtëpinë e sulltanit, dhe i tregojnë Emirit atë që ndodhi. Emiri e thërret dhe i thotë: “A e di se ai, i cili del prej sulltanit (i tejkalon kufijtë) përfundimin e ka në burg”. Ebu Gajathi i thotë: “A e di se ai, i cili del prej të

Gjithëmëshirshmit (i tejkalon kufijtë e Tij) përfundimin e ka në xhehenem.

- Kush të ka emëruar inspektor.
- Po ai që të ka emëruar Emirë.
- Po mua më ka emëruar Halifja Emirë.
- Po mua inspektor më ka emëruar Zoti i Halifes.

Emiri thotë: Të kam emëruar inspektor në Samerkand.

Ebul Gajathi thotë: “Kam dhënë dorëheqje prej atij posti”.

Emiri thotë: “Çudi me ty, inspekton aty ku nuk je i emëruar. Ndërsa ke dhënë dorëheqje aty ku je emëruar e nuk inspekton”.

Ebu Gajathi: “Për arsye se nëse ti më emëron, prej aty më shkarkon, ndërsa aty ku më emëron Zoti im nuk më shkarkon asnjëherë”.

Emiri: “Kërko diç, do të ta jap”.

Ebu Gajathi: “Më kthe rininë”.

Nuk është në kompetencën time, po a ke ndonjë nevojë tjetër.

- Shkruaj që meleku i xhehenemit të mos më dënojë me zjarr.
- Edhe kjo nuk është në kompetencën time.
- A ke ndonjë kërkesë tjetër?
- Thuaj Melekut të xhenetit të quajtur Ridvan të më shpie në xhenet.
- Edhe kjo nuk është në kompetencën time.
- Të gjitha janë në kompetencën e Allahut, i Cili i ka në dorën e Tij çdo nevojë, dhe çdo gjë që kërkoj prej Tij, Ai më përgjigjet.
- Emiri ia liroi rrugën dhe u befasua me trimërinë dhe imanin e fortë të tij.

**[37] - NË GRACKË BIE GRACKËVËNËSI**

Tregohet për një shërbëtor të mbretit, të cilin, shërbëtor, *të vogël e kishin gjetur* në rrugë. Mbreti urdhëron për t'u përkujdesur dhe për ta edukuar, dhe e bashkëngjiti me familjen e tij dhe e quan Ahmedin Jetim. Kur rritet, te ai paraqiten shenjat e urtësisë dhe mençurisë. Kështu që ai e mësoi, e edukoi dhe e arsimoi. Kështu ai i shkroi testament, përpos kësaj e emëron në post të mirë të pallatit shtetëror. E zgjodhi dhe e emëroi që të jetë mbikëqyrës i të gjithë të punësuarve në kështjellën e tij. Një ditë prej ditëve Emiri e urdhëron t'i sjellë ushqim prej një dhome të tij. Kur shkon ta marrë ushqimin, kur sheh se njëra prej grave të emirit me një djalosh, i cili ishte shërbëtor në krevatin e tij bën prostitucion. Gruaja e mbretit i thotë që mos të tregojë, dhe nëse nuk tregon do t'i jep çka të dëshirojë, bile edhe të kontaktojë seksualisht me të. Ai i thotë Allahu më mbrojt, që unë ta tradhtoj emirin, që të bëj prostitucion, kurse ai të gjitha të mirat m'i ka bërë. Pastaj shkon, largohet dhe i thotë asaj se nuk do të tregojë asgjë. Mirëpo, gruaja ndien një frikë në vetvete dhe mendon se Ahmedin jetim do t'i tregojë emirit atë që ka parë. Kështu që ajo e pret emirin kur kthehet në kështjellë dhe i afrohet duke qajtur. Ai e pyet pse po qan? I thotë: Ahmedin Jetim ka dashur të më përdhunojë. Kur dëgjon Emiri këtë hidhërohet për së tepërmi, dhe vendos ta mbytë. Pastaj e bën planin që mbytja e tij të planifikohet me kujdes ashtu që njerëzit mos ta marrin vesh se emiri e ka mbytur, e as shkakun e mbytjes. Kështu ai i thotë njërit prej shërbëtorëve kryesorë: “Nëse ta dërgoj një shërbëtor me pako dhe të kërkon ty këtë e këtë ti hiqja kokën, vendose në pako me gjithë kokën dhe përcille tek unë. Shërbëtori kryesor i thotë: “U bë”.

Një ditë emiri e thërret Ahmedin Jetim dhe i thotë: “Shko tek filan shërbëtori dhe i thuaj atij: Merre këtë dhe këtë”. Ai e pranoi urdhrin dhe u nis për ta kryer, mirëpo gjatë rrugës i takon disa shokë shërbëtorë, të cilët dëshironin që tu sqaronte disa gjëra atyre, Ahmedin Jetim arsyetohet duke u thënë se e ka marrë

përsipër me ia kryer një punë emirit. Ata i thonë: “Po do ta dërgojmë një shërbëtor tjetër, i cili do ta përcjellë porosinë e kërkuar, e ti vetëm zgjidhi çështjet tona”. Ahmed i Jetim pranon. Ata e dërgojnë njërin prej tyre, mirëpo ai kishte qenë i njëjti shërbëtor, i cili kishte bërë prostitucion me gruan e emirit. Kur ai shkon të kryeshërbëtori, e dërgon te vendi i caktuar, ia prenë kokën, pastaj e mbështjell në pako dhe ia kthen Emirit. Emiri kur e hap pakon e sheh kokën e shërbëtorit tjetër, e jo kokën e Ahmedit Jetim. E thërret Ahmed jetimin dhe e pyet çka ka punuar, ai i tregon se si ka ndodhur. Emiri e pyet: “A e di se ky shërbëtor ka bërë ndonjë gabim?” I Thotë: Po, ka bërë këtë e këtë me *gruan tënde*, dhe i kam pa dhe më ka shti me u përbetuar në Allahun me fsheh këtë rast mos me treguar. Kur e dëgjoi Emiri, urdhëroi për ekzekutimin e asaj gruaje, dhe Ahmed Jetimin e gradoi, e nderoi dhe shtoi dashuri edhe më të madhe mbi të. Kështu përfundoi tradhtia. “Dhe nuk kthehet e keqja e kurthit te ai i cili e ka përgatitur kurthin”.

### [38] - TREGIMI I SHEJTANIT ME EBU HUREJRËN

Tregohet se Ebu Hurejre ka thënë: “I dërguari i Allahut s.a.v.s. më ka ngarkuar për ta ruajtur në muajin Ramazan zekatin. Erdhi një njeri, i cili kërkonte ushqim dhe mori pa pyetur fare. I thashë: “Do të të padis te i Dërguari Allahut s.a.v.s. E ai më tha: “Unë kam nevojë dhe familja ime ka nevojë të madhe”. Kështu që e lirova. Të nesërmen i Dërguari i Allahut s.a.v.s më tha: “O Ebu Hurejrete, si veproji dje i zënuri duke marr ushqim?”. I thash: “O i dërguari i Allahut s.a.v.s., më tha unë dhe familja ime jemi në gjendje shumë të vështirë dhe kemi nevojë për këtë ushqim dhe e lirova.”

Më tha: “Ai ka gënjyer, e do të kthehet prapë”. E kuptova se ai prapë do të kthehet, në bazë të fjalës së të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. E ai erdhi dhe kërkonte ushqim (merrte ushqim). I thashë se do të padis te i Dërguari i Allahut, e ai më tha: “Më liro vetëm sot, se nuk do të kthehem më, se kam nevojë unë dhe familja ime për së tepërmi”. E mëshirova dhe e lirova. Të nesërmen në mëngjes i Dërguari i Allahut s.a.v.s. më tha: “O Ebu Hurejre çka veprove dje me të zenurin duke marrë ushqim”. I thotë: “O i Dërguari i Allahut u ankua se ka shumë nevojë ai dhe familja e tij, e u tregova i mëshirshëm dhe e lirova”. I dërguari i Allahut s.a.v.s. i thotë: “Të ka gënjyer dhe gjithsesi ai prapë do të kthehet”. E prita prapë, dhe ai të nesërmen erdhi për të tretën herë. Mori ushqim pa pyetur. E unë i thash: “Do të të padis te i Dërguari i Allahut s.a.v.s., se kjo është hera e tretë që thua se nuk do të kthehem, ndërsa prapë je kthyer. Ai më tha: “Më lejo të t’i mësoj disa lutje, që kur t’i thuash, Allahu do të të bëjë dobi”. I thash: “Cilat janë ato?” - Kur të shtrihesh në shtrat lexoje Ajetul Kursijen, se Allahu do të të ruajë dhe shejtani nuk mund të të afrohet deri në mëngjes”. E lirova. Të nesërmen në mëngjes i Dërguari i Allahut s.a.v.s. më tha: “Ç’veproi i zënuri duke marrë ushqim pa pyetur dje?” I thash: “O i Dërguari i Allahut, më tha se do të m’i mësojë disa lutje, të cilat nëse i them më ndihmon Allahu, dhe e lirova. “Cilat janë ato?” – më pyeti. I thash: Më tha: “Kur të biesh në shtrat lexoje Ajetul Kursijen, prej fillimit e deri në fund të ajetit - *“E Allahu La ilahe il-la huvel-Hajul Kajum”*. E më tha: “Nëse e thua këtë do të jetë Allahu mbrojtës i yti, ndërsa shejtani nuk mund të të afrohet deri në mëngjes”. i Dërguari i Allahut s.a.v.s. më tha: “E ka thënë të vërtetën edhe pse është rrenacak”. Pastaj më tha: “O Ebu Hurejre, po a e di kush ka qenë në ato tri herë?” I thash: “Po kush o i Dërguari i Allahut?” Më tha: “Ai ka qenë vet shejtani”.

## [39] - MËSIMË DHE PËRVOJË NGA SHOQËRIMI ME TË MIRËT

Shefik el Belhiju (i njohur si shërues i zemrave) një ditë i thotë nxënësit të tij - Hatem el Esamit: “Çka ke mësuar nga unë gjatë tridhjetë viteve?”

Hatem el Esami i thotë: “Kam mësuar gjashtë gjëra”:

*E para:* Kam parë njerëzit se ankohen dhe brengosen për çështjen e rizkut, ndërsa secili prej tyre është lakmues në atë që është te tjetri, e nuk e sheh se çka ka në vete. Ndërsa unë i jam mbështetur Allahut, duke u bazuar në fjalën e Tij: **“Dhe nuk ka gjallesë në tokë e që nuk e ka rizkun prej Allahut”**, sepse unë jam prej gjallesave dhe nuk e kam lodhur zemrën dhe mendjen time në atë që përkujdeset i Fuqishmi e i Forti.

- Shefiku i thotë: “Shumë mirë”.

*E dyta:* Kam parë se çdo njeri e ka nga një shok, të cilit ia shpalesë të fshehtat e tij dhe ankohet te ai, mirëpo asnjëri prej tyre nuk i mbulon sekretet dhe nuk i largon ndeshjet e kadereve, fatkeqësive. Ndërsa unë shok timin e kam bërë veprën e mirë, që të jetë mbrojtje në Ditën e Llogarisë, e cila më përforcon para Allahut të Lartmadhëruar dhe më ndihmon për ta kaluar urën e siratit.

Shefiku i thotë: “Shumë mirë”.

*E treta:* Kam parë se çdo njeri ka armik. E kam vështruar se ai, i cili përgojon nuk është armiku im; as ai, i cili më bën padrejtësi; madje as ai, i cili më bënë keq, sepse ata m’i dhurojnë të mira (shpërblime) e m’i marrin të këqijat e mia. Armik imi është ai, i cili më largon nga dëgjueshmëria e Allahut dhe më qon në mëkate. E ai është Iblisi, epshi dhe dynjaja. Këto i kam konsideruar armiq, prandaj jam ruajtur prej tyre, jam përgatitur



dhe jam armatosur për t'i sulmuar. Kështu që nuk e lë asnjërin prej tyre të më afrohet.

- Shefiku i thotë: “Shumë mirë”.

*E katërta:* Kam parë se çdo gjallesë kërkohet që ta japë jetën. E kërkues i shpirtit është Melekulmeuti dhe e kam përgatitur vetën që kur të takohem me të, të shkoj pa kurrfarë pengese.

- Shefiku i thotë: “Shumë mirë”.

*E pesta:* Kam parë njerëz që e donë njëri-tjetrin dhe që e urrejnë njëri-tjetrin. E kam vërtetuar se i dashuri nuk posedon asgjë nga i dashuruari. E për këtë arsye e kam hulumtuar shkakun e dashurisë e të urrejtjes dhe e kam zbuluar se ai shkak është trupi. Për këtë arsye e kam distancuar trupin dhe e kam larguar prej epsheve dhe dëshirave. E i kam dashur të gjithë njerëzit dhe nuk jam kënaqur me ta, pos me atë që do të kisha qenë i kënaqur me veten time.

- Shefiku i thotë: “Shumë mirë”.

*E gjashta :* E kam parë se çdo vendbanues do ta lë vendin e tij, e përfundimi i çdo banuesi është te varri. E jam përgatitur, me aq sa kam pasur mundësi, për të bërë vepra, të cilat më sjellin te ai vendbanim i ri, ku pas atij vendbanimi nuk ka asgjë tjetër pos xhenetit ose xhehenemit.

Në fund Shefiku i thotë: Kjo të mjafton dhe kështu vazhdo deri në çastin e fundit, deri në vdekje.

## **[40] - MENÇURIA E LEJTH BIN SEADIT**

Luelui, shërbëtor i Harun Reshidit, tregon se ka ndodh një zënkë në mes të Harun Reshidit dhe vajzës së axhës së tij Zebeijdes, dhe i ka thënë: “Nëse nuk jam prej banorëve të xhenetit, ti je e

shkurorëzuar”, e pastaj është penduar (për atë përбетim). Janë tubuar dijetarët dhe kanë dhënë mendime të kundërta rreth përбетimit të tij. Ai ju shkruan letër qyteteve të ndryshme (dijetarëve të tyre) dhe të gjithë vijnë para tij. Kur ata ulen para tij i pyet për përбетimin e tij “Ti je e shkurorëzuar, nëse nuk hyj në xhenet”. Ata bien në kundërshtim, ndërsa Shejhu nuk fliste fare, ai e kishte fjalën e fundit në vendkuvendim, ai ishte Lejth bin Seadi. Tregon shërbëtori: Harun Reshidi e pyet atë, e Lejthi i thotë: “Nëse Emiri i besimtarëve mbetet e të tjerët e lëshojnë vendkuvendimin, atëherë do të flas. Ashtu edhe vepruan. Thotë Lejthi: Më sillni Emirin e besimtarëve këtu, dhe ia sjellin. I thotë: “Je duke folur seriozisht?” Thotë: “Po”. Lejthi urdhëroi t’ia sjellin një mus-haf. Pasi që ia sjellin përpara thotë: “O Emir i besimtarëve, shfletojë deri sa të arrish te suretu “Err-Rrahman” dhe lexoje. Ai e lexoi suren deri sa e përfundoi ajetin e Zotit të Lartmadhëruar: **“Dhe kush i frikësohet madhësisë së Zotit të tij ai i ka dy xhenete”**. Aty i thotë: “O emir i besimtarëve ndalu, dhe thuaj: “Për Zotin (përбетohu)”. Kjo e shtrëngoi Harunin, e Seadi i tha: “O emir i besimtarëve, kusht është ta mbash (.....)”. Ai tha: “Pasha Zotin”, dhe u lirua nga përбетimi. Seadi i tha: “Thuaj: Unë i frikësohem dënimit të Zotit tim”. Ai i tha. Atëherë Seadi i thotë: “O emir i besimtarëve aty janë dy xhenete, e jo një”. Pastaj Luelui tregon: Dëgjuam duartrokitje dhe gëzim pas perdes. Atëherë Reshidi i thotë: “Mirë bëre”, - dhe e shpërbleu.

Ky veprim i Seadit është veprim fisnik dhe mençuri e rrallë, ku ndërthehet e drejta dhe sjellja e mirë në mes vete. Shihet se imami, Lejth bin Seadi, e ka kuptuar shkakun e shkurorëzimit, e ai shkak ka qenë se nuk ndodh shkurorëzimi i Reshidit, përderisa i frikësohet dënimit të Zotit të tij. Dhe e ka ditur se nuk lejohet të jepet fetva pa u vërtetuar sharti, e ai shart është frika ndaj Zotit të Lartmadhëruar. E kjo vërtetohet me përбетimin e Rashidit,

ashtu që të jetë i sigurt imami - Lejth se fetfaja e tij të jetë e drejtë. I largoi ata, të cilët ishin prezent, sepse ka mundur që ndonjëri prej tyre të përbetohet, e jo Rashidi. Po ashtu e ka shtyrë kur ka qenë dashur të përbetohet, sepse po të mos ia kishte përmendur shartin (kushtin), i cili ka qenë emanet prej tij, dhe pastaj të jetë i qetë dhe i sigurt. Përpos kësaj, Lejth bin Seadi nuk ka dhënë fetva prej vetvetes, por drejtpërdrejtë prej Kur'anit. Për këtë arsye i ka thënë të lexojë Mus-hafin, deri sa arriti deri te ajeti kur'anor ***“Dhe kush i frikësohet dënimit të Zotit të vet, ai ka dy xhenete”***. Me këtë i pushoi zemra Rashidit, dhe e ka kuptuar plotësisht se ka të drejtë të mbaj gruan e tij me tekst të qartë kur'anor, me fjalën e Allahut. Kjo është dhunti e vërtetë, dhe sjellje e drejtë e atij, i cili di dhe është i mençur.

## **[41] - TREGU I XHENETIT**

Ebu Hurejre r.a. e takon Seid bin Musejibin dhe i thotë: “Lus Allahun që të na bashkojë në tregun e xhenetit! Seidi tha: A ka në të (xhenet) treg? I thotë: Po, më ka treguar i Dërguari i Allahut s.a.v.s. se kur njerëzit do të hynë në xhenet, vendosen në to, varësisht prej veprave të mira të tyre, dhe thirren ata, përafërsisht, javë për javë të ditëve të kësaj bote, dhe e vizitojnë Allahun e Lartmadhëruar, i Cili iu paraqitet atyre nga arshi i Tij. Dhe vendosën në një bahçe prej bahçeve të xhenetit. U jepet rasti atyre të hipin në minbere prej minbereve me material të diamantit, me material të perlave, me material të floririt, me material të argjendit. Ulën mbi to, dhe mbi to ka aroma të miskut, kafurit dhe gjithçka është komode, pra karrige çka është më komfore për vendkuvendimin. Tregon Ebu Hurejre: I kam thënë të Dërguarit të Allahut s.a.v.s: “A do ta shohim Zotin tonë?” – “Po a dyshoni diçka kur e shihni diellin dhe hënën e re?” I thanë: “Nuk dyshojmë kurrsesi”. Atëherë, pra do ta shihni Zotin tuaj të Lartmadhëruar dhe çdo njëri, i cili do të jetë aty do

ta përjetojë kënaqësinë e shikimit të Allahut të Lartmadhëruar. E Zoti i Lartmadhëruar do t'i thotë ndonjërit: “O filan, a të kujtohet kur ke vepruar kështu e kështu?” Atij i kujtohen disa lëshime në jetën e tij, dhe thotë: “O Zoti im, a nuk po më falë?!” E Zoti i thotë: “Po, me faljen time ti e ke arritur këtë pozitë”. Dhe deri sa ata të jenë në atë gjendje, i mbulojnë ata retë dhe fillon mbi ta të bie shi i mirë, me aso arome që më pare kurrë nuk e kanë ndier. Pastaj Zoti thotë: “Tani vazhdoni dhe shihni çka kam përgatitur për ju, dhe merrni e merrni çka të dëshironi”. Tregon në vazhdim - shkojmë në një treg të mbushur me melek, ku janë aso të mira çka syri si ka parë, veshi nuk i ka dëgjuar dhe as njeriut në mend nuk ka mundur t'i shkojë.

Tregon: Dhe na jepet neve çka të dëshirojmë. Aty as nuk shiten gjërat, e as nuk blihen, por është vetëm treg simbolik ku takohen banorët e xhenetit dhe e shohin njëri-tjetrin; dhe shokun, i cili është në një pozitë më të lartë, e sheh shoku i tij në pozitë më të ulët, të cilit ia pëlqen rrobat e tij, dhe pa e përfunduar bisedën, i jepet çka ta mendojë, edhe më të mirë se ajo që e ka menduar. Kjo është për arsye që asnjëri të mos lakmojë dhe të mos jetë i pikëlluar. Pastaj kalojmë prej atij vendi dhe i takojmë gratë tona, të cilat na përshëndesin me: “Mirë se erdhët, mire se erdhët”. Na paskeni ardhur me rroba, veshje dhe erë më të mirë se sa kur keni shkuar!” Ndërsa ne i përgjigjemi: “Ne kemi qenë në venkuvendimin e Zotit tonë Madhështor, dhe e rendit ka qenë që të kthehemi kështu siç po na shihni!”.

*(TRANSMETON TERMIDHIU DHE KA THËNË HADITHI GARIBË.  
E KA TRANSMETU IBN MAXHE NË SUNENIN E TIJ. VËLL. I, fq. 207)*

## **[42] - O ZOTI IM MË RINGJALL ME KRAHË TË SHPENDIT**

Njeri prej udhëheqësve të luftës kundër romakëve tregon: “Isha udhëheqës dhe bëra apel për luftë në rrugë të Allahut. Një grua më erdhi dhe më dha një letër të mbyllur. E mora letrën ta lexoj dhe të shikoj se çfarë ka brenda. Kur e lexova në letër shkruante: “Bismilahirr-rrahmanirr-rrahimë. Prej muslimanes, robëreshës së Allahut deri te Emiri i ushtrisë muslimane, Selamullahi alejke: Dhe ... ti na ke bërë ftesë për luftë në rrugë të Allahut. Unë nuk kam mundësi të luftoj, dhe nuk kam fuqi për xihad (për shkak të pleqërisë), mirëpo në këtë letër i ke flokët e mia në bishtaleca, merri dhe bëji fre të kalit tënd, se ndoshta Allahu më shkruan shpërblimin e luftëtarëve në rrugë të Allahut. Tregon Ebu Kudame: E falënderova Allahun për qëndrimin e saj, dhe e kuptova se muslimanët e ndiejnë për obligim për t’u rreshtuar kundër armiqve të tyre. Para se të konfrontohemi me armikun, e vërejta një djalosh në moshën shumë të re, dhe mendova se ai nuk është për luftë, për shkak se ishte shumë i ri. Dhe shkova ta kthej prapë për të mirën e tij, kështu u tregova i mëshirshëm ndaj tij. E ai më tha: “Si po më urdhëron të kthehem, kurse Allahu i Lartmadhëruar ka urdhëruar: **“Shkoni në luftë, pa marr parasysh a është lehtë a rëndë”**”. Tregon Ebu Kudame: - E lejova. Pastaj ai mu kthye dhe më tha: “Më jep tri shigjeta”. I thashë atij: “Unë kam nevojë dhe dua këto shigjeta t’i kem vetëm unë. Por unë do të të jap çka të dëshirosh, me kusht, që nëse e ke fatin të biesh shehid të ndërmjetësosh për mua (tek Allahu), sepse ndieja diçka të posaçme ndaj tij”. Ai më tha: “Po, nëse dëshiron Allahu”. Pastaj ia dhashë tri shigjeta dhe ai u nis në drejtim të armikut me forcë dhe i flaktë. Dhe ai vazhdimisht u shkaktonte humbje atyre, derisa plagoset rëndë në fushëbetejë. Gjatë tërë ofensivës sytë e mi nuk janë ndarë nga ai djalosh, sepse e doja dhe kisha një ndjenjë të posaçme ndaj tij. Pas ofensivës, pasi që ishte i plagosur rëndë, shkova te ai dhe e pyeta: Për çka ke nevojë, për ujë apo për ushqim, mirëpo ai më tha: Jo, unë e falënderoj Allahun që po shkoj te Ai. Por, e kam

vetëm një dëshirë. I thashë: Do të ishte nder për mua që të ta plotësoj. Urdhëro çfarë dëshire ke. Deri sa i nxirrte frymëmarrjet e fundit të pastra më tha: “Përcjellja nënës sime selamin tim, dhe jepja këtë rrobë timen si shenjë”. I thashë: “Po cila është nëna jote o djalosh?” - Tha: “Nëna ime është ajo, e cila t’i ka dërguar flokët në bishtaleca për t’i bërë fre të kalit tënd, pasi që ajo nuk mundte të luftonte në rrugë të Allahut”. I thashë: “Zoti e bekoftë familjen tënde!” Dhe ai dha shpirt. Fillova t’i kryej obligimet që i kisha ndaj tij. Kur e vendosa në varr, toka foli dhe e ngriti mbi vete, pastaj prapë e thellova varrin, por prapë toka foli dhe e nxori mbi varr, pastaj edhe për të tretën here e vendosa në varr dhe toka nuk e pranoi, por e nxori mbi varr. Thash me vete, mos ndoshta ka ardhur në luftë pa pëlqimin e nënës së tij. I fala dy rekate dhe e luta Allahun që të ma sqarojë çështjen e këtij djaloshi. Pastaj dëgjova një zë, i cili thoshte: “O Ebu Kudame lëre të qetë të dashurin e Allahut”. Dhe u largova se e kuptova që tani ai është mu në duart e Allahut. Dhe përderisa qëndruam larg prej tij, kur një shpend u afrua dhe e mbërtheu me krahët e tij dhe e ngriti lartë. U habita për së tepërmi. Pastaj shkova te nëna e tij për t’ia kryer porosinë. Kur më pa nëna e tij më tha: “Çfarë lajmi ke o Ebu Kudame? Më ke ardhur për ngushëllim apo për përgëzim?” - I thashë: “Çfarë do të thotë kjo?” - Tha: “Nëse biri im ka vdekur, atëherë ke ardhur për ngushëllim, ndërsa nëse është vvarë në rrugë të Allahut, dhe e ka fituar dëshmorinë, ke ardhur për përgëzim. Ia tregova ngjarjen e tij dhe trimërinë e tij në betejë, dhe për dëshmorinë, e pastaj si ka vepruar shpendi. Tha: “Ja paska plotësuar Allahu lutjen e tij”. - I thashë asaj: “Po cila dua?” - Tha: “Ai kur ishte në namaz dhe i vetmuar, bënte lutjen ditë e natë: “O Zoti im! Më tubo në krahët e shpendit”. U largova nga ajo dhe e kuptova se pse Allahu na ka shpërblyer me fitore kundër armiqve.

## **[43] - MOS DËGJO ÇKA THONË TJERËT**

Nasradini dhe djali i tij gjithmonë ishin në kundërshtim mes vete dhe çdo here kur e urdhëronte diçka birin e tij, ai ia kthente: “Po e di çka thonë njerëzit nëse punoj ashtu. Nusradini si babë dëshironte t’i jepte mësim praktik, nga i cili do të kishte dobi, dhe të largohej nga paragjykimi se çka thonë njerëzit, e mos t’u shkojë për shtati atyre, sepse atë asnjëherë nuk do ta arrinte. Kështu ai hipi në gomar dhe i tha birit të tij të shkonte pas tij. Dhe, deri sa ai hipur në gomar, e biri ecte pas tij në këmbë, kalojnë pranë disa grave, të cilat filluan t’i bërtasin Nasrudinit: “Çka është puna me ty ore njeri, a nuk ke kurrfarë mëshire me shpirt, ti hipur në gomar, ndërsa pas teje ky djalosh i lodhur e i raskapitur?!” Atëherë Nasrudini zbriti dhe i tha djalit: “Hip ti në gomar”. Derisa kalonte pranë disa pleqve, të cilët rrinin ulur në diell, i ranë njerit-tjetrit në duar dhe ia tërhoqën vëmendjen të tjerëve duke menduar se çka është puna me këtë njeri të çmendur, i cili e ka hipur të birin e vet, ndërsa vet ec me këmbë pas tij. Njeri tha: “O njeri, ti plak të ecësh në këmbë, ndërsa ky djaloshi të hipë në gomar, a kështu i mësohet edukata dhe mirësjellja?! Atëherë Nasrudini i thotë birit të tij: “Ai i dëgjove? Eja pra të hipim që të dy së bashku.” Hipin dhe kalojnë pranë disa njerëzve, të cilët kanë mëshirë ndaj kafshëve (vegjetarian) dhe i bërtasin atij dhe birit të tij: “A nuk po i frikoheni aspak Allahut për këtë kafshë të gjorë, e i kini hipur që të dy këtij gomari, ku secili prej jush e ka peshën më të rëndë se vet gomari?!” Atëherë Nasrudini zbret, e zbret edhe të birin dhe i thotë: “A i dëgjove? Eja pra të ecim së bashku në këmbë, dhe gomari të ecë para nesh, që të mos na kritikojnë as gratë, as pleqtë, e as vegjetarianët”. Dhe vazhduan rrugën duke ecur gomari para, ndërsa ata dy pas tij; kur takohen me një grup të njerëzve të këqij, të cilët mezi kishin pritur që këtë rast ta marrin

si lojë e zbavitje, e thoshin: “Për Zotin, ky gomar për çka tjetër është, përpos se për t’i hipur dhe për të mos u lodhur në rrugë”. Dhe këtu përfundon tregimi me mesazhin se: Pasi që Nasrudini i dëgjoi fjalët tyre, ai me birin e tij shkojnë te një lis rreth rrugës, e pret një degë të trashë të atij trugu dhe ia hodhi gomarit, ndërsa një degë tjetër e merr vet, si dhe një degë tjetër ia ngarkon birit të vet. Dhe nuk kalojnë gjatë rrugë, deri sa i shohin një grup të njerëzve duke qeshur me pamjen e tyre të veçantë, dhe njeri i lajmëron në polici, e polici i konsideron se jam çmendur dhe i dërgon në spitalin e të çmendurve.

Pasi që Nasrudini përfundon në burgun e të çmendurve ia sqaron birit të tij përfundimin e eksperiencës së tij, duke i thënë: “O biri im! Kështu është përfundimi i atyre, të cilët dëgjojnë thashethemet dhe punon ashtu siç ia ka ënda të tjerëve. Këtë mësim praktik të Nasrudinit është trashëgimi, të cilën e kanë ruajtur gjeneratë pas gjenerate.

## **[44] - TREGIMI I LOPËS DHE DJALIT, I CILI ËSHTË SJELL MIRË ME NËNËN E TIJ**

Ishte një pasanik i beni israilëve, i cili e kishte djalin e vëllait të varfër, mirëpo ky (i pasuri) nuk kishte trashëgimtar tjetër, pos këtij (të varfërin). Mirëpo, pasi që jeta e tij shihej se sa do të zgjaste, djali i vëllait e mbyt për t’ia marr trashëgiminë dhe



shkon e hedh kufomën në një fshat tjetër. Pasi që e hodhi atë në greminë, të nesërmen shkon në atë fshat dhe ua kërkon pagimin e gjakut. Fshatarët e atij vendi shkojnë te Musa a.s. dhe kërkojnë prej tij që ta lutë Allahun që t'ia tregojë vrasësin. Ai i urdhëron me pre një lope, duke u thënë atyre: **“Vërtetë Allahu ju urdhëron juve që të prenë një lopë. Ata i thanë: A po tallesh me ne?!”,** pra deri sa ne po kërkojmë prej teje zgjedhjen e problemeve për një të vrarë, ndërsa ti ende po tallesh me ne!

Musa i thotë: **“Kërkoj mbrojtje prej Allahut, që unë të jem prej aso injoranteve”,** – pra prej talljes me besimtarët. Kur njerëzit e kuptuan se prerja e lopës është urdhër i Allahut të Lartmadhëruar, atëherë ata e morën atë përgjegjësi, e në atë veprim ka rezultuar urtësi e madhe. Kjo nga arsyeja se një njeri i mirë prej beni israilëve, i cili e kishte pasur një familje dhe një viç, e merr viçin dhe e shpie në një mal të pashkelur dhe thotë: “O zoti im, këtë viç po e lë në dorën Tënde, për familjen time kur të rritet”, dhe pas pak ai vdes. Kështu viçi kalon në atë pyll vite të tëra, dhe ikte nga çdo njëri, sa që askush nuk mund ta shihte. Kur djali i tij rritet, sillej mirë me nënën e tij. Ai natën e ndante në tri pjesë. Në një pjesë falej, në një pjesë flinte dhe në një pjesë ulet te koka e nënës së tij. Në mëngjes barte dru me shpinën e tij, i shitte në treg sa kushtonin. Pastaj prej atij fitimi një të tretën e jepte sadaka, një të tretën e shpenzonte për vete dhe familjen, ndërsa një të tretën ia jepte nënës së vet. Një ditë prej ditëve nëna i thotë: “Babai yt ta ka lënë në trashëgim një viç, të cilin e ka dërguar në një pyll. Shko në atë pyll dhe thirr: “Për zotin e Ibrahimit, Ismailit e Is-hakut, që të kthehet te ti. Shenjë e atij viçi është se kur ta pashë shkëlqen aq shumë, sa që do të të duket se prej qimeve të saj po dalin rrezet e diellit, ai quhet viçi i arit për shkak të shkëlqimit dhe bukurisë së tij. Shkon në atë pyll dhe e sheh duke kullotë dhe e thërret me të madhe: “Po të thërras, për Zotin e Ibrahimit Ismailit e Is-hakut e të Jaekubit”. Ajo i shkon pranë, e kap për qafe dhe niset për në

shtëpi. Duke ecur lopa (viçi i cili është rritur) me lejen e Allahut flet: O djalosh, i cili sillesh mirë me nënën tënde! Hip mbi mua se do ta kesh më lehtë gjatë udhëtimit”. Djaloshi ia kthen: “Nëna ime nuk më ka thënë ashtu siç po kërkon ti për të të hipur, por më ka thënë që të të mbaj për qafe”. Lopa i thotë: “Për Zotin e beni israilëve, po të kishe hipur kurrë nuk do të më kishe parë pastaj. Vazhdo rrugën se po që se edhe kodrën e urdhëron që të shkulet në rrënjë, do të shkulej dhe do të ecte me ty për shkak të mirësjelljes tënde ndaj nënës”. Djaloshi pastaj shkon te nëna e vet me të. Nëna i thotë: “Je i varfër, nuk ke pasuri dhe duke bart dru po lodhesh dhe po mundohesh shumë gjatë ditës, e pastaj po falesh natën. Prandaj shko dhe shite këtë lopë. (Djaloshi) i thotë: “Po sa ta shesë?” Nëna i thotë: “Tre dinar, e për çdo ndryshim të çmimit të mos e shesësh pa u konsultuar me mua”. Çmimi i lopës ishte tre dinarë, dhe shkon në treg për ta shitur me atë çmim. Allahu e dërgon një melaqe në formë të njeriut për ta sprovuar dhe për ta vërtetuar se ai asgjë nuk vepron në kundërshtim me fjalën e nënës së tij. Sepse Allahu është i informuar për gjithçka. Melaqja në formë të njeriut e pyet: “Sa e shet këtë lopë?” Ai i thotë: “Tre dinar, dhe atë nëse me këtë çmim pajtohet nëna ime”. Melaqja i thotë: “Po e blej për gjashtë dinarë, por pa u konsultuar me nënën tënde”. Djaloshi i thotë: “Po edhe nëse sa pushon kjo lopë më jep ari, nuk e jap pa u pajtuar nëna ime”. Shkon te nëna dhe ia tregon. Nëna i thotë: “shko dhe shite me atë çmim dhe thuaj se edhe unë pajtohem”. Shkon në treg e takon Melaqen, e cila i thotë: “a u konsultove me nënën tënde?” Djaloshi i thotë: “Ajo më ka thënë që mos ta shes më pak se gjashtë dinarë pa u konsultuar me të, për më pak ose më shumë”. Melaqja në formë të njeriut i thotë: “Po e blej për dybëdhjetë dinarë”. Djaloshi e refuzon dhe kthehet te nëna e vet dhe ia tregon rastin. Nëna i thotë: “Ai i cili ka dashur ta blej është melaqe në formë të njeriut për të të testuar. Nëse edhe

një herë të vjen thuaj: “A ta shesim këtë lopë apo a jo?” Ashtu edhe veproi, e Melaqja i thotë: “Shko te nëna jote dhe mbaje këtë lopë, sepse Musa i biri imranit do ta blejë këtë lopë, për shkak të një të vrari, i cili është vrarë prej beni israilëve dhe mos ia shitni pa ju dhënë aq dinarë sa peshon një vagë. Kështu që (lopën) e mbajnë. Allahu e ka caktuar që ajo lopë të prehej prej beni israilëve, sepse ato cilësi të cilat ia kërkonin ishin vetëm te ajo lopë me qëllim që ai të shpërblehej për shkak të mirësjelljes ndaj nënës së tij, për shkak të nderimit dhe mëshirës ndaj saj. Dhe e blejnë me ari aq sa ka peshuar dhe e presin, e pastaj me një pjesë të saj i mëshojnë të vrarit, ashtu siq ka i ka urdhëruar Allahu atëherë i vrari ngritet i gjallë në këmbë me lejen e Allahut dhe thotë: “Me ka vrarë filani (djali i vëllait), pastaj prapë bie dhe në atë moment vdes. Atëherë atij (djalit të vëllait) i ndalohet për të trashëguar pasurinë e axhës së tij.

## **[45] - DËNIMI DHE BEGATIA NË VARR**

Nga Berra bin Azib transmetohet: “Kemi prezantuar me të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. në (përcjelljen) një kufomë të Ensarëve. Pasi shkuam te varri dhe ende pa e mbuluar, u ul i Dërguari i Allahut s.a.v.s., dhe ne u ulëm rreth tij, dhe u bë sikurse mbi ne u mbush me shpend, e ai tha: “Kërkoni mbrojtje prej Allahut nga dënimi në varr”, këtë e përsëriti dy-tri herë.

Pastaj vazhdoi: “Me të vërtet kur besimtari ndahet nga kjo botë dhe shkon në botën tjetër, atij nga qielli i zbresin melaqe me fytyra të bardha, fytyrat e të cilëve shndrisin si dielli; me vete kanë rroba të bardha, erë të mirë të xhenetit; ulen në largësi prej tij sa sheh syri. Pastaj i shkon melaqja, e cila i merr shpirtrat, ulet te koka e tij dhe i thotë: - O ti shpirt i mirë, dil se je i falur prej Allahut dhe ke fituar kënaqësinë e tij. Pastaj vazhdoi duke treguar, - dhe i del shpirti sikurse del një pike uji prej burimi, dhe kur t’ia merr shpirtin ia merr me aq lehtësi sa që nuk hetohet, e pastaj e marrin melaqet, e veshin me ato rroba, me atë erë të mirë, dhe prej tij del shpirti si një frymëmarrje me erë misku të kësaj bote. Pastaj ka vazhduar duke treguar, - dhe ngriten lartë me të, dhe sa herë që kalojnë pranë një grupi të melaqeve, ato pyesin: - Po, çka është kjo erë e mirë?! Ata i përgjigjen: - Filani i biri i filanit, duke e emëruar me emrat më të bukur të tij, me të cilat e kanë thirrur në këtë botë; deri sa ta kalojnë qiellin e kësaj bote, në fillim të botës tjetër. Aty kërkojnë t’u hapen dyert dhe ju hapet dera, e cila shndrit tërë qiellin paraprak, e deri te qielli i ardhshëm, e kështu me radhë, derisa arrijnë te qielli i shtatë, ku Zoti i Lartmadhëruar thotë: “Shkruajeni librin e robit tim në *ilijnë*, dhe kthejeni prapë në tokë, se prej saj ju kemi krijuar, në të do t’ju rikthejmë. Pastaj vazhdoi duke treguar: - Dhe i kthehet shpirti në trupin e tij, pastaj i shkojnë prapë dy melaqe, ulen pranë tij dhe e pyesin: - Kush është Zoti yt? Ai përgjigjet: - Allahu është Zoti im.. Pastaj e pyesin: - Cila është feja jote? Ai përgjigjet: - Feja ime është islami. Pastaj e pyesin: - Çka thua për Pejgamberin, i cili u është zbritur juve? Përgjigjet: I Dërguari i Allahut s.a.v.s. Pastaj e pyesin: - Cilën dituri e ke pasur për bazë. Ai përgjigjet: - E kam lexuar librin e Allahut, i kam besuar, e kam dëshmuar dhe vërtetuar. Atëherë thërret një zë nga qielli: - Robi e ka thënë të vërtetën, andaj shtrojani rrugën e xhenetit, visheni me rroba të

xhenetit, dhe hapjani dyert e xhenetit. Dhe prej erës dhe aromës së tij i zgjerohet varri në gjerësi sa sheh syri. I vjen një njeri me pamje të bukur, rroba të bukura, erë të mirë dhe i thotë: - Përgëzohu me atë, i cili të ka gëzuar sot me atë që të ka premtuar. I thotë: Po kush jeni ju që po më jep lajme të mira?! Ai i përgjigjet: - Unë jam vepra e jote e mirë. Atëherë ai thotë: - O Zoti im! Le të bëhet Kijamet që të kthehem sa më shpejt te familja dhe pasuria ime ... .

Pastaj (I Dërguari i Allahut a.s.) vazhdoi duke treguar: Pabesimtari kur të ndahet prej kësaj bote dhe shkon në botën tjetër, i shkojnë melaqet prej qielli me fytyrë të zezë, rroba të zeza, ulen pranë tij në largësi sa sheh syri, pastaj i vjen melaqja për t'ia marrë shpirtin, ulet te koka e tij dhe i thotë: - O ti shpirt i keq, dil se Allahu është i hidhëruar me ty, dhe i del shpirti prej trupit sikurse hekuri i zjarrtë kur flakërohet prej leshi, dhe ia merr.

Çdo herë kur të kalojnë pranë ndonjë grupi të melaqeve pyesin: - Çka është kjo erë e keqe? I përgjigjen: - Filani i biri i filanit, pra me emrin, me të cilin e kanë thirrur në këtë botë deri sa arrin në fund të qiellit të kësaj bote, kurse porta nuk hapet. Pastaj i Dërguari i Allahut s.a.v.s. e lexo ajetin kur'anor:

***“... atyre nuk u hapen dyert e qiellit dhe nuk do të hyjnë në xhennet deri të përbirojnë deveja nëpër vrimën e gjilpërës...”***

*(El-E'arafë, 40)*

Pastaj Allahu thotë: - Shkruajeni në librin Sixhinë të tokës së thellë, pastaj shpirti tronditet dhe thotë:

***“... e kush i përshkruan shok All-llahut, ai është sikur të bie nga qielli e ta rrëmbejë shpendi, ose si ai të cilin e gjuan era e stuhishme në ndonjë vend të humbur”***

*(El-Haxh, 31)*

Shpirti kthehet në trupin e tij, shkojnë dy melaqe, ulen pranë tij dhe e pyesin: - Kush është Zoti yt? Ai nuk di të përgjigjet por thotë: - Ah, ah, nuk e d! Pastaj e pyesin: - Cila është feja jote? Ai

thotë: Ah, ah, nuk e di! Pastaj e pyesin: - Cili pejgamber është dërguar te ju? Ai thotë: Ah, ah, nuk e di! Thërret një zë nga qielli dhe thotë: - Ai është përgënjeshtues, andaj shtrojani rugën e zjarrit, hapjani dyert e zjarrit. Atëherë i vjen nxehtësia dhe vapullimi e përvëlimi, dhe aq shumë i ngushtohet varri, sa që ia thyen edhe eshtrat. I shkon pastaj një njeri me fytyrë të keqe, rroba të këqija, erë të keqe dhe i thotë: Lajm i keq për ty, sot është një ditë e kobshme, e cila ka qenë e premtuar më pare. Ai thotë: - Po kush je ti, i cili ke ardhur me më sjellë kob? Ai ia kthen: - Unë jam vepra jote e keqe, e ai thotë: - O Zot, le të mos bëhet kurrë Kijameti.

(TRANSMETON BEJHEKIU ME ISNAD SAHIH)

## [46] - VLERA E MIRËSISË NDAJ FAMILJES SË DËSHMORIT

Tregohet prej Alevijinëve se një Alevi ka shkuar në një vend të huaj, ai e kishte gruan edhe vajzat. Kishin jetë të mirë dhe pasuri të mjaftueshme. Mirëpo, burri i vdes, e pastaj gruaja me fëmijë varfërohen aq shumë sa që nuk kishin asgjë. Atëherë gruaja me vajzat e saj shkojnë në një vend tjetër, sepse frikohej nga e njerëzit këqij. I merr fëmijët dhe i vendosë në një xhami të lënë pas dore, sepse ishte ftohtë i madh dhe shkon për të kërkuar ushqim.

Ndihmë kërkon prej dy njerëzve: Njëri ishte musliman dhe më i dalluari i qyteti dhe tjetri zjarrputist (pabesimtar). Ndihmë kërkon prej muslimanit, duke ia treguar kushtet e saj të vështira dhe se ajo ishte alevije e ndershme, dhe nuk kërkon asgjë tjetër prej tij, pos ushqim për fëmijët e saj. Ai i thotë: - Më sill argument se me të vërtetë je alevije e ndershme. Ajo i thotë: - Po unë në këtë vend jam e panjohur dhe askush prej këtij

vendi nuk më njeh. Ai largohet prej saj, ndërsa ajo kthehet e përbotur dhe e pikëlluar.

Shkon te një zjarrputist, të cilit ia tregon gjendjen e saj. Ai e dërgon gruan e vet për t'i marrë atë dhe vajzat e saj, i ushqen si është më së miri, i vesh me rrobat më të mira, dhe vazhdojnë të banojnë si është më së miri te ai.

Kur arrin mesi i natës, muslimani sheh ëndërr sikur Kijamet ka ndodhur, ndërsa në kokë të Pejgamberit s.a.v.s. valonte flamuri, i cili gjendej në një kështjellë rreth e rrotull me gjelbërim; muret prej diamantit, kubet prej diamanti, dhe i thotë: “E kujt është kjo kështjellë?” - i Dërguari i Allahut s.a.v.s. i thotë: “E njeriut musliman, i cili beson në Zotin Një”. E ai i thotë: “O i Dërguar i Allahut, po unë jam musliman, i cili besoj në Zotin Një”. - I Dërguari i Allahut s.a.v.s. e pyet: “A ke ndonjë argument të qartë se ti je musliman dhe beson në Zotin Një?!” Ai fillon të mendojë. Atëherë i Dërguari i Allahut s.a.v.s. i thotë: “Kur erdhi te ti gruaja alevije, për të kërkuar ndihmë, i ke thënë asaj për të të sjellë argument se ti je musliman”.

Njeriu zgjohet nga gjumi i pikëlluar, nga shkakut se e kishte kthyer prapë gruan nevojtare. Pastaj del nëpër qytet për të pyetur për të se ku është, derisa e kupton se ajo është te zjarrputisti (pabesimtari). Shkon te ai dhe i thotë: “Dua që të ma sjellësh gruan e ndershme alevite dhe vajzat e saj!”. Njëherit i thotë: “Ja merri njëmijë dinarë, vetëm ma dorëzo të përkujdesem unë për të”. - Ai i thotë: “Kurrë!” Ai i thotë: “Patjetër ke për të m'i sjellë”. - Ai i përgjigjet: “Atë që e dëshiron ti, unë jam më meritori. Kështjellën e xhenetit, të cilën e ke parë ti është për mua”. - Por, a po më tregon ti se a je musliman apo zjarrputist?” - “Po për Zotin, asnjëri prej familjes sime, e as unë nuk kemi ra në gjumë pa e pranuar fenë islame prej dorës së kësaj gruaje të ndershme dhe fisnike. Pasi kam rënë të flejë, kam parë në ëndërr atë që ke parë edhe ti. E i Dërguari i Allahut s.a.v.s. më ka pyetur: “Gruaja alevite me

vajzat e tua është te ti?” - I thashë: “Po, o i Dërguari i Allahut”. - i Dërguari i Allahut s.a.v.s. më tha: “Atëherë kështjella është e jotja dhe e familjes tënde; ti dhe familja jote jeni prej banorëve të xhenetit, Allahu prej krijimit tuaj ju ka caktuar që ju të jeni musliman”.

Kështu muslimani largohet i pikëlluar aq shumë dhe i brengosur, aq sa vetëm Allahu e di. Shikoni begatitë e mirësisë ndaj familjes së dëshmorit dhe jetimëve, dhe të mirat që vijnë pas tyre!

### [47] - TREGIMI I HAJNIT DIJETAR DHE DIJETARIT

Tregohet se Gjykatësi i *Antalijës* një natë del për të shkuar në arën e tij dhe, duke kaluar nëpër qytet, i del një hajn përpara, i cili i thotë: - Hiqi çka ke me vete, se për ndryshe do të ndodhë çka është më e keqja. Gjykatësi i thotë: Zoti të ndihmoftë, po dijetarët janë të shenjtë, e unë jam gjykatësi i këtij vendi, e më liro. Hajni i thotë: - E falënderoj Allahun që më ka mundësuar që ty të të zë, sepse unë jam i sigurt se kur të kthehesh në shtëpi ke rroba dhe kafshë të mjaftueshme, e të kishte qëlluar tjetër, pos teje, ndoshta do të kishte qenë i dobët në gjendje të vështirë dhe i varfër. Gjykatësi i thotë: - Po e shoh se jeni i mprehtë nga goja. I thotë: - Po, “*mbi çdo të ditur ka edhe më të ditur*”. Gjykatësi i thotë: - Po çka thua ti për hadithin, të cilin e kanë transmetuar se i Dërguari i Allahut s.a.v.s ka thënë: “*Feja është fe e Allahut, robërit janë robërit e Allahut, suneti është suneti im, e kush bën bid'at ai është i mallkuar prej Allahut*”. E bllokimi i rrugëve dhe vjedhja e pasurisë janë bid'at, e unë po ta shpalosi të vërtetën që të mos fitosh mallkimin e Allahut. Hajni i thotë: - O i nderuar im gjykatës, ky është hadith hadith



MURSEL, nuk është transmetuar as nga Nafiu, as nga Ibn Umeri. Po edhe të kishte qen i pranuar si i vërtetë (*as i shkëputur, e edhe transmetuesi i drejtë*) çka të bëjë hajni, i cili nuk ka ushqim fare e nuk ka mundësi për ta siguruar vetes asgjë, ndërsa çka është e jotja është hallall për mua, sepse transmeton Maliku nga Nafiu, e ai nga ibn Umeri r.a. se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: “Po të kishte qenë e tërë bota e përgjakur do të kishte qenë ushqimi i besimtarëve hallall”. Për këtë janë pajtuar të gjithë dijetarët e nuk ka asnjë kundërshtim mes tyre, për atë kur njeriu shpëton veten dhe familjen nga vdekja me ushqimin apo pasurinë e tjetrit. E unë për Zotin kam frikë nga Allahu se mund të vdes urie, ndërsa me atë që e ke ti më shpëton nga vdekja mua dhe familjen time, prandaj ma dorëzo mua çka ke dhe pastaj ec i lirë. Gjykatësi i thotë: - Pasi që e ke gjendjen ashtu, më lejo të shkoj te ara ime e t’u them robërve dhe shërbëtorëve të mi që të të sjellin rroba për të ta mbuluar trupin, dhe të të jap çka kam unë. Hajni i thotë: - I mjeri ti, po ti je tani si zogu në kafaz, nëse del prej kafazit të del prej dore, e po kam frikë se nëse të liroj nuk do të të më japësh asgjë pastaj. Gjykatësi i thotë: - Të betohem se do të të veproj ashtu siç thash. Hajni i thotë: - Na ka treguar hadithin Maliku, e ai nga ibn Umeri se Muhamedi s.a.v.s ka thënë: **“Përbetimi i të detyruarit është i pavlefshëm”**, e Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: **“Përpos atyre që janë të detyruar, por zemrat e tyre i kanë plot iman”**. E po kam frikë se po e merr këtë kuptim, e më mirë më jep çka ke. Gjykatësi ja jep kafshën dhe rrobat, përpos pantallonave. Hajni i thotë: - Hiqi dhe dorëzoji edhe pantallonat. Gjykatësi i thotë: - Është koha e namazit, e i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: - **Është i mallkuar ai, i cili shikon pjesët e turpshme të vëllait të tij**. E tani lakuriq i zhveshur, lakuriq nuk falet, se Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: “Vishuni mirë para se të shkoni (të faleni) ne xhami”. Komentimi ka të bëjë me rroba gjatë namazit. Hajni i thotë: - Namazi yt do të jetë i plotë, se na

ka tregu Maliku e ai nga Nafiu, e ai nga ibn Umeri se i Dërguari i Allahut s.a.v.s ka thënë: “Lakuriqët falen në këmbë e *imami* qëndron në mes tyre”. Maliku thotë se nuk falen në këmbë, por falen larg njëri-tjetrit, të ndarë aq sa asnjëri nuk ia sheh pjesët e turpshme tjetrit. Ebu Hanife thotë se falen ulur, ndërsa sa i përket hadithit të cilin e citova, është hadith mursel, po edhe nëse pranohet ka të bëjë me raste kur shikohet me epsh. Ndërsa ti je në gjendje të jashtëzakonshme, nuk ke zgjidhje tjetër. A e di se femra e pastron organin seksual të saj prej ndyrësisë dhe është e pamundur pa e pa, po ashtu edhe mashkulli kur rruhet rreth organit seksual. Njeriu e bën sunet tjetrin po ashtu edhe mjeku gjatë mjekimit. Pasi që është puna kështu, atëherë gjykatësi nuk është kushtëzuar. Gjykatësi i thotë: - Ti je gjykatës e unë i akuzuar, dhe ti je dijetar, ti je mufti, e unë pyetës. Merr çka të duash. “La Havle ve la kuvete il-la bil-lah!”. Hajni i merr pantallonat dhe rrobat e shkon. Gjykatësi tregon se: - Ai është prej *fukahave* (dijetarëve) me famë. Ai ka pritur shumë deri sa e ka realizuar çka ka dashur. Ia dërgon një njeri i shpreh nderim dhe mirënjohje dhe e shpërblen për angazhimin e tij.

## [48] - EDUKATA E EBU HANIFES

Jeid bin Haruni ka thënë: “Nuk kam parë njeri më të edukuar se Ebu Hanifen. Një herë e kam parë duke qëndruar në diell pranë derës së një njeriu, e i kam thënë: “O Ebu Hanife hyr nën hije të murit”. E ai më tha: “Ky mur është mur i kësaj shtëpie, e unë nuk dua të rri nën hije të shtëpisë së tij (për shfrytëzuar hijen e shtëpisë së tij)”. Po ku ka edukatë më të mirë se kjo? Në një variant tjetër thuhet se i ka thënë: Çka të pengoi që të mos hysh nën hije? E Ebu Hanifja i ka thënë: - Pronarit të kësaj shtëpie i

kam diçka që e urrej, e unë nuk desha të qëndroj nën hijen e murit të tij, e për se ta shfrytëzoj. Këtë nuk e shoh se është detyrë e njerëzve, por dijetari ka nevojë që prej diturisë së tij të marrë më shumë për vete, se sa t’u japë njerëzve apo të kërkojë prej të tjerëve.

Ebu Hanife, Zoti e pastë mëshiruar, nuk e ka ngrënë mishin e deleve shtat vite, për shkak se kur ka dëgjuar se në Kufe ka humbur një dele, pasi që ka pyetur dhe ka marrë përgjigje se në përgjithësi delja jeton aq vite. Pra, i kanë thënë 7 vite, e ai 7 vite nuk ka ngrënë mish dele fare, duke llogaritur se ndoshta ai mish është i deles haram, e pastaj i bë dëm apo padrejtësi zemrës së tij, edhe pse nuk është haram të hash diçka të ndaluar nga mosdija.

## [49] - SHKOPI INTERESANT

Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë: Një njeri nga beni israilët ia kërkoi një beni israilit tjetër 1000 dinarë. Ai i thotë: “Sillmi dy dëshmitarë le të dëshmojnë.” Ai i thotë: “A mjafton që vetëm Allahu të jetë dëshmitar.” Ai i thotë: “Sillma hipotekën.” Ai i thotë: “Mjafton që Allahu të jetë garantues.” I thotë: “Të vërtetën e the”, dhe ia jep për një afat të caktuar. Kaloi në anën tjetër të detit, *kreu punën me to*. Kur erdh afati kërkoi anije për t’ia quar në afatin e caktuar, mirëpo anije nuk kishte. Atëherë e merr një dërrasë, e shpon dhe i shti brenda 1000 dinarë dhe letrën (të shkruar) prej filanit te filani. “ mbyll mirë e tha: “O Zoti im! Ti e di kur i kam marrë borxh prej filanit 1000 dinarë, i cili kërkoi garancion, e unë i thashë që garantues të jesh Ti o Zoti im, dhe ai u pajtua për këtë. Ai më kërkoi dëshmitarë, unë i thashë mjafton që dëshmitar të jesh Ti o Zoti im, dhe ai u pajtua me këtë. Mirëpo unë u mundova të gjej anije

për t'ia larë borxhin, por nuk gjeta. Për këtë arsye po i dorëzoj tek Ti, dhe e hodhi në det". E përcolli deri sa u largua, dhe përfundimisht nuk gjeti anije. Në anën tjetër, njeriu, të cilit i kishte marrë borxh, shikon mos ka ardhur ndonjë anije duke pritur kthimin e borxhit. Por, e sheh vetëm një shkop, në brendinë e të cilit ishte malli. Duke tubuar dru për familjen e tij, dhe duke i thyer (qarë drutë) i gjeti 1000 lirat dhe letrën. Pas një kohe vjen borxhmarrësi me 1000 dinarë tjera dhe i thotë: "Për Zotin, pandërprerë kam kërkuar anije për të ardhur dhe për të t'i sjellë të hollat, mirëpo ishte e pamundur. Deri sa sot e takova një anije dhe erdha". Ai i thotë: "Vallë mos më ke dërguar mua diçka?" Tha: "Të tregova se nuk kam mundur të gjej anije deri sot." I tha: "Zoti e ka la borxhin në vend tëndin, i cili e ka dërguar shkopin (me të holla). E ti me 1000 dinarët tjera vepro si të duash në rrugë të hajrit."

## [50] – DUAJA NË RREZIK FATKEQËSIE

Tregohet se njëri prej ensarëve, i cili ishte shok i pejgamberit s.a.v.s. që quhej Eba Muglik, ishte tregtar, dhe tregtonte me mallin e tij dhe mallin e të tjerëve në vende të largëta. Ishte mistik, i devotshëm. Njëherë shkon për tregti dhe në mes të rrugës e ndalon një hajn kriminel, me armë në dorë. Hajni i thotë: "Gjithçka që ke lëshoji në tokë se përndryshe të vras!" Ai i thotë: "Çka dëshiron: pasurinë apo pasurinë dhe jetën time?" Ai i përgjigjet: "Pasininë veç do të ta marr, por edhe do

të të vras”. Ai i thotë: “ Më lejo që para ekzekutimit tim t’i fali katër rekate namaz”. Hajni i thotë: “Po”. Ai mori abdest, pastaj i fali katër rekate. Në fund të namazit në sexhden e fundit u lut: “O Zoti im i dashur, o Mbajtës i Arshit famëlartë! O Ai, i Cili vepron ç’të duash, - të lutem për hir të madhërisë Tënde të pakufishme dhe për hir të dritës Tënde, e cila përfshinë arshin Tënd, që të më mbrosh nga e keqja e këtij krimineli hajn; O ndihmëtar më ndihmo, o ndihmëtar më ndihmo, o ndihmëtar më ndihmo!”

Kur në ato momente paraqitet një kalorës dhe me të shpejtë ia largon shpatën (hajnit), të cilën e kishte afruar mbi kokën time. Kur e shikon hajni, ai me të shpejtë i bie hajnit dhe e mbytë. Pastaj ky kalorës i afrohet tregtarit të drejtë dhe të devotshëm dhe i thotë: “Ngritu”. Tregtari e pyet: “Po kush jeni ju, i cili nëpërmjet Allahut më ndihmon?” Ai i përgjigjet: “Unë jam melek i katit të katërt të qiellit. Kur e ke bërë lutjen e parë, ka arritur lutja dhe ka trokitur në dyer të qiejve. Pastaj kur e ke bërë lutjen e dytë, çka ka në qiej e kanë dëgjuar një zë. Pastaj kur e ke bërë lutjen e tretë, më është thënë: “Duaja e të dëmtuarit dhe atij i cili është në rrezik. Pastaj e kam lutur Allahun që të më japë leje që ta mbys (hajnin).

Hasani tregon: “Kush merr abdest dhe i falë 4 rekate dhe bën këtë lutje, Zoti i përgjigjet atij, i cili është në rrezik fatkeqësie, por i ndihmon edhe nëse nuk është në rrezik fatkeqësie”.

## **[51] - DASHURIA E FËMIJËVE PËR TË DËRGUIARIN E ALLAHUT S.A.V.S.**

Tregohet se disa fëmijë të Bahrejnit kanë dalë për të luajtur futboll. Dhe topi bie mbi kulm dhe në gjoks të njeriut në shtëpi. Ata shkojnë dhe e kërkojnë prej tij, mirëpo ai refuzon. Njeri prej

fëmijëve i thotë: Për nder të Muhamedit a.s. na kthe topin.” Ai prapë refuzon dhe fillon ta shajë të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. Atëherë fëmijët me shkopinj e sulmojnë, dhe i mëshojnë deri sa ai vdes. Atëherë këtë ngjarje ia tregojnë Omerit r.a. Për Zotin Omeri r.a. asnjëherë nuk është gëzuar më shumë se për këtë rast, as për çlirimin e ndonjë vendi, as prej pasurisë së luftës. Por ka thënë: “Kjo është madhështia e islamit, kur fëmijët e vegjël, për shkak të ofendimit të Pejgamberit të tyre, janë hidhëruar dhe e kanë mbytur Eshefin.

## [52] - NDJESHMËRIA

Tregohet se Shafiu dhe Muhamed bin Hasani shohin një njeri. Shafiu tha: Ai është zdrukthëtar, ndërsa Muhamed bin Hasani: Farkatar. Kur e pyes për zanatin e tij ai thotë: Kam qenë farkëtar dhe tani jam zdrukthëtar.

\* \* \*

Një i ditur dhe lexues i Kur’anit i thotë një njeriu: “Pa ulu pak, se prej fjalëve tua po e ndjej erën e pabesimit!” Ai njeri ishte konvertuar në krishterizëm pasi kishte qenë musliman. Zoti na ruajt prej një gjëje të tillë. E pyesin: “Po a di diçka nga Kurani?” - Nuk mbaj mend diçka tjetër pos një ajeti, i cili thotë: ***“Ata që nuk besuan, shpeshherë do të kishin dëshiruar të kishin qenë muslimanë.”***

(SURETUL HIXHËR, 2)

\* \* \*

Ebu Seid Harazi thotë: “Në qabe kam pas një njeri të varfër, i cili nuk kishte rroba as për ta mbuluar trupin e tij. Unë në vetvete apo në brendi kam ofsharë, mirëpo ai e kishte ndier

ofshamën e brendshme time dhe më tha: “Ta dini se Allahu e di çka në vetën tuaj, pra kini kujdes”. U pendova dhe në vete kërkova falje prej Allahut. E ai më tha: “Ai është, i Cili pranon pendimin prej robërve të tij, dhe i shlyen të këqijat prej tyre”.

## **[53] - PREJ VIRTYTEVE TË LARTA**

a. Një njeri e shan Ebu Dherrin, e ai ia kthen: “O njeri, mos u fundos me sharje, por lejo vend për përmirësim, sepse ne nuk e shpërblejmë atë, i cili mëkaton në Allahun më shumë se sa i përkushtohemi Allahut.

b. Një njeri e shan Shaebijun Fehih. E ai i kthen: Nëse e ke me të drejtë atë që thua: “Zoti më faltë, e nëse ke gënjyer, atëherë Zoti të faltë ty”.

c. Omer bin Abdul Azizi e dëgjon një fjalë për të nga një njeri, e i thotë: “Ti dëshiron që me forcën e shejtanin të më kaplojë mua shejtani nesër, ashtu siq të ka kapluar ty sot, por më mirë largohu, Zoti të mëshiroftë.

d. Tregohet se Sehl Testeri u r.a. e ka pasur një fqinj pabesimtar. Ai e kishte një kanalizim të WC, i cili rridhte në shtëpinë e Sehlit. Sehl Testeri u vendoste një enë dhe ndyrësira e cila derdhej tërë ditën e mbushte atë, e ai e merrte dhe e hidhte atë natën, që mos ta shihte askush. Kështu ai ka vepruar një kohë të gjatë, deri sa i afrohet vdekja. E kur i afrohet vdekja e fton fqinjin e i thotë: “Shko dhe shiko se çka vjen nga shtëpia jote. Kur shkon e sheh se nga shtëpia e tij dilnin mbeturina dhe derdheshin në enën, të cilën e kishte vendosur ndër ta Sehli. Pabesimtari tha: Ç’është kjo? Sehli i përgjigjet: Ka një kohë të gjatë që nga shtëpia jote, në shtëpinë time vijnë ujërat e zeza

(ndyrësirat), e unë e lë të mbushet gjatë tërë ditës, ndërsa unë e hedh atë në mbrëmje. Po mos të kisha qenë para vdekjes nuk do të kisha treguar, por frikësohem se të tjerët pas meje nuk do ta lejojnë një gjë të tillë. Pabesimtari i tha: O Shejh: Ti kështu ke duruar për një kohë të gjatë e unë kam qenë gjatë gjithë asaj kohe pabesimtar. Zgjate dorën se unë prej tani: Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër pos Allahut dhe Muhamedi është i Dërguari i Allahut. Pastaj Sehli, Zoti e mëshiroftë, ndërroi jetë.

### [54] – TREGIMI I SHEFA'ATIT

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Në Ditën e Kijametit unë do të jem i pari i njerëzimit. Po a e dini pse? (Ja pse) Zoti i tubon të gjithë gjeneratat, të parët e të fundit në një vend. Secili shikon për të parë se çka do të ndodhë, dhe secili dëgjon se çka do të flitet. Dielli u afrohet atyre, njerëzit do të kenë probleme dhe do të jenë rrezik, të cilin nuk kanë mundësi ta përballojnë dhe ta tejkalojnë. Njerëzit thonë: “Nuk po e shihni në çfarë gjendje kemi ardhur? A nuk e dini se kush do të ndërmjetësojë për ju te Zoti juaj? Disa do të thonë: Babai juaj – Ademi. Shkojnë te Ademi dhe i thonë: “O Adem, ti je babai i njerëzimit. Allahu të ka krijuar me dorën e Tij, të ka dhënë shpirtin, i ka urdhëruar melekët për të të rënë në sexhde, të ka bërë banorë të xhenetit. A po ndërmjetëson te Zoti yt për ne? A nuk po e sheh se në çfarë gjendje jemi?” Ai u thotë: “Zoti im është i hidhëruar aq shumë me mua sa kurrë më parë, dhe kurrë nuk do të jetë i hidhëruar aq shumë as në të ardhmen, sepse ai më ka ndaluar të ha pemën, mirëpo unë kam kundërshtuar. Unë jam vetë në hallin tim, shkoni tek dikush tjetër, shkoni te Nuhu.

Shkojnë te Nuhu dhe i thonë: “ O Nuhë! Ti je pejgamberi i parë në fytyrën e tokës, të cilin Zoti e ka cilësuar “rob



falënderues”. A nuk po e sheh se në çfarë gjendje jemi. A nuk po ndërmjetëson te Zoti ynë për ne. Ai u thotë: “Zoti im aq shumë është i hidhëruar në mua sa kurrë më parë, dhe as në të ardhmen nuk do të jetë i hidhëruar si sot, sepse jam pas lutur për familjen time. Unë jam vetëm në hallin tim. Unë lutem për vete, për vete, për vete. E ju shkoni te dikush tjetër. Shkoni te Ibrahim”.

Shkojnë te Ibrahim dhe i thonë: “O Ibrahim, ti je peygamber i Zotit dhe dashamir i Allahut në tokë. Ndërmjetëso te Zoti yt për ne. A nuk po e sheh se në çfarë gjendje jemi?! Ai u thotë: “Zoti im, aq shumë është i hidhëruar me mua sa kurrë më parë, por edhe në të ardhmen nuk do të jetë i hidhëruar aq shumë, sepse unë kam gënjyer tri herë. Unë lutem për vete, për vete, për vete. Shkoni te dikush tjetër. Shkoni te Musa”.

Shkojnë te Musa dhe i thonë: “O Musa, ti je i dërguar i Allahut, Allahu të ka lartësuar me shpallje dhe ka folur me ty. Ndërmjetëso te Zoti yt për ne. A nuk po e sheh se në çfarë gjendje jemi! Ai u thotë: “Zoti im aq shumë është i hidhëruar me mua sa kurrë më parë, por edhe në të ardhmen nuk do të jetë i hidhëruar aq shumë, sepse unë kam mbytur një njeri, të cilin nuk ka qenë dashur ta mbysë. Unë lutem për veten time, për veten time, për veten time. Shkoni te dikush tjetër, shkoni te Isa.

Shkojnë te Isa dhe i thonë: “O Isa, ti je i dërguar i Allahut dhe me urdhër dhe fjalë të Allahut shpirti yt ka hyrë te Merjemja. Ti je ai, i cili u ke folur njerëzve në djep. Ndërmjetëso për ne. A nuk po e sheh se në çfarë gjendje jemi. Isa thotë: “Zoti im aq shumë është i hidhëruar më mua sa kurrë më parë, por edhe në të ardhmen nuk do të jetë i hidhëruar q a shumë, mirëpo nuk përmend ndonjë gabim, por thotë: “Unë lutem vetëm për vete, vetëm për vete. Shkoni te dikush tjetër, shkoni te Muhamedi s.a.v.s.”.

Shkojnë te i dërguari i Allahut s.a.v.s. dhe i thonë: “O Muhamed, ti je i dërguar i Allahut dhe vula e peygamberëve. Zoti ti ka falur ty gabimet e mëhershme dhe të mëvonshme.

Ndërmjetëso te Zoti yt për ne. A nuk po e sheh se në çfarë gjendje jemi. Atëherë do të shkojë nën Arshin e Madh, i bie në sexhde Zotit tim, pastaj Allahu m'i hap dyert e veçanta, të cilat nuk ia ka hapur askujt tjetër, pos meje. E ngriti kokën nga sexhdeja dhe do të them: “Umeti im! Umeti im! Umeti im! O Zot fale umetin tim. Atëherë do të më thuhet: “O Muhamed, shpie umetin tënd në derën e djathtë prej dyerve të xhenetit, se nuk do të japin llogari, ata do të jenë të vetmit që do të hyjnë nga ajo derë. Pastaj ka vazhduar dhe ka treguar: “Pasha Atë që shpirti im është në dorën e Tij, gjerësia e qosheve të dyerve të xhenetit është sa është gjerësia prej Mekes dhe Hixhrit apo sa është gjerësia prej Mekes dhe Busarijës”.

*(Transmeton Buhariu dhe Muslimi)*

## [55] - SHENJAT E KIJAMETIT DHE DEXHALLI

Para ditës së Kijametit do të paraqiten shenjat e vogla dhe të mëdha.

### **Prej shenjave të vogla janë:**

Dukuria shkatërruese, vrasjet e shumta, përhapja e imoralitetit, dukuritë negative, prostitucioni, pirja e alkoolit, bixhozi, krenaria me punët e këqija, sa që për ta mbajtur fenë do të jetë vështirë, sikur ta mbash gacën në dorë. Prej shenjave të vogla të Kijamett janë edhe humbja e diturisë, paraqitja e injorancës, shtimi i gjinisë femërore, zvogëlimi i gjinisë mashkullore, veshja e mëndafshit, shumimi i këngëtarëve. Njeriu do të kalojë pranë varrit të vëllait të vetë dhe do të thotë: “I mjeri unë, sikur të isha në vendin tënd. Po ashtu prej shenjave të vogla të Kijametit janë,

se do të paraqiten thirrësit injorantë, udhëheqësit e padrejtë, humbja e emanetit, pozitat do t'i marrin jo kompetentët. Do të zvogëlohen begatitë, nuk do të ketë shira, do të ketë tërmete e vërshime, çmimet do të jenë të papërbalueshme, femrat do të dalin të zhveshura e kokëshpluar. Po ashtu prej shenjave është edhe lufta përfundimtare mes muslimanëve dhe qifutëve, muslimanët do të triumfojnë dhe çdo herë kur një qifut fshihet pas një guri apo lisi, guri ose lisi do të thotë: “O musliman! O rob i Allahut, ky qifut fshihet pas meje, eja dhe vraje, përpos lisi “GARKAD”. Ai do të jetë prej lisave të qifutëve. Po ashtu prej shenjave të Kijametit janë zvogëlimi i kohës, sa që viti do të jetë si muaji, muaji si java, java si dita, e dita si ora, të cilën e merr flaka. Po ashtu prej ditës Kijametit janë, mosfalja e namazit, pasimi i epsheve, të besuarit rrenacakut, mosbesimi ndaj të sinqertit, të besuarit tradhtarit, e tradhtia ndaj besnikut, humbja e leximit të Kuranit, sa që do të mbetet vetëm të shkruarit dhe mus-hafat me ngjyrë ari, ku ligjëruese do të jenë gratë, e xhamitë e stolisura.

### **Prej shenjave të mëdha janë:**

Lindja e diellit nga perëndimi.

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë:

“Nuk do të bëhet Dita e Kijametit pa perënduar dielli nga lindja, e kur do të shohin njerëzit do të besojnë, atëherë kur njeriut nuk i bën dobi imani i tij, nëse nuk ka besuar më herët, ose nëse besimi nuk i ka bërë dobi”.

### ***TYMI***

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

***“Ti pra, prite ditën kur qielli sjell një tym konkret. Ai (tymi) i përfshinë njerëzit. Ky është një ndëshkim i mundimshëm”.***

*(Ed-Duhan, 10-11)*

Në këtë ajet “TYMI” ka për qëllim, tymi i cili do të paraqitet para Ditës së Kijametit ose tymi i errët, i cili do ta

tymosë çka ka në qiej dhe në tokë, i cili i ngulfat pabesimtarët për vdekje, ndërsa besimtarëve prej saj do t'u paraqitet vetëm një kollitje e lehtë. Ky tym në tokë do të zgjasë katërdhjet ditë.

### ***DALJA E SHTAZËS NGA BRENDIA E TOKËS E CILA DO T'U FLASË NJERËZVE***

Një nga shenjat e mëdha të Ditës së Kijametit është edhe dalja e shtazës prej tokës, e cila do t'u flasë njerëzve në gjuhën e tyre të qartë, të cilën do ta kuptojë çdo njeri i cili e dëgjon. Ajo i informon njerëzit se ata ishin që nuk u kanë besuar ajeteve të Allahut. Kjo shtazë do të dalë në kohë të fundit, atëherë kur njerëzit do të degjenerohen, kur nuk do t'i dëgjojnë urdhrat e Allahut, dhe kur do të devijojnë nga feja e vërtetë. Ajo shtazë do të thotë: Ju njerëz nuk iu keni bindur ajeteve të Allahut. Kjo shtazë do të ketë shkopin e Musasë dhe unazën e Sulejmanit a.s. Me unazën e Sulejmanit do t'ia thyejë hundën jobesimtarit, ndërsa do ta ndriçojë fytyrën e besimtarit me shkop. Kjo për t'u dalluar besimtarët prej jobesimtarëve.

### ***PARAQITJA E DEXHALLIT***

Përndryshe quhet *Dexhalli i Verbër*, sepse njërin sy e ka të verbëruar. Kjo është prej sprovave më të mëdha me të cilën do të sprovohen njerëzit. Ky Dexhall me një sy nuk pretendon se është vetëm Pejgamber, por pretendon se është Zot. Ai do t'i bëjë edhe disa gjëra të jashtëzakonshme me të cilat do të sprovohen njerëzit. Ai i thotë qiellit: “Zbrit shi”, - dhe shiu do të zbresë. Do t'i thotë tokës: “Mbini bimët dhe nxjerri xehet nga toka”, - e toka do ta bëjë atë çka thotë ai. Pastaj e mbyt njeriun dhe e ngjallë dhe do t'i sillt tokës, sa që në çdo qytet do të shkojë e do të shkaktojë çrregullime, përpos në Meke dhe Medine. Kur

dëshiron të hyjë në to (Meke dhe Medine) i gjen Melekët duke bërë roje, kështu që kthehet pa sukses. Qyteti i parë në të cilin do të paraqitet është Esbehani. Në fillim atë do ta pasojnë shtatëdhjetë mijë jehudë, pastaj do ta pasojnë të poshtrit, e pastaj injorantët, e pastaj çobanët. Ai do të qëndrojë në tokë katërdhjetë ditë: një ditë do të jetë sa një vit, një ditë tjetër sa një muaj, një ditë tjetër sa një javë, ndërsa ditët tjera do të jenë sikurse ditët tona. Të gjitha këto janë treguar në hadithe të vërteta, që disa prej tyre do t'i përmendim me ndihmën e Allahut.

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: ***“Çdo pejgamber ia ka tërhequr vërejtjen popullit të tij për Syqorrin Rrenacak. Ai është një sy, ndërsa Zoti juaj nuk është me një sy, në mes të syve të tij është i shkruar “jobesimtar” të cilën do ta lexojë çdo musliman”***.

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: ***“Kur të vijë dexhalli, ai do të ketë me vete ujë dhe zjarr. Sa i përket asaj që njerëzve u duket ujë, ai është zjarri që do ta humbë, ndërsa ai që njerëzit e shohin zjarr, ai është uji i ftohë dhe që ëmbëlson. Ai i cili e arrin këtë, le të shkojë te ai që duket zjarr, se ai është ujë i ëmbël dhe i mirë”***.

Nga Navas bin Seman r.a. transmetohet se: “Në një mesditë e ka përmendur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. Dexhalin, e uli dhe e lartësoi sa që menduam se është afër një palme, që do të thotë se aq shumë e ka poshtëruar çështjen e tij, i cili është me një sy qorr dhe në mes të syve i është e shkruar “jobesimtar”. E ka treguar të madhe fitnen e tij, sepse ai shkakton trazira të jashtëzakonshme. E kjo do të thotë se: Pejgamberi s.a.v.s. ka përdorë metodologjinë e lartë artistike për të treguar se sa afër mundet me qenë ardhja e tij, pra menjëherë, pas një palme, e cila është në Medine.

Ka thënë: “Mirëpo, përderisa unë jam me ju, dexhali frikësohet që të vijë, por nëse vjen, e unë jam me ju atëherë unë ia ndërpres aktivitetin dhe suksesin e tij, ngase ai nuk mund të sjellë

argumente. Po nëse vjen e unë nuk jam në atë mes, secili le të mbrohet me argumentet e veta. Se Allahu është ndihmëtarë për çdo musliman. Ai është i ri me flokë të dendura, syri i ndriçon (si ari kur ndriçon). Ai i përngjan robit - Aziz bin Katanit (një person, i cili ka vdekur në kohën e injorancës) . Kush e sheh atë le të lexojë ajetet e suretul Kehf. Ai do të dalë nga një vend, i cili është në mes të Sirisë dhe Irakut. E pastaj përhapet shkatërrimi në të djathtë e në të majtë. “O robër të Allahut bëhuni të vendosur e përforcohuni (në iman, e mos lajthitni)”. E pyetëm. “O i Dërguar i Allahut: Sa do të qëndrojë në tokë? Ai u përgjigj: Dyzet ditë, por dita do të jetë sa një vit, një ditë sa një muaj, një ditë sa një javë, ndërsa ditët tjera sa janë të gjata ditët tuaja.” Ne i thamë: “O i Dërguari i Allahut, dita e cila do të jetë e gjatë sa një vit a mjafton për namaz?”

Është përgjigju: “Nuk e di vlerën e atij namazi”. I thamë: “O i Dërguari i Allahut, sa do të jetë shpejtësia e tij në tokë?” Tha: “Sa shpejtësia e mjegullave, të cilat i bartë era. Vjen te një popull, ai i thërret, e i besojnë atij dhe çka tu thotë veprojnë. Urdhëron qiellin për të rënë shi, shi bie; urdhëron tokën për të mbirë bimë, toka mbinë bimë dhe toka sjell begati të madha. Begatia do të jetë e pëlleshme dhe për shkak të ushqimit të tepërt do të sjellin përfitime të mëdha, do të jenë kafshët të majme dhe tërë dhjamë. Pastaj vjen tek një popull tjetër, të cilët i thërret ata, e ato nuk pranojnë (përforcohen në fe), e ai kur kthehet (tërhiqet) prej tyre dhe (toka e tyre) bëhet e papëlleshme, ngase ndërpriten shirat, nuk do të ketë bereqet, nuk do të kenë asgjë në duart e tyre dhe kalojnë në një faze të shkatërrimit. (Dexhalli) i thotë tokës: Nxirre jashtë thesarin tënd, atëherë thesari del si bletë nga zgjojet e tyre. Pastaj e thërret një njeri të ri dhe të shëndoshë, të cilit i bie me shpatë dhe e ndanë në dysh. Pastaj e thërret atë, e ai vjen prapë (i gjallë) me fytyrë të qeshur.

Deri sa ai është në këtë gjendje (duke i shkatërruar robërit) Allahu e dërgon Mesihun birin e Merjemes r.a. Ai do të zbresë te minarja e bardhë në lindje të Damaskut me dy rroba (i veshur me dy rroba) me ngjyrë veres dhe të Zafranit, dy melekë mbi supet e tij, kur ai e lëviz kokën bie shi prej trupit të tij, e kur ta ngrit lartë, dalin shkëndija si të diamantit prej trupit të tij. Çdo pabesimtar kur ta ndiejë erën e tij do të vdesë. Pabesimtarët përfundojnë në çdo vend ku arrin ai.

Atëherë e kërkon (e kërkon Isa a.s. dexhallin) *dhe e gjen në babilud* (vend në Siri) dhe e mbytë aty. Pastaj Isa a.s. shkon te një popull, i cili ka qenë i mbrojtur prej Allahut, ua fërkon fytyrat atyre, dhe ua tregon gradat e secilit prej tyre në xhenet. Pas kësaj Allahu i shpall Isës s.a.v.s.: “Unë i kam nxjerrë (kanë dalë) disa robër të Mi, të cilët nuk mund t’i luftojë askush ata (për shkak se janë shumë). Andaj merri robërit e Mi (besimtarë) dhe strehoji në kodrën Tur dhe mbroji ata. Pastaj Allahu dërgon Jeëxhuxhët dhe Meëxhuxhët, të cilët shpërndahen në çdo kodrinë (me nxitim). Grupi i parë i tyre kalon liqenin e turbullt, të cilët e pinë tërë atë që është në të. Pastaj kalon grupi i dytë, të cilët thonë: Këtu njëherë ka pasur ujë. Isa a.s. me shokët e tij i rrethon deri në atë masë sa që koka e kaut të ndonjërit prej tyre është më e nevojshme se sa njëqind dinarë tuaja të sotme. Atëherë Pejgamberi i Zotit Isa a.s. dhe sehabët i luten Zotit për t’i shpëtuar dëmtimit të Jeëxhuxhëve dhe Meëxhuxhëve dhe për t’u shpëtuar krimit të tyre. Për atë arsye Allahu do të dërgojë krimba në qafat e tyre dhe Jeëxhuxhët e Meëxhuxhët mbyten përnjëherë. Pastaj Isa a.s. me shokët e tij zbresin nëpër tokë për kontrollim, dhe shohin se në çdo pëllëmbë të tokës ka gjurmë të shkatërrimit dhe erë të keqe të Jeëxhuxhëve dhe Meëxhuxhëve. Atëherë Isa a.s. me shokët e tij luten dhe Allahu ua pranon lutjen dhe dërgon shpend me qafa si qafa të devesë dhe e bëjnë pastrimin e asaj ere të keqe sa do Allahu. Pastaj Allahu i Lartmadhëruar zbret shi, nga i cili nuk mbet kulm, gurë, e tullë

pa u pastruar, ashtu që toka pastrohet dhe shkëlqen si pasqyrë. Atëherë i thuhet tokës: “Lulëzo, sjell fryte” dhe sjell të lashta e të korrura. Aq të mëdha janë shegët sa që një shegë u mjafton një grupi të madh njerëzish. Ashtu Allahu i bekon devetë sa që një deve mjafton për një grup të madh njerëzish. Një lopë mjafton për një fis, e një dele mjafton për më pak se një fis. Deri sa ato të jenë në këto kushte, Allahu i Lartmadhëruar dërgon një erë të lehtë e të mire në mes të tyre dhe ua merr shpirtin çdo besimtari e çdo muslimani, ndërsa mbesin njerëz amoral, të cilët kryejnë marrëdhënie para të tjerëve, ashtu siç kryejnë gomarët dhe ata do t’i godasë Dita e Kijametit.

(TRANSMETON MUSLIMI)

### **ZBRITJA E ISAUT A.S. BIR I MERJEMES**

Prej shenjave të mëdha të ditës së Kijametit është edhe zbritja e Isaute, birit të Merjemes. Për këtë tregojnë edhe ajetet fisnike edhe hadithet. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: **“Dhe çdo pasues i librit patjetër duhet t’i besojë para vdekjes së tij. Ndërsa në Ditën e Kijametit ai do të jetë dëshmitar kundër tyre”**. Pra çdo pjesëtar i pasuesve të librit do të besojë në Isaun para vdekjes së tij, ndërsa Isau do të dëshmojë kundër tyre Ditën e Kijametit. Po ashtu, Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: **“Dhe ai është shenjë për Kijametin, e mos dyshoni në të, kjo është rruga e drejtë”**.

Pra Isa është shenjë e afrimit të Ditës së Kijametit. Dhe për zbritjen e tij janë përputhur shumë informata. Ai tani është në



qiell, e ka ngritur Allahu me trup e me shpirt, e do ta zbres në tokë si udhëheqës i drejtë, udhëheqës me ligjin e sheriatit të zotërisë së peygamberëve, Muhamedit s.a.v.s.

Nga dy shejhat (Buhariu dhe Muslimi), transmetohet prej Ebi Hurejretes se Peygamberi s.a.v.s. ka thënë: *“Pasha atë në dorën e të cilit është shpirti im, gati sa do të dyshoni në zbritjen e Isës si udhëheqës i drejtë, e ai do ta thyejë kryqin, do ta mbysë derrin, do ta asgjësojë institucionin e xhizjes dhe nuk do të ketë nevojë për ta paguar xhizjen, sepse ai nuk pranon alternativë tjetër, pos pranimin të islamit. Do të ketë pasuri të shpërndarë, sa që askush nuk do të pranojë (sadaka) se nuk do të ketë nevojë. Një sexhde do të jetë më e mirë se tërë kjo botë dhe gfarë ka në të”*.

Po ashtu, është dëshmuar në hadithe të vërteta se Isa do ta mbysë dexhallin. Pasi ta kryejë misionin e tij do të vdesë, e namazin e xhenazes do t’ia falin muslimanët, ndërsa do të varroset në dhomën e pastër të Peygamberit s.a.v.s.

### ***PARAQITJA E JETË XHUXHËVE ME MEËXHUXHËVE***

Në Kur’an janë përmendur jeëxhuxhët dhe meëxhuxhët në ajetin:

**“Thanë: O Dhelkarnejn, vërtetë Jeëxhuxhët janë shkatërrimtarë të mëdhenj të tokës”.**

Ato janë dy fise me prejardhje nga Jafith bin Nuha që do të paraqiten në kohë të fundit, pasi që do të shkatërrohet penda (meri) e Dhulkarnejnit. E ata do të bëjnë shkatërrime në tokë me të gjitha llojet kriminale dhe mizore. Për shkak se ato do të jenë shumë, do të hanë të gjitha ushqimet dhe të gjitha bimët, do të pine ujën e liqenit, dhe do ta shterin të tërin.

***SHPËRTHIMI I ZJARRIT DHE PËRMBLEDHJA  
E NJERËZVE NË NJË VEND TUBIM***

Ky zjarr do të shpërthejë prej vendit Adn, ai është zjarri i madh, të cilin nuk mund ta fikë asgjë, i përmbledh njerëzit në një vend. E ai tubim i tyre në atë vend është prej shenjave të mëdha të Kijametit. E lusim Allahun që të na mbrojë edhe prej zjarrit të kësaj bote, edhe prej zjarrit të botës tjetër, si dhe të na shpëtojë prej trishtimit të Ditës së Kijametit, me Madhërinë dhe Fisnikërinë e Tij, vërtet Ai është afër dhe dëgjon.

**[56] - FËMIJA I CILI FALET NATËN**

Shejh ibn Dhfr el -Mekiju thotë: “Kam dëgjuar se Eba Jezid Tajfur bin Isa Bestaniju r.a. kur e ka lexuar ajetin: **“O ti i mbuluar, zgjohu natën e falu, përpos një pjesë ...”**, (SURETUL-MUZEMIL, ajeti, 1), i thotë babait të tij: “O baba im! Kujt i drejtohet Allahu me këtë ajet?” Ai i thotë: “I drejtohet Pejgamberit, Muhamed s.a.v.s. Fëmija i thotë: “O baba, po pse ti nuk vepron si ka vepruar Muhamedi s.a.v.s.?” Babai i përgjigjet: “O biri im! Falja e namazit të mesnatës është specifike e Muhamedit s.a.v.s., e jo për umetin e tij.” Fëmija heshti. Kur fëmija e lexon ajetin kur'anor, ku Zoti i Lartmadhëruar thotë:

**“Vërtet Zoti yt, e di se ti falesh më pak se një të tretën e**

**natës, edhe gjysmë nate, e një të tretën e natës, e njësoj një grup të cilit janë me ty**” (SURETUL MUZEMIL ajeti 20) i thotë: “O baba im, unë po e dëgjoj dhe po e shoh se një grup janë falur natën, po kush janë ata.” Babai i thotë: “O biri im! Ata janë sahabët, Zoti qoftë i kënaqur me ta.” I biri pyet: “O baba im! Po çfarë dobie kemi nëse nuk veprojmë ashtu siç ka vepruar Pejgamberi s.a.v.s. dhe sahabët e tij?” I ati i përgjigjet: “E fole të vërtetën biri im.” Pas këtij rasti babai zgjohej natën dhe falej. U zgjua edhe Jezidi natën, dhe kur e sheh babanë duke u falur, i thotë: - O baba im! Më mëso të pastrohëm dhe të falem me ty. Kurse babai i thotë: “O biri im fli, se ti ende je i vogël.” E ai i thotë: “O baba im! Kur të vijë Dita, kur njerëzit do të dalin para Zotit veç e veç, për t’i parë veprat e tyre, do ti them: O Zoti im! Unë e kam pyetur babin tim si të pastrohëm e të falem me të, por më ka refuzuar duke më thënë se jam ende i vogël. A ke dëshirë që kjo të të ndodhë?” Babai thotë: “Jo për Zotin, o biri im, assesi nuk dua të ndodhë ashtu.”

Kështu babai e mësoi të birin dhe ai filloi të falej me të.

## [57] - SHKAQET E MOSPRANIMIT TË LUTJES

Tregohet se Ibrahim ibn Ed’hemi, përderisa kalonte nëpër tregun e Basrës, u tubuan njerëzit rreth tij dhe i thanë: “O Ebu Is-hak, Çka është me ne që i lutemi Allahut, por ai nuk na pranon?”

Ai i thotë: “Për shkak se zemrat e juaja janë të vdekura në dhjetë çështje:

E para: E njihni Allahun dhe nuk i kryeni obligimet e Tij.

E dyta: Deklaroni se e doni të Dërguarin e Allahut s.a.v.s., e nuk veproni sipas sunetit të tij.

E treta: E lexoni Kur'anin dhe nuk veproni me të.

E katërta: I shfrytëzoni të mirat e Allahut, e nuk e falënderoni.

E pesta: Thoni se shejtani është armiku juaj, e nuk e kundërshtoni.

E gjashta: Thoni se xheneti është i vërtetë, e nuk punoni për të.

E shtata: Thoni se *xhehenemi* është i vërtetë, e nuk largoheni prej tij.

E teta: Thoni se vdekja është e pashmangshme, e nuk përgatiteni për çastin e tij.

E nënta : Zgjoheni nga gjumi, i shihni të metat e të tjerëve, e i harroni tuajat.

E dhjeta: I varrosni të vdekurit, e nuk llogaritni se do t'ju ndodhë njësoj si atyre”.

## **[58] – NJË DIJETAR MË I VËSHTIRË PËR SHEJTANIN SE NJË MIJË ADHURUES**

a). Tregohet se një adhurues, prej beni Israilëve e adhuronte Allahun e Lartmadhëruar në një faltore në një maje të një kodre. Një ditë prej ditësh, si zakonisht, del të shëtisë vërdallë faltores së tij për të vështruar se çka ka krijuar Allahu i Lartmadhëruar. Gjatë shëtitjes në mes të rrugës e sheh një kufomë prej të cilit buronte një erë e keqe. Adhuruesi lakon rrugës për t'i ikur erës së keqe. Atëherë shejtani i paraqitet në formë të një njeriu të devotshëm dhe i thotë: “Të mirat e tua aq shumë janë larguar sa

që nuk vlejnë te Allahu fare. Adhuresi i thotë: “Po përse?!” Ai i thotë: “Sepse ti nuk pranove ta durosh erën e keqe të njeriut sikurse ti. Në atë moment adhuresi u skuq në fytyrë. Mirëpo, shejtani si këshilltar i mirë i thotë: “Nëse dëshiron që Allahu të ta falë mëkatin, atëherë mbyte një mi dhe varre në shpinën tënde dhe me të adhuroje Zotin tënd gjatë gjithë jetës tënde. Adhuresi injorant e zbotoi këshillën e shejtanit. Kështu që e zuri një mi, e mbyti dhe vazhdoi ta adhurojë Allahun me ndyrësi në shpinë më shumë se 60 vjet, deri sa vdiq (dhe i tërë adhurimi i tij është zhvlerësuar).

Në lidhje me këtë ngjarje Pejgamberi s.a.v.s. ka komentuar vlerën e diturisë apo ndejën (qëndrimin) me dijetarë *“është me vlefshme se adhurimi i 60 viteve”*.

b). Tregohet se përderisa një ditë prej ditësh Abdul Kadir Xhejlaniju (Zoti e pastë mëshiruar) kalonte nëpër shkretëtirë, sheh në horizont një dritë të madhe dhe dëgjon një zë: “O Abdul Kadir! Zoti yt t’i ka lejuar ty të ndaluarat”. Abdul Kadiri i thotë: “Mbylle gojën o i mallkuar”. Kur në atë moment drita venitet, atëherë një zë i thotë: “O Abdul Kadir! Ti shpëtove nga unë, falë diturisë tënde dhe fikhut tënd, dhe urdhrin të Zotit tënd. Po me këtë mënyrë i kam humbur 70 adhures të mëdhenj, po mos të ishte dituria jote, do të të kisha humbur edhe ty”.

c). Tregohet se, përderisa një ditë Isa a.s. qëndronte në një kep, i shkon shejtani e i thotë: “A nuk thoni se kur Allahu dëshiron që dikush të vdes ai patjetër duhet të vdes?” I thotë: “Po. Përndryshe nuk vdes”. Atëherë Iblisi, qoftë i mallkuar, i thotë Isaut a.s.: “Atëherë, hidhu prej këtij kepi dhe shiko nëse Allahu ka caktuar të vdesësh do të vdesësh, e nëse jo, nuk do të vdesësh”. Isa a.s. i thotë: “Mbylle gojën o i mallkuar, se Allahu është Ai, i Cili i vë në sprovë njerëzit, e nuk është që njerëzit ta vendosin në sprovë Zotin e tyre”.

d). Tregohet se përderisa Shafiju r.a. ishte i ulur në një kuvend të ditorisë me njerëzit, kur i vjen Iblisi i mallkuar në mesin e nxënësve të tij në formë të njeriut dhe ia parashtron një pyetje: “Çka mendon për atë, i cili më ka krijuar ashtu siç e ka zgjedhur vetë, më vë në shërbim ashtu siç e ka zgjedhur vetë, e pas kësaj nëse dëshiron më shpie në xhenet, e nëse dëshiron më shpie në xhehenem. A është e drejtë kjo apo jo?”

Shafi’iju me dritën e Allahut e kuptoi se ai është shejtani dhe ia ktheu përgjigjen: “O ti, nëse të ka krijuar ashtu siç dëshiron ti, atëherë Ai të ka bërë padrejtësi, e nëse të ka krijuar ashtu siç ka dëshiruar Ai, atëherë Ai nuk pyetet se çka dhe si vepron”.

e). Tregohet se një beni Israil ka agjëruar 70 vjet dhe prej çdo viti nuk ka agjëruar vetëm nga 7 ditë, dhe e ka lutur Allahun që t’i tregojë se si i mashtron shejtani njerëzit. Kur kalon një kohë të gjatë dhe këtë nuk e sheh, atëherë thotë: “Më mirë të kisha bërë një mëkat ndaj Allahut, se sa të kisha kërkuar atë që kam kërkuar”. Atëherë Allahu ia dërgon një melek dhe i thotë: “Allahu më ka dërguar te ti për të të thënë: “Fjalën, të cilën e ke thënë është më e dashur tek unë se agjërimi yt 70 vjet. Për këtë arsye Allahu do të ta forcojë shikimin me dritën e Tij, andaj shiko”. Kur sheh se si ushtria e Iblisit e kishte përfshirë tokën rreth tij, nuk kishte asnjë njeri, pos që shejtanët silleshin rreth e rrotull tij, të tërbuar si ujë. Ai thotë: “O Zoti im, po si mund të shpëtohet prej të gjithë këtyre: “Zoti i thotë: “Modestia dhe butësia”.

f). Iblisi në mëngjes e tubon ushtrinë e tij, e shpërndan në fytyrën e tokës dhe u thotë: “Kush e humb një musliman do t’ia vendos këtë kurorë në kokë”. Pasi kthehen, njëri prej shejtanëve i thotë: “Nuk iu kam larguar filanit, derisa e kam ndarë prej

gruas së tij”. Ai i thotë: “Ka mundësi të martohet përsëri”. Tjetri i thotë: “Nuk iu kam ndarë filanit, derisa është sjell ashpër ndaj prindërve”. Ai thotë: “Ndoshta kthehet e sillet butësisht me ta”. Tjetri thotë: “Nuk iu kam ndarë filanit, derisa ka bërë prostitucion”. I thotë: “Mirë ke vepruar”. Tjetri i thotë: “Nuk iu kam larguar filanit, derisa ka pirë alkool”. I thotë: “Mirë”. Tjetri i thotë: “Nuk iu kam ndarë filanit, derisa ka vvarë tjetrin”. I thotë: “Ashtu, ashtu; mirë, mirë”.

g). Tregohet se shejtani i ka thënë femrës: “Ti je gjysma e ushtrisë sime, ti je shigjeta ime me të cilën gjuaj e nuk gaboj; ti je sekreti im që të dërgoj aty ka kam nevojë të kryejë ndonjë punë”.

h). Tregohet se Iblisi i mallkuar i është paraqitur firaunit në formë të njeriut, derisa ai ishte në banjë, e ai e largon. Pastaj shejtani i thotë: “Mjerë për ty, po a nuk po më njeh?” – “Po si të të njoh?!” – I thotë: “Po ti më ke krijuar. Pse a nuk ke thënë: “Unë jam Zoti i juaj më i madhi”?

i). Iblisi iu paraqitet Sulejmanit a.s. e (Sulejmani a.s.) e pyet: “Cilat vepra janë më të dashura tek ti dhe më të urryera tek Allahu?” Ai i thotë: “Po të mos e kisha ditur nivelin e afërsisë tënde tek Allahu, nuk do të të kisha treguar. Pra, po të të tregoj: “Unë nuk di se ka diçka më të dashur në veten time se sa pedofilizmi dhe lezbicizmi”.

j). Një njeri e mallkonte Iblisin për çdo ditë nga 1000 herë. Përderisa një ditë ishte fjetur, shejtani e zgjon dhe i thotë: “Zgjohu se muri do të rrëzohet e do të bjerë mbi ty”. Ai i thotë: “Po kush jeni ju që aq shumë po kujdeseni për mua?!” I thotë: “Unë jam Iblisi”. I thotë: “Po pse atëherë po më shpëton, kurse unë të mallkoj çdo ditë nga 1000 herë?!” Shejtani i thotë: “Unë e bëra këtë, sepse e di vlerën e dëshmorëve dhe gradën e tyre tek

Allahu dhe u frikova se do të shkosh dëshmor, pasi të bjerë muri mbi ty”.

*(Vërejtje: I përmbyturi prej murit, i cili bie mbi të (për shkak të tërmetejeve, katastrofave) apo mbetet nën gërmadha të shtëpive konsiderohet dëshmor, sepse Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Dëshmorët janë pesë llojesh: Ai, i cili vdes prej kolerës, ai i cili vdes prej sëmundjeve të barkut, i përmbyturi në ujë, i përmbyturi prej gërmadhave, dëshmori, i cili bie në rrugë të Allahut të Lartmadhëruar”).*

*(Transmeton Muslimi).*

k). Tregohet se Hasani ka thënë: “Ka qenë një pemë, e cila adhurohej në vend të Allahut. Një njeri thotë: “Do ta presë”. Dhe niset i hidhëruar për të shkuar deri te ai lis. Në mes të rrugës e takon shejtanin në formën e njeriut, e i thotë: “Çka do të bësh?” I thotë: “Dëshiroj ta presë atë pemë, e cila adhurohet në vend të Allahut”. I thotë: “Nëse ti nuk e adhuron atë pemë, çka të dëmton nëse të tjerët e adhurojnë. Ai i thotë: “Unë do ta presë”. Shejtani i thotë: “Unë do të të jap një propozim më të mirë: Mos e pre, se për çdo mëngjes do t’i kesh nën jastëkun tënd nga 2 dinarë”. I thotë: “Po prej kujt do t’i kem?” I thotë: “Prej meje”. Ai shkon në shtëpi dhe në mëngjes i gjen dy dinarë nën jastëkun e tij. Mirëpo, herën tjetër nuk i gjen. Dhe i hidhëruar e me tërbim niset për të prerë pemën. Atëherë shejtani i paraqitet në formën e tij dhe i thotë: “Çka do të bësh?” I thotë: “Dëshiroj ta presë pemën, e cila adhurohet në vend të Allahut”. Shejtani i thotë: “Po gënjen, ti nuk ke zgjedhje”. Ai vazhdon rrugën për ta prerë, por shejtani i bie, e ai përplasat për tokë, sa që për pak sa nuk vritet. Pastaj i thotë: “A e di kush jam unë? - Unë jam Shejtani, i cili të kam takuar për parën herë, kur je nisur i hidhëruar, por unë të kam mashtruar me dy dinarë, e pastaj nuk të kam lënë nën



jastëk dy dinarë, e ti tani je i hidhëruar për shkak se nuk i gjetur dy dinarë, e për këtë arsye të mposhta”.

## **[59] - OMERI DHE TESTIMI I NËPUNËSVE TË TIJ**

Omeri r.a. e ka pasur princip që vet t’i testonte nëpunësit e tij kur ato i emëronte në vende të ndryshme. Përpos kësaj, ai e pyeste popullin për ta, për sjelljet e tyre, aftësinë e tyre.

Një ditë Omeri shkon në Hamas. Në atë vend në post ishte i emëruar Seid bin Amir El-Xhehmiju. I tuboi qytetarët dhe u tha: “O banorë të Hamasit, çfarë është mendimi juaj për Saidin? Ata i thonë: “Nuk jemi të kënaqur me të në katër çështje: E para: Ai nuk del herët, por vetëm pasi të kalojë një kohë e ditës.

E dyta: Asnjërin prej nesh nuk e pranon për të biseduar natën.

E treta: Një ditë në muaj nuk pranon fare palë, dhe ndonjëherë i humb vetëdija sikurse të jetë i vdekur”.

Omer i r.a i tuboi qytetarët dhe e fton Seid bin Amirin që edhe ai të jetë në mesin e tyre. Dhe bën Omeri dua në vetvete: “O zoti im bëre që e vërteta të del në shesh”. Dhe ia thotë ankesat e tyre. Seidi i tha: “Shkaku pse nuk dal herët në mëngjes është se në familjen time nuk ka shërbëtor, kështu që unë i zë bukët dhe priti deri sa të fryhen, pastaj i gatuj bukët, marr abdest dhe dal në punë. Sa i përket ankesës së dytë: Nuk pranoj takim natën, nga shkak se unë ditën ia kushtoj atyre, ndërsa natën i a kushtoj Allahut të Lartmadhëruar (bëj ibadet). Ndërsa sa i përket asaj se një ditë një muaj nuk punoj është se unë nuk kam shërbëtor të mi lajë rrobat, e unë nuk kam rroba për t’i ndërruar kur t’i laj; për këtë arsye atë ditë i laj rrobat, i priti për

t'u terur, e të nesërmen të dal me rrobat e lara në punë. Ndërsa shkaku se unë humbi vetëdijen ndonjëherë, kjo është një çështje shumë e dhimbshme. Sepse unë kam qenë prezent kur Hubejb bin Adi el Ensariju është ekzekutuar, dhe e kam parë se si Kurejshitët ia rrjepnin mishin, pastaj se si e ngulitën në lis, se si e dënonin, çfarë vuajtje dhe çfarë maltretimi i bënë, vetëm e vetëm të mos i besojë asaj që i ka zbritur Muhamedit s.a.v.s. Dhe e pyesnin: A kishe pasur dëshirë që Muhamedi, të cilit i beson të ishte në vendin tënd? Ndërsa ai u thoshte: “Për Zotin nuk kisha pasur dëshirë që të jem gjallë në mesin e familjes time, ndërsa Muhamedit s.a.v.s. t'i bëhej ndonjë e keqe, e cila do t'ia lëndonte qoftë edhe majën e gishtit të tij”. Prandaj, çdo herë kur e kujtoj atë ditë dhe atë pamje, dhe përse nuk i kam ndihmuar në ato momente tepër të vështira, edhe pse në atë kohë kam qenë idhujtar, nuk kam pas besuar ende në Zotin e Lartmadhëruar dhe në Pejgamberin fisnik, prandaj frikohem se Allahu atë gabim nuk do të ma falë kurrë. E në atë moment më kaplon dridhja dhe e humbi vetëdijen. Omeri i tha: E falënderoj Allahun se i tregove çështjet ashtu siç janë (dhe nuk u zhgënjeva).

## **[60] - MIRËSIA DHE MËSHIRA NDAJ KAFSHËVE SHKAK I FALJES SË MËKATEVE**

I dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: “*Deri sa një njeri po kalonte nëpër një rrugë, e kaplon një etje e madhe. E sheh një bunarë, zbret në thellësi të tij, piu ujë dhe doli nga aty. Pasi që doli, e sheh një qen duke lehur dhe duke lëpi lëmshqje prej etjes. Thotë me vete: “Ky qen është i etur, ashtu siç isha unë më parë”. Kështu që zbret përsëri në bunar, e mbush këpucën e tij dhe e mbante me gojë deri sa u ngrit lart dhe i dha të pijë ujë*

*qenit. Për këtë mirësi që e bëri e falënderoi Allahu, e ia fali atij”.*

*TRANSMETON BUHARIU DHE MUSLIMI*

Në një transmetim të dy koleksioneve sahihë thuhet: *“Përderisa qeni sillej rreth e rrotull bunarit, dhe ishte duke ngordhur nga etja, kur një mëkatar prej mëkatarëve beni Israil e sheh, e heq këpucën e tij, e mbush me ujë dhe i jep të pijë. Për këtë iu falen mëkatet”.*

## **[61] - TREGIMI I SPROVIMIT TË SULEJMANIT A.S.**

I dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: Sulejman bin Davud a.s. ka thënë: “Sonte do t’i vizitoj (kontaktoj me) njëqind gratë e mia dhe prej secilës do të lind kalorës, të cilët do të luftojnë në rrugën e Allahut. Shoku i tij i thotë: “Thuaj: “Nëse do Allahu”. Mirëpo ai nuk thotë “Nëse do Allahu”. Kështu që prej të gjitha atyre ka mbetur shtatzënë vetëm njëra, e cila lind një fëmijë gjysmak (me aftësi i të kufizuara). Pasha atë në dorën e të cilit është shpirti im, po të kishte thënë “*Nëse do Allahu*”, të gjithë do të lindnin kalorës dhe të gjithë do të kishin luftuar me rrugë të Allahut së bashku”.

*TRANSMETON BUHARIU DHE MUSLIMI*

Po ashtu në transmetimet e tyre ekziston se Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: “Sulejmani ka thënë: Sonte do t’i vizitoj (kontaktoj) shtatëdhjetë gratë e mia, dhe prej secilës prej tyre do të kem nga një kalorës, i cili do të luftojë në rrugë të Allahut. Dhe nuk ka thënë “Nëse do Allah”. Kur i vizitoi (kontaktoi) me ta nuk mbet asnjëra nga ato shtatzënë, pos njëra, e cila e lindi një fëmijë gjysmak, të cilin ia sjellin në fronin e tij. - Pasha Atë në

dorën e të Cilit është shpirti im, po të kishte thënë “Nëse do Allahu”, do të kishin lindur që të gjithë, dhe të gjithë do të ishin bërë kalorës, që do të kishin luftuar së bashku në rrugë të Allahut. Këtë e tregon ajeti: **“Dhe ne veç e kemi sprovuar Sulejmanin”**.

## [62] - TREGIMI I ADEMIT DHE MUSA A.S.

I Dërguari i Allahut, Muhamedi s.a.v.s., ka thënë: “Kanë debatuar Ademi dhe Musa në mes vete. Musa i thotë: “O Adem, ti je babai dhe i pari i ynë dhe ti je ai që na ke nxjerrë nga xheneti”. Ademi i thotë: “O Musa, Allahu të ka dalluar ty me të folurit e Tij (ka biseduar me ty me fjalë) dhe Vetë të ka shkruar libër dhe ta ka dhënë. E tash po më akuzon mua për një çështje, të cilën e ka caktuar Allahu që të ndodhë katërdhjetë vjet para se të më krijojë. Kështu Ademi del fitues ndaj Musasë. Ademi del fitues ndaj Musasë, Ademi del fitues ndaj Musasë.

*TRANSMETON BUHARIU*

### **Përfitim i rëndësishëm**

Ademi fitoi ndaj Musasë me argumente, sepse fatkeqësitë (ndodhitë) argumentohen me fakte, e mëkatet jo. Sepse fatkeqësinë nuk e dëshiron njeriu, dhe për këtë arsye nuk iu është dhënë e drejta e zgjedhjes. Por, i ndodh papritur e pakujtuar, dhe padëshiruar e pa zgjedhur fare. Është mirë të argumentohet me caktimin (kaderin e Zotit) për t’iu lehtësuar dhimbja.

Ndërsa sa i përket mëkatit, njeriu vepron me vullnet dhe ai e di se Allahu e urren dhe e ka ndaluar. E kur ta bëjë mëkatin nuk lejohet logjikisht, as ligjësisht të arsyetohet e të sjellë

argumente se kjo është më dëshirën e Allahut të Lartmadhëruar, dhe me caktimin (kaderin) e Tij, në asnjë mënyrë.

Shejhul Isalm - **Ibnu Tejmije** thotë: “Musa a.s. është më i ditur sa i përket njohjes së Allahut, cilësive të Tij, emrave të Tij, për të akuzuar për mëkatin, për të cilën veç mëkatari është penduar, e Zoti e ka zgjedhur dhe e ka udhëzuar. Ndërsa Ademi është më i ditur sa i përket Zotit të tij në lidhje me Kadanë dhe Kaderin, dhe për fatkeqësitë. Por, Musa e ka akuzuar Ademin për fatkeqësinë, e cila i ka ndodhur pasardhësve të tij me daljen e tyre prej xhenetit, dhe zbritjen e tyre në botën e sprovave dhe të vështirësive, për shkak të gabimit të babait të tyre. Ai (Musa a.s.) ka përmendur gabimin, si vërejtje e shkakut të fatkeqësive dhe sprovave të pasardhësve të tij. Për këtë arsye i ka thënë: “Na ke nxjerrë ne dhe vetën tënde prej xhenetit”.

Në një transmetim dhe tekst tjetër thuhet: “Ademi u argumentua me kaderin për fatkeqësi dhe ka thënë: “Kjo fatkeqësi, të cilën e përjetojnë pasardhësit e tij, është shkak i gabimit, i cili veç ka qenë i shkruar dhe i caktuar, para se të jetë i krijuar. Kaderi argumentohet në fatkeqësi, e jo në mëkate. Pra, apo më akuzon mua për fatkeqësinë, e cila ka qenë e shkruar dhe e caktuar për mua, para se të isha krijuar, para kaq e kaq viteve?!”

## **[63] - SHPËTUESIT PREJ SHKATËRRIMEVE**

Abdurrahman bin Sumrete transmeton se: “Deri sa ishim në sufe të Medines, erdhi i Dërguari i Allahut s.a.v.s. dhe tha:

“Mbrëmë kam parë ëndërr interesante. Kam parë se si një njeriut të umetit tim i shkon Melekul Mevti për t’ia marrë shpirtin, mirëpo mirësia e tij ndaj prindërve e shpëton atë nga Melekul Mevti.

Pastaj, kam parë një njeri të umetit tim *se si i vjen* dënimi në varr, mirëpo i del përpara abdesti dhe e shpëton prej atij dënimi.

Pastaj, kam parë një njeri të umetit tim se si i silleshin vërdallë shejtanët, mirëpo u del përpara atyre “dhikri i Allahut” dhe i largon shejtanët prej tij.

Pastaj, pashë një njeri të umetit tim se si i shkuan melekët për ta dënuar, mirëpo para tyre u del namazi dhe e shpëton prej atij dënimi.

Pastaj, pashë një njeri të umetit tim, i cili digjej së eturi, dhe çdo herë kur i afrohej burimit dëbohej, mirëpo i shkon agjërimi i muajit ramazan, i jep të pijë ujë dhe e freskon.

Pashë një njeri të umetit tim, dhe i pashë Pejgamberët të vendosur shkallë pas shkalle. Dhe sa herë që tentonte të shkojë te ata, zbriste një shkallë më poshtë, pastaj shkoi gusli (pastrimi) dhe e kapi për dore, e sollti dhe e vendosi pranë meje.

Pastaj, pashë një njeri të umetit tim, para tij errësirë, në anën e majtë të tij errësirë, në anën e djathtë të tij errësirë, përmbi kokën e tij errësirë, ndërsa ai nuk dinte se kah të shkonte. I shkon Haxhi dhe Umreja dhe e nxorën prej errësirës në dritë.

Pastaj, pashë një njeri të umetit tim e që në dorën e tij ishin mbështetur të këqijat dhe zjarri. I shkon sadakaja dhe u bë mburojë mes tij e zjarrit, dhe mjegull mbi kokën e tij.

Pashë një njeri të umetit tim, i cili u fliste besimtarëve, ndërsa ata nuk flisnin me të. I shkon “ndërlidhja farefisnore” dhe thotë: “O ju grup i besimtarëve, ky ka qenë ai i cili ka ndërlidhur farefisnin e ai u fali atyre”. E besimtarët ia falën, folën me të dhe e morën në mesin e tyre.

Pastaj, e pashë një njeri të umetit tim, të cilin melaqet e ashpra, të quajtura Zebanije, e kishin rrethuar. I shkoi vepra e *urdhërimit në të mira dhe ndalimi nga e keqja*, e shpëtoi atë prej mesit të tyre dhe e përcolli deri te melaqet e rahmetit.

E pashë një njeri të umetit tim, këmbëzbathur dhe në mes tij dhe Zotit të Lartmadhëruar një perde. Shkon karakteri dhe morali i mirë i tij dhe e zbulon perden dhe e shpie te Allahu.

E pashë një njeri të umtit tim, të cilit fletushkat iu ishin vendosur në anën e majtë të tij, e shkon “frika e tij ndaj Allahut” i merr fletushkat dhe ia vendos në anën e djathtë të tij.

E pashë një njeri të umetit tim, peshorja e të cilit i ishte shumë e lehtë me vepra të mira, shkon EFRATUHU (fëmijët e vdekur të vegjël të tij) dhe e rëndojnë peshoren e tij.

E pashë një njeri të umetit tim, i cili qëndronte në një humnerë të xhehenemit, të cilit i shkon frika e tij ndaj Allahut të Lartmadhëruar, e nxjerr nga aty dhe e shpëton.

E pashë një njeri të umetit tim duke u djegur (përvëlur) në zjarr, e shkojnë lotët e tij, të cilët kanë pikuar vetëm prej frikës së Allahut të Lartmadhëruar, dhe e shpëtojnë.

E pashë një njeri të umetit tim, i cili lëkundej mbi urën e Siratit, ashtu si lëkundet prej erës së fortë. Dhe shkon mendimi i mirë ndaj Allahut, e qetëson dhe ai e kalon atë rrezik.

E pashë një njeri të umetit tim, i cili mbi urën e siratit një herë rrëzohej, tjetrën herë varej për të. E i shkon salavati, të cilin e ka dërguar për mua dhe e ngrit në këmbë.

E pashë një njeri të umetit tim, i cili ka arritur te dera e xhenetit, ndërsa dera e xhenetit u mbyll. E shkon Shahadeti-dëshmia se nuk ka Zot tjetër pos Allahut dhe e hap derën e xhenetit dha ai hyn në xhenet.

*(E ka regjistruar Medemi, i cili ka thënë se është hadith i mirë.*

*E kanë regjistruar një grup hafidhësh të hadithit, sepse  
në të ka vërtetësi të qarta).*

## [64] - PËRFUNDIMI I MIRË I LEXUESIT TË KURANIT

Një njeri i mirë kishte shprehi që për çdo ditë t'i lexonte nga dhjetë xhuza të Kuranit fisnik. Një ditë deri sa e lexonte suretu Ja Sinë, arrin te ajeti “*vërtet unë do të isha në humbje të sigurt*” shpirti i ngritet në qiell. Shokët për rreth u habitën dhe thanë: “Ky njeri ka qenë i mirë, e si të jep shpirt ajetin “*Vërtetë unë atëherë do të isha në humbje të sigurt*”?! Disa njerëz të mirë e kishin parë në ëndërr pas varrimit, dhe e kishin pyetur: “O filan, ti përfundove këtë botë me ajetin “*Vërtetë unë atëherë do të isha në humbje të sigurt*”. Po si është puna jote me Allahun sot? Ai iu përgjigjet atyre: “Kur më keni varrosur, dhe më keni lënë vetëm, erdhën dy melekët dhe më pyetën: - Kush është Zoti yt? Unë e vazhdova ajetin “**unë kam besuar në Zotin tuaj, a po dëgjoni**”. Atëherë më është thënë: “*Hyn në xhenet*”, e unë thashë (ajetin): “*O mjerë për popullin tim sikur ta dinin, se më ka falur mua Zoti im, dhe më ka bërë prej të nderuarve*”.

## [65] - OMERI R.A.

Omer bin Hatabi r.a., kur ishte *emir i besimtarëve*, blen një kalë dhe shkon larg tij për ta testuar. Mirëpo, kalit i paraqiten plot të meta fizike. Kthehet për t'ia kthyer shitësit, pasi që mendonte se ai e ka mashtruar. Mirëpo, shitësi nuk e pranon kalin prej emirit të besimtarëve. Atëherë, çka të bëjë emiri me këtë njeri të brishtë? Të urdhërojë për ta burgosur, apo ta akuzojë në gjyq? Atëherë, ai e ruajti të drejtën për ta akuzuar në gjyq. Mirëpo, i akuzuari e zgjedh për prokuror Sherihun, i cili ishte gjykatës i njohur në çështje të tregtisë. Emiri i besimtarëve doli në karrigen e të akuzuarve dhe vendimi u mor në dëm të



Omerit, sipas ligjit të drejtësisë, ku gjykatësi i thotë: “Merre atë që e ke blerë ose ktheje si ka qenë. Omeri e shikon Sherihun i gëzuar dhe i thotë: “A nuk ka vendim tjetër, pos këtij vendimi?! Pastaj nuk urdhëron për ta burgosur, e as për ta shkarkuar prej detyrës, as për ta degraduar, por, përkundrazi e emëron me një pozitë më të lartë, Gjykatës të Kufes.

Njëherë kur arritën stofat Jemenase, u shpërndahen muslimanëve, të gjithëve në mënyrë të barabartë dhe me drejtësi, Omeri vesh rrobat e reja të cilat vëreheshin se ishin një numër më i madh. Këtë e vërejtën muslimanët, pasi që gjërat shpërndaheshin haptazi. Omeri hipi në minber dhe i nxiti qytetarët për xhihad, duke pasur veshë rrobën (jemenase) dhe duke thënë: “Dëgjomëni dhe respektoni”. Mirëpo nuk përcillet me duartrokkitje të ngrohta, por dëgjohet zëri lart “Nuk ka dëgjueshmëri dhe nuk ka respekt, - mos dëgjoni dhe mos respektoni”. Kjo gjendje pastaj vazhdoi të ashpërsohet kur dhjetëra ushtarë brohoritën (duke shprehur pakënaqësi). Atmosfera qetësohet, kur Omeri me butësi thotë: “Po pse kështu? Allahu ju mëshiroftë!”. Njëri thotë: “Ju keni marrë stof sa kemi marr dhe ne, mirëpo si është e mundur që ajo të të mjaftojë ty për këmishë, kur ti je më i gjatë se ne? Diçka nuk është në rregull! Patjetër se ti ke marrë një hise më shumë se ne”. Atëherë Omeri e arsyeton veten duke e thirr djalin e tij, Abdullahin, për ta argumentuar. Abdullahi, djali i tij, deklaroi me zë të lartë se hisen e tij ia kishte dhënë babës, pandaj që të dy hiset i kanë mjaftuar për një këmishë, sepse vetëm njëra (pjesa e tij) nuk i mjaftonte as për t’i mbuluar organet e turpshme. Atëherë të gjithë e pranuan dhe revoltuesi i qetë tha: “Tani meriton dëgjim dhe respekt”.

Sikurse çdo njëri, gjatë natës edhe Omeri ka ndezur kandilin kur vinin njerëzit për zgjidhjen e çështjeve shtetërore, mirëpo kur fillonte ndonjëherë bisedë për çështje jo shtetërore, atëherë e

fikte dritën dhe thoshte se ky kandil është pronë shtetërore dhe nuk lejohet të përdoret për çështjet private.

Ishte dita e xhumasë, xhemati ishte tubuar dhe prisnin Hatibin (ligjëruesin), e ai ishte Omeri. Omeri ishte i fundit që erdhi, hipi në minber dhe kërkoi falje prej tyre. Kur e pyetën për shkakun e vonesës së tij, kuptuan se Emiri i besimtarëve - Omeri e kishte pastruar këmishën e tij, dhe pasi nuk kishte këmishë tjetër, pos asaj, kishte pritur deri sa të terej, e pastaj e kishte veshur dhe kishte ardhur në xhami për të ligjëruar.

Një natë Omeri r.a kishte dalë për të kontrolluar qytetin dhearrin në një tendë, e cila ishte tri milje larg Medinës. Vëren se në atë tendë ishte i ndezur një zjarr. Kur i afrohet tendës, sheh se brenda ishte një grua me fëmijët e saj, të cilët qanin. Omeri e pyet gruan: - Si po kaloni? Ajo i përgjigjet: - Është natë e ftohtë”.

- Po fëmijët pse po qajnë?
- Për shkak se janë të uritur.
- Po çka ka në kusi?
- Ujë.

E përziej thuaja se është ushqim, deri sa fëmijët të flenë. Pastaj gruaja thotë: “Allahu është në mes nesh dhe Omerit”(ajo nuk e dinte se ishte duke biseduar me Omerin).

Omer i thotë: - Zoti të mëshiroftë, po ku e di Omeri gjendjen e juaj? Gruaja i përgjigjet: - Subhanallah, ai e ka marrë përsipër qeverisjen për ne, ndërsa nuk e di asgjë për ne! Omeri me të shpejtë shkon në arkën shtetërore - depon e rezervave shtetërore, merr gjëra ushqimore: miell, vaj, dhe i vendos në shpinën e tij për t’ia sjellë në tendë, duke mos lejuar që dikush tjetër t’i bartë pas tij, duke thënë se në Ditën e Kijametit nuk dëshiroj t’ia barti mëkatet e tij. Pastaj Omeri *Emir e besimtarëve* përgatit ushqimin për fëmijët, ndërsa gruaja habitet me atë përgatitje dhe thotë:

*“Zoti të shpërbleftë me të mira. Për Zotin, ti ke më shumë të drejtë të jesh Emir i besimtarëve se sa Omeri”.*

Ebu Musa Esh-shaeriju e ka dënuar një ushtar në Irak me heqje të flokëve. Ushtari e konsideron se kjo është shkelje e të drejtës së tij dhe dënim jo i merituar. Kështu ai i tubon flokët dhe udhëton prej Irakut e deri në Medinë. Hyn te Emiri i besimtarëve dhe ia paraqet flokët e prera të tij para tij, duke thënë: “Kështu veprojnë me në të emëruarit e tu!” Omeri thërret me zë të lartë e thotë: “Po të ishin të gjithë guximtarë si ky, do të ishte më e dashur për mua se sa ajo që kemi çliruar prej vendeve deri më sot. Kjo është shëmbëlltyra e Umetit tonë.”

Omeri r.a vazhdimisht ka qajtur prej frikës se Allahut të Lartmadhëruar, sa që në fytyrën e tij ke mundur të shohësh dy vija të zeza prej lotëve të shumtë, të cilët rridhnin nëpër faqe dhe thoshte: “Mjerë për mua, po më mirë mos të kisha lindur fare; mjerë për mua po të kisha qenë një kime floku në trupin e Ebu Bekri Sidikut”. Ai gjithashtu thoshte: “Po të thërriste një zë e të thoshte se të gjithë njerëzit do të hynë në xhenet, vetëm njëri jo, do të kisha menduar se ai i cili nuk do të hyjë në xhenet jam unë!”

## **[66] - ÇDO GJALLESË NË TOKË E KA FURNIZIMIN PREJ ALLAHUT**

Tregohet se një njeri ulet nën hije të hurmave dhe pasi u shtri në shpinë e sheh një vremç, i cili në gojën e tij kishte një hurmë të pjekur dhe një të papjekur. Pastaj e përcjell dhe e vëren se e njëjta gjë përsëritej disa herë. Kjo gjë e mahniti dhe tha në vetvete: Do të ngritem lart të shoh çka është puna? U ngjit lart në trupin e hurmës, kur sheh se në një vrimë të trungut

një gjarpër i verbër e hapte gojën ndërsa vremçi (zogu) e vendoste hurmën në gojën e tij. Kjo gjë e habiti dhe tha: “Zoti i Lartmadhëruar ka folur të vërtetën kur ka thënë: “Nuk ka asnjë gjallesë në tokë që nuk e ka furnizimin prej Allahut”.

Tregohet se ibn Ebshadhi, i njohur si gjuhëtar, një ditë qëndronte në kulm të një xhamie të Egjiptit. Ishte duke ngrënë diçka, kurse pranë tij ishin disa tjerë. Afrohet një macë në mesin e tyre, ia japin një pjesë buke, ndërsa ajo e merr me gojë, shkon dhe pas një kohe prapë kthehet. I japin diçka tjetër, e ajo veprimi njësoj. Ajo vazhdimisht shkonte e vinte, ndërsa ata i jepnin nga diçka. Ata e kuptuan se tërë atë ushqim ajo nuk po e hante vet, sepse ajo ishte sasi e madhe. Pasi dyshuan, herën e fundit e përcollën dhe e panë se ajo ngjitej nëpër mur, e në kulm të xhamisë, e pastaj zbriste në mes dy mureve, në një vend ku ishte një mace tjetër e verbër. Dhe sa herë që kishte marrë ushqimin ia kishte dërguar macës së verbër, ia kishte vendos pranë dhe ajo e kishte ngrënë. Ata ishin befasuar, ndërsa Ibn Shadhi u thotë atyre: “Përderisa kësaj kafshë, e cila nuk flet, Allahu ia ka mundësuar që macja të përkujdeset për të, atëherë për çka të brengosem për veten time sa i përket rizkut.

## **[67] - TREGIMI I VËRTETIMIT DHE FLETUSHKAVE**

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: “Në Ditën e Kijamit Allahu e paraqet njeriun e fundit të umetit tim para krijesave, e pastaj i paraqet para tij nëntëdhjetë e nëntë fletushka (regjistra), ku secila nga fletushkat është në gjatësi sa sheh syri. E i thotë: “A mohon diçka prej këtyre?” Ai thotë: “Jo o Zoti im”. Zoti i

thotë: “Mos ndoshta regjistruesit e mi kanë shkruar gabim, apo të kanë bërë ndonjë padrejtësi?” Ai thotë: “Jo, Zoti im”. Zoti i thotë: “A ke ndonjë arsyetim për këto (gabime) apo ndonjë vepër të mirë?” Ai thotë: “Jo, Zoti im”. Allahu i Lartmadhëruar i thotë: “Por, ti ke te Ne një punë të mire, e ne nuk të bëjmë padrejtësi sot, dhe ia qet përpara vërtetimin (dokumentin) në të cilën është e shkruar “Eshhedu en la ilahe il-lallah ve ene Muhamedun resulullah”. E pastaj thotë: “Silleni peshojën (vagën) e tij”. Ai thotë: O Zoti im po çka është puna me këtë, si mund të matet ky dokument vërtetimi me të gjitha këto fletushka?! Zoti i thotë: “Ty nuk të bëhet padrejtësi”. Dhe në njërën anë të peshojës vendosën fletushkat, ndërsa në anën tjetër *dokument vërtetimi* i shahadetit. Mirëpo do të peshojë më rëndë *dokument vërtetimi* i *Shahadetit*, ndërsa nuk peshojnë fare fletushkat, dhe asgjë nuk mund të matet me emrin e Allahut.

*(Këtë e ka regjistruar Ibn Maxhe dhe Termidhiu, i cili ka thënë: hadithë hasen garibë. Po ashtu edhe Bejhekiu dhe Hakimi kanë thënë se është hadith Sahihë në bazë të kushtit të Muslimit).*

## [68] - TREGIMI I THERJES SË VDEKJES

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: “Do të sillet vdekja si një dash pa brirë, dhe thërret një thirrës: ‘O ju banorë të xhenetit!’ Ata i ngritin kokat lart dhe presin çka do t’u thuhet. E thirrësi thotë: ‘A e njihni këtë?’ Ata përgjigjen: - Po, kjo është vdekja dhe secili prej nesh veç e ka parë (e ka përjetuar). Pastaj prapë thërret: ‘O ju banorë të xhehenemit!’ Ata i ngrisin kokat lart dhe presin çka do tu thuhet. E thirrësi thotë: ‘A e njihni

këtë?’ - Po, e njohim, kjo është vdekja dhe secili prej nesh vetëm se e ka parë (e ka përjetuar). Atëherë ajo pritet (vdekja thërret) dhe u thuhet: ‘O ju banorë të xhenetit! Keni përjetësi e jo vdekje. O ju banorë të xhehenemit! Ju do të jeni përgjithmonë në të e nuk do të ketë vdekje.

Në një transmetim tjetër thuhet: “Banorëve të xhenetit u shtohet gëzimi edhe më shumë, ndërsa banorëve të xhehenemit u shtohet pikëllimi edhe më shumë, - dhe (Pejgamberi a.s.) e lexon ajetin kur’anor: “Dhe lëri që të presin ata deri në Ditën e Dështimit kur do të përfundojë çdo gjë, deri sa ata nuk janë në dijeni për të, e ata as që besojnë”. Ata janë indiferent, nuk janë në dijeni në këtë botë.

Këtë e ka transmetuar Ebi Said el Hudriju. Ndërsa në një tekst të përafërt dhe një tjetër të ngjashëm e kanë regjistruar dy Shejhat (Buhariu dhe Muslim) nga ibn Umeri.

## [69] – PAJTIMI NË FATKEQËSI

Tregohet se një njeri i mirë kalon pranë një njeriu, të cilin e kishte kapluar sëmundja e rëndë. Ai ishte i ngjitur për toke, sa që nuk mund të ngritej; i verbër, i shurdhër dhe thoshte: “ E falënderoj Allahun, i Cili nuk më ka sprovuar me sprovë, të cilat janë ballafaquar shumica e njerëzve”. Kalimtarë habitet e i thotë: “O vëlla, po çfarë të mira të ka dhënë Allahu ty, kur unë po shoh se të gjitha të këqijat (të metat) janë në trupin tënd. Ai i thotë: “Largohu or i çmendur, po a nuk po i sheh të mirat e mia, të cilat i kam, kur Allahu ma ka dhënë gjuhën të dëshmojë njëshmërinë

e Tij, zemrën për ta njohur Atë dhe në çdo çast për ta përkujtuar”.

\* \* \*

Tregohet se një njeriut të mirë kur i ndodhte ndonjë fatkeqësi apo sprovohej me diçka thoshte: “E bëftë Zoti mirë”.

Një natë i shkon ujku dhe ia grabit gjelin, e ai tha: “E bëftë Zoti mirë!” Pastaj në të njëjtën natë qeni rojtar i shtëpisë i ngordhi. E ai tha: “Zoti e bëftë mirë!” Pastaj gomari i pall për herë të fundit dhe ngordh. E ai tha: Zoti e bëftë mirë!” Pastaj tha: “Nëse do Zoti e bën mirë”. Familja e tij me këto fjalë të tij lodhen pa masë dhe nuk mundën ta duronin. Në të njëjtën natë hajnat arab e sulmuan fshatin dhe i mbysin që të gjithë fshatarët, e nuk shpëton askush, pos tij (dhe familjes së tij). Hajnat arab janë orientuar në fshat nëpërmjet të lehurit të qenit, këndimit të gjelit dhe palljes së gomarit (për shkak të errësirës), mirëpo atij veç i kishin ngordhur, kështu që ngordhja e tyre ka qenë shkak i shpëtimit. Qoftë i lartësuar i Planifikuesi i Mençur.

\* \* \*

Tregon Medainiju: “E kam parë në fshat një grua të bukur, aq trupin e strukturuar, aq lëkurë të ndritur dhe asi fytyrë të bukur që kurrë më parë nuk kisha parë, e i kam thënë: “Pashë Allahun, çka është ajo që ti ke këtë formë dhe këtë lumturi?” E ajo më tha: “Për Zotin në brendinë time ka pikëllim dhe brenga, ja po të tregoj: - E kam pasur burrin dhe dy fëmijë. Babai i tyre e pret një dele kurban në ditën e Kurban Bajramit. Derisa fëmijët loznin, djali i madh i thotë të voglit: “A dëshiron të të tregoj se si babai e ka prerë delen? I thotë: “Po”. E ai e pret atë. Kur e sheh se i del gjaku, ai trishtohet dhe ik në pyll, ku e han ujku. Babai del pas tij për ta kërkuar dhe duke e kërkuar pandërprerë vdes urie. E mbeta vetëm, kështu si jam.” I thashë asaj: “Po si je me

durim?” Ajo tha: **“Ka mund të më ndodhë ashtu siç u ka ndodhur atyre.** Unë jam e lënduar, por po i përballoj”.

\* \* \*

Kur Shafiut i vdes i biri thotë: “O Zoti im, nëse e ke sprovuar, e ke falur, e nëse atë e ke marrë, të tjerët i ke lënë. E ke marrë një pjesë (anëtar), ke lënë pjesët (anëtarët) tjetër. E ke marrë një djalë, e ke lënë djem të tjerë.

\* \* \*

Tregon Ahnaf bin Kajsi: Jam ankuar te xhaxhai im për dhembje të barkut, e ai më qortoi duke më thënë: “Nëse të ndodh diçka mos i trego askujt, sepse njerëzit janë dy llojesh: Ke shok, i cili pikëllohet kur të dëgjojë, e ke armik, i cili gëzohet. Çdo gjë që të ndodhë mos iu anko krijesave të njëjta si ti, të cilët të njëjtën gjë nuk mund ta largojnë as prej vetes së tyre. Por, ankoju Atij që të ka sprovuar, vetëm Ai ka mundësi për të ta larguar. O djali i vëllait tim, njëri prej syve të mi ka katërdhjetë vjet që nuk sheh, e nuk i kam treguar as gruas sime, e asnjë anëtari të familjes sime.

\* \* \*

Një njeri i mirë është sprovuar me fëmijë. Çdo herë kur i lindte një fëmijë, përkohësisht është gëzuar, por menjëherë i ka vdekur dhe e ka lënë të pikëlluar e me zemër të thyer. Mirëpo ai prapëseprapë posedonte iman të fortë, duronte burrisht dhe thoshte: “Allahu e ka falë, Allahu e ka marrë. O Zoti im! Më shpërble për shkak të kësaj fatkeqësie dhe me zëvendëso me më të mirë”.

I lind edhe fëmija i tretë dhe pas disa viteve i sëmuret aq shumë, sa që ishte shtrirë në shtratin e vdekjes. Babai qëndronte pranë tij, me sy të përplotur e të përgjakur prej pikëllimit. Për shkak të lodhjes e kaplon një sy gjumë dhe sheh ëndërr sikurse



ka ndodhë Kijameti dhe kanë filluar vështirësitë e tij. E sheh urën e siratit mbi xhehenemin, të cilin patjetër duhej ta kalonte. Duke kaluar mbi të frikohej se mos po rrëzohej. I afrohet fëmija i parë i vdekur me shpejtësi e i thotë: “Unë do të mbaj o baba im. Mbështetu në mua, e babai vazhdonte të ecte.” Mirëpo frikohej se mos po rrëzohej në anën tjetër. E sheh fëmijën e dytë, i cili i vjen dhe e mban në anën tjetër. Ai gëzohet për së tepërmi. Pasi ecën pak, e kaplon etja për së tepërmi dhe kërkon nga fëmijët ujë. Ata i thonë: “Jo, se nëse ndonjëri prej nesh largohet prej teje e shkon të marrë ujë, atëherë ti do të biesh në zjarr”. – Po çka të bëj? Njëri prej tyre i thotë: “O babai ynë, po të kishte qenë me ne vëllai ynë i tretë, ai do të kishte sjellë ujë. Njeriu në atë moment zgjohet nga gjumi dhe e falënderon Allahun se ende është gjallë në këtë botë dhe se Kijameti nuk kishte ndodhur. E shikoi fëmijën e sëmurë afër, kur sheh se edhe ai kishte vdekur. Dhe klith: “O Zot, të falënderoj se kam rezervuar te Ti vepra dhe shpërblim dhe Ti më bën të mundur ta kaloj urën e Siratit në Ditën e Kijametit.” Kjo ka qenë freski dhe qetësimi i zemrës së tij.

## **70 - NËNA E TË KËQIJAVE**

Uthman bin Afani r.a. deri sa ligjëronte tha: “O ju njerëz, largohuni nga alkooli, sepse është nëna e të këqijave. Para jush ka qenë një rob i devotshëm përderisa ishte në xhaminë e tij, ra në një pozitë tepër të vështirë, kur një grua shpirtkeqe e dërgoi vajzën (shërbëtoren) e saj dhe e thërret në shtëpi. Kur ai hyn në atë shtëpi, ajo ia mbyllë derën. E ajo kishte një foshnje dhe alkool, e i thotë: Nuk mund të dalësh nga kjo derë deri mos ta bësh njërën prej tri gjërave: të pishë këtë gotë me alkool, të bësh dashuri me mua ose ta mbytësh këtë foshnje, se për ndryshe do

të bërtas. E kur të vijnë njerëzit, do t'u them se ky ka hyrë në shtëpinë time të më dhunojë. E kush do të të besonte? Ai njeri mendon:

- Të qoj dashuri me të? Jo nuk do ta bëj atë vepër.
- Ta mbys fëmijën. Kurrë nuk do ta bëj.
- E pra do të pi alkool. Për Zotin deri sa ishte aty u deh, e pastaj bën prostitucion me atë grua, dhe në fund e mbyti edhe fëmijën. Në fund Othmani r.a. tha: Largohuni prej tij, sepse alkooli është nëna e të këqijave, sepse për Zotin, nuk mund të qëndrojnë bashkë në zemrën e njeriut alkooli dhe imani, sepse njëra e zë vendin e tjetrës.

## [71] - DËSHMORI I QESHUR

Said bin Xhubejri është dijetar, i cili diturinë e kishte përfituar nga Abdullah bin Abasi dhe Abdullah bin Umeri, njëherit edhe prej dijetarëve me famë në kohën e tabiinëve. Ai ka qenë në anën e Abdurrahman bil Eshathit, kur Halifja - Abdul Melik bin Mervani ishte mizor dhe vrasës. Pasi që humbi Eshathi në betejën e xhamaxhimit dhe u vra, Saidi shkon në Meke. Valiju i Mekes i asaj kohe - Halid bin Abdullah el Kusariji e arreston dhe e dërgon te Haxhaxh bin Jusuf eth-Thekafiju, e ai i thotë: Si e ke emrin?

- Said bin Xhubejr.
- Por ti je Shehij kesirë.
- Nëna ime e di më së miri pse më ka emëruar ashtu.
- Nëna ka gabuar edhe ti ke gabuar.
- Të fshehtën e di tjetër kush e jo ti.
- Jetën tënde do ta shndërroj në zjarr të flakosur.
- Po ta dija këtë do të të konsideroja Zot.
- Çka mendon për Muhamedin?
- Pejgamber i mëshirshëm dhe imam udhëzues.

- Çka mendon për Alijen, a është në xhenet apo në xhehenem?
- Po të kisha hyrë atje dhe t'i kisha parë se kush janë aty do ta kisha ditur.
- Çka mendon për Halifët?
- Nuk jam kompetent të flas për ta.
- Cilin e do më së shumti?
- Ai me të cilin më së shumti është i kënaqur Krijuesi.
- Po me cilin është më së shumti i kënaqur Krijuesi?
- Dituria është te Ai i Cili e di të fshehtën dhe të hapurën e tyre.
- Dëshiroj të jesh më konkret dhe më i sinqertë ndaj meje.
- Nëse nuk të jam përgjigjur, së paku nuk të kam gënjyer.
- Çka është me ty, pse nuk qesh?
- Po si të qesh krijesa e krijuar prej dheut, ndërsa atë krijesë prej dheu do ta djeg zjarri!
- Po, pse pra ne qeshim?
- Për shkak se zemrat nuk janë të mira.

Haxhaxhi dëshironte ta mashtronte Saidin, me të mirat e kësaj bote, me dëfrimet e tij, kështu që tubon para vetes ari, argjend, flori e diamant, *dhe krekoset me to.*

Saidi i thotë: Nëse i ke tubuar për t'iu frikuar Zotit në Ditën e Kijamett, kjo është mirë për ty, e nëse jo, atëherë vetëm një tronditje (në atë ditë) do ta pashë se si nëna e lë foshnjën, të cilën e ka lind, prej gjirit dhe nuk ka kurrfarë dobie ajo e cila tubohet vetëm për këtë dunja, nëse nuk e pastron e nuk jep zekatin.

Haxhaxhi i kërkon një kamxhik dhe një gyp i cili hedh flakë e zjarr, dhe kur i binte me shkop dhe i frynte gypit, gypi hidhte flake mbi të, Saidi qan. Haxhaxhi i thotë: - Pse po qan, a mos ndoshta po tallesh? Saidi i thotë: - Kjo është pikëlluese, ndërsa sa i përket fryrjes, po më përkujton Ditën e Madhe kur do ti fryhet surit. Ndërkaq shkopi më përkujton lisin, i cili është prerë pa të drejtë, ndërsa gypi po më përkujton se si do t'i fryhet Ditën e Kijametit.

Haxhaxhi thotë: - Mjerë për ty o Said? “Nuk ka mjerë për atë i cili shpëton në çastet e fundit nga zjarri dhe futet në xhenet.” Haxhaxhi i thotë: “Said, zgjidh në çfarë mënyre të të ekzekutoj?”

Saidi: “Zgjidhe për veten tënde o Haxhaxh, se për Zotin në çfarë forme më mbyt, në atë mënyrë ka për të të dënuar Allahu në botën tjetër.”

Haxhaxhi: “A mos po dëshiron të të fali?” Saidi: - Nëse më falë, më falë Allahu, ndërsa ti nuk ke çka të më falësh, dhe nuk ke kurrfarë arsye.

Haxhaxhi thotë: “Merreni dhe ekzekutojeni”. Duke dalë nga aty, ai qeshë. Për këtë i tregojnë Haxhaxhit, e ai thotë: “Kthejeni prapë.” E kthyen te Haxhaxhi dhe ai e pyet: “Pse qeshe?” “U habita me atë që nuk je mirënjohës ndaj Allahut, përderisa Allahu është tepër i butë ndaj teje” – u përgjigj Seidi. Haxhaxhi thotë: “Ekzekutojeni!” Seidi thotë: “E ktheva fytyrën time në drejtim të Atij, i Cili ka krijuar qiejt dhe tokën në përsosmëri, dhe unë besoj në besimin e pastër dhe nuk jam idhujtar.” Haxhaxhi thotë: “Mos e lejoni të kthehet në drejtim të kibles” Saidi (lexon ajetin) thotë: “**Ngado që të ktheheni edhe në atë drejtim është Allahu**”. Haxhaxhi thotë: “Zvarriteni me fytyrë për toke?” Saidi (lexon ajetin) thotë: “**Prej saj ju kemi krijuar, në të do tu kthejmë, dhe prej saj do t’ju rikthejmë edhe herën tjetër**”. Haxhaxhi thotë: “Prejani kokën. Saidi thotë: “Dhe unë shqiptoj “Eshhedu en la ilahe il-lallah vahdehu la sherike leh ve enne Muhameden abduhu ve resuluhu.” Merre këtë prej meje se me këtë do të ta takoj në Ditën e Kijametit.” Pastaj e bën këtë lutje: “O Zoti im, mos ia mundëso që pas meje të ekzekutoj njeri!”.

Ekzekutimi ka qenë në muajin Shaëban të vitit 95 hixhrij, ndërsa Haxhaxhi vdes në muajin Ramazan të të njëjtit vit dhe deri në vdekje nuk ka dënuar askënd.

Kur iu është prerë koka Saidit, ka rrjedh gjak për së tepërmi, e Haxhaxhi i fton mjekët dhe i pyet për të, dhe për të tjerët që i ka dënuar me vdekje para tij, sepse te të tjerët ka rrjedh gjak shumë më pak. Ata i shpjegojnë: “Ky kur është ekzekutuar, shpirti i ka dalë pas prerjes së kokës, ndërsa tek të tjerët, prej frikës shpirti iu ka dalë para prerjes së kokës, për këtë arsye u ka rrjedh pak gjak.

Kur Hasan el Basriu ka dëgjuar se Haxhaxhi e ka dënuar Said bin Xhubejrin me prerje të kokës, është lutur: “O Zoti im, dënoje këtë kriminel mizor.” Pastaj ka shtuar: “Për Zotin, po që se lindja e perëndimi të ishin bashkuar në dënimin e Saidit me vdekje, që të gjithë Allahu do t’i kishte dënuar me zjarr.”

Para se të vdiste Haxhaxhi, shpesh alivanosej dhe thoshte: “Çka ma keni sjellë këtu afër Said bin Xhubejrin?!” Kur është sëmurë, lodhej e flinte dhe e shihte Saidin me rrobat e tij duke i thënë: “O armik i Allahut, me çka më mbyte? E ai zgjohej i tronditur dhe thoshte: “Çka është ky Said bin Xhubejr këtu?” Haxhaxhi e sheh edhe një ëndërr se si ka vdekur dhe pas vdekjes është pyetur: “Po si veproi Allahu me ty pas vdekjes?”. E ai ka thënë: “Për çdo ekzekutues jam ekzekutuar, ndërsa vetëm për Said bin Xhubejrin jam ekzekutuar shtatëdhjetë herë.”

Said bin Xhubejri ka qenë hafiz i Kuranit, ka qenë më i njohuri për komentimin e Kuranit. Po ashtu ka qenë më i dituri në hadithë, në hallall e haram. Tregon Vefa bin Ijasi se një herë në Ramazan i ka thënë Saidi: “Mbama këtë Kuran” dhe nuk është zgjuar nga ai vend deri sa e ka bërë hatme Kuranin përmendsh. Po ashtu, Saidi ka treguar se në Qabe i ka falur dy rekate nafile dhe në ato dy rekate e ka bërë hatme Kuranin. Zoti e pastë mëshiruar dhe e pastë shpërblyer.

## [72] - TREGIMI I TRE PROKLAMUESVE

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: “Njerëzit e parë, të cilët do të gjykohen në Ditën e Kijametit janë:

**I pari** Shehidi, të cilit i paraqitet begatia e tij (e veprës së tij) dhe e sheh. I thuhet: “Pse ke ra shehid?” Përgjigjet: “Kam luftuar në rrugën Tënde o Zoti im, deri sa rashë shehid.” I thuhet: “Nuk është e vërtetë, kjo është rrenë. E vërteta është se ti ke luftuar që të thuhet për ty: “Filani ka luftuar kështu ...”, dhe ajo veç është thënë.” Pastaj jepet urdhri, tërhiqet për fytyre dhe hidhet në zjarr.

**I dyti:** Njeriu i cili ka arritur shkallë të lartë të diturisë, ka mësuar dhe ka lexuar Kuran. I paraqitet begatia e tij (e veprave të tij) dhe e sheh. I thuhet: Pse e ke mësuar? Përgjigjet: “Kam përfutuar dituri dhe kam mësuar, e kam lexuar për Ty o Zoti im Kuran.” I thuhet: “Nuk është e vërtetë, kjo është rrenë. E vërteta është se ti ke mësuar, që të thuhet për ty se ti je dijetar dhe ke lexuar Kuran që të thuhet: “sa lexues i mirë i Kuranit”. Dhe e vërteta është se ashtu është thënë.” Pastaj jepet urdhri, dhe tërhiqet për fytyre, dhe hidhet në zjarr.

**I treti:** Njeriu pasanik, të cilit iu është dhënë pasuri dhe ka dhënë (sadaka). I paraqitet begatia e tij (e veprave të tij) dhe e sheh. I thuhet: “Pse ke dhënë pasuri?” Përgjigjet: “Çdo herë kur ka qenë në pyetje me dhënë në rrugë të Allahut kam dhënë.” I thuhet: “Nuk është e vërtetë, kjo është rrenë. E vërteta është se ti ke vepruar ashtu që të thuhet se filani është dorëlibër, fisnik, dhe ashtu është thënë.” Pastaj jepet urdhri, dhe tërhiqet për fytyre dhe hidhet në zjarr.”

## **[73] - TREGIMI I IBRAHIMIT A.S. DHE AZERIT NË DITËN E KIJAMETIT**

I dërguari i Allahut s.a.v.s ka thënë: “E takon Ibrahim babën e tij - Azerin në Ditën e Kijametit, e Azeri fytyrën tërë pluhur dhe katran të zi. Ibrahim i thotë: “A nuk të kam thënë të mos më kundërshtosh?!” Babai i thotë: “Sot nuk të kundërshtoj”. Ibrahim thotë: “O zoti im! Vërtet, ti më ke premtuar që nuk do të më pikëllosh Ditën e Ringjalljes! E ku ka pikëllim më të madh që babai im të jetë më së largu nga mëshira jote?! Allahu i Lartmadhëruar thotë: “Unë ia kam ndaluar xhenetit që t’i pranojë pabesimtarët”. Pastaj i thuhet: “O Ibrahim çka ka nën këmbët tua? Kur shikon sheh një cofëtinë plot erë, e cila kapet për këmbë (cofëtina) dhe hidhet në zjarr. Kjo do të thotë se Ibrahim a.s. shikon dhe sheh se Azeri e ka prekë një ujë të ndotur dhe të fëlliqur. Urtësia është në atë se në prekjën e ujkut, ujku është kafsha më e çmendur. E pasi që e ka kundërshtuar këshillën e Ibrahimit dhe ka pasuar hapat e shejtanit, është njësoj si të ishte kafsha më e çmendura.

*TRANSMETON BUHARIU*

## **[74] - TREGIMI I DY MBRETËRVE TË CILËT E KANË LËNË MBRETËRINË PREJ FRIKËS SË ALLAHUT**

Muhamedi s.a.v.s. ka treguar: “Para jush ka qenë një mbret, i cili, deri sa ishte në fronin e tij, mendon një çast dhe e kupton se një ditë fronti i tij do të përfundojë, dhe se mbretëria ka

ndikuar që të largohet nga ibadeti i Zotit të Lartmadhëruar. Kështu që menjëherë largohet prej kështjellës së tij (Në vend të tij nga fronti mbretëror të tij emërohet mbret një tjetër). Ai shkoi në bregdet ku prodhonte qerpiç dhe tulla me paqë dhe prej atij fitimi ushqej, e tepricën e jepte sadaka. Ai vazhdoi kështu derisa arriti fjala te mbreti i riemëruar se si bënte ibadet dhe jepte sadaka. Mbreti e dërgon një njeri dhe e thërret në kështjellë për t'u bërë mbret, por ai refuzon. E dërgon për së dyti, kurse ai prapë refuzon. Atëherë mbreti mendon: “pasuria ime dhe pasuria e tij”. Për këtë arsye shkon vetë te ai, e kur e sheh, ai ik prej tij. Kështu kur e sheh mbreti se po ikën i shkon gjurmëve të tij duke vrapuar, mirëpo nuk e arrin dot. Prandaj e thërret: “O rob i Allahut! Nuk do të bëj asgjë të keqe dhe e ndal. Pastaj e arrin dhe thotë: “Po kush je ti, Zoti të mëshiroftë? I thotë: Unë jam filani, ish mbret këtu e këtu ..., mirëpo duke menduar e kuptova se një ditë mbretëria ime do të marrë fund, ndërsa ajo pozitë ishte shkaktare për mua që të largohem prej ibadetit të Zotit tim. Për këtë arsye e kam lënë mbretërinë dhe kam ardhur në këtë vend ta adhuroj Allahun e Lartmadhëruar. Mbreti i ri i thotë: Të njëjtën brengë si ti e kam edhe unë. Prandaj edhe unë do të veproj si ti. Zbret prej kalit dhe i bashkëngjitet. Ata së bashku e kanë adhuroj Allahun dhe e kanë lutur Allahun që të vdesin së bashku. Abdullah bin Mesudi thotë: “Po të kisha qenë në Egjipt do t'u kisha treguar edhe varrin e tyre, ashtu siç na ka përshkruar i Dërguari i Allahut s.a.v.s.”

*TRANSMETON TABERANIU NË KOLEKSIONIN E  
MADH DHE TË MESËM*

Nga ky tregim përfitohet:

1. Vlera e kujtimit të llogarisë dhe të menduarit e cila shpie në pedestal të lartë, jep frytet më të mira, sepse kjo i ka shtyrë mbretërit ta lënë këtë botë kalimtare dhe ta dëshirojnë botën tjetër. Çka është te ju zhduket, ndërsa çka është te Allahu është e përgjithmonshme.



2. Po ashtu nga tregimi përfitohet, vlera e fitimit nga puna e duarve tua dhe nuk bie ndesh misticizmin dhe imanin e plotë, me përjetimin e kënaqësive të kësaj bote, si të ushqimit, pijes, veshmbathjes, kuajve, të cilët këta dy mbretër i kanë lënë.

Në Sahihun e tij, nga Mikdari, transmeton Buhariu se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë:

*“Asnjë nga ju nuk ka ngrënë ushqim më të mirë, se sa ai i cili e ka fituar me dorën e tij, sepse Pejgamberi i Allahut - Davudi ushqehet prej fitimit të punës së duarve të tij”.*

## **[75] - VLERA E NAMAZIT ME XHEMATË**

Transmetohet nga Abidullah Kavariri (Shejhu i Buhariut dhe Muslimit) r.a. se ka thënë: “Asnjëherë nuk më ka kaluar pa e falur namazin e Jacisë me xhematë. Një natë më erdhën musafirë dhe isha i zënë, kështu që më kaloi namazi me xhemat në xhami. Dhe shkova nëpër xhami të Basrës mos po takoj ndonjë xhemat duke falur Jacinë. Mirëpo, për fat të keq, të gjitha xhamitë kishin qenë të mbyllura. U ktheva në shtëpinë time dhe thashë në vetvete: “Është transmetuar në hadithë se namazi me xhematë është më i vlefshëm se namazi që falet vetëm për njëzet e shtatë shkallë, prandaj fala namazin e Jacisë njëzet e shtatë herë. Pastaj fjeta dhe pashë në ëndërr se garoja me garë kuajsh. Unë isha mbi kalë, mirëpo ishte e pamundur t’i arrija. Njëri prej tyre u kthye dhe nga larg më tha: “Mos e lodh kalin tënd, se nuk mund të më arrish dot.” I thashë: “Po përse?” “Sepse ne e kemi falë namazin e Jacisë me xhematë, ndërsa ti e ke falë vetëm.” U zgjova nga gjumi i pikëlluar dhe shumë i mërzhitur për këtë.

## [76] - VARRET

Muhamed bin Rezizë El Haraniju shkon prej shtëpisë në arën e tij dhe tregon se çka i ka ndodhur. Ai tregon: “Para se të perëndojë dielli arrita te varret, kur e pashë një varr, i cili kishte gaca zjarri sa gota. I vdekuri në mes, dhe mbi të gacat prush. I fshija sytë e mi dhe thosha në vete: “Zgjuar jam apo fjetur?!”. Kur e shikova qytetin, e vërtetova dhe thashë: “Për Zotin nuk jam në ëndërr, por kjo është realitet”. Pastaj i frikësuar shkova në shtëpi. Më sollën ushqim, të cilit as që munda t’i afrohesha. Pastaj shkova në qytet dhe pyeta se kush ka qenë i varrosur në atë vend. Ata më treguan se aty në varr është një njeri kriminel, i cili po atë ditë kishte vdekur.

\* \* \*

Transmeton Shaebiuju, se një njeri i ka treguar Pejgamberit s.a.v.s.: “Kam kaluar rreth krojeve të Bedrit dhe kam parë se si një njeri e nxirrte toka jashtë, një njeri tjetër i binte me çekan deri sa humbte në tokë. Pastaj toka i nxirrte dhe prapë një njeri i binte me çekan deri sa humbte në tokë, dhe kjo gjendje vazhdonte pandërprerë. Ndërsa Muhamedi s.a.v.s. tha: Ai është Ebu Xhelil bin Hishami i cili do të dënohet në varr deri në Ditën e Kijametit.

\* \* \*

Transmeton *Salim* bin Abdullahu nga babai i tij se ka thënë: “Deri sa shkonim prej Mekes në Medine, me deve, kaluam pranë një varreze, kur aty pamë se një i vdekur kishte dalë nga varri, i cili ishte i prangosur me zinxhirë të hekurt, qafë e duar, i cili digjej flakë, tërhiqej zvarrë, dhe i thuhej: “O rob i Allahut zvarritu!”

Pastaj pamë edhe tjetrin duke dalë nga varri, i cili shkonte pas tij dhe i thuhej: “O rob i Allahut mos u zvarrit!”

Pastaj u tërhoqën dhe e kthyen prapë në varr. Pastaj ai tregon se në atë moment i kishte rënë të fikët dhe kishte rënë prej devesë në tokë, ndërsa flokët m’u zbardhën. Këtë ia ka treguar Othman bin Afanit, e për këtë arsye ai ia ka ndaluar që ai të udhëtojë i vetëm.

\* \* \*

Një Medinas e ka pasur një motër, e cila i vdes. Pasi e varrosi, kthehet në shtëpi, mirëpo, i kujtohet se i kishte rënë diçka në varr. E merr një shok dhe shkojnë së bashku. E çelin varrin dhe e gjejnë sendin e humbur. Pastaj i thotë shokut: “A po largohesh pak ta shoh motrën time”. Dhe kur e sheh se ajo digjej flakë, atëherë me të shpejtë e mbulon varrin dhe kthehet te nëna e tij dhe e pyet: “Oj nëna ime, më trego diçka më shumë për motrën?” Nëna i thotë: “Po çka të të tregoj tash, kur ajo është e vdekur?” Ai i tregon se çka kishte parë te varri i saj. Atëherë nëna i tregon: “Motra jote e vononte kohën e namazit dhe e kishte zakon që të shkonte nëpër dyer të shtëpive të fqinjëve, të dëgjonte në heshtje dhe t’ua zbulonte çështjet e tyre”.

\* \* \*

Një hajn i varreve, pasi që ishte penduar e kishin pyetur: “Cila është ajo që ke parë më habitëse te të varrosurit?” Ai u thotë: “Kam parë të varrosur, i cili ishte i gozhdur me gozhda në tërë trupin e tij, ndërsa gozhdat më të mëdha në kokë dhe në këmbë.

Por ajo që kam parë më se shumti është se shumë të varrosur i kam jo të kthyer në drejtim të kibles.

\* \* \*

## [77] - NDIKIM I KURANIT FISNIK TE TË MIRËT

Mensur bin Amari e sheh një djalosh, i cili falte namazin me frikë e i thotë: “O djalosh a e ke lexuar ajetin e Zotit të Lartmadhëruar: “O ju të cilët keni besuar, ruajeni veten tuaj dhe familjen tuaj nga zjarri, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët, mbi ta janë melekët e fortë dhe të ashpër, të cilët nuk e kundërshtojnë Allahun për çka do që i urdhëron dhe veprojnë çka do që urdhërohen”. Kur djaloshi e dëgjon këtë ajet i bie të fikët. E kur i vjen vetëdija thotë: “Më lexo edhe më shumë?” I thotë: “A e di se në xhehenem është një kodrinë që quhet “Flakë”, e cila i rrjepë lëkurat e pjekura, dhe e thërret atë i cili ia kthen shpinën e largohet nga rruga e drejtë”. Ai nuk mundi ta dëgjojë më shumë këtë këshillë të Kur’anit fisnik, kështu që vdes. Ia shpalos gjoksin, kur e sheh se në gjoks kishte të shkruar: “Ai është në jetë të kënaqshme, në xhenetet e larta të Sundimtari i Gjithëfuqishëm”. Dhe tregon: “Rashë për të fjetur duke menduar për rastin e këtij djaloshi dhe e pashë në ëndërr duke ecur nëpër xhenet, kurse në kokë kishte taxhin e devotshmërisë dhe e pyeta: “Si e arrite këtë pozitë të lartë?” Ai m’u përgjigj: “Po a nuk e lexove ajetin: “Nuk ka dyshim se të devotshmit janë në xhenete dhe lumenj, në pozicionet dhe ulëset e sinqeritetit të Sundimtari Absolut, Përcaktues i gjithçkaje”. O ibni Amar, Allahu më ka dhënë shpërblimin e dëshmorëve të Bedrit, e edhe më shumë”. E pyeta: “Po pse?” Ai m’u përgjigj: “Sepse ata kanë vdekur prej tehut të shpatës se pabesimtarëve, ndërsa unë kam vdekur prej tehut të shpatës se Kuranit fisnik”.

\* \* \*

Tregohet se Mesruki r.a. kur e ka dëgjuar se një lexues duke lexuar një ajet ka filluar të dridhet dhe të qajë. Lexuesit i thotë: “Ma lexo përsëri”. Ai e lexon. Kështu i thotë disa herë, e lexuesi ia lexon disa here, deri sa duke qajtur edhe vdes. Zoti e mëshiroftë, ngase ka qenë prej të mbyturve prej Kur’anit.

\* \* \*

Mensurë bin Amar r.a. tregon: “Hyra në qytetin e Kufes dhe, deri sa isha duke ecur në thellësi të natës dëgjova të qajturit e një njeriu me zë dridhës në brendi të shtëpisë së tij dhe duke u lutur: “Pashë Madhërinë Tënde, nuk kam dashur asnjëherë të të kundërshtoj e të të bëj mëkat, mirëpo kam bërë mëkat për shkak të paditurisë sime. Por tash, a thua, kush mund të më shpëtojë nga mëkati im ndaj Teje?! E kush mund të m’i forcojë marrëdhëniet me Ty, nëse i ndërpret ato?! Kërkoj prej teje të m’i falësh gabimet dhe të më ndihmosh, o Zoti im!” Pastaj vazhdon duke treguar Mensur bin Amari: “Ai me ato fjalë më bëri të qajë, e u ndala dhe e lexova ajetin: “O ju të cilët keni besuar, ruajeni veten tuaj dhe familjen tuaj nga zjarri, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët, e mbikëqyrës në të janë melaqet e forta e të ashpra, e të cilat nuk e kundërshtojnë Allahun për atë çka i urdhëron ata, dhe zbatojnë çdo urdhër, me të cilin u urdhërohen”. Për shkak të këtij ajeti dëgjova një britmë të madhe të tij. U ndala deri sa nuk u dëgjua të qajturit e tij dhe shkova nga aty. Të nesërmen shkova pranë shtëpisë së atij njeriu dhe e pashë se kishte vdekur. Njerëzit e përgatitnin për varrim, ndërsa një plakë qante. Pyeta se kush është ajo dhe më thane se është nëna e tij. Shkova te ajo dhe e pyeta se si ka qenë gjendja e tij, e ajo më tha: “Agjëronte ditën e falej natën, fitonte të holla dhe i ndante në tresh: një të tretën e shpenzonte për veten e tij, me një

të tretën më ushqente mua, dhe një të tretën e jepte sadaka. Ndërsa mbrëmë deri sa kishte kaluar një njeri dhe ai e kishte lexuar një ajet të Kuranit, ai kur e kishte dëgjuar kishte vdekur”.

\* \* \*

Tregohet se Mudiri, lexues i Kuranit, derisa lexonte ajetin “Ky është libri ynë, i cili u flet juve të vërtetën”, ka filluar të qajë. Abdul Vahid bin Zejdi deri sa e dëgjonte i bie të fikët. Kur i vjen vetëdija thotë: “O Zoti im! Për Madhërinë Tënde, nuk do të të kundërshtoj kurrë; më ndihmo që gjithmonë të jem i dëgjueshëm ndaj Teje!” Pastaj e dëgjon një lexues duke lexuar: “O ti shpirt i bindur, kthehu te Zoti yt i kënaqur plotësisht”. Pastaj i thotë atij lexuesit: “Sa e sa herë po i them shpirtit tim t’i kthehet Zotit dhe do t’i kthehem vendosmërisht, fillon të frikohet prej dënimit të Allahut, pendohet dhe përmirësohet. Zoti e ka folur të vërtetën kur ka thënë:

***“Sikur Ne ta zbritnim këtë Kur'an mbi ndonjë kodër, do ta shihje atë të strukur e të çarë prej frikës nga All-llahu”.***

*(El-Hashr, 21)*

Zuraret bin Eufa deri sa ua falte namazin e sabahit xhematit, e lexon ajetin kur'anor:

“Dhe kur t’i fryhet Nakurit, ajo ditë do të jetë ditë shumë e vështirë”. Duke e lexuar këtë, vdes. Zoti e mëshiroftë!

Kur ka zbritur ajeti kur'anor: “Dhe me të vërtetë xhehenemi është i premtuar për të gjithë ata”. Selman Faresiju ka klithur me një britmë, i ka vendosur duart në kokë dhe pastaj i ka rënë fytyrës së tij.

**[78] – KATËR LUTJET**

Ishte një pijanec, cili i thirri të pranishmit. Ata erdhën pranë tij dhe u ulën. Pastaj thirri shërbëtorin, ia dha 4 dërhëm dhe i tha që të shkojë të blejë pemë për këtë kuvend. Shërbëtori gjatë rrugës kaloi pranë një mistiku të njohur, i quajtur - Mensur bin Amar, i cili thotë: “Kush i jep këtij të varfëri do t’i bëjë katër lutje për të”. Djaloshi ia jep 4 dërhëm. Mensur bin Amarit. E ai i thotë: “Çka dëshiron të lutem për ty?”.

Djaloshi i thotë: “Zotëria im është i rreptë, dëshiroj të lirohem prej tij. E dyta: Që Zoti të m’i rikthejë 4 dërhëmët që jam duke i dhënë. E treta: Që zotëria im të pendohet. E Katërta: Allahu të ia falë gabimet e zotërisë dhe popullit tim.”

Mensur bin Amari bën katër lutjet. Djaloshi largohet prej tij dhe kthehet te Zotëria, i cili e pyet: “Përse je vonuar? Ku i ke pemët?” Shërbëtori ia tregoi rastin e Mensurit dhe si ia ka dhënë 4 dërhëmët, përballë 4 lutjeve. Zotëria u qetësua dhe i tha: “Cilat lutje i ke kërkuar prej tij për ty?” (Shërbëtori) thotë: “E para: E luta të lutej që të lirohem nga robëria.” Zotëria i thotë: “Të liroj, ti je i lirë për Allahun. Cila ka qenë kërkesa për lutjen e dytë?” “Që Allahu të m’i rikthejë 4 dërhëmët, të cilat ia dhashë”, - u përgjigj shërbëtori. Zotëria i thotë: “Ja ku i ke 4 dërhëm. Cila ka qenë kërkesa për lutjen e tretë.” “Që ti të pendohesh dhe t’i drejtohesh Allahut.” Zotëria e tundi kokën dhe filloi të qajë, e me dorën e tiji theu gotat e mbushura me alkool, dhe tha: “Pendohem te Allahu dhe kurrë nuk do të pi më alkool.” Pastaj e pyeti: “Cila ka qenë kërkesa për lutjen tënde të katërt?” Ai tha: “Që Allahu të t’i falë gabimet e tua dhe të popullit.” Zotëria tha: “Kjo nuk është në kompetencën time, por në kompetencën e Falësit të Gjithëmëshirshmit.”

Kur zotëria ra të flejë, atë natë dëgjoji një zë: “Ti e ke bërë punën tënde, e Allahu i ka falur gabimet e tua, të djaloshit, të Mensur bin Amarit dhe të gjithë atyre, të cilët kanë qenë prezent.”

## [79] – REZULTATI I ZILISË

Tregohet se një njeri vdes dhe i lë dy djem. Ata dy trashëguan shumë pasuri, të cilën e ndanë në mes vete. Secili prej tyre vepronte me pasurinë çka dëshironte. Djali i vogël merrej me tregti. Zoti ia shtoi pasurinë. Ai ishte i zgjuar, i sinqertë, e adhuronte Allahun, e falënderonte për të mirat dhe për profitin prej tregtie. Pasuria i shtoj dhe nuk kishte kundërshtarë. Për këtë arsye pasuria e tij ishte e mbrojtur dhe asgjë nuk mund t'i bënte syri i keq e as zilia.

Përderisa djali tjetër, i cili kishte marrë rrugën e keqe, tërë pasurinë e kishte harxhuar në alkool, bixhoz, prostitucion dhe nuk i kishte mbetur asgjë; ishte varfëruar dhe nuk kishte çka të hante. Përkundër kësaj, vëllai i tij ishte i ndjeshëm, përkujdesej për të, e ushqente, e veshmbathte dhe i jepte çka i nevojitej. Vëllai nuk kënaqej me këtë dhe nuk i mjaftonte, por kishte zili të madhe për vëllanë e tij. Kështu mendon t'ia bllokojë rrugën e tregtisë vëllait të tij, që të barazoheshin në varfëri dhe atëherë t'i lëshohej (qetësohej) zemra, që njerëzit mos ta nënçmojnë për shkak të varfërisë së tij, përderisa e vlerësojnë reputacionin e vëllait të tij. Kështu ai angazhohet ta arrijë realizimin e qëllimit të tij. Në fund veprimi me udhëzimin e Iblisit për të shkuar te një ziliqar, i cili ishte me famë për zili dhe shumë pak kush i kishte shpëtuar zilisë dhe syrit të keq të tij. Ziliqari nuk shihte shumë larg, por prej së afërmi. Vëllai i madh shkon te ky ziliqar i njohur me zili dhe kërkon që ai t'ia shikon me syrin e keq të tij pasurinë e vëllait dhe t'ia shkatërrojë. Vëllai i tij ishte në një rrugë dhe kur të kthehet ai ta bëjë një gjë të tillë, para se të kthehet nga rruga e tregtisë. Vëllai i madh i thotë ziliqarit: “Përgatitu se malli i tregtisë së vëllait është afruar dhe nga këtu nuk është më larg se një km. Njeriu ziliqar me fuqinë e syrit të tij i thotë: “A po mundesh ta shohësh nga kjo largësi? Ah



mjeri unë, po të kisha pasur këtë largpamësi (thotë ziliqari). Ai (Vëllai i madh) ndjeu një shtrëngim të madh në kokë, dh iu errësua shikimi dhe përnjëherë u verbërua (nga syri i keq). Ndërsa tregtia e vëllait kaloi pa kurrfarë të keqe.

## **[80] - SHPËTIMI PREJ KURTHEVE**

Tregon Ebu Hanife: “Në mesnatë më erdhi një njeri dhe më tha: “Më gjej zgjidhje para sabahut se përndryshe gruaja ime do të jetë e shkurorëzuar”. E pyeta: - Po si është puna? Ai më tha: - I kam thënë gruas sime se nëse nuk flas me ty ose nuk flet me mua para sabahut do ta shkurorëzoj tri herë. I kam përdorur të gjitha format dhe të gjitha metodat, mirëpo ajo nuk po flet. Ebu Hanife i thotë: - Shko dhe thuaji muezinit le të shkojë në xhami dhe le të thërret ezanin para kohe se ndoshta kur ta dëgjojë ezanin, ndërkohë t’i shko te ajo dhe kërko prej saj të flasë para ezanit të muezinit. Ai dhe vepron ashtu; shkon dhe kërkon nga ajo të bisedojë. Kur thërret ezani, ajo thotë: “Ja tani mori fund çdo gjë erdhi sabahu, e unë jam e liruar prej teje”, e ai i thotë: “Jo përkundrazi, ti fole para sabahut, dhe unë u lirova nga përbetimi”.

\* \* \*

Një njeri e sheh gruan e tij, e cila ishte ngritur lart në shkallë, e i thotë: Nëse rri lart je e shkurorëzuar, nëse zbret shkallëve të poshtë je e shkurorëzuar. Ajo prej shkallëve kërcen (gjuhët) në mes të oborrit. Pastaj burri i thotë: “Për babanë dhe nënën time, nëse vdes imam Maliku banorët e Medinës do të vijnë tek ti për zgjedhjen e problemeve të tyre (duke e lavdëruar gruan e tij për shkak të mendjemprehtësisë së saj).

Dahak bin Mezahim i thotë një krishteri: “Pse nuk po e pranon islamin?” Ai i thotë: “Për shkak se unë pi alkoolin shumë.” Ai i thotë: “Pranoje islamin e vazhdo të pishë.”

Pasi që i krishteri e pranon islamin i thotë: “Nëse pi alkool dënohesh, nëse largohesh prej fesë ekzekutohesh.” Kështu ai u bë më i sinqertë në islam.

\* \* \*

Një ditë Harun Er-Rreshidi, i cili ishte shumë xheloz ndaj bashkëshortes së vet një herë (nga mosmarrëveshjeve me të) i thotë: “Nëse një natë kalon natën në mbretërinë time je e shkuroreзуat tri here.” Pas kësaj shkojnë dhe e pyesin Kadijen, Ebu Jusufin, si të veprojnë, e ai thotë: “Le ta kalojë natën në xhami, sepse xhamitë janë të Allahut. Atëherë Reshidi e cakton Kadi në tërë mbretërinë e tij.”

\* \* \*

Tregohet se një kuzhinier ia sjell ushqimin mbretit Persian, dhe duke ia vendosur i bie një pikë ushqim në tavolinë. Atëherë mbreti i thotë: “Je i dënuar me vdekje!”

Kuzhinierit i merr pjatat e i hedh nëpër tavolina e nëpër trup të mbretit. Mbreti i thotë: Çka të shtyri që të veprosh kështu?! Unë për një pikë që ra në tavolinë të thashë se je i dënuar me vdekje?

Kuzhinieri i thotë: “Më erdhi turp që kur të dëgjojnë njerëzit se ti më ke ekzekutuar për një pikë, e cila ra në tavolinë, dhe atë rastësisht, edhe pse të kam shërbyer shumë e shumë vite. Kështu që unë dëshirova që të bëj gabim më të madh që kur ti, si mbret, të më ekzekutosh, së paku të kesh një arsyetim të plotë para tjerëve.” Atëherë mbreti ia fali dhe i jep shpërblim për atë arsyetim.

## [81] - NDËRTIMI I QABES

Nga Ibn Abasi r.a. transmetohet se Ibrahim i a.s. e ka marrë (bashkëshorten e tij) nënën e Ismailit, Haxherën, e cila ende ishte duke i dhënë gji foshnjës, dhe i ka lënë te vendi DEHVATU (ku ka qenë një lis i madh), pra saktësisht te Shtëpia e Shenjtë (Qabeja), përmbi pusin Zemzem mbi xhami. Në atë kohë, në Meke, nuk kishte njeri, nuk kishte ujë. Pasi i vendosi aty, ua la një enë me hurma dhe një gastare me ujë. Pasi i vendosi aty, Ibrahim u nis për të shkuar. Kur Ibrahim i a.s. niset, nëna e Ismailit i thotë: “O Ibrahim, ku po shkon e ku po na le në këtë kodrinë, në të cilën nuk ka asgjë?!” Këtë ia thotë disa herë dhe e bën që ai të kthehet në fytyrë në drejtim të saj. Pastaj Haxherja i thotë: “A Allahu të ka urdhëruar për këtë?” I thotë: “Po”. Atëherë ajo i thotë: “Atëherë Zoti nuk do të na lë në humbje” dhe kthehet. Largohet Ibrahim i s.a.v.s. prej tyre deri sa arrin në Thenije (vend në Meke) prej nga nuk mund ta shihnin ata; kthehet në drejtim të Kibbles, pra në drejtim të Qabesë, lutet për ta, i gëritet duart dhe thotë:

***“Zoti ynë! Unë një pjesë të familjes sime e vendosa në një luginë, ku nuk ka bimë, e pranë shtëpisë Tënde të shenjtë. Zoti ynë (i vendosa aty) që ta falin namazin, pra bën që zemrat e disa njerëzve të mallëngjehen për ata, dhe për të të falënderuar me mirënjohje, furnizoi ata me fruta”.*** (Ibrahim, 37)

Nëna e Ismailit i jepte gji Ismailit dhe e pinte ujin deri sa i shpenzohet i tëri. Pastaj Ismaili etet, etet edhe nëna, kurse ajo fillon ta shikojë fëmijën e saj se si i lëviz buzët për shkak të etjes. Dhe nuk mund të durojë duke e parë në atë gjendje. E sheh kodrinën Safa, e cila ishte kodrina më e afërt. Hip mbi atë kodrinë dhe shikon mos po e sheh ndokënd, por nuk sheh askënd. Zbret prej majës së kodrës në rrafsh, ngre një pjesë të këmishës, pastaj ecën me hap normal, deri sa e kalon tërë

gjatësinë deri te kodrina Mervete dhe hip në maje që të shikojë ndokënd. Kështu ka vrapuar shtatë herë.

Ibni Abasi thotë se ka treguar Pejgamberi s.a.v.s.: “Për këtë arsye haxhinjtë e bëjnë *Saëjin* në mes këtyre dy kodrinave. Kur për herë të fundit arrin në Mervete e dëgjuan një zë. Hesht (në vetvete), pastaj përqendrohet të dëgjojë me vëmendje dhe thotë: “Kam dëgjuar një zë duke thënë se nëse ke nevojë për ndihmë, kërko të të ndihmoj. Kur e sheh një melaqe (xhibrilin a.s.) te vendi Zemzem dhe shkon në atë drejtim deri sa e sheh sesi shpërthen një burim, i cili burim bëhet bazen dhe i sinjalizon me dorën e saj kështu, dhe i mbush grushtet me ujë dhe pastaj prej grushteve pi ujë.

Tregon ibni Abasi r.a. Ka thënë Muhamedi s.a.v.s.: “*Zoti e mëshiroftë nënën e Ismailit, sepse po të mos kishte pirë ujë me grushte, atëherë Zemzemi do t’ kishte mbetur burim i rëndomtë*”. Pastaj tregon: Ajo ka pirë ujë, i ka dhënë qumësht fëmijës së saj. E Melaqja thotë: - Mos u frikëso, nuk do të shkatërrohesh, sepse këtu është një shtëpi preh shtëpive të Allahut, të cilën do ta ringrit ky fëmijë me babanë e tij. Allahu nuk e humb familjen e tij.

Qabeja i ka pasur të ngritura themelet mbi tokë dhe ka qenë e ngritur, ndërsa nga ana e djathtë dhe e majtë kalonin udhëtarët, derisa kalon një karvan në atë drejtim dhe arrijnë në Mekë, aty e shohim në qiell se si një shpend sillet rreth e rrotull ujit për të pirë ujë. Ata thonë: “Ky shpend po sillet rreth e rrotull, sepse ka vërejtur ujë, prandaj të dërgojmë një vëzhgues në atë kodrinë. Dhe ashtu vendosën. E dërguan një vëzhgues apo dy dhe shohin se aty ka ujë. Shkojnë te nëna e Ismailit, saktësisht te burimi i ujit dhe i thonë: “A na lejon të vendosim këtu?” Ajo u thotë: “Po, mirëpo e drejta e ujit është e imja, jo e juaja (pra, të drejtën e ujit e kam unë. Nëse dëshiroj ju jap, nëse dëshiroj nuk ju jap).” Ata pranojnë. Tregon Ibni Abasi:

“Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Nëna e Ismailit ka dëshiruar që ata të vendosen në atë vend për shoqëri. Atëherë ata vendosen aty, i thërrasin edhe familjet e tyre (Xherum bin Katani). Ata vendosen aty dhe ky vend bëhet vendbanim në kuptim të plotë të fjalës. Djaloshi (Ismaili) rritet me ta dhe e mëson gjuhën arabe prej tyre. Kështu ata e donin dhe kur arrin moshën e pjekurisë e martojnë me njërin prej vajzë të tyre. Nëna e Ismailit vdes. Pas martesës së Ismailit, Ibrahim i a.s. shkon në atë vend për të parë pasardhësit e tij. Mirëpo Ismailin nuk e takon në shtëpi. E pyet gruan e Ismailit për gjendjen ekonomike të tyre, e ajo i përgjigjet: “Ne jemi në gjendje të vështirë, as që mundemi të mbijetojmë”, - kështu i ankohet atij. Ibrahim i thotë: “Kur të vijë burri yt, përcille selamin (përshëndetjen) time dhe thuaj se të kam thënë që ta ndërrojë pragun e shtëpisë. Kur kthehet Ismaili në shtëpi e pyet gruan: “Mos vallë ka qenë ndokush?” Ajo i përgjigjet: “Po, ka ardhur një plak dhe me pyeti për ty, e unë i thashë: Jetojmë me përpjekje dhe vështirësi të madhe.” “Po a të ka porositur diçka?” Ajo thotë: “Po, më ka thënë të ta përcjell selamin dhe të të them: “Ndryshojë pragun e shtëpisë”. Ismaili thotë: “Po ai është babi im dhe më paska ardhur për të thënë që të të lëshoj dhe të të dërgoj në familjen tënde. Dhe e lëshon e martohet me një grua tjetër prej mesit të tyre. Pas një kohe prapë Ibrahim shkon dhe nuk e gjen Ismailin. Hynë në shtëpi dhe e pyet gruan për Ismailin. Ajo i thotë: “Ka dalë të punojë për familje.” Ibrahim e pyet: “Si e keni gjendjen, si po jetoni?” Ajo i përgjigjet: “Elhamdulillah! E Falënderojmë Allahun, mirë jemi duke jetuar.” Pastaj e pyet: “Me çka po ushqeheni?” “Me mish”, - ia ktheu ajo. “Po çka po pini?” “Ujë”, - i përgjigjet. Ibrahim bënë lutje: “O Zoti im, bekoji ata me mish e me ujë”. Pejgamberi s.a.v.s. Thotë: “Në atë kohë aty nuk ka pasur bimë, sepse po të kishte pasur do të lutje për t’u shtuar bimët. Ata, e kanë pasur traditë që çdo kush që kalonte andej e shoqëronin dhe e ndihmonin. Ai i thotë: “Kur të vjen

bashkëshorti përcillja selamin tim dhe urdhëroje ta forcojë pragun e shtëpisë. Kur Ismaili kthehet në shtëpi. E pyet bashkëshortin se a ka qenë ndokush. Ajo i përgjigjet se ka ardhur një njeri i moshuar, me pamje të mirë. Më pyeti për ju dhe i tregova. Më pyeti se si jetojmë e unë i tregova se jemi duke jetuar mirë. Pastaj Ismaili a.s. e pyeti bashkëshorten e tij se a kishte lënë ndonjë porosi. Ajo i thotë: “Po, më porositi që të ta përcjell selamin dhe që ta forcosh pragun e shtëpisë tënde.” Ismaili a.s. i thotë se ai ishte babai im e ti je pragu im dhe më ka urdhëruar që të të mbaj nën kurorë. Pastaj ka jetuar një kohë sa ka dashur Allahu, më pas Ismaili a.s. e mbolli një pemë afër ujit Zem-zem. Kur herën tjetër vjen babai i tij, përqafohen mes vete dhe babai (Ibrahimi a.s.) i thotë : “O Ismail, Allahu më ka urdhëruar të ndërtoj një faltore (xhami).” Ismaili a.s. i thotë: “Vepro ashtu siç të ka urdhëruar Allahu.” Ai i thotë: “Po, a më ndihmon?” Ismaili a.s. i thotë: “Po, të ndihmoj.”

Ibrahimi a.s. i thotë se Allahu më ka urdhëruar ta ndërtoj xhaminë këtu dhe sinjalizoi në vendin ku kanë qenë themelet e vendosura. Pastaj i ngriti ato themele. Ismaili a.s. i sillte tulla dhe gurë, ndërsa Ibrahimi a.s. i vendoste derisa arriti te guri mekamiibrahim dhe e vendos aty, gjatë vendosjes i ndihmon edhe Ismaili a.s. duke thënë së bashku: “O Zoti ynë, pranoje nga ne, vërtet Ti dëgjon dhe je i Ditur.”

*(Transmeton Buhariu)*

## **[82] - NJË E MIRË PËR NJË TË MIRË**

Tregohet se Vehb bin Munbehi ka thënë: “Deri sa një grua prej beni Israilëve ishte buzë detit duke i larë rrobat dhe në afërsi fëmija i saj luante, vjen një lypës, e ajo ia jep një pjesë buke, të cilën e kishte me vete. Nuk kalon shumë kohë dhe një ujk ia kap foshnjën, ndërsa ajo vraponte pas tij duke thënë: “O

ujk, ai është biri i im, ai është biri i im.” Allahu e dërgon një melek, i cili ia heq prej gojës së ujkut dhe ia sjell nënës e i thotë: “Një e mirë për një të mirë”.

## **[83] - TREGIMI I FRIZERES PRIVATE (FLOKTARES) SË VAJZËS SË FIRAUNIT**

Transmeton Ibn Abasi se Muhamedi a.s. ka thënë:

“Në Natën e Israsë dhe të Miraxhit, kur jam ngritur në një vend prej vendeve, e kam ndier një aromë të këndshme, dhe pyeta: “O Xhibril, ç’është kjo erë e këndshme?!” Ai tha: “Kjo është aroma e floktares së bijës së firaunit dhe bijve të vet (floktares).” E pyeta: “Po çka ka qenë puna me të?” Ai tha: “Derisa e krihte bijën e firaunit i bie krehri prej dorës së saj, e ajo prapë e merr prej toke duke thotë “Bismilahi”. E bija e firaunit i thotë: “Thuaj me emrin e babait tim!” Ajo i thotë: “Jo (me emrin e babait tënd), por me emrin e Zotit tim, Zotit tënd dhe Zotit të babait tënd. Pra, me emrin e Allahut.”

Ajo e pyet: “A ke ndonjë Zot tjetër, pos babait tim?” Ajo iu përgjigj: “Po.” Ndërsa ajo i tregoi firaunit, i cili e thërret atë dhe i thotë: “Oj filane (N.N.)! A ke Zot pos meje?” Ajo i përgjigjet: “Zoti im është edhe Zoti yt, Allahu i cili mbizotëron çdo gjë.”

Firauni urdhëroi që të ndizej një zjarr nën një kazan të madh, i cili vlonte. Pastaj i merr djemtë e saj dhe i gjuante një nga një. Ajo i thotë: “Kam një kërkesë.” Firauni i thotë: “Cila është ajo kërkesë?” Ajo i thotë: “Dëshiroj që t’i tubosh eshtrat e mia dhe të fëmijëve të mi në një qefin dhe të na varrosësh të gjithëve së bashku.” “Këtë edhe do ta bëjmë”, - iu përgjigj firauni. Fëmijët e saj i hidhte në kazan një nga një, derisa i erdhi radha edhe fëmijës së saj në gji. Dhe sikur për të u brengos për së tepërmi, mirëpo fëmija në gji i thotë: “Oj nëna ime, hidhu në

zjarr së bashku me mua se dënimi në dunja është shumë më i lehtë se dënimi i ahiretit!” Pastaj u gjuajtën me fëmijën e saj. Katër fëmijë (në djep) kanë folur, e ato janë: Foshnja e frizeres së vajzës së Firaunit, Dëshmitari i Jusufit, Shoku Xhurejxh dhe Isa - i biri i Merjemes”.

*(Transmeton Ahmedi dhe Berraziju, ibn Habani,  
Hakimi dhe të tjerët)*

## **[84] - TREGIMI I PABESIMTARIT TË PARË**

Amër bin Luhij ka qen njeri i cili gjatë sezonës së vizitës së Qabës i ushqente njerëzit dhe i veshmbathte. Ka ndodhur që vetëm në një sezonë t’i ketë dhënë dhjetëmijë deve. Ka qenë arab shumë fisnik dhe guximtar, ndërsa arabët këto dy cilësi të njeriut shumë i kanë çmuar. Për këtë shkak edhe njerëzit e kanë dashur shumë, janë pajtuar me mendimet e tij dhe i kanë kryer urdhrat e tij. Çdo risi që e përfitonin arabët e bënëin zakon. Ai njëherë shkon prej Mekes në Sham ( Siri ) për një punë të tij. Në atë kohë Sirinë e sundonin Amalikët. I sheh se ata adhuronin idhujt. Ai i pyet: “Çka janë këto idhuj që po i adhuron.” Amalikët i përgjigjen: “I adhurojmë, ngase kur kemi nevojë për shi, lutemi për shi, dhe bie shi; u lutemi të na ndihmojnë dhe na ndihmojnë.” U thotë atyre: “A nuk po ma jepni një idhull ta dërgoj në vendet arabe që ta adhurojnë.” Ia japin idhullin e ashtuquajtur HUBEL. E sjell në Meke, e vendos në Qabe dhe i urdhëron njerëzit për ta adhuruar dhe që ta madhërojnë. Njerëzit e dëgjuan, sepse fjala e tij ka qenë e dëgjueshme dhe adhurim. Përderisa ai ka qenë në Mekë, ishte një njeri i cili gatuate bukë dhe u ofronte Haxhinjve. Bukën e gatuate në gurin që e quante “Guri i Latit”. Pra, guri ku është hedhur brumi dhe është gatuar deri sa është bërë bukë. Kur ky njeri i quajtur “Latë” vdes, Amër



bin Luhij thotë: “Ky njeri nuk ka vdekur, por ka hyrë në gur” dhe i urdhëron kurejshitët që ta adhurojnë, dhe t’ia ndërtojnë një shtëpi dhe ta quajnë “Latë”, - ashtu edhe kanë vepruar. Pastaj, me ardhjen e islamit, Muhamedi a.s. e ka kuptuar realitetin dhe e ka kuptuar se Amër bin Luhij është ai i cili ka urdhëruar Kurejshitët të ndërtojnë tempullin e “LATIT”.

Muhamedi s.a.v.s. na ka mësuar edhe më shumë për këtë njeri. Pejgamberi a.s. i ka thënë njërit prej Sehabeve, i quajtur Ethem: “E kam parë Amër bin Luhijun se si i tërhiqte zorrët e tij në zjarr, dhe nuk kam parë njerëz të cilët i ngjajnë njëri-tjetrit më shumë se ti me të, e ai me ty.” Ethem i thotë: “Ngjashmëria e tij me mua ndoshta do të më bëjë keq o i Dërguar i Allahut.” I Dërguari i Allahut s.a.v.s. thotë: “Jo se ti je besimtar e ai pabesimtar.” Ai ka qenë njeriu i parë pabesimtar, i cili nuk e ka pasuar fenë e Ismailit, ka adhuruar idhujt dhe ka shpikur besëtytninë e Behires, Saibes, Vasiles dhe Hamës.

## **[85] - ËMBËLSIRA E IMANIT, TREGIM I ABDULLAH BIN HUDHAFETES ME HERAKLIUN PERANDOR ROMAK**

Abdullah bin Hudhave ka qenë udhëheqës i ushtrisë muslimane në ekspeditën e çlirimit të Shamit (Sirisë). Ai kishte marrë përsipër detyrën e sulmit mbi Kajserët, Qytetin Palestinez, i cili ishte e fortifikuar Brigjeve të tij dështon dhe ai zihet rob prej romakëve.

Perandori Herakli e gjeti rastin e posaçëm për t'i torturuar. Abdullah bin Hudhafen ia sjellin para vetes dhe ai dëshironte ta provonte në fenë e tij dhe ta mënjanonte nga islami.

Në fillim e përdori mjetin e karotës dhe ai i ofroi pasuri pa masë duke i thënë atij: “Konvertoju në Krishterizëm dhe do të kesh pasuri sa të duash.” Ibn Hudhafete e refuzon ofertën. Pastaj Herakliu i thotë: “Konvertoju në Krishterizëm e pastaj do të të martoj me bijën time.” Përsëri Ibn Hudhafete refuzon ofertën. Herakliu sërish i thotë: “Konvertoju në Krishterizem dhe do të bëhesh shok në mbretërinë time.” Edhe kësaj radhe Ibn Hudhafete e refuzon ofertën.

Herakliu e kupton se gjendet para një njeriu të llojit të veçantë, kështu që ia paraqet ofertën e katërtë: “Konvertoju në krishterizem dhe do të kesh gjysmën e perandorisë sime si dhe gjysmën e pasurisë sime.” Ibn Hudhafete i dha përgjigje të prerë: “Po edhe nëse më jep tërë atë që posedon ti dhe tërë atë që posedojnë arabët, nuk do të largohesha nga feja e Muhamedit s.a.v.s. asnjë milimetër.” Pasi që Herakliut i dështoi mjeti i “Karotës”, pra pasi dështuan të gjitha ofertat e tij, atëherë kalon me mjetin e dënimit, të torturimit dhe atë të kërcënimit, e i thotë: “Atëherë nuk më mbetet asgjë tjetër, pos të të vrasë.” Herkaliu nuk e kuptonte se ai i cili fiton kundër armës së “Karotës” dhe të ofertave ai fiton edhe kundër armës së torturave, dënimeve; dhe ai i cili shkel dunjanë me këmbët e tij, ai nuk heziton as ta japë shpirtin e tij për ta sakrifikuar. E i thotë Herakliut: “Bëje atë, dhe më vrit.” Pastaj, Ibn Hudhafen e shpiejnë në qeli dhe tri ditë nuk

i japim fare as për të ngrënë, as për të pirë. Atij i dërgojnë në qeli alkool dhe mish derri, mirëpo Ibn Hudhafete as që e shijon. Kalojnë ditë e ditë pa ngrënë e pa pirë, gati i afrohet vdekjes. Pastaj e nxjerr Herakliu nga qelia dhe i thotë: “Çka të pengoi për të ngrënë mishin e derrit dhe për ta pirë alkoolin, kur je i uritur dhe je i detyruar?” Ibn Hudhafete ia kthen: “Sa i përket domosdoshmërisë është e vërtetë se më është lejuar dhe nuk është e ndaluar, mirëpo unë vendosa të mos ha, që mos të të lejoj ty ta nënvlerësosh islam! Pastaj Herakliu urdhëron që ta lidhin dhe ta gozhdojnë. E lidhën për dërrase, pastaj shigjetarët gjuanin për rreth trupit të tij, mirëpo ai qëndronte i fortë.

Herakliu ia ofron pranimin e krishterimin, ai e refuzon. Pastaj e zgjidhin dhe urdhëron që ta marrin një kazan të madh ta mbushin me ujë, ta ndezin zjarrin nën të dhe ta vlojnë ujin. E kur uji në kazan vloi, e sjellin një rob musliman. E hedhin në të dhe i shkrihet trupi. I mbesin vetëm eshtrat, plotësisht skelet njeriu, pastaj e hedhin robin musliman të dytë, ndërsa Ibn Hudhafete i shikonte.

Pastaj Herakliu urdhëron që ta hedhin Ibn Hudhafeten në ujin e vluar. Kur e marrin për ta hedhur në ujë valë, fillon të qajë! I tregojnë Herakliut se Ibn Hudhafete po qan. Herakliu mendon se të qajturit e Ibn Hudhafetës është për shkak se i frikësohet vdekjes, se ai e kishte ndryshuar mendjen, se më nuk është i vendosur dhe mund t’i pranon ofertat. Prandaj e thirr, dhe ia propozon krishterimin, e ai prapë e refuzon. Atëherë i thotë: “Po përse qajte?!” Ibn Hudhafete i përgjigjet me përgjigje mahnitëse, e cila e dëshmon dështimin e Herakliut dhe fitoren e vet kundër tij: “Kam qajtur për arsye se e kam vetëm një shpirt, të cilin dua ta sakrifikojë në rrugën e Allahut. Prandaj kisha pasur dëshirë të kisha pasur shpirtra po aq sa qime kam në kokë (flokët e mia) dhe të gjitha me i dhënë në rrugën e Allahut, dhe për fenë time.” Herakliu më në fund u bind se ka humb betejën me Ibn Hudhafetën, edhe pse ka pasur pasuri, reputacion,

mbretëri dhe forcë të kësaj bote, përderisa muslimani nuk e kishte asnjërën prej këtyre çështjeve dhe ia ofroi ofertën e fundit me të cilin doli ngadhënjimtar.

Herakliu për ta mbrojtur fytyrën e tij i thotë: “O Hudhafete, a pranon të ma puthësh kokën time në mënyrë që unë të të liroj?”. Ibn Hudhafete i thotë: “Po, por me kusht që së bashku me mua t’i lirosh të gjithë muslimanët e zënë rob prej borxheve tua (numri i tyre ka qenë mbi treqind!)” Ibn Hudhafete ia puth kokën dhe shkon te Omer bin El Hatabi në Medinë dhe ia tregon ngjarjen me Herakliun. Disa prej Sehaveve nuk e pëlqyen këtë veprim që Ibn Hudhafete t’ia puthte kokën Herakliut, prandaj e ofenduan, duke thënë se puthja nuk barazohet me lirimin e atij numri të madh të robërve. Omeri u pajtua me veprimin e Ibni Hudhafes, dhe tha: “Detyrë dhe obligim i çdo muslimani është që t’ia puth kokën Ibni Hudhafës, edhe unë do t’ia puthë dhe këtë do ta bëj i pari.” Ngritet në këmbë Omeri dhe ia puth kokën Ibni Hudhafes, e pas tij njësoj veprojnë edhe sahabët e tjerë.

## **[86] - TREGIMI I HULUMTUESIT TË VËRTETËS - SELMAN FARESIJUT**

Selmani ka qenë Persian nga qyteti Esbahan. Baba i tij gjithashtu ishte Persian nga qyteti Esbahan. Babai i tij ka qenë i pari i fshatit dhe Selmanin e ka dashur me shumë se çdo gjë. Ai ishte një zjarrputist dhe ishte ruajtës i zjarrit. Ai nuk e linte të fikej zjarri, sepse fshati e adhuronte zjarrin. Babai i Selmanit

kishte një plantacion dhe një ditë i thotë Selmanit: “Shko dhe shikoje si janë të mbjellat.” Selmani duke shkuar gjatë rrugës e sheh një kishë krishtere, afrohet dhe i dëgjon njerëzit duke u lutur në të. Hyn brenda të shikojë se si falen. Kur i sheh, i pëlqen mënyra e lutjes së tyre, dhe lakmon në krishterizëm, e thotë: “Për Zotin, kjo është më emirë se feja jonë.” Selmani qëndron me ta derisa perëndon dielli, dhe nuk shkon te plantacioni fare. Por, pasi i pëlqen feja krishtere i pyet ata për vendburimin apo bazën e fesë së tyre. I tregojnë se është në Siri. Kur Selmani kthehet në shtëpinë e vet i thotë të atit: “Unë kam kaluar pran një grupi njerëzish, të cilët luteshin në kishën e tyre, dhe më pëlqeu lutja e tyre. Dhe e pash se feja e tyre është më e mirë se feja jonë.” I ati i thotë: “O biri im, ajo fe nuk është më e mirë se feja jote (zjarrputiste).” Selmani i thotë: “Fjala e Allahut është më e mirë se feja jonë.” I ati i Selmanit as që e dëgjoji këtë arsyetim, por frikësohet se Selmani do të konvertohet në krishterizëm dhe për këtë arsye ia lidh këmbët dhe e mbyll në shtëpi. Selmani e dërgon një letër në krishterizëm dhe u tregon atyre se është konvertuar në krishterizëm. Në të, në mes tjerash, ka shkruar: “Nëse vjen nga Siria ndonjë delegacion, më lajmëroni, se unë dëshiroj të shkoj me ta në Siri.”

Kur ata i lajmërojnë, ai thyen zinxhirët, zgjidhet dhe shkon me atë delegacionin në Siri. Kur shkon në Siri pyet: “Cili është kryetari i kësaj feje?” Ata i thonë se kryesor është kryepeshkopi i kishës. Selmani shkon atje dhe i thotë atij: “Unë e dua këtë fe dhe dëshiroj të qëndroj me ju në kishën tuaj, që të mësoj nga ju dhe të lutem me ty.” Kryepeshkopi i thotë: “Si urdhëro, hyr dhe qëndro me ne.” Selmani hyn dhe vazhdon të qëndrojë me të. Kryepeshkopi ka qenë njeri i keq. Ai urdhëronte tjerët për të paguar tatimin, pastaj ato i ndalte për vete, dhe nuk ua shpërndante të varfërve dhe nevojtarëve, deri sa i tubon shtatë duqe me ari dhe argjend. Për këtë Selmani e urrente pa masë.

Kur vdes kryepeshkopi tubohen krishterët për ta varrosur, por Selmani u thotë atyre: “Ky kryepeshkop ka qenë njeri i keq, ju ka urdhëruar të paguani tatimin e pastaj atë e tubonte vetëm për veten e tij dhe nuk ua ka shpërndarë të varfëve. Ejani të ju tregoj se ku e ka fshehur pasurinë e tubuar prej jush.” Kur shkojnë te ai vend, e shohin dhe i marrin të shtatë duqit të mbushura me ar dhe argjend, dhe thonë: “Për Zotin kurrë nuk do ta varrosim, por, përkundrazi, do ta lidhim, do ta kryqëzojmë dhe do ta gjuajmë me gurë.” Në vend të tij e emërojnë kryepeshkop një tjetër. Për dallim nga i pari ky ishte njeri i mirë i devotshëm në fenë e tij dhe e donte botën tjetër, për këtë arsye Selmani e donte shumë. Dhe ky ka qenë shkaku që Selamni të qëndrojë pranë tij një kohë të gjatë. Mirëpo, kryepeshkopi shtrihet në shtrat të vdekjes. E Selmani i thotë: “Kam qenë me ty, të kam dashur për së tepërmi, mirëpo caktimi i Zotit, po e shoh se je para vdekjes, prandaj çfarë më kishe porositur, kujt t’i besoj?” Kryepeshkopi i thotë: “O biri im, unë nuk e di se ka njeri të mirë dhe besnik sikur unë, pos njeriut i cili banon në Musul.” Kur kryepeshkopi vdes Selmani shkon te ai njeri në Musul, dhe i tregon çka e ka porositur kryepeshkopi. Kështu Selmani qëndron pranë tij një kohë të gjatë deri sa edhe ky njeri vdes.

Para vdekjes Selmani e pyet: “Çka me porosit dhe kujt t’i besoj?” Kryepeshkopi i thotë: “O biri im, nuk njoh njeri më të mirë se një njeri në Nesibejnë.” Kur vdes kryepeshkopi, Selmani shkon në Nesibejnë, e takon atë njeri dhe i tregon çka e ka porositur kryepeshkopi.

Pas një kohe edhe ky bie në shtrat të vdekjes, e Selmani i thotë: “Çka më këshillon, kujt t’i besoj?” Kryepeshkopi i thotë të shkojë te një njeri në Umerie të Bazantit. Selmani shkon te ai, qëndron me të dhe e sheh se ky ka qenë më i miri nga të gjithë të parët. Pastaj Selmani merret me tregti të bagëtisë, deri sa përfitoi

shumë lopë e dele. Pastaj kryepeshkopi ra në shtrat të vdekjes, e Selmani i thotë: “Çka më kishe porositur, kujt ti besoj?” Ai i thotë: “O biri im nuk njoh ndonjë njeri të mirë që me të të kalosh mirë ashtu siq kemi kaluar ne të dy së bashku. Mirëpo, ka ardhur koha të vijë një pejgamber prej fesë së pastër të Ibrahimit, i cili do të vijë në vendet arabe, i cili do të emigrojë në një vend ku do të ketë hurma (Medinë). Ai do të ketë argumente të qarta. Ai nuk e pranon Sadakanë, por dhuratën po, në krah e ka vulën e pejgamberllëkut”. Pastaj kryepeshkopi vdes. Selmani hyp në një kafshë dhe pyet për gadishullin arabik se ku gjendet. Ai u thotë disa njerëzve: “Nëse më dërgoni deri në atë vend do t’u jap të gjithë lopët dhe delet e mia.” Ata pranuan. Tregon Selmani: “Ata më morën me vete deri në një kodrinë, atje më tradhtuan; më morën gjithçka kisha dhe më shitën si rob te një Jehudi. Kur më mori Jehudiu në kopshtin e tij, pashë shumë hurma, mendova se mos vallë është vendi të cilën ma ka përshkruar kryepeshkopi dhe se në këtë vend do të emigrojë Pejgamberi i pritur, mirëpo nuk kishte qenë ashtu.” Selmani nuk kishte ç’të bënte, dhe deri sa ai ishte aty, vjen një Jehudi tjetër prej fisit Beni Kurejdha, dhe e blen Selmanin nga pronari i tij, dhe e dërgon e në Medinë ku banonte. Kur e sheh Selmani vendin e Medinës, bindet se ai është vendi të cilin ia kishte përshkruar kryepeshkopi, dhe mu ai ishte vendi i kërkuar. Pejgamberi s.a.v.s. zbret pejgamber në Meke, e pastaj emigron në Medinë. Dhe një ditë, deri sa Selmani qëndronte në maje të hurmës, ndërsa nën hurme pronari i tij ishte ulur, vjen djali i axhës së zotërisë dhe i thotë: “Zoti i vraftë bijtë e Kijles (Evisi dha Hazrexhi). Për Zotin, ata janë mbledhur në Kuba për të pritur njeriun, i cili sot do të vijë prej Meke, dhe thonë se ai është Pejgamber.” Kur e dëgjon Selmani atë bisedë mes tyre fillon të rrëqethet e të dridhet, sa që për pak bie nga hurma. Pastaj Selmani zbret me të shpejt dhe i thotë zotërisë së tij: “Çka po thua, çka ka të re?” Zotëria e ngrit dorën lart, por Selmani insiston me këmbëngulësi, deri sa zotëria i thotë papë:

“Ç”të intereson ty kjo, kthehu në punën tënde.” Kur bëhet natë, Selmani merr ushqim me vete dhe shkon në Kuba te i Dërguari i Allahut s.a.v.s., hyn aty ku qëndronte Pejgamberi me shokët e vet dhe u thotë: “Ju jeni gurbetçar dhe nevojtari, kisha ushqim dhe vendosa të jap sadaka dhe ju keni prioritet më shumë se të tjerët”, dhe Selmani e vendosi para tyre. I Dërguari i Allahu s.a.v.s. u thotë sehavebe: “Hani”, dhe fillon me Bismilah, por vet i Dërguari i Allahut nuk hëngri. Selmani tha me vetvete: “Ky është argumenti i parë se ai nuk e pranon sadakanë.” Pastaj të nesërmen në mesditë selmani shkoi prapë te i Dërguari i Allahu s.a.v.s. dhe me vete kishte marrë ushqim dhe i thotë: Pejgamberit s.a.v.s.: “E kam parë se ti dje nuk ke ngrënë, se ka qenë sadaka. Kjo tani është dhuratë që e kam sjellë posaçërisht për ty.” Pejgamberi s.a.v.s. u thotë Sahabëve: “Hani me Bismilah” dhe hëngri së bashku me ta. Selmani tha me vetvete: Ky është argumenti i dytë se ai ka ngrënë nga dhurata. Pastaj Selmani kthehet. Dhe deri sa një ditë në Bekie Pejgamberi s.a.v.s. përcillte një kufomë dhe përreth i kishte sahabët, shkon, i përshëndet, pastaj Selmani i sillet rreth e rrotull Pejgamberit a.s. për të parë vulën, të cilën ia kishte përshkruar kryepeshkopi. Mirëpo, i Dërguari i Allahut s.a.v.s. e kupton se çka hulumtonte Selmani, atëherë e heq këmishën (rrobën) prej kraharorit dhe Selmani e sheh vulën, ashtu siç i ishte përshkruar. I afrohet e ia puth duke qajtur, pastaj ia tregon ngjarjen e tij dhe e pranon islamin. Mirëpo, pasi që ishte rob ai nuk mundi të merrte pjesë në luftën e Bedrit dhe të Uhadit. Një ditë i Dërguari i Allahu s.a.v.s. i thotë Selmanit: “Thuaj pronarit që, nëse dëshiron të të shes, ne do të të blejmë dhe do të të lirojmë nga robëria.” Pronari i tij pranon. I Dërguari i Allahut s.a.v.s. u thotë sahabëve për t’i ndihmuar Selmanit, që ta blejnë dhe ta lirojnë, kështu ai bëhet njeri i lirë. Pastaj ka marrë pjesë me të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. në luftën e Hendekut, dhe si ide e tij ka qenë hapja e



hendekut rreth Medines. E pastaj ka marrë pjesë në të gjitha luftërat tjera me të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. I Dërguari i Allahut s.a.v.s. për të ka thënë: “Selmani është i yni (prej familjes time)”.

## **[87] - TË NDALUARIT E ALKOOLIT EDHE PËR SHËRIM**

Tregohet se Fadil bin Ajadi shkon te nxënësi i tij, i cili ishte në shtrat të vdekjes, dhe ia rikujton shahadetin. Mirëpo, ai nuk mund ta thoshte, kështu ai ia përsëriste disa herë. Atëherë nxënësi i thotë: “Nuk mund ta them edhe nëse dua.” Del nga shtëpia e tij Fadili duke qajtur. Pas një kohe e sheh në ëndërr duke u hedhur në zjarr, e i thotë : “O i gjorë, po si të humbi ajo dituri?” Ai i përgjigjet: “O profesori im! Kam qenë i sëmur, nga një sëmundje, dhe për këtë kam shkuar tek disa mjekë, të cilët më kanë sugjeruar që për çdo vit të pi nga një bidon me alkool. Nëse nuk do të veproja ashtu sipas tyre, atëherë sëmundja do të zgjerohej shumë. Andaj, për çdo vit e kam pirë vetëm si ilaç për shërim.”

Kështu i ndodh atij, i cili e pi alkoolin për ilaç, po si do të jetë ngjarja e atij, i cili e pi për qejf. I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë:

*“Vërtet Allahu për umetin tim nuk ka caktuar ilaç prej gjërave të ndaluara, të cilat janë haram”.*

## **[88] - TREGIMI I JAHJAS DHE ISA A.S. DHE PESË URDHËRESAVE**

Transmetohet nga Harithi El-Eshariu r.a. se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë:

“Zoti i Lartmadhëruar e ka obliguar Jahjan - birin e Zekerija a.s. me pesë urdhëresa dhe me ato urdhëresa t’i obligojë edhe beni israilët. Për pak ai nuk pat mundësi për ta kryer atë detyrë, po të mos ishte Isa a.s., i cili i thotë: “Allahu të ka obliguar me pesë urdhëresa, ndoshta të ka obliguar që ato pesë urdhëresa t’ia përcjellësh beni israilëve. Andaj, ose do të t’i urdhërosh beni israilët me ato pesë urdhëresa, ose këtë detyrë do ta kryej unë.” Jahja a.s. i thotë: “Frikohem se nëse ti e kryen këtë detyrë para meje, ose do të më lëshoj toka, ose do të dënohem. Kështu i tuboi njerëzit në shtëpinë e shpejtë. Mexhidi Aksaja u mbush me njerëz, të cilët u ulën brenda, e ai tha: “Vërtetë Allahu me ka obliguar me pesë urdhëresa dhe njëherit më ka obliguar që t’ju obligoj me to edhe ju, që me të veproni. E ato janë:

**E para:** Që ta adhuron Allahun e të mos i bëni shok atij, sepse nëse i bëni shok atij, kjo i ngjason njeri njeriu, i cili e blen një rob prej parave të pastra ose me ari dhe i thotë atij: “Kjo është shtëpia ime, këtu është puna jote, kryeji detyrat ndaj meje, mirëpo ai i kryen detyrat e tjetërkujt, e jo të zotërisë së tij. Cili prej jush do të dëshironte që robi i tij të veprojë ashtu?”

**E dyta:** Allahu ju urdhëron me namazin, e kur të faleni mos e lakoni kokën (duke shikuar anash), sepse Allahu e shikon robin e tij deri sa ai falet, deri sa mos ta lakojë kokën.

**E treta:** Ju ka obliguar agjërimin. E agjërimi i gjason një njeriu, i cili ka një gotë me misk, e secili e do atë erë të mirë. Vërtet era e agjëruarit te Allahu është erë më e këndshme se era e miskut.

**E katërta:** Ju urdhëroj dhënien e Sadakasë. Kjo i ngjason një njeriu, të cilin e ka zënë peng armiku, ia ka lidhur duart për qafe, dhe e paraqet në shesh për ta ekzekutuar, e ai i thotë: “Unë e sakrifikoj jetën time për pak e për shumë” dhe sakrifikohet.

**E pesta:** Ju urdhëroj për ta kujtuar Allahun, sepse sikurse një njeriut i shkon armiku pas dhe e përcjell këmba këmbës deri sa arrin në një kështjellë, dhe fortifikohet dhe e siguron vetën në të. Kështu robi e fortifikon dhe e siguron vetën e tij prej shejtanit duke kujtuar Allahun e Lartmadhëruar. Pastaj Muhamedi s.a.v.s. tha: “Unë po ju obligoj po ashtu me pesë urdhëresa me të cilat më ka obliguar Allahu, e ato janë: Dëgjueshmëria, përkushtueshmëria, xhihadi, hixhreti dhe xhemati. Vërtet kush mënjanohet nga xhemati një pëllëmbë, ai është zhveshur nga petku islam vetëm nëse i kthehet xhematit, jo. Kush thërret me thirrje të injorancës, ai do të jetë në xhehenem. Një njeri i thotë: “Po edhe nëse agjëron, o i Dërguar i Allahut?” Po, edhe nëse falet e agjëron. Për këtë arsye thirrni më fjalë të Allahut, i cili ju ka quajtur muslimanë, besimtarë dhe robër të Allahut.

*(Trasmeton Tirimidhu dhe Hakini me Senedin Sahihë)*

## **[89] - SKENA TË DITËS SË KIJAMETIT**

Ebu Seid transmeton se e kanë pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: “Në Ditën e Kijametit a do ta shohim Zotin tonë?” E ai më tha: “A dyshoni në shikimin e diellit kur është

kthjellët në mes të ditës, e nuk ka megjulla fare? Dhe a dyshoni në shikimin e hënës pesëmbëdhjetëshe (hënës së plotë), kur nuk ka megjulla fare?” Ne i thamë: “Jo (nuk dyshojmë) o i Dërguari i Allahut.” Ai tha: “Ju nuk do të dyshoni në shikimin e Allahut në Ditën e Kijametit, ashtu si nuk dyshoni në shikimin e ndonjërit prej tyre (diellit dhe hënës). Në Ditën e Kijametit do të thërret një thirrës dhe çdo umet do ta përcjellë atë që ka adhurar, se të gjithë ata të cilët kanë adhurar idhuj e puta do të bien në zjarr, përpos atyre të cilët kanë adhurar Allahun, të mirë e mëkatarë, aty do të jenë edhe pasuesit e librit. Prej tyre jehudët, të cilët do t’u thuhet: “Çka keni adhurar?” Ata do të përgjigjen: “Kemi adhurar Uzejrin, djalë të Zotit.” Do tu thuhet: “Ju keni gënjyer, se Allahu nuk ka as djalë as ortak. Çka dëshironi?” Ata do të thonë: “O Zoti ynë, jemi të etur.” U sinjalizohet atyre se nuk do t’u plotësohet dëshira, por do të tubohen dhe do të hidhen në zjarr. Ata do të shtyhen si kafshët mes vetë, duke rënë në zjarr. Pastaj thirrën të krishterët dhe u thuhet: “Çka keni adhurar?” Ata do të thonë se kanë adhurar Mesihun, bir të Zotit. Do t’u thuhet: “Keni gënjyer. Çka dëshironi?” Ata do të thonë: “O Zoti ynë jemi të etur, na sjell ujë.” U sinjalizohet atyre se nuk do t’u plotësohet dëshira, por do të tubohen dhe do të hidhen në zjarr. Ata do të shtyhen si kafshët duke rënë në zjarr. Kur nuk mbetet askush tjetër, pos atyre që kanë adhurar Allahun, të mirë e mëkatarë, Allahu u vjen më afër se sa e kanë parë më parë dhe u thotë: “Çka po prisni? Secili le ta pasojë atë që e ka adhurar.” Ata do të thonë: “O Zoti ynë, ne nuk iu kemi bashkuar dhe jemi ndarë prej njerëzve të tjerë, edhe pse kemi qenë të varfër nuk iu kemi bashkëngjitur atyre.” Zoti Thotë: “Unë jam Zoti juaj.” Ata thonë: “Kërkojmë mbrojtje prej Allahut, nuk bëjmë shok Atij”, dy apo tre here, sa që disa prej tyre nuk rrezohen. Zoti i thotë: “A ka ndonjë argument prej jush që të njiheni (se jeni musliman)?” Ata thonë: “Po.” Dhe zbulohet perdja. Çdo njeri i

cili i ka bërë sexhde Allahut me bindje dhe perulshmëri, i thuhet të bie në sexhde, dhe ai bie në sexhde pa kurrfarë pengese, ndërsa çdo njeri i cili i ka bërë sexhde sipërfaqësisht dhe vetëm për t'u proklamuar para njerëzve, shpina e tij bëhet si dërrasë, dhe çdo herë që dëshiron të bie në sexhde përplasat me kokë për toke, dhe kur e ngritin kokën, koka e tyre prapë kthehet në formën e përparme. Pastaj (Zoti) thotë: - Unë jam Zoti juaj. Ata pohojnë: "Po, ti je Zoti ynë." Pastaj sillen ata mbi urën e Xhehenemit, e shefaati u vjen përpara. Ata thonë: "O Zot na shpëto, na shpëto!"

E kanë pyetur të Dërguarin s.a.v.s.: "Çka është Ura e siratit?" Ai ka thënë:

"Besimtarët e kalojnë atë sa çel e mbyll sytë, prej tyre ka që e kalojnë me shpejtësi të vetëtimës, me shpejtësi të erës, me shpejtësi të shpendëve, me shpejtësi të kuajve të shpejtë, me shpejtësi të kafshëve tjera. E besimtarët shpëtojnë. Pasha atë që shpirti im është në dorën e Tij, asnjëri prej jush nuk ka dëshirë më të madhe për të fituar e vërteta, kështu që në Ditën e Kijametit Allahu e bën që besimtarët t'i nxjerrin vëllezërit e tyre prej xhehenemit. Besimtarët do të thonë: "Zoti ynë, ata kanë agjëruar, janë falur, e kanë kryer haxhin." U thuhet atyre: "Ata të cilët i njihni nxirrni prej xhehenemit". Atëherë një turmë e madhe do të nxirret prej xhehenemit, të cilët zjarri i ka djegur prej thembrave e deri në gjunjë. Pastaj thonë: "O Zoti ynë, të gjithë ata për të cilët kemi kërkuar, nuk ka mbetur asnjë në zjarr." Zoti thotë: "Kthehuni dhe kush në zemrën e tij ka një vlerë të një dinarit mirësi, nxirreni nga xhehenemi." Atëherë i nxjerrin prapë një turmë të madhe, pastaj thonë: "Zoti ynë, i kemi nxjerrë të gjithë ata që na ke thënë." Pastaj Zoti thotë: "Kthehuni dhe kush në zemrën e tij ka mirësi të vlerës së gjysmë dinarit nxirreni." Dhe prapë e nxjerrin një turmë të madhe. Pastaj thonë: "Zoti ynë, nuk ka mbetur asnjë prej kategorisë së tyre." Ebu Seidi ka thënë: "Nëse nuk e besoni këtë hadith, atëherë nëse

doni lexoni ajetin kur'anor: ***“Vërtet Allahu nuk bën padrejtësi as sa grimca e atomit, vetëm se nëse është një punë e mirë do ta shtoj atë”***, dhe, përpos kësaj, prej Vetes së Tij do t'i japë shpërblime të mëdha. Allahu thotë: “Kanë ndërmjetësuar melaqet, kanë ndërmjetësuar Pejgamberët, kanë ndërmjetësuar besimtarët dhe ka mbetur tani më i Mëshirshmi i të gjithë Mëshiruesve”, e pastaj me një kapje nxjerr njerëz, të cilët nuk kanë bërë asnjë të mirë, por kanë qenë të mbrojtur. Pastaj dërgohen në një lumë të burimit prej xhenetit, i cili lumë quhet “Lumi i jetës”. Dhe nxirren prej aty siç nxirren farat, ashtu siç i keni parë mbi trung, apo mbi gur, dhe kur dielli i ka tharë i ka bërë plotësisht të verdha, apo të verdha, ndërsa edhe të bardha, kur farat kanë qenë nën hije. I thonë: “O i Dërguari i Allahut, po ti sikur të ishe bujk!”. Pejgamberi s.a.v.s. thotë: “Do të nxirren dhe në qafat e tyre do të kenë qafore si të diamantit, në bazë të së cilës shenjë do të dallohen prej xhenetlinjëve tjerë, si të liruar të Allahut. Pra, ata dallohen se Allahu i ka shpënë në xhenet pa punuar asnjë vepër të mirë, dhe pa pasur shpërblime fare. Pastaj thotë: “Hyni në xhenet dhe çka të shihni është e juaja.” Ata thonë: “Na ke dhënë atë që nuk i ke dhënë askujt tjetër.” Zoti u thotë: “Unë kam edhe më të mirë se kjo.” Ata thonë: “Po cila është ajo më e mirë se kjo?!” Zoti thotë: “Kënaqësia Ime ndaj jush dhe Unë më asnjëherë nuk do të hidhërohem me ju.”

#### *TRANSMETON MUSLIMI*

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Në ditën e Kijametit, pasi që të paraqitet, Zoti i Lartmadhëruar i thotë (ndonjërit): “A nuk ta kam dhënë dëgjimin, ushqimin, pasuri e fëmijë; ti kam nënshtruar kafshët, ta kam bërë shtrojë token, të kam bërë mëkëmbës? A nuk ke menduar se do të paraqitesh para Meje në këtë Ditë?” Ai i thotë: “Jo.” Zoti i thotë: “Sot do të të harroj ashtu siç më ke harruar ti Mua.”

*TRANSMETON MUSLIMI DHE TIRMIDHIU*

Enesi r.a. transmeton: “Kemi qenë te i Dërguari i Allahut s.a.v.s. dhe pasi qeshi na pyeti: “A e dini përse qesha?” Ne i thamë: “Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri.” Ai tha: “Për fjalën e robit, i cili do t’i thotë Zotit: “O Zoti im, a nuk po më shpëton nga padrejtësia?” Zoti thotë: “Po gjithsesi!” Ai do t’u thotë: “Ju shkronjësit fisnikë që keni qenë dëshmitarë mos flisni, e ti, o njeri, mjafton që vet ta gjykosh veten tënde; dhe i thotë: “Ju pjesët e trupit flisni”, pastaj pjesët e trupit flasin për veprat e tij, e pastaj fillon polemizimi mes pjesëve të trupit dhe atij, e ai thotë: “Mallkuar qofshi, po unë për ju jam munduar.”

*TRANSMETON MUSLIMI*

## **[90] - VLERA E SINQERITETIT, MOSPJESËMARRJA E TRE PERSONAVE NË LUFTËN E TEBUKUT**

Transmetohet nga Abdullah bin Keabi bin Malik, e Keabi ka qenë udhëheqës kur është verbëruar, të ketë thënë: “Kam dëgjuar Keab bin Malikun për ngjarjen e atyre, të cilët nuk kanë

marrë pjesë me të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. në luftën e Tebekut.” Keabi r.a. ka thënë: “Në çdo luftë të cilën ka marrë pjesë i Dërguari i Allahut s.a.v.s. nuk e ka qortuar asnjërin, i cili nuk ka marrë pjesë në atë betejë, sepse i Dërguari i Allahut s.a.v.s. dhe muslimanët kanë dalë për ta ndalur karvanin e kurejshëve, deri sa Allahu i takoi ata dhe kurejshët në kohë të paplanifikuar dhe të pa përcaktuar të konfrontimit të tyre. Kam qenë me të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. natën e Akabes kur e bëmë besëlidhjen për islam. Kam marrë pjesë në luftën e Bedrit dhe i mbaj mend të gjithë pjesëmarrësit .Unë nuk kam pasur arsye, kur nuk kam marrë pjesë me të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. në luftën e Tebekut. Asnjëherë nuk kam qenë më i përgatitur dhe më i fuqishëm se atëherë, kur nuk kam marr pjesë në atë luftë. Për Zotin, asnjëherë nuk i kam pasur në të njëjtën kohë dy kafshë lufte.”

Deri sa në atë luftë, në të cilën i Dërguari i Allahut ka luftuar në nxehtësi të madhe, ka udhëtuar shumë, ka fituar shumë, por edhe numri i pjesëmarrësve në luftë ka qenë i madh. Muslimanët filluan të marrin me dyshim dhe frikë atë luftë, mirëpo i Dërguari i Allahut s.a.v.s. u tregoi qëllimin e tyre dhe atë çka dëshirojnë muslimanët, që numri i tyre ishte shumë i madh.

Tregon Keabi: “Ishte një numër i vogël, të cilët nuk dëshironin të merrnin pjesë dhe që mendonin se nuk do të merrej vesh mosprezenca e tyre, përderisa nuk zbret shpallja prej Allahut. I dërguari i Allahut e ka zhvilluar atë betejë kur kanë lulëzuar dhe kanë filluar frutat. Unë isha prej atyre të cilëve nuk dëshironin të merrnin pjesë. I dërguari i Allahut u përgatit për ekspeditë, e me të u përgatitën edhe muslimanët e tjerë. Më lajmëruan që të përgatitesha, por unë nuk u përgatita, e thosha me vetvete: “Unë, nëse dëshiroja, mund të shkoja sa isha në hamendje, andaj nuk u përgatita, ndërsa me të shkuan edhe muslimanët. Pasi që unë



isha përgatitur, nuk shkova me ta, mirëpo derisa unë isha në mëdyshje, ata me të shpejt shkuan në front. Unë mësyva pas tyre që t'i arrij, por nuk munda t'i arrija dot. Ah, i mjeri unë, po t'i kisha arritur. Ç'ndodhi pastaj? Pasi që nuk i kisha arritur, pasi që i Dërguari i Allahut s.a.v.s. kishte shkuar në luftë, unë mbeta prapa tyre. E tani, e shihja veten në mesin e hipokritëve, ose në mesin e atyre që kanë arsytim për mos shkuarje në luftë, pse janë të paafhtë. I Dërguari i Allahut s.a.v.s. nuk më ka përmendur në asnjërin prej atyre dy grupeve, por kur ka arritur në Tebuk, deri sa ka qenë në mesin e luftëtarëve të ekspeditës së Tebukut dhe ka pyetur: “Çka është puna me Keab bin Malikun?” Njeri prej beni Selmetes i thotë: “O i Dërguari i Allahut është ndalur për ta gjetur sendin e humbur. Muadh bin Xhebeli ndërhyrë e thotë: “Nuk është e vërtetë, mjerë për ty, çka po thua. O i Dërguar i Allahut, ne për te dimë vetëm çka është mirë për të. Atëherë i Dërguari i Allahut s.a.v.s. heshti. Në atë moment e sheh i Dërguari i Allahut s.a.v.s. një njeri duke lëvizur andej-këndeje e thotë: “Ky duhet të jetë Ebu Hajthemi.” Kur pamë se me të vërtetë ishte Ebu Hajthem El-Ensariju, i cili ishte duke dhënë sadaka një Saa me hurma, për atë se e kishin akuzuar munafikët, duke i thënë se Zoti s'ka nevojë për këtë saa me hurma. Tregon Keabi se kur i erdhi lajmi se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ishte kthyer nga beteja e Tebukut, u pikëllova për së tepërmi, mendova në vete të përgatiti ndonjë rrenë dhe thashë: “Si të shpëtoj nga hidhërimi i tij në të ardhmen dhe unë e familja ime të mbështetem tek ai për çështjet tona. Kur u tha se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. veç ka ardhur, nuk munda të mendoja ashtu sepse e dija se të Dërguarit e Allahut s.a.v.s. nuk mund t'i shpëtojë kurrë me rrenë dhe vendosa të tregoj të vërtetën. Muhamedi s.a.v.s. kur kthehej nga udhëtimi, shkante në xhami i falte dy rekate dhe ulej para njerëzve. Kur veproi ashtu, siç vepronte zakonisht, shkuan pas tij mospjesëmarrësit e betejës së Tebukut, arsyetoheshin para tij dhe përbetoheshin. Numri i tyre

ishte tetëdhjetë. Ua pranoi arsyetimin haptazi, i pranoi faljet e tyre dhe kërkoi falje te Allahu për ta, ua shpalosi të fshehtat e tyre të dyfytërsisë te Allahu, deri sa më erdhi radha mua. Kur e përshëndeta me selam, buzëqeshi me një buzëqeshje hidhërimi dhe tha: “Eja pranë meje.” Shkova dhe u ula pranë tij dhe më pyeti: “Pse je zbrapsur? A nuk ta kam blerë devenë ty për luftë?” Pastaj vazhdon të tregojë Keabi: “I thashë: “O i Dërguari i Allahut. Po të kisha qenë në këtë moment para ndokujt tjetër, do të kisha shpëtuar nga hidhërimi i tij, duke gjetur ndonjë arsye të fortë dhe të qartë, mirëpo e di se nëse sot të gënjej ty, vetëm që ti të jesh i kënaqur me mua, frikohem se Allahu do të më kaplojë me hidhërimin e Tij. Nëse të tregoj të vërtetën, ti do të hidhërohesh në mua, por kam shpresë se Allahu i Lartmadhëruar do të gjykojë për këtë çështje. Andaj: Për Zotin nuk kam pasur fare arsye, dhe asnjëherë nuk kam qenë më i përgatitur dhe më i fuqishëm se sa atë ditë, kur nuk erdha me ju në front.” (Tregon Keabi) I Dërguari i Allahut s.a.v.s. tha: “Ky e ka thënë të vërtetën. Shko e prit deri sa Allahu ta thotë fjalën e Tij për ty.” Anëtarët e fisit Selmete më përcollën dhe më thane: “Për Zotin, nuk dimë se ndonjëherë ke bërë ndonjë mëkat, a nuk pate mundësi që të arsyetohesh me ndonjë arsyetim para të Dërguarit të Allahut s.a.v.s., ashtu siç janë arsyetuar “me arsyetime” mospjesëmarrësit e luftës. Të ka mjaftuar që nga Allahu do të kishte kërkuar falje për ty. (Tregon Keabi) Për zotin, deri sa ata më qortonin, erdhe në një moment sa që mendova prapë të kthehesha te i Dërguari i Allahut s.a.v.s. dhe të arsyetohesha, por më në fund u thashë atyre: “Po a ka vepruar si unë ndokush tjetër?” Ata thanë: “Po, dy të tjerë kanë vepruar ashtu siç ke vepruar ti, dhe iu është thënë atyre, ajo çka të është thënë ti.” Pastaj i kam pyetur: “Kush janë ata?” Ata më thanë: “Merar bin Rebiye El-Umerij dhe Hilal bin Umejti El-Vakifij.” Vazhdon të tregojë Keabi: “Që të dy personat për të cilët më

treguan ishin njerëz të mirë dhe ishin pjesëmarrës të luftës së Bedrit dhe kanë qenë shëmbëlltyrë në betejë. Pasi m'i treguan emrat e tyre, vazhdova rrugën. Ndërsa i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka ndaluar që të bisedohej me ne të tre, ashtu siç ka ndaluar të bisedohej me mospjesëmarrësit tjerë në luftë.” Tregon Keabi: “Njerëzit u distancuan nga ne dhe u larguan në tërësi sa që toka vendi u bë sikur të ishte vend tjetër i huaj, e jo ashtu siç e shihja më parë. Kështu kemi qëndruar pesëdhjetë ditë. Sa i përket dy shokëve të mi, ata janë izoluar në shtëpitë e tyre, duke qajtur ditë e natë. Ndërsa unë, pasi që isha më i riu, shkoja në xhami dhe falesha me muslimanët, shkoja në treg, shëtitsha nëpër rrugë dhe askush nuk fliste me mua. Shkoja te i Dërguari i Allahut s.a.v.s. e përshëndetsha me selam, pasi që ai falej, apo kur ishte në ndonjë vend, dhe thosha në vetvete: “A thua i Dërguari i Allahut s.a.v.s. i lëvizi buzët për ta kthyer selamin apo jo?” Pastaj falesha afër tij dhe e përvjedhshja me shikim, pasi që pas namazit kthehej në drejtim të xhematit, se a po shikon në drejtim timin, apo jo. Kur unë shikoja në drejtimin e tij, ai e lakonte shikimin nga unë. Kështu, u distancuan nga unë të gjithë muslimanët. Atëherë shkova te muri i Ebi Katades, i cili ishte djali i axhës tim të cilin e doja më së shumti dhe e përshëndeta me selam. Për Zotin edhe ai nuk ma ktheu përshëndetjen e selamit. Atëherë i thash atij: “O Eba Katade, për Zotin, a më mëson ta dua Allahun dhe të Dërguarin e tij?” Mirëpo ai nuk më dha përgjigje. Heshti. E përsërita edhe njëherë kërkesën, e ai prapë heshti. E përsërita edhe njëherë kërkesën, e ai më tha: “Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri.” Sytë mu mbushën me lot dhe u ktheva. Duke u kthyer në shtëpi, gjatë rrugës së Medinës, një bujk i Sirisë, i cili kishte sjell ushqim për të shitur në Medinë pyeste: “Kush na tregon se ku gjendet Keab bin Maliku?” Njerëzit sinjalizuan në drejtim timin. Ai erdhi tek unë dhe më dha një letër nga mbreti Gasanit. E lexova, ku në mes tjerash shkruante: “Ne kemi dëgjuar se shoku yt është

distancuar nga ti dhe Allahu nuk të ka lënë vend që të qëndrosh më aty, e ne e kemi për detyrë të të thërrasim që të vish e të qëndrosh tek ne. Pasi e lexova letrën thashë: “Kjo është provë edhe më e keqe.” Vendosa ta djeg, por në fund e shkyejta të tërën. Kaluan dyzet ditë që nuk kishte zbritur (nga Kurani) asgjë për rastin tim. Kur u bënë pesëdhjetë ditë, një i deleguar i të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. erdhi dhe më tha: “I Dërguari i Allahut s.a.v.s. të urdhëron të largohesh nga bashkëshortja jote.” I thashë: “Ta lëshoj apo si të veprojmë?” Më tha: “Jo, por largohu nga ajo dhe mos iu afro fare.” Njësoj kishte shkuar dhe i kishte urdhëruar edhe dy shokët e mi. Bashkëshortes sime i thashë: “Shko te familja jote dhe qëndro te ta, deri sa Allahu të sjell ndonjë vendim.”

Bashkëshortja e Hilal bin Umejes shkoi te i Dërguari i Allahut s.a.v.s. dhe i thotë: “O i Dërguari Allahut, Hilali është tepër i moshuar, nuk ka kush t’i shërbejë. A mundem që së paku t’i shërbej atij?” I Dërguari i Allahut i thotë: “Shërbeji, por mos kontakto me të.” Ajo i thotë të Dërguarit të Allahut: “Për Zotin, ai as që mund të lëviz nga vendi. Dhe, për Zotin, prej asaj dite që i ka ndodhur (rasti), qan pandërprerë.” Njëri i familjes sime më tha: “Kërko leje prej të Dërguarit të Allahut që së paku të të shërbejë (bashkëshortja), pasi që ia ka lejuar gruas së Hilal bin Umejes t’i shërbejë atij.” Thashë: “As nuk kërkoj leje prej të Dërguarit të Allahut dhe as nuk di se çfarë pergjigjje do të më japë i Dërguari i Allahut, pasi që unë jam i ri.” Vazhdova ashtu edhe dhjetë ditë. Kështu, kaluan pesëdhjetë ditë nga dita kur i Dërguari i Allahut ka urdhëruar distancimin ndaj nesh. Pasi që e fala namazin e sabahut të ditës së pesëdhjetë në shtëpi dhe deri sa isha ulur, dhe e kujtoja Allahun, toka me tërë gjerësinë që kishte u ngushtua për së tepërmi. Dëgjova një zë të lartë nga një largësi të një vendi të lartë: “O Keab bin Malik, urime!” Menjëherë rashë në sexhde dhe e kuptova se ishte hapur rruga

dhe se kishte ndodhur zgjidhja për mua. I Dërguari i Allahut kishte lejuar që të pendohen mospjesëmarrësit e luftës. Njerëzit filluan të vinin dhe të na përgëzonin. Kur shkuan në drejtim të dy shokëve të mi për ti përgëzuar dhe erdh ai, zërin e të cilit e kisha dëgjuar, duke më përgëzuar, e unë hoqa rrobën time dhe ia veshja atij, për shkak se më kishte përgëzuar. Për Zotin nuk kisha rrobë tjetër, pos saj. Kështu që huazova dy rroba, i veshja dhe ia mësyva të shkoj te i Dërguari i Allahut s.a.v.s. Dhe duke shkuar, njerëzit vinin tek unë grupe-grupe dhe më përgëzonin me pendim dhe më thoshin: “Allahu të ka përgëzuar kur ta ka lejuar pendimin.” Hyra në xhami dhe aty ishte i ulur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. dhe rreth tij ishin tubuar njerëzit. Prej mesit të tyre u ngrit Talhata bin Adidullah r.a. dhe u nis me të shpejtë në drejtim timin dhe më rroki për dore e më uroi. Për Zotin, asnjë tjetër, pos tij, prej muhaxhirëve nuk u ngrit. Keabi nuk e ka harruar asnjëherë Talhan. Tregon Keabi: “Kur e përshëndeta me selam të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. me fytyrë të ndritur, e cila shkëlqente, ai i gëzuar më tha: “Urime për ditën më të mirë të jetës tënde, prej se të ka lindur nëna!” I thashë: “O i Dërguar i Allahut, a është ky përgëzim prej teje apo prej Allahut?” I Dërguari i Allahut s.a.v.s. tha: “Po, kjo është prej Allahut të Lartmadhëruar.” I Dërguari i Allahut s.a.v.s. kur ishte i gëzuar i shkëlqente fytyra e tij, si të ishte shkëlqimi i hënës, dhe në bazë të shkëlqimit në fytyrë e kuptonim. Pasi që u ula pranë tij, i thashë: “O i Dërguari i Allahut, tevbeja ime është dhënia e tërë pasurinë time sadaka për Allahun dhe të Dërguarin e tij.” I Dërguari i Allahut s.a.v.s. tha: “Një pjesë të pasurisë mbaje për vete se ke nevojë për të.” I thash: “Do ta mbaj vetëm pjesën, të cilën e kam fituar në Hajber”, dhe vazhdova: “O i Dërguari i Allahut, vërtetë Allahu i Lartmadhëruar ka vendosur drejtësi dhe më ka shpëtuar me sinqeritet, dhe pendimi im duhet të jetë me sinqeritet dhe të mos flasë asgjë tjetër, pos të vërtetën. Për Zotin nuk di se ka qenë i sprovuar ndonjëri prej muslimanëve, e që në

fund Allahu e ka begatuar vetëm për shkak të së vërtetës.” Prej se ia kam kujtuar këtë të Dërguarit të Allahut dhe për Zotin asnjëherë as që kam tentuar të gënjej prej se ia kam thënë të vërtetën të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. e deri më sot. E prej sot e në të ardhmen, e lus Allahun që të më mbrojë nga gënjeshttra.

Tregon Keabi: Pastaj zbriti ajeti kur’anor:

“All-llahu ia fali Pejgamberit, edhe muhaxhirëve edhe ensarëve, të cilët në çastin e vështirë shkuan pas tij, kur (nga vështirësitë) zemrat e një grupi nga ata gati u lëkundën, por Ai ua fali (i stabilizoi zemrat e) atyre. Vërtet Ai është i butë, i mëshirshëm ndaj tyre”.

“(Ai u fali) Edhe atyre të treve, të cilëve iu pat shtyrë aq (pranimi i pendimit), saqë toka u bë e ngushtë për ta, përkundër gjerësisë së saj, kur u ngushtuan edhe shpirtrat e tyre, saqë u bindën se nuk ka strehim prej All-llahut (tjetërku) pos te Ai. Prandaj edhe atyre ua fali Ai, në mënyrë që të pendohen. All-llahu pranon pendimin se është mëshirues”.

***“O ju që besuat! Ta keni në kujdes All-llahun dhe të jeni me ata të drejtit”.***

(ET TEVBE, 117-119)

Tregon Keabi. Për Zotin, përpos begatisë së madhe të pranimit të islamit, për mua nuk ka pasur begati më të madhe se sa me atë që Allahu vërtetoi se unë nuk e kam gënjyer të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. Ndërsa gënjeshtarët u shkatërruan për shkak të gënjeshtrove të tyre. Allahu për gënjeshtarët e zbriti ajetin:

***“Ata do t’ju betohen në All-llahun, kur të ktheheni te ata, për të mos i qortuar, ju pra hiquni atyre, ata janë të ndyrë, e vendi i tyre do të jetë xhehennemi, shpërblim për atë që fituan”.***

(ET-TEVBE, 95)

Tregon Keabi: Ne të tre, nuk kemi qenë prej atyre (nuk kemi marrë pjesë), të cilët janë përbetuar (rrejshëm) para të

Dërguarit të Allahut s.a.v.s., e i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ua pranoi, u lut për ta, ndërsa për ne të tre tha se do të presë deri sa Allahu të sjellë ndonjë vendim për çështjen tonë. Pastaj, Zoti i Lartmadhëruar tha: **“Dhe ata të tre, të cilët nuk morën pjesë”**, kjo pjesë e ajetit nuk ka të bëjë për mospjesëmarrjen tonë në luftë, por për mospjesëmarrjen tonë në përбетim, dhe pritja e vendimit për çështjen tonë, e jo për ata të cilët janë përбетuar, janë arsyetuar, e i Dërguari i Allahut ua ka pranuar.

*BUHARIU DHE MUSLIMI*

Nga ky tregim përfitohet se:

1. Mbajtja sekrete e sulmit konsiderohet sekret i kërkuar në luftë.

2. Ai i cili dëgjon se një musliman përгоjohet, duhet ta mbrojë, sepse kur njeriu e ka përгоjuar Keab bin Malikun, menjëherë ka reaguuar Muadh bin Xhebeli r.a. duke thënë: “Mjerë për ty, po çka po thua! Për Zotin o i Dërguari i Allahut, gjithçka që dimë për të e dimë se është i mirë.” Ndërsa në hadithë tjetër Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: “Kush e gjuan nderin e vëllait të tij, Allahu do ta gjuajë me zjarr në fytyrën e tij në Ditën e Kijametit.”

3. Muslimani kur të kthehet nga udhëtimi, është mustehab që në rend të parë të shkojë në xhami dhe t’i falë dy rekate, falënderim ndaj Allahut, për atë se është kthyer në vendin dhe familjen e tij, shëndosh e mirë.

4. Për të edukuar mëkatarin lejohet distancimi prej tij, sepse Muhamedi s.a.v.s. i ka ndaluar muslimanët që t’i flasin Keabit dhe dy shokëve të tij. Hetabiu tregon thënien e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. se e ka ndaluar i Dërguari i Allahut s.a.v.s. të flitet me ata të tre. Ndërsa, ajo çka i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ua ka ndaluar muslimanëve që të hidhërohen dhe të mos flasin mes vete më shumë se tri ditë, kjo është për shkak të hidhërimit mes vete për çështje personale e të ngjashme. Ndërsa, sa i përket çështjes së fesë, distancimi nga mëkatarët është i

përgjithmonshëm ose përderisa nuk pendohen apo nuk kthehen në rrugë të drejtë.

5. Imami i muslimanëve duhet t'i ndëshkojë mëkatarët e mëdhenj, duke i distancuar të tjerët nga ata, ndërsa Kadiu, gjykatësi, apo imami për ta ndarë gruan prej burrit për një kohë të caktuar nuk lejohet, sepse kjo ka qenë specifike prej specifikave të Pejgamberit s.a.v.s.

6. Nëse burri i thotë gruas: “Shko në familje”, nuk konsiderohet shkurorëzim nëse nuk ka shenja apo argumente tjera, të cilat e tregojnë atë.

7. Sexhdeja e falënderimit është mustehab nëse përjetojmë mirësi, sepse Keabi ka thënë: Nga gëzimi bëra sexhde, po ashtu është vërtetuar sexhdeja e falënderimit në bazë të veprimit të Pejgamberit s.a.v.s. kur Xhibrili e ka përgëzuar se nëse dikush të dërgon salavate një herë, Allahu i dërgon atij dhjetë herë.

8. Lejohet sexhdeja e falënderimit edhe në kohërat kur është mekruh falja, sepse Keabi ka bërë sexhde pas namazit të sabahut dhe para lindjes së diellit, e kjo është koha kur mekruh është të falurit.

9. Mustehab është të uruarit kur vjen ndonjë e mirë e fesë. Pejgamberi s.a.v.s. e ka përgëzuar Keabin, se Zoti ia ka pranuar tevben, e po ashtu i ka përgëzuar sahabët.

10. Mustehab është t'i jepet dhuratë përgëzuesit, si shpërblim për shkak të lajmit të mirë, sepse Keabi ia ka dhënë dhuratë Hamzetu bin Amr el Evstit dy rrobat për shkak se ia ka sjellë lajmin se Zoti ia ka pranuar pendimin.

11. Kur një njeri i cili hynë brenda, lejohet që ai i cili është brenda t'i ngritet në këmbë dhe ai ta përgëzojë. Ndërsa, sa i përket hadithit: “Kush dëshiron që kur të hyjë në një vend, e ata që janë brenda t'i ngriten në këmbë ai le ta përgatis vendin e tij në zjarr.” Ky hadith nuk e ndalon të ngriturin, por e ndalon



kryelartësinë e personit, i cili dëshiron që kur të hyjë brenda, njerëzit t'i ngriten në këmbë.

12. Kur muslimani e tejkalon një vështirësi apo një fatkeqësi, ose pas një sëmundje shërohet, mustehab është dhënia e një pjese të pasurisë sadaka.

13. Nuk është e mirë që e tërë pasuria të jepet sadaka. Keabi kur ka thënë: O i Dërguari i Allahut, pasi që Allahu ma ka pranuar pendimin, dëshiroj që tërë pasurin time ta jap sadaka për Allahun dhe për të Dërguarin e Tij, ndërsa i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: “Një pjesë të pasurisë mbaje, se ajo është më mirë për ty”.

*(I. H. “SIJRU SALIHJINE BI TESARUF”)*

## **[91] - TREGIMI I ISRASË DHE MIËRAXHIT**

Imam Buhariu thotë se e ka transmetuar Enes bin Maliku hadithin, ku thuhet:

“Natën kur e ka bërë i Dërguari i Allahut Isranë prej Qabesë, deri sa një natë përpara ai ka qenë fjetur në Qabe, dhe para se ti shpallej diçka, i kanë ardhur tre persona: Njëri prej tyre ka pyetur: “Cili është ai?” I dyti i është përgjigjur: “Ai është më i miri prej tyre.” I treti ka thënë: “Merreni pra më të mirin prej tyre.” Atë natë nuk i ka parë. Natën tjetër zemra e tyre i ka parë, edhe pse sytë i ka pasur mbyllur (pra ka qenë në gjumë), zemra nuk ka qenë fjetur. Kështu kanë qenë pejgamberët, sytë e tyre kanë fjetur, ndërsa zemrat e tyre jo. Nuk kanë folur me të deri sa e kanë bartur dhe e kanë sjellë deri te uji zem-zem. Atëherë Xhibrili e ka marrë përsipër, ia ka qa gjoksin, ia ka pastruar me ujë të zemzemit, me dorën e tij zemrën e tij.

Pastaj është ngritur në qiellin e kësaj bote, ka trokitur në njërën nga dyert e saj. Atëherë banorët e qiellit kanë pyetur: “Kush është?” Xhibrili është përgjigjur: “Unë.” Pastaj kanë

pyetur: “Kush është me ty?” Është përgjigjur: “Muhamedi.” Ata kanë thënë: “Ai i cili është peygamber?” Ka thënë: “Po.” Atëherë kanë thënë: “Mirë se keni ardhur dhe merhaba ju qoftë!” Banorët e qiellit e përgëzojnë njëri tjetrin. Banorët e qiellit nuk e dinë se çka ka dashur Allahu me të, deri sa i njofton. Në qiellin e tokës e takon Ademin. Xhibrili i thotë: “Ky është baba i yt, Ademi”, dhe e përshëndesin njëri-tjetrin me selam. Pastaj Ademi tha: “Mirë se erdhe, o biri im. Djalë më të mirë se ti nuk ka.” Ai ishte në mes të dy lumenjve. E pyeta Xhibrilin: “Si quhen këta dy lumenj?” Ai u përgjigj: “Këto janë ujëra prej lumenjve: “Nili dhe Eufрати.” Pastaj kalon prej qiellit të kësaj bote, kur qe (panë) një lumë, e mbi të një kështjellë prej diamantit, dhe e prek me dorën e tij. Kur i morën erë i vinte era miskë. E pyeta: “Çka është kjo o Xhibril?” Më tha: “Ky është Kevtheri, të cilin Zoti yt e ka bërë për ty.” Pastaj jam ngritur në qiellin e dytë. Atëherë melaqet pyetën, ashtu siç kanë pyetur melaqet tjera më herët.

- Kush është?
- Unë jam Xhibrili.
- Kush është me ty?
- Muhamedi s.a.v.s.
- Ai i cili është zbritur peygamber?
- Po.
- Merhaba dhe mire se erdhët!

Pastaj jam ngritur në qiellin e tretë. Melaqet prapë kanë pyetur ashtu siç kanë pyetur melaqet më herët. Pastaj jam ngritur në qiellin e katërtë dhe kaluam njësoj.

Pastaj jam ngritur në qiellin e pestë dhe kaluam njësoj.

Pastaj jam ngritur në qiellin e gjashtë dhe kaluam njësoj.

Pastaj jam ngritur në qiellin e shtatë dhe kaluam njësoj.

Në secilin qiell ishte nga një peygamber. Dhe nga ajo që kam mbajtur mend, në të dytin ka qenë Idrisi, në të katërtin Haruni, kurse në të pestën nuk e mbaj mend. Ibrahimimi në të gjashtin dhe

Musa me të shtatin, të cilin e ka graduar Allahu, për shkak se ka folur me të: E Musa i thotë: “O Zoti im! Kam menduar se te unë nuk do ta ngritësh askënd.” Pastaj jam ngritur edhe më lart në një vend, të cilin nuk e di askush tjetër, pos Allahut të Lartmadhëruar, deri sa kemi arritur në Sidretul Munteha. Aty iu afruam Allahut të Lartmadhëruar dy shtiza apo më shumë se kjo dhe Allahu ia shpall Muhamedit s.a.v.s. që umeti i tij t’i falë pesëdhjetë kohë të namazit për çdo ditë dhe natë. Pastaj Muhamedi s.a.v.s. zbret dhe e takon Musanë. Musa a.s. i thotë: “O Muhamed. Çka të ka obliguar Zoti yt?” I thotë: “Më ka obliguar pesëdhjetë kohë për çdo ditë e natë.” I thotë: “Ymeti yt nuk do të ketë mundësi t’i kryejë këto. Kthehu dhe lute Zotit tënd t’ua lehtësojë (pakësojë).” Pejgamberi s.a.v.s. e shikon Xhibrilin dhe e vëren se edhe ai e përkrah për një gjë të tillë, i cili i thotë: “Po, shko nëse dëshiron.” Atëherë ngritet te Allahu i Lartmadhëruar dhe i thotë: “O Zoti im, lehtëso (pakësoji) për ne, se umeti im nuk mundet. Dhe ia heq, apo ia lehtëson për dhjetë namaze, *derisa arrin në pesë*. Muhamedi s.a.v.s. ndalet dhe i thotë Musasë se pesë mjaftojnë. Pastaj Musa i thotë: “O Muhamed! Për Zotin, populli im beni israil kanë pasur edhe më pak se kaq, mirëpo janë treguar të dobët dhe i kanë lënë, përderisa populli yt janë më të dobët me trup, më të dobët me zemër, më të dobët me shikim dhe më të dobët me dëgjim. Kthehu edhe njëherë dhe kërko lehtësim (pakësim) për ta.” Prapë Pejgamberi e shikon Xhibrilin se çfarë po i thotë. Mirëpo, Xhibrili e miraton atë mendim dhe ndalet në pesë e Muhamedi a.s. thotë: “O Zoti im, pjesëtarët e umetit tim janë të dobët, me trup e me zemër, me dëgjim e shikim, na lehtëso.” Zoti i Lartmadhëruar i thotë: “O Muhamed? Muhamedi i thotë: “Si urdhëroni, Të përgjigjem o Zot të përgjigjem.” Zoti i thotë: “Allahu nuk e ndryshon fjalën e Tij. Ashtu siç e kam paraparë në librin bazë, për çdo të mirë dhjetë shpërblime, ato janë pesëdhjetë në librin bazë, ndërsa për ty (në vepër) pesë.” Pastaj

kthehet te Musa. Musa i thotë: “Çka u bë?” Muhamedi s.a.v.s. i thotë: “Na ka lehtësuar ashtu që për çdo të mirë dhjetë shpërblime.” Musa i thotë: “Për Zotin beni israilët kanë pasur edhe më pak se kaq, por i kanë lënë. Por kthehu te Zoti yt, që të të pakësojë edhe më shumë.” I Dërguari i Allahut s.a.v.s. thotë: “O Musa, për Zotin, kam turp prej Zotit të Lartmadhëruar, për atë që po më thua, që të kërkoj edhe më.” Tha: “Zbrit në tokë me emrin e Allahut.” U zgjua Muhamedi s.a.v.s. prapë në Mesxhidi Haram.

Kështu e ka regjistruar Buhariu në librin Tevhidë.

Në ajetin e Israsë, nga Ebi Hurejre r.a. transmetohet për Pejgamberin s.a.v.s. se i shkojnë atij me një kalë, e hipin në të dhe çdo hap i tij sa sheh syri larg. Udhëton me atë kalë, e me të edhe Xhibrili, dhe arrin te një popull, i cili ditën mbillnin (farën) dhe po atë ditë e korrnin. Dhe çdo herë kur korrnin shtohet begatia. E pyet Xhibrilin: “Kush janë ata?” Ai i përgjigjet: “Ata janë luftëtarët në rrugën e Allahut, të cilëve e mira u shtohet në shtatëqind, (dhe çdo gjë që shpenzoni, ajo ka për t’ju ardhur pas. Ai është më i miri furnizues).” Pastaj shkon te një popull, kokat e të cilëve qaheshin me gurë, dhe çdo herë që u qahej, u rikthehej në gjendjen e mëparshme. E pyet: “O Xhibril, kush janë ata?!” Përgjigjet: “Ata janë kokat, të cilat nuk kanë rënë në sexhde.” Pastaj arrijnë te një popull, të cilët para kishin një greminë, e mbrapa kishin një greminë tjetër. Kur hidheshin në valë të drurit të zekumit, dhe të përzier me gurë të xhehenemit pallnin si kafshët. E pyet: “O Xhibril, po kush janë ata?” Ai përgjigjet: “Ata të cilët nuk e kanë dhënë zekatin e pasurisë se tyre. Allahu nuk u bën padrejtësi atyre, sepse Allahu nuk është i padrejtë ndaj robërve të vet.” Pastaj arrijnë te një popull tjetër, të cilët para vetes kishin sasi të mishit të pjekur mirë, ndërsa në anën tjetër kishin mish të keq. Ata hanin mishin e keq, ndërsa e linin pas dhe nuk e hanin mishin e mirë. E pyet: “O Xhibril, po

kush janë ata?” I përgjigjet: “Ky njeri dhe këta janë njerëz të cilët i kanë pasur gratë e tyre hallall, por kanë shkuar te gratë e këqija (të ndaluara për ta) dhe kanë qëndruar me ta deri në mëngjes.” Pastaj arrin deri te një dërrasë në rrugë, dhe çdo gjë që e kalonte ajo dërrasë e ndante përgjysmë. Zoti i Lartmadhëruar thotë: ***“Dhe mos qëndroni e mos u ulni në çdo rrugë e cilat u premtohet”***. Pastaj kalon pranë një njeriu, i cili kishte tubuar barrë të madhe, nuk mund ta barte, ndërsa ai e shtonte barrën edhe më shumë. E pyet Xhibrilin: “Po ky kush është?” I përgjigjet: “Ky është një njeri i umetit tënd, i cili ka një emanet për ta kryer, e ai jo që mundet ta kryejë, por pranon edhe amanete (detyra) tjera.” Pastaj arrin te një popull, buzët e të cilëve preheshin në gërshërë të hekurit, dhe çdo herë që u preheshin, u ripërtëriheshin dhe ashtu vazhdonte përsëri prej fillimit. E pyet: “O Xhibril, po kush janë ata?” I përgjigjet: “Këta janë ligjëruesit e fitneve (sprovave-ngatërresave).” Pastaj arrin te një gur i vogël prej të cilit dilte një ka i madh, i cili dëshironte të hynte nga ka dalë, por nuk mundte. E pyet: “O Xhibril, po kjo çka është?” I përgjigjet: “Ky njeri e thotë një fjalë, por pendohet për atë fjalë. Dëshiron ta kthejë prapë, por nuk mundet.”

Tregon i Dërguari i Allahut s.a.v.s. se kur ka qenë në Miraxh ka kaluar edhe pranë një populli, i cili i kishte thonjtë prej bakri dhe me ato thonj gërvishtnin fytyrat dhe gjokset e tyre. E pyeta: “O Xhibril, po kush janë këta?” U përgjigj: “Janë ata, të cilët e hanë mishin e të tjerëve dhe pasurinë e të tjerëve.”

E ka përmendur Bejhekiu nga transmetimi i Ebi Seid el Hudrijut se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Kur jemi ngritur unë dhe Xhibrili, është hapur dera, kur pamë Ademin me formën e tij, sikur të asaj dite kur ka qenë i krijuar prej Allahut, dhe i dolën përpara shpirtrat e besimtarëve, e ai thoshte: Shpirtra të mirë, njerëz të mirë, shpjerini në ILIJINË (XHENET). Pastaj, i dolën përpara pasardhësit e tij kriminelë, e ai thoshte: “Shpirtra

të këqij, shpjerini në SIXHINË (XHEHNEM).” Pastaj, u afrova pranë një tryeze (tavolinë), në të cilën kishte mish të mirë, por nuk i afrohej askush, ndërsa në anën tjetër ishte tryeza (tavolina) me mish të keq, erë të keqe, në të cilin hanin njerëzit. I thash: “O Xhibril, kush janë këta?” Ai u përgjigj: “Janë ata, të cilët e lënë hallallin e shkojnë pas haramit.” Pastaj shkova në një vend ku pash një popull, barqet e të cilit ishin sa një shtëpi. Dhe çdo njeri që dëshironte të ngrihej në këmbë rrezohej, e ai thoshte: “O Zot mos të bëhet kijamet!” Ata ishin në Sabiletin e firaunit.

Shkonte (Sabileti) i firaunit i shkelte, ndërsa ata bërtitnin. E pyeta: - O Xhibril, kush janë këta? “Këta janë ata, të cilët e hanin kamatën dhe nuk mund të ngriten, ashtu siç nuk mund të ngritet ai, të cilin shejtani e ka shkel prej vetes së tij” – tha Xhibrili. Pastaj shkova në një vend ku ishte një popull, qafat e të cilëve ishin si qafat e deveve. Hapej goja e tyre, gjuheshin gacat ne gojët e tyre, e pastaj ato gaca binin prej pjesës së poshtme të tyre. Dhe dëgjova se ata janë ata të cilët e hanë pasurinë e jetimeve me padrejtësi. Pastaj shkova në një vend dhe pashë se si gratë ishin të varura në gjinj të tyre e ato bërtitnin.

E pyeta: “Kush janë këto?” U përgjigj: “Këto janë prostitutat.” Pastaj shkova në një vend, ku pashë një popull, ku shkëputej prej trupit të tyre mishi, e prapë u gjuhej atyre, dhe u thuhej: “Haje ashtu siç e ke ngrënë mishin e vëllait tënd.” E pyeta: “Kush janë këta?” U përgjigj: “Shpifësit dhe përgojuet e popullit tënd.”

## **[92] - TREGIMI I ATIJ, I CILI KA URDHËRUAR BIJTË E TIJ PËR T’IA DJEGUR TRUPIN E TIJ PAS VDEKJES**

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: “Një njeri asnjë të mirë nuk e ka pasur në jetën e tij. I thotë familjes së tij: “Kur të vdes, ma digjni trupin, bëjeni hi, e pastaj hirin ndajeni në dy

pjesë: Njërën pjesë shpërndajeni në tokë, ndërsa pjesën tjetër shpërndajeni në det, se për Zotin, nëse Allahu ka caktuar që të japin përgjegjësi për vepra, do të jap aq llogari të madhe dhe do të dënohem aq shumë, sa që asnjë njeri në botë nuk është dënuar.” Kur vdiq njeriu, vepruan ashtu siç i kishte porositur. Mirëpo, Allahu e urdhëroi detin dhe e tuboi pjesën e tij. E urdhëroi tokën dhe e tuboi pjesën e tij (Zoti e ngjalli atë), e pastaj i tha: “Përse veprime kështu (Çka të shtyri të urdhërosh të vepronë me ty kështu)?” Ai u përgjigj: “O Zoti im, Ti e di më së miri, nga frika jote.” Atëherë Allahu i Lartmadhëruar ia fali atij.”

*BUHARIU DHE MUSLIMI*

## **[93] - TREGIMI I EBI TAHLAS DHE GRUAS SË TIJ UMI SELIM**

Transmeton Enesi r.a. se: Ebu Talha r.a. e kishte një fëmijë shumë të sëmurë. Ai del nga shtëpia për punë dhe djali i tij vdes. Kur u kthye në shtëpi, i thotë gruas së tij Umi Selimj: “Si është puna me fëmijën. Ka pushuar dhe është qetësuar (duke pasur për qëllim se ka vdekur)”, ndërsa Ebu Tahla ka menduar se është shëruar. Pas jaxisë i afrohet gruas dhe kryen me te marrëdhënie aq mirë sa kurrë më parë. Kur e sheh se ai e ka përfunduar, pas një kohe të shkurtër i thotë: “O Ebu Tahla, çka mendon, nëse marrin borxh në një shtëpi, e pas një kohe familja e asaj shtëpie e kërkon borxhin, a është e drejtë t’ia ndalosh?” Thotë: “Jo.” Ajo i thotë: “Konsideroje fëmijën tënd (fëmija yt ka vdekur e kërko shpërblim prej Zotit).” Thotë Enesi: “Ai hidhërohet me gruan e tij dhe i thotë: “Më ke lënë që të bëhem i papastër (xhunub) prej marrëdhënieve, e tani po më tregon për fëmijën?!” Pastaj del prej shtëpie, shkon te i Dërguari i Allahut s.a.v.s. dhe i tregon çka i ka ndodhur. Muhamedi s.a.v.s. i thotë se gruaja jote ka vepruar me të drejtë dhe është lutur: “Zoti e bekoftë natën e

juaj!”. Në një transmetim tjetër ekziston: “Zoti ju bekoftë!”. Atyre (Ebu Tulhas dhe Umi Selijmet) u lind një fëmijë, të cilin Muhamedi a.s. e emëron Abdullah. Një Ensar tregon se pastaj (nga ky fëmijë) i kanë pasur nëntë fëmijë, dhe të gjithë lexonin Kur’an (*ka pasur për qëllim fëmijët e Allahut*), dhe kjo ka qenë pranimi i duasë së të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. “O Zot bekoji ata!”

(Transmetojnë dy shejhat)

## [94] - NGJARJA E “IFKUT” (SHPIFJES)

Transmeton Aisheja r.a., gruaja e Pejgamberit s.a.v.s., se Pejgamberi s.a.v.s. kur shkonte në udhëtim të gjatë hidhte short në mes grave të tij, dhe cilës i binte shorti e merrte me vete. “Në një luftë prej luftërave, pasi që hodhi short, më ra mua. Kështu që unë shkova me *Pejgamberin s.a.v.s.*, hyra në shportë (ulëse e mbuluar për udhëtim). Kjo ishte koha kur ka zbrit ajeti për mbulesën e femrës. Unë e kam vendos mbulesën dhe kam shkuar me të. Pasi që i Dërguari i Allahut s.a.v.s. e ka përfunduar betejën, jemi nisur për t’u kthyer në Medine. Natën është dhënë urdhri për nisje. Unë jam bërë gati për vazhdimin e rrugës dhe iu kam bashkangjitur radhëve. Pasi që kam hipur në devenë time, kam shikuar në gjoks kur shoh se qaforja ime ishte këputur dhe më kishte rënë. Jam kthyer për ta kërkuar dhe jam vonuar pak. Në devenë ku kam qenë unë, kanë menduar se kam hipur në të, andaj ata kanë vazhduar rrugën.” Ajo tregon se në atë kohë gratë kanë qenë të holla, nuk hanin shumë ushqim, dhe kanë qenë të lehta. “Për këtë arsye kur e kanë vendosur shportën nuk e kanë kuptuar se unë kam qenë në të, ngase edhe kam qenë shumë e re. Kështu që e kanë tërhequr devenë dhe kanë shkuar. Unë pastaj e gjeta qaforen por ushtria kishte shkuar. Mandej shkova në vendin ku kanë qenë të vendosur ushtria, thirra, por



nuk mu përgjigj askush. Atëherë prapë u ktheva në vendin tim, sepse mendoja se kur ta vërejnë se nuk jam në devenë do të kthehen për të më marrë. Duke pritur në vendin e shatorit tim, më kishte kapluar gjumi. Pas karavanit kishte qenë Safvan bin Muatal, i cili ka mesi i natës, duke shkuar pas ushtrisë në vendin ku isha unë, sheh diçka të zezë, si një njeri fjetur, sepse ai më ka pas parë para zbritjes së ajetit të mbulesës. Ai për të më sinjalizuar dhe për të më zgjuar nga gjumi, ka thënë: “Ne jemi të Allahut dhe ne tek Ai do të kthehemi”, pasi që ai veç më kishte parë fytyrën me shaminë time. Për Zotin, as që më ka folur dhe as që kam dëgjuar ndonjë fjalë tjetër prej tij, pos kur ka thënë: “Ne jemi të Allahut dhe ne tek Ai do të kthehemi.” Pastaj e ka përgatitur devenë, e ka ulur dhe unë kam hipur në të. Dhe kështu ai ecte përpara, e unë hipur në devenë, deri sa iu kemi bashkangjitur ushtrisë dhe jemi ndalur në Mugarijne, në mesditë. Është shkatërruar ai i cili është shkatërruar për shkak të shpifjes ndaj meje, në krye të së cilës shpifje ishte kryemunafiku - Abdullah bin Ubej bin Seluli, e pastaj arritëm në Medine. Kur kemi arritur në Medine kam qëndruar e sëmure një muaj. Njerëzit e kishin përhapur shpifjen, ndërsa unë nuk kisha ditur asgjë. Te i Dërguar i Allahut nuk e shihja atë disponim të mëhershëm ndaj meje, përpos se çdo herë kur vinte në shtëpi, jepte selam dhe thoshte: “Si je me shëndet?”, mirëpo kjo ishte përkujdesje ndaj meje, e nuk kishte asgjë të keqe. Deri sa pas një muaji me Umi Mustahin dolëm në vendin Mesanië, një largësi prej shtëpive dhe aty nuk shkonim, pos kur errësohej, sepse shkonim për të kryer nevojë, paksa larg shtëpie dhe për shkak të ruajtjes së ambientit nuk kryenim nevojë nëpër shtëpi. Shkova së bashku me Umi Mustahin, e cila ishte bija e Ubej Rahmit bin Abdul Mutalibit bin Menafit, ndërsa nëna e saj ishte bija e Sahr bin Amirit. Halla e Ebu Bekrit, e djali i saj ishte Mustah bin Ethathetu bin Ubad bin Abdul Mutalib bin Abdu Menaf. Pasi që kryem punën tonë, unë dh vajza e Ebi Rehmit bin Mustahit u

kthiem për në shtëpi dhe e dëgjova Umi Mustahin, e cila zuri në thua duke thënë: “Mallkuar qoftë për ty o Mustah.” I thash asaj: “Po çka po flet kështu, po e shan njeriun i cili ka marrë pjesë në luftën e Bedrit?!” Ajo më tha: “Oj grua, po a nuk ke dëgjuar çka ka thanë?” I thash: “Po çka ka thënë?” E ajo më informoi për shpifjen ndaj meje. Pastaj sëmundja m’u shtua edhe më shumë. Kur arrita në shtëpi më erdhën prindërit. Unë atëherë kam dëshiruar që të dëgjoj prej tyre çka ata mendojnë. Pasi kërkoja leje prej të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. iu afrova prindërve dhe e pyeta nënën: “Oj nëna ime, po çka po flasin njerëzit për mua?” Ajo më tha: “Oj bija ime, qetësohu, se për Zotin, çdo herë kur një grua qëllon rastësisht me ndonjë njeri, asaj vetëm se i shtojnë dhe ia zmadhojnë gjërat.” Tregon Aishja: I kam thënë: “Subhanallah”, ashtu kanë folur njerëzit”, dhe kam qajtur tërë natën pandërprerë deri në mëngjes, e lotët më shkonin rrëke. As që kam mundur të fle fare deri në mëngjes. Tregon: “I Dërguari i Allahut s.a.v.s. e ftoi Ali bin Ebi Talibin dhe Usamete bin Zejdin, para se të zbriste Vahji, i pyet dhe këshillohet me ta për familjen.” Tregon: “Pasi e pyeti i Dërguari i Allahut s.a.v.s. Usamete bin Zejdin për pastërtinë time, ai i është përgjigjur: “O i Dërguari i Allahut, ne dimë vetëm çka është më e mira për të, ndërsa të tjerët janë të shkatërruar.” Ndërsa Ali bin Ebi Talibi tha: “O i Dërguari i Allahut, mos e ngushto veten, pyeti gratë, ata do të të informojnë më mirë.” Pastaj i Dërguari i Allahut s.a.v.s. e thirri Berijreten dhe e pyeti: - Oj Berijrete, mos ke vërejtur diçka të dyshimtë te Aishja?” Berijrete i është përgjigjur: “Pasha Atë, i Cili të ka dërguar me të vërtetën, kurrë s’kam parë te ajo asnjë të keqe, përpos që ajo është shumë e re dhe flenë në shtëpinë e saj.” Atëherë Muhamedi a.s. shkon dhe hipi në minber dhe thotë: “O ju musliman! Ai i cili ka gjetur arsye të panevojshme vetëm e vetëm për ta ofenduar familjen time, për Zotin, unë në familjen time nuk di asgjë tjetër, pos atë

çka është më e mira, e kanë përmendur (duke akuzuar) për një njeri, për të cilin nuk di asgjë tjetër, pos ajo çka është më e mira, dhe ai kur ka hyrë në familjen time ka hyrë gjithmonë së bashku me mua.” Ngritet në këmbë Sead bin Muadhi r.a., i pari i ensarëve dhe thotë: “O i Dërguari i Allahut, unë konsideroj se ke të drejtë, andaj nëse shpifësi është prej Evsit do t’ia heqim kokën menjëherë, e nëse është prej vëllezërve tanë të Hazrexhit, çka do që të na urdhërosh të veprojmë me të, do të veprojmë.” Pastaj ngritet Sead bin Ubadete, kryetari i fisit Hazrexh, ai ka qenë njeri i mirë, mirëpo ka qenë i hutuar dhe i kundërpërgjigjet Sead bin Muadhit, duke i thënë: “Po rrenë, se për Zotin, as nuk mundesh ta ekzekutosh, as nuk mundesh ta vrasësh, edhe po të ishte i fisit tënd nuk do të kisha dashur të vritej.” Atëherë ngritet Esjed bin Hudejri, i cili ishte djali i axhës së Sead bin Muadhit, dhe i thotë Sead bin Ubadetes: “Jo, por ti po rrenë, se për Zotin, e vrasim, ndërsa ti je munafik, pasi që po i mbron munafikët. Dhe u konsultuan që të dy fiset, Evsi dhe Hazrexhi dhe deshën që ta mbytnin (shpifësin), deri sa i Dërguari i Allahut s.a.v.s. qëndronte në minber. Mirëpo i Dërguari i Allahut s.a.v.s. vazhdimisht kërkoi prej tyre qetësi, deri sa i qetësoi, e pastaj u qetësua edhe i Dërguari i Allahut s.a.v.s.” Pastaj vazhdoi duke treguar Aishja r.a.: “Atë ditë kam qajtur tërë ditën, dhe lotët më shkonin rrëke, e tërë natën nuk flija, *ndërsa prindërit e mi mendonin se mushkërit do të më prishen duke qajtur.*

Dhe deri sa ata ishin ulur pranë meje, një grua prej Ensarëve kërkoi leje që të vijë tek unë. Unë i thashë eja dhe mu afro”, e ajo u ul pranë meje dhe qante së bashku me mua. Dhe përderisa ne ishim në atë gjendje, hyri edhe i Dërguari i Allahut s.a.v.s. dhe u ul. (Vazhdon duke treguar Aishja) Ai nuk ishte ulur pranë meje prej momentit kur kanë thënë çfarë kanë thënë dhe kishte kaluar një muaj që asgjë nuk kishte zbritur për mua prej vahjit (shpalljes). Pasi e filloi fjalimin me shehadet tha: “Aishe, unë kam dëgjuar për ty këtë e këtë, nëse je e pastër dhe e pafajshme,

do të të mbroj dhe do të të shfajësojë Allahu, ndërsa nëse më ke shkaktuar problem me ndonjë mëkat, kërko falje prej Allahut, pendohu te Ai, sepse kur robi e pranon gabimin, kërkon falje e pendohet, Allahu e pranon. Kur i Dërguari i Allahut e përfundoi fjalimin e tij, m'u ndalën lotët, dhe nuk më rridhte asnjë pikë. I thashë babait tim: “Përgjigju të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.” Ai më tha: “Për Zotin, nuk po di çfarë t'i them.” I thashë nënës: “Përgjigju të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.” Ajo më tha: “Për Zotin, nuk po di çfarë t'i them.” Edhe pse isha e re, thashë: “Po unë nuk di shumë nga Kur'ani. Por, për Zotin e kam ditur se ju keni dëgjuar çka flitet për mua dhe ju ndoshta u keni besuar atyre fjalëve. Unë po ju them se jam e pafajshme, Allahu e di për mua se jam e pafajshme. Çka do që të them, ju prapë nuk më besoni, por pasi që Allahu e di pafajësinë time, unë nuk di çfarë t'ju them tjetër, pos atë që e ka thënë baba i Jusufit: **“Durimi është më i miri, Allahu është mbrojtësi i imi për ata që po thoni.”**

Pastaj u ktheva në krah, dhe u shtrina në shtratin tim. Dhe për Zotin, e kam ditur se Allahu do ta shpalosë pafajësinë time, mirëpo nuk e kam menduar se do të zbresin ajete posaçërisht për mua, sepse e ndieja veten të përulur që Allahu të flasë për mua dhe për çështjen time. Mirëpo kam pasur dëshirë që Vetë të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. në ëndërr t'i kumtohet pafajësia ime prej Allahut. Për Zotin, posa është larguar i Dërguari i Allahut s.a.v.s. nga vendi ku ishte, dhe ende pa dalë nga shtëpia asnjëri prej nesh, kur Zoti i Lartmadhëruar ia zbret të Dërguarit të Tij (*ajetet e ifkit*), ndërsa derisa i pranonte ajetet i djersitej tërë trupi, dhe djersët i binin si shi prej trupit të tij, për shkak të vështirësisë së fjalëve, të cilat i zbrisnin atij. Pasi që përfundoi vahji (shpallja), dhe pasi që iu hoq të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. të rënduarit, e cila e mundonte, filloi të qeshë, dhe fjalën e parë që e foli ishte: “Përgëzim për ty oj Aishe! Zoti i Lartmadhëruar e

vërtetoi pafajësinë tënde.” Atëherë nëna më tha: “Ngritu dhe shko te i Dërguari i Allahut s.a.v.s.”. I thashë: “Për Zotin nuk shkoj te ai dhe nuk e falënderoj kënd tjetër, pos Allahut të Lartmadhëruar, i cili vërtetoi pafajësinë time dhe i zbriti ajetet:

**“Ata të cilët kanë përcjellë shpifjet, janë prej mesit tuaj ...”** dhe dhjet ajetet që pasojnë pas tij (Ajetet në suretu En-Nur). Kështu zbritën ajetet të cilat vërtetonin pafajësinë time. Ebu Bekri r.a. e kishte të afërt Mustah bin Ethathen dhe shpenzonte për të vazhdimisht, pasi që ishte i varfër, në atë moment tha: “Për Zotin, më nuk do t’i jap asgjë pas asaj çfarë ka thënë për Aishen.”

Pastaj Zoti i Lartmadhëruar zbriti ajetin:

**“Të ndershmit dhe të pasurit nga ju, të mos betohen se nuk do t’u japin të afërmve, të varfërve dhe atyre që për hir të All-llahut lanë vendlindjet e tyre, po le t’ua falin (gabimin) dhe mos t’ua zënë për të madhe. A nuk dëshironi që All-llahu t’u falë ju? All-llahu falë dhe mëshiron shumë.”**

(En-Nur, 22)

Atëherë Ebu Bekri r.a.thotë: “Për Zotin, dëshiroj që Allahu të më falë. Shkoi te Mustahi dhe vazhdoi t’i japë atë që i jepte më parë”, dhe tha: “Kurrë nuk do t’ia ndërpres ndihmat. Dhe prapë ia vazhdoi ndihmat Mustahit.”

Tregon Aishja r.a.: “I dërguari i Allahut s.a.v.s. e pyeste Zejnebe bin Xhahshin: “Oj Zejnebe, çka di ti dhe çka mendon për Aishen?” Ajo i përgjigjej: “O i Dërguar i Allahu, unë ruaj dëgjimin dhe shikimin tim (nga ato që fliten e përfliten), për Zotin, unë di vetëm çfarë është mirë për të.” Ajo e ngrite vlerën time dhe ishte gruaja e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. Për këtë arsye e ka mbrojtur Allahu dhe e ka bërë të devotshme, ndërsa motra e saj (Hamnetu bin Xhahshi) e sulmonte dhe ia kishte zili. Dhe kështu ka dështuar ai i cili ka dështuar. Ibn Shihabi ka thënë: “Dhe kështu përfundoi çështja e atyre shpifësve.”

Neveviju r.a. ka thënë: “Ta dini se në hadithin e ngjarjes së “Ifkut” përfundohen shumë çështje:

E para: Hedhja e shortit mes grave, nëse dëshirohet të udhëtohet me njërën prej tyre.

E dyta: Lejohet udhëtimi i burrit me gruan e tij dhe lejohet që gratë të marrin pjesë në beteja; lejohet që ato të hipin në mjete transportuese (kafshë), dhe lejohet që burrat t’u ndihmojnë atyre gjatë udhëtimit.

E treta: Lejohet që gruaja të dalë për nevoja të domosdoshme të saj, pa lejen e burrit, kuptohet në raste të jashtëzakonshme.

E katërta: Ai i cili hip një grua (të huaj) në devenë nuk flet me të, nëse nuk është i afërt i saj, vetëm nëse është e domosdoshme, sepse Aishja ka udhëtuar me devenë, por nuk folur me grahësin e devesë.

E pesta: Është mirë që gratë të mos hanë mish, i cili e trashë shumë, sepse kështu ka qenë në kohën e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. E, ajo çka ka qenë në kohën e Pejgamberit s.a.v.s. ajo është e mirë dhe e dobishme që të praktikohet.

E gjashta: Të ndihmuarit e nevojtarit dhe të atij, i cili ka mbetur në rrugë; të shpëtuarit e të humburit, dhe të nderuarit të vlefshmëve, ashtu siç ka vepruar Safuani r.a.

E shtata: Sjellja e mirë me të huajt, posaçërisht me ata që, për shkak të domosdoshmërisë, kanë mbetur të vetmuar në vend të huaj. Njësoj siç ka vepruar Safuani në rastin e përgatitjes së devesë, pa folur, pa pyetur, dhe duke ecur përpara, as paralel, e as pas saj.

E teta: Kur të ndodhë ndonjë fatkeqësi, pa marrë parasysh a është në fe, në jetë, në trup, ose kur ngushëllohet dikush *mustehab* është t’i thuhet atyre: “Ne jemi të Allahut dhe ne te ai do të kthehemi.”

E nënta: Që gruaja të e mbulojë fytyrën kur ta shikojë i huaji, pa marrë parasysh a është i ndershëm ai apo jo.

E Dhjeta: Mustehab është që të fshihet ajo çka thuhet për ndonjë njeri, deri sa nuk është e dobishme që të tregohet, ashtu siç e kanë fshehur nga Aishja r.a. çështjen e saj një muaj, dhe një muaj nuk i ka dëgjuar, deri kur është paraqitur nevoja, kur nëna e Mustahit ka thënë: “U shkatërroftë Mustahi!”

E njëmbëdhjeta: Është mustehab që burri të jetë i butë dhe të sillet mirë me bashkëshorten, nëse i ndodh asaj ndonjë fatkeqësi, që t’ia lehtësojë (ia lehtëson duke u sjell mirë me të), njëherit duhet të pyetet ajo për shkakun dhe problemin, me qëllim që t’ia largojë.

E dymbëdhjeta: Gruaja nëse del për ndonjë nevojë, mustehab është që ta marrë me vete një shoqëruese, për të mos i ndodh diçka.

E trembëdhjeta: Që njeriu të urrejë shoqërinë apo të afërmit nëse ofendojnë të mirët dhe të ndershmit, ose nëse veprojnë gjëra të pahijshme, ashtu siç ka vepruar nëna e Mustahit, kur ka mallkuar.

E katërbëdhjeta: Që gruaja të mos shkojë te shtëpia e prindërve të saj pa lejen e burrit.

E pesëmbëdhjeta: Që kur të konsultohet ndonjë njeri për familjen e tij, për shoqërinë e tij, t’i përgjigjet për gjëra që kërkon dhe që i nevojiten.

E gjashtëmbëdhjeta: Lejohet të sharit e fanatikut për ta mposhtur, atë ashtu siç e ka sharë Ejsen bin Hudejri, Sead bin Ibadetin, për fanatizmin dhe dyfytyrësinë e tij, sepse i ka thënë: “Ti je munafik dhe po i mbron mynafikët”. Ai ka pasur për qëllim ti thotë: Ti bën veprimin e munafikëve, e nuk e ka pasur për qëllim munafikllëkun e vërtetë.

E shtatëmbëdhjeta: Pafajësia e Aishes r.a. nga shpifja kundër saj (Ifkut). Ajo është pafajësuar me argument të qartë kur’anor, dhe

nëse ndonjë njeri dyshon diçka, atëherë ai është pabesimtar (Zoti na mbrojt) dhe këtë me ixhmain e muslimanëve.

E tetëmbëdhjeta: Vlerat e Ebu Bekri Sidik r.a. Kjo vërtetohet me ajetin kur'anor.

E nëntëmbëdhjeta: Mustehab është që të bëhet lidhja farefisnore, edhe nëse nuk janë të mirë, dhe mustehab është t'i falet keqbërësit.

E njëzeta: Nëse dikush përbetohet për diçka, ndërsa e kupton se veprimi i kundërt është më e dobishme, atëherë e thyen përbetimin, e kompenson, dhe e bënë atë punë të mirë”.

## [95] – FOSH NJJA, E CILA I KA FOLUR NËNËS SË SAJ

Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Një grua nga beni israilët i jepte gji foshnjës së saj. Aty pranë kalon një kalorës i pashëm, me rroba të bukura. Gruaja thotë: “O Zoti im! Fëmijën tim bëre si ky”. Foshnja e ndërpret gjirin, e kthen fytyrën në drejtim të kalorësit, e shikon, dhe thotë: “O Zoti im, mos më bën si ky”, - pastaj vazhdon prapë të thithë. Tregon Ebu Hureje: “Më duket sikurse po e shoh duke treguar



rastin Pejgamberi s.a.v.s., aq mirë që e tregonte”. Pastaj vazhdon duke treguar: “Pastaj aty pranë e sjellin një vajzë duke e goditur pandërprerë dhe duke thënë: “Ke bërë prostitucion, ke vjedhur”, ndërsa ajo thoshte: “Më mjafton Allahu, Ai është ndihmëtari më i miri.” Nëna thotë: “O Zot, fëmijën tim mos e bën si kjo!” Foshnja e ndërpret gjimarrjen, e shikon atë dhe thotë: “O Zoti im, më bën si kjo!” Pastaj e tregon tregimin dhe sqarimin e foshnjës, e cila ka thënë: “Ka kaluar një njeri me pamje të mirë, e nëna tha: “O Zoti im, bëre foshnjën time si ai, e unë thashë: “O Zoti im, mos më bën si ai!” E kur kaluan këta njerëz me vajzën duke e rrahur dhe duke i thënë: “Ke vjedhur, ke bërë prostitucion”, e nëna tha: “O Zoti im, mos e bën foshnjën time si ajo”. Thashë: “O Zoti im, më bën si ajo!” Tregon se ai njeri (kalorësi i pashëm) ka qenë kriminel (i fshehur), e foshnja ka thënë: “O Zoti im, mos më bën si ai!” Ndërsa për vajzën, të cilës i kanë thënë: “Ke vjedhur, ke bërë prostitucion.” Ajo as nuk ka vjedhur, as nuk ka bërë prostitucion, e unë kam thënë: “O Zoti im, më bën si ajo!”

*(TRANSMETON BUHARIU DHE MUSLIMI)*

## **[96] - TREGIMI I LUFTËTARIT PEJGAMBER ME TRADHËTARIN**

Ebu Hurejre r.a. transmeton se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Një Pejgamber prej Pejgamberëve (Jashua bin Nuni) ka luftuar dhe, para betejës, i thotë popullit të tij: “Mos të vijë me mua në front ai, i cili dëshiron të martohet dhe është në prag të martesës, veç sa nuk ka lidhë kurorë, veç sa s’ka hyrë dhëndër, as ai, i cili ka filluar të ndërtojë shtëpi, e ende nuk e ka vendosur kulmin. E, as

ai i cili ka blerë bagëti dhe i pret që të lindin, bagëtia pëlle. E fillon luftën, zbret në një fshat në kohën e namazit të ikindisë, apo afër namazit të ikindisë dhe i thotë diellit: “Ti je i urdhëruar, por edhe unë jam i urdhëruar. O Zot ndale!” Dhe dielli ndalet, deri sa ta çlirojë. E tubon pasurin e luftës e pastaj vjen zjarri për ta përpirë, por nuk e përpin. Pejgamberi thotë: “Në mesin e juaj ka tradhëtar (Gulul-tradhëtar quhet vjedhja prej pasurisë së luftës, para se ajo të ndahet). Secili njeri prej fisit (secili luftëtar) le të ma japë dorën që ta shikoj a po ngjitet dora e tij me dorën time.” (Kjo ishte shenjë, të cilën Allahu e argumentonte tradhëtinë-vjedhjen e pasurisë së luftës, dhe vërejtje se ajo dorë duhet të dënohet) . Dhe u thotë: “Në mesin e fisit tënd ka tradhëtarë, e le të ma japin dorën.” E kur ia japin dorën, dyve apo treve të fisit u ngjitet dora për dorën e tij. E thotë: “Ju jeni tradhtarët (hajna të pasurisë së luftës).” Dhe sjellin koka, si koka të lopës me ari dhe i vendosin në tokë, e pastaj shkon zjarri dhe i shtrinë e i përpin. Pastaj Allahu na ka lejuar neve pasurinë e luftës, sepse e ka parë se ne jemi të dobët e mund të gabojmë.

(TRANSMETON BUHARIU DHE MUSLIMI)

## **[97] - TREGIMI I DY SHOKËVE, NJËRI BESIMTAR E TJETRI PABESIMTAR**

Tregon Sudaiju: “Kanë qenë dy shokë nga beni israilët, njëri besimtar e tjetri pabesimtar, të cilët pastaj janë ndarë mes veti, pasi që kishin fituar 6000 dinarë dhe pasi secili prej tyre i kishte marrë nga 3000 dinarë. Pas një kohe takohen përsëri. Pabesimtari e pyet besimtarin: “Çfarë ke bërë me pasurinë tënde,

a ke bërë ndonjë tregti apo jo?” Besimtari i thotë: “Jo. Po çfarë ke bërë ti?” Ai i thotë: “Kam blerë një parcelë toke me hurma, në vlerë prej 1000 dinarëve.” Besimtari i thotë: “Me të vërtetë?” Ai ia kthen: “Me të vërtetë.” Besimtari shkon në shtëpi dhe kur bëhet mes i natës falet, sa ka dashur Allahu që ai të falet, i merr 1000 dinarë dhe thotë: “O Zoti im! Filani (shoku i tij pabesimtarë) ka blerë parcele me hurma, ku ka lumenj për 1000 dinarë, mirëpo ai nesër do të vdesë dhe do ta lë pas vete. O Zoti im, unë dëshiroj që prej Teje të blej parcelë me hurma dhe lumenj në xhenet!” Dhe të nesërmen në mëngjes ia ndan 1000 dinarët të varfërve. Pastaj vazhdoi kështu deri sa përsëri pas një kohe janë takuar. Pabesimtari i thotë besimtarit: “Çfarë ke bërë me pasurinë, a ke bërë ndonjë tregti?” I thotë: “Jo. Po ti çfarë ke bërë?” Ai (pabesimtari) i thotë: “Punishtja ime ishte e madhe, ndërsa vetëm nuk mund ta punoja, kështu që bleva robër në vlerë prej 1000 dinarëve, për të punuar për mua.” Besimtari i thotë: “A kështu paske vepruar?” I thotë: “Po.” Besimtari shkon në shtëpi dhe kur bëhet mes i natës, falet sa ka dashur Allahu që ai të falet, i merr 1000 dinarë në dorë dhe thotë: “O Zoti im! Filani (shoku i tij pabesimtar) ka blerë robër prej robërve të kësaj bote në vlerë prej 1000 dinarëve, nesër vdes e i len ata pas vete, ose ata vdesin e lënë atë. O Zot, unë po blej prej Teje me këto 1000 dinarë robër të xhenetit.” Dhe të nesërmen në mëngjes ua ndan të varfërve. Pastaj kalon edhe ca kohë dhe prapë takohen. Pabesimtari i thotë besimtarit: “Çfarë ke bërë me pasurinë tënde, a ke bërë ndonjë tregti?” I thotë: “Jo. Po ti çfarë ke bërë?” Ai i thotë: “Të gjitha dëshirat i kam pasur të plotësuara, më mungonte vetëm diçka. Një gruajë i ka vdekur burri, e asaj ia kam dhanë 1000 dinarë, dhe ajo ka ardhur tek unë edhe me të hollat dhe ka pranuar të martohet me mua. E, unë u martova me të.” Besimtari i thotë: “Kështu paske vepruar?” Thotë: “Po.” Besimtari shkon në shtëpi dhe në mesnatë fal namaz, sa ka dashur Allahu që ai të falë dhe pasi e përfundon namazin, i merr

1000 dinarët tjera, i vendosë në duar dhe thotë: “O Zoti im! Filani (shoku i tij pabesimtar) është martuar me një grua prej grave të kësaj bote për 1000 dinarë. Nesër ai do të vdesë e do ta lë pas vete, ose ajo do të vdesë e do ta lë. O Zoti im, unë dua që me këto 1000 dinarë të fejoj prej Teje një hyri të xhenetit.” Të nesërmen në mëngjes 1000 dinarë ua jep të varfërve. Besimtari pastaj mbet pa të holla. Shoku i tij pabesimtar kur e sheh, e njej, e kap për dore e i thotë: “A nuk ke pasur pasuri shumë? Tani paskeni mbetur në këtë gjendje!” Thotë: “Po, është e vërtet.” I thotë: “Pra a më tregon se ku i ke harxhuar ato mjete?” Thotë: “I kam huazuar.” “Po cilit?” Besimtari i thotë: “Atij, i Cili m’i kthen”. Pabesimtari pyet: “Po kush është Ai?” Ai i thotë: “Allahu, Zoti im.” E largoi dorën e vet prej dorës së tij e tha: “A me të vërtet ti je prej lëmoshëdhënësve. Vallë, atëherë kur të jemi të vdekur e të bëhemi eshtra, a ne do të japim llogari (pyet pabesimtari)?!”

Suda tha: “Ata të dy, gjithsesi kanë për të dhënë llogari.” Ai tha: “Pabesimtari shkoi dhe e la besimtarin, pasi e sheh se nuk kishte asgjë. E la besimtarin të jetojë jetë të vështirë, në kohë të vështirë, ndërsa ai vet si pabesimtar kalonte jetë të mirë.

Kur të bëhet Dita e Kijametit, Allahu e shpie besimtarin në xhenet, dhe duke u shëtitur nëpër xhenet kur sheh vende me hurma e lumenj dhe pyet: “Të kujt janë këto?” Tuajat i thuhet. Ai thotë: “Subhanallah, ashtu siç kam menduar dhe punuar dhe ashtu u shpërbleva.”

Pastaj duke ecur kur sheh robër të panumërt e pyet: “Kush janë këta?” I thuhet: “Të gjithë këta do të përkuqdesen dhe do të të shërbejnë ty.” Thotë: “Subhanallah, ashtu siç kam menduar dhe kam punuar, ashtu u shpërbleva.” Pastaj duke ecur kur sheh vendbanime me hyri. Pyet: “Të kujt janë këta?” “Këta janë për ty”, thuhet. Ai thotë: “Subhanallah, ashtu siç kam menduar dhe kam punuar dhe ashtu u shpërbleva.” Pastaj i kujtohet shoku i tij

pabesimtar, i cili më herët i kishte thënë: “A me të vërtetë ti je prej lëmshëdhënësve, a atëherë kur të jemi të vdekur, e do të bëhemi eshtra e dhé, ne do të japim llogari?” Xheneti është i lartë, e xhehenemi i poshtë. Allahu i Lartmadhëruar ia tregon shokun e tij, i cili digjej në mes të xhehenemit me banorët e xhehenemit. Kur besimtari e sheh dhe e njuh, thotë: ***“Për Zotin për pak ke qenë duke më bindur për të më lakuar nga rruga e drejtë. Po mos të kishte qenë mirësia e Zotit tim, do të kisha qenë prej të dënuarve në zjarr. Po a nuk jemi ne prej atyre që do të vdesim, e ne do të jemi që vetëm një here vdesim dhe nuk do të jemi prej të ndëshkuarve. Vërtet kjo ishte një fitore e madhe, për këtë arsye le të punojnë punëtorët.”*** Ai (pabesimtari) i thotë: “Me çka ia arrite të shkosh atje?!” Atij besimtarit i kujtohet se nëpër çfarë vështirësish ka kaluar në këtë botë. Dhe nuk e kujton se vështirësitë, të cilat i ka përjetuar në botë kanë qenë më të vështira se vetë vdekja.

*(E ka regjistruar Ebi Hatemi dhe Ibni Kethiri në tefsirin e tij në Suretu Saffat)*

## [98] - TREGIMI I NJERIUT BANOR I XHENETIT

Transmeton Zuhriju se Enes bin Maliku ka treguar: "Ishim ulur me të Dërguarin e Allahut s.a.v.s., e ai tha: ***“Tani do të vijë një njeri prej banorëve të Xhenetit”***. Kur erdhi një njeri prej ensarëve, i cili e kishte paksa të lagur mjekrën prej abdesit dhe në dorën e tij të majtë mbante nalle (këpucë). Të nesërmen Muhamedi a.s. prapë tha njësoj, sikur në ditën e parë. Kur prapë u paraqit i njëjti njeri! Edhe ditën e tretë Muhamedi a.s. prapë

tha sikur ditën e mëparme. Kur u paraqit i njëjti njeri! Pasi shkoi Muhamedi a.s. Abdullah bin Amri bin Asi shkon pas atij njeriu dhe i thotë: “Jam përbetuar se tri ditë nuk do të hyjë në shtëpinë e babait tim, andaj për të mos e thyer përbetimin kërkohet që të strehohem tek ju tri ditë. Ai njeri iu përgjigj: “Po.” Vazhdon të tregojë Enesi se Abdullahu tregonte për tri ditët e qëndrimit të tij tek ai njeri, se ai nuk ka parë që ai të falte namaz të natës. Mirëpo, para se të binte e kujtonte Allahun dhe e madhëronte Allahun deri në mëngjes (namaz të sabahut). Tregonte Abdullahu se ai kur fliste, gjithnjë fliste fjalë të mira dhe të dobishme. Pasi që kanë kaluar tri netët, dëshirova të përfitoj prej veprimtarisë së tij, e i thashë: “O rob i Allahut, unë nuk kam ndonjë hidhërim me babën tim, dhe nuk jam përbetuar se nuk do të shkoj më në shtëpi tri ditë. Mirëpo, tri herë e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë: *“Tani do të vijë një njeri prej banorëve të xhenetit”*, ndërsa që tri herë jeni paraqitur ju. Për këtë arsye kam dëshiruar të banoj me ty, të shoh se çka vepron, çfarë punë të mira keni që edhe unë t’i veproj të njëjtat. Mirëpo nuk pash tek ju diçka të veçantë nga veprat e mira, andaj nuk e di se çka ka dëgjuar për ju i Dërguari i Allahut” Ai njeri u përgjigj: “Nuk veproj në jetën time, pos atë çka e ke parë gjatë këtyre tri netëve.” Pasi që ia ktheva shpinën dhe u nisa për të shkuar, më thirri dhe më tha: “Nuk ka diçka, pos çka më ke parë, mirëpo unë *kurrë nuk i tradhtoj muslimanët, nuk e urrej askënd, nuk kam zili në atë të mirë që Allahu ia ka dhënë dikujt tjetër*. Atëherë Abdullahu i thotë: “Kjo është arsyeja për çka ka thënë i dërguari i Allahut për ty. Kjo është ajo që duhet ta kemi ne.”

(Transmeton Ahmedi me zingjirin sipas kushteve të Buhariut, Transmeton Muslimi dhe Nesaiu)

## **[99] - TREGIMI I MUSASË ME MELEKUN E VDEKJES**

Nga Ebu Hurejrete r.a. transmetohet se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: “Ka shkuar Meleku Mevti te Musa a.s., dhe kur i afrohet afër Musa a.s., i bie shuplakë në sy, sepse ai ishte shndërruar në njeri, e nuk kishte qenë në formën e melekut dhe nuk e kishte pyetur për vdekjen se a dëshironte të jetonte ende, ashtu siç ka qenë zakon tek Pejgamberët. E, kur i jep të drejtë të zgjedhë në mes të vdekjes dhe vazhdimit të jetës, e ka zgjedhur vdekjen që sa më parë të takohet me Zotin e tij të Lartmadhëruar. E, i verbërohet syri (melekut të vdekjes), kthehet te Zoti i tij e i thotë: “Më ke dërguar te një rob, i cili nuk e dëshiron vdekjen.” Tregon se Allahu ia kthen shikimin, e i thotë: “Kthehu prapë te ai dhe thuaj që ta vendosë dorën mbi shpinë të kaut dhe sa qime të përfshijë me dorën e tij, po aq vite do të jetojë. (Meleku shkon tek Musa a.s. dhe ia përcjell këtë) (Musa a.s.) thotë: “Po, O Zoti im, po pastaj?” “Pastaj do të vdesësh”, - i thotë. “Po tani?” “Tani lute Zotin që t’i afroresh tokës së shenjtë, në largësi të një gjuajtje të gurit (ku e ka varrin, para se të arrihet te Mesxhidi Aksaja).”

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. tha: *“Po të isha atje, do t’jua tregoja varrin e tij, në anën e poshtme të rrugës, ku është e tubuar rëra e kuqe mbi të.”*

*(Transmetojnë dy shejhat)*

## **[100] - TREGIMI I IBRAHIMIT DHE SARËS ME KRIMINELIN**

Transmeton Ibn Hurejre r.a. se Pejgamberi s.a.v.s ka thënë: “Ibrahimi a.s. asnjëherë nuk ka gënjyer, përpos në tri raste

(quhet gënjeshtër në mënyrë ironike) se në të vërtet ka qenë vetëm veprim, i cili ka pasur mundësi të ketë kuptim të dy çështjeve në aspekt fetar. Ajo ishte kthjelltësi, mprehtësi dhe mbrojtje prej gënjeshtres, sikurse është rasti i tregimit të dy çështjeve në mënyrë ironike, për t'i ikur gënjeshtres. E me këtë nuk mund të argumentohet se Pejgamberët nuk janë të mbrojtur prej mëkateve, dy herë për Allahun kur ka thënë: “Unë jam i sëmurë” dhe “mos ndoshta ka vepruar kështu i madhi i tyre (i ka thyer zotat-idhujt)”, dhe njëherë me ngjarjen e Sares (gruas së tij), kur ka shkuar në një vend të një pushtuesi mizor, ndërsa me vete e kishte Sarën, e cila ishte shumë e mirë, e i thotë asaj: “Ky mizor, nëse merr vesh se je gruaja e ime, do të të pronësojë, por nëse të pyet, ti i përgjigjesh se je motra ime, edhe pse e vërteta është se ti je motra ime në islam, sepse në tokë sot nuk ka musliman tjetër, pos meje e teje”. Kur hyri në atë vend, e shohin banorët e mbretit mizor dhe i thonë mbretit: “Nëse në vendin tënd vjen ndonjë grua, nuk i takon askujt tjetër, pos teje, dhe lëshoje të vijë te ti” dhe ia sjellin atij. Ibrahim i a.s. filloi të falej. Kur hyn Sara te ai, ai nuk mundi ta zgjaste dorën (për t’ia marrë dorën), por i shtrëngohet dhe i paralizohet. I thotë asaj: “Lute Allahun të ma lirojë dorën se nuk do të bëj të keqe.” Dhe ashtu ajo veprroi. Kthehet të nesërmen, por dora i shtrëngohet edhe më shumë. I thotë asaj si herën e parë, e ajo njësoj vepron. Kthehet herën tjetër dhe i shtrëngohet dhe i paralizohet dora më shumë se dy herët e para. I thotë asaj: “Lute Allahun të më lirohet dora pash Zotin, se nuk do të të bëj keq”. Ashtu ajo vepron dhe i lirohet dora. E thirr njeriun, i cili e kishte sjellë Sarën, e i thotë: “Me të vërtet ti ma ke sjellë shejtanin e nuk ke sjellë njeri, merre dhe largoje nga ky vend dhe jepja Haxheren.” Ajo kthehet duke ecur normal, e kur e sheh Ibrahim i a.s. se ai është larguar prej saj i thotë: “E ka penguar Allahu dorën e mizorit dhe e ka



paralizuar dhe e ka bërë rrogëtarë.” Ebu Hurejra ka thënë: “Kjo është nëna e juaj, o bijtë e ujit të qiellit.”

(TRANSMETON BUHARIU DHE MUSLIMI)

Nga ky tregim përfitohet se

E para: Lejohet ironia, sepse ironia dhe alegoria e fjalës nuk është rrenë, por sqarim.

E dyta: Pranimi i dhuratës nga idhujtari qoftë edhe mizor. Sepse ai mbret ia jep Ibrahimit dhuratë Haxheren, e Ibrahim i ka pranuar dhuratën nga idhujtari mizor.

E treta: Ndonjëherë Allahu i Hakmerret të padrejtit aty për aty, ashtu siç i ka ndodhur që mbretit iu është paralizuar dora tri herë, kur e ka zgjatur që t’ia japë dorën.

E katërta: Të mirëve Allahu iu përgjigjet menjëherë, ashtu siç iu ka përgjigjur Sarës tri herë, e iu është liruar dora e mbretit prej paralizimit.

E pesta: Zoti i sprovon të mirët për t’i ngritur në shkallë edhe më të lartë, ashtu siç e ka sprovuar Sarën dhe Ibrahimin me këtë mizor, dhe siç i ka sprovuar të tjerët. Në hadith thuhet: “*Njerëzit të cilët më së shumti sprovohen janë Pejgamberët, e pastaj të ngjashmit me ta, e pastaj të ngjashmit me ta*”.

E gjashta: Duhet që njeriu në rastet e fatkeqësive të angazhohet me namaz. Kështu ka vepruar Ibrahim i, e kështu ka vepruar Pejgamberi ynë s.a.v.s.

## **[101] - MARTESA E BEKUAR**

Sejid bin el Musejeb ka qenë dijetar i njohur, i cili diturinë e ka marrë prej Muhammedit s.a.v.s. Ai ka pasur një vajzë besimtare, dhe me emër, sa që emri i saj për bukuri, nder dhe devotshmëri, besimtare e sinqertë dhe vepruese sipas Kur’anit dhe hadithit të Muhamedit a.s., është përhapur në të gjitha anët.

Kur Hisham bin Abdul Maliku, i cili ishte Emir i besimtarëve, ka dëgjuar për të, dëshiroi ta fejonte për djalin e tij. Ai dërgoi një mësiti te babai i saj në qytetin e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. për t'i treguar Sejid bin Musejebit se Emiri i besimtarëve dëshiron ta fejojë djalin e vet me bijën e tij. Sejid bin Musejebi i thotë mësimit: “Tregoji Emirit të besimtarëve se e refuzoj një gjë të tillë”. Mësi i tha: “Po, për çfarë arsye?” Sejid bin Musejed i tha: “Sepse, Emiri i besimtarëve nuk ka biografi të mirë dhe të lavdëruar.” Në fillim mësiti tenton me metodologji dinake duke i thënë: “Si po e refuzon sundimtarin, i cili ka famë, emër, reputacion dhe pasuri?! A po e refuzon sundimtarin, Emir i besimtarëve?” Sejid bin Musejeb i kundërpërgjigjet: “Pasi që për Allahun, e tërë bota nuk ka peshë as sa një fletë e mizës, atëherë sundimtari, Emiri i besimtarëve, sa është i rëndë në fletën e asaj mize?!” Mësi i thotë me kërcënim: “Frikësohem për ty, se Emiri i besimtarëve mund të të shkaktojë ndonjë të keqe.” Sejidi i tha: “Nuk ka dyshim se Allahu i mbron ata, të cilët besojnë.” Pas kësaj Sejidi u ul në Xhaminë e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s për të vazhduar ligjëratat e tij. Në mesin e studentëve ka qenë një djalë i pashëm, modest, i quajtur Eba Vedati. Ai kishte munguar në ligjërata tri ditë. Kur e sheh Sejidi që veç kishte ardhur për të vazhduar mësimin, e pyeti: “Ku ishte që tri ditë o Eba Vedaa?” Ebu Vedaa i tha: “O profesori im! Më ka vdekur bashkëshortja, Zoti e pastë mëshiruar, e kam qenë i angazhuar në pritje të ngushëllimeve.” “Kjo është me vend, por përse nuk na ke lajmëruar që edhe ne të kishim ardhur te ti për ngushëllime?” Ai iu përgjigj: “O profesori im, të kam lënë të qetë, që të vazhdosh këshillimet dhe thirrjen në rrugë të Allahut ty dhe muslimanët tjerë, sepse e di se kjo është më e drejtë dhe më prioritare, se sa të ishte angazhuar për ngushëllime tek unë.” Për këtë mirëkuptim Sejid e falënderoi dhe pastaj e pyeti: “Po a je martuar pastaj?” “Jo, o profesori im.” “Por, pse? A nuk e di

se Allahu nuk dëshiron që ndonjëri nga ne të rrijë një natë pa grua, sepse nëse një natë flenë pa grua, shejtani fle në anën e majtë të tij?” Ebu Vedaat i tha: “Po, kush ma jep vajzën mua, kur unë në jetën time nuk posedoj më shumë se tre dërhëm.” “Po unë të martoj, tha Sejidi.”

Tregon Vedaati: “Kur e kam dëgjuar Sejidin duke thënë “unë” në vetvete mendova se ky Shejh ka për qëllim të më ndihmojë me pak të holla, që ta gjej një bashkëshorte, e cila përshtatet me gjendjen ekonomike timen, sepse unë nuk posedoja pasuri, isha i varfër. Ose ka për qëllim, që në ndonjë mënyrë, me autoritetin e tij, do të hulumtojë për të më fejuar me ndonjë vajzë të varfër, e cila do të dëshironte dhe do ta pranonte ofertën.” Vazhdon të tregoj Ebu Vedaati: “Derisa ishim duke falur namaz nate dhe më dukej se të gjitha i kisha afër, çka ka në qiej, melekët, Xhenetet e firdevsit dhe që të gjitha thurnin vargje për mua, e pashë Sejidin, i cili e drejtoi dorën në drejtimin tim dhe para të pranishmëve në Xhaminë e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. dhe pasi filloi me “Bismil-lah” fjalimin, e lavdëroi Allahun e Lartmadhëruar, dërgoi salavate për të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. dhe tha: “Dëshmoj para këtij xhemati muslimanë se Sejid bin Musejeb e marton bijën e tij fisnike filanen me Ebu Vedaatin, sipas Librit të Allahut dhe Sunetit të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. me shumë të mehrit tre dërhëm. Pastaj, e përfundoi fjalimin duke dërguar salavate për të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. dhe na dëshiroi fat dhe lumturi në jetë. Pastaj, u ul i nderuari ynë Sejid duke na sqaruar kuptimin e hadithit të të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.: “Kush martohet me një femër për shkak pasurisë, atij i shtohet varfëria. Kush martohet me një femër për shkaqe bukurie, Allahu do ta përulë dhe do ta nënçmoj. Kush martohet me një femër për shkak fisi, ai do të jetë i turpëruar. Kush martohet me një femër për shkak se ajo është fetare, Allahu do ta bekojë atë çift bashkëshortor”.

Sejidi e përfundoi mësimin, u kthye në shtëpi dhe e sheh se bija e tij e lexonte ajetin kur'anor të Suretul Bekare, ku Zoti i Lartmadhëruar Thotë: “Dhe ka prej tyre që thonë: O Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë dhe të mira në botën tjetër dhe na ruaj nga dënimi i zjarrit”, dhe në përfundim të këtij ajeti ndalet dhe e pyet babën e saj: “O babi im, ne e dimë se e mira e botës tjetër është Xheneti, po cila është e mira e kësaj bote?” I thotë: “Oj bija ime, e mira e kësaj bote është bashkëshortja e mirë, për bashkëshortin e mirë. Sot ta ka mundësuar Allahu që të martohesh me një bashkëshort të mirë. Përgatitu për martesë.” Dhe, përderisa Ebu Vedaati e përgatiste ushqimin për iftarin e ditës që kishte agjëruar, kur dikush troket në derë. Ebu Vedaati pyet: “Kush është në derë?” Sejidi thotë: “Unë jam.” Ebu Vedaati thotë: “Atëherë mendova në vetvete se kush mund të jetë pos Sejid bin el Musejebit.” E hapa derën me paragjykim dhe prita se ndoshta Shejhu e ka ndryshuar mendjen ose ndoshta e bija e tij ka refuzuar. Mirëpo, pasi që ia hapa derën, kur shoh Sejidin me bijën e tij fisnike, të veshur me rroba të nusërisë e shoqëruar me vajza të tjera, të cilat mbanin në dorë dhurata dhe të mira të Allahut. Thotë Ebu Vedaati: “E pyeta: “Ç’është ajo që të ka shtyrë ta shpejtosh, o i nderuari im?” Ai m’u përgjigj: “Po, a nuk të kam thënë se *Allahu nuk dëshiron që ndonjëri prej nesh të flejë një natë pa gruan e tij, që në anën e majtë të tij të mos flejë shejtani o Ebu Vedaat*. Kjo është bashkëshortja jote. Zoti të bekoftë ty dhe atë!” Pastaj, Sejidi ka shkuar, kurse nusja mbeti në shtëpinë e burrit të saj.

Thotë Ebu Vedaati: “Unë e kisha e vendosur iftarin e përgatitur në tryezë ku ishte një iftar modest prej Fulit, idamit (pasulit), pak gjalpë, disa kokrra elb dhe një gotë me ujë. E hëngra këtë ushqim me shpejtësi, larg nga nusja, që mos të jetë përshtypja e parë se çfarë ushqimi të paktë kam në shtëpi. Pastaj hipa në kulm të shtëpisë sime dhe thirra: “O filan, o filan”, disa prej

fqinjëve dolën prej shtëpive të tyre dhe thanë: “Çfarë po kërkon në këtë kohë o Ebu Vedaat?!” U thash: “Dëshmoj para jush se Sejid bin Musejebi e ka martuar bijën e tij fisnike për mua dhe tani ajo prej kësaj nate është në shtëpinë time. Këtë po ua them se mos të mendojë ndonjëri keq, kur të dëgjojë apo të shohë gruan në shtëpinë time, me mua.” Disa më thanë mua: “Mos po tallesh me ne, o Ebu Vedaat?” Disa të tjerë thanë: “Ebu Vedaati qenka çmendur, po si ta martojë Sejid bin Musejebi bijën e tij për Ebu Vedaatin, kur ka refuzuar të njëjtën bijë ta martojë me djalin e Emirit të besimtarëve.” U thashë: “Për Zotin, Shejhu e realizoi premtimin e tij dhe tani ajo është tek unë.” Fqinjët dërguan gratë e tyre për të vërtetuar çështjen, kur e panë nusen në shtëpinë time dhe u kthyen te burrat e tyre dhe u përbetuan se bija fisnike e Sejdit me të vërtetë është nuse te Ebu Vedaati. Pastaj, të gjithë burrat prezantuan në gosti në shtëpinë time dhe gratë filluan të manifestojnë, me manifestim islam pa zbatimje e dëfrim”.

Tregon Ebu Vedaati: “Pastaj, të gjithë shkuan në shtëpitë e tyre duke e falënderuar Allahun për mua. Pastaj, qëndrova një javë të plotë me nusen në shtëpi, thuaja jam në Xhenet dhe thuaja se i përjetova kënaqësitë e Xhenetit.

Pasi kaloi një javë, kërkova leje prej saj të dalë. E ajo më pyeti: “Ku?” I thash: “Të prezantoj në ligjëratën e Sejdit.” Nusja më tha: “Ulu këtu të ta mësoj diturinë babait tim, Sejdit.”

Kështu, shohim se besimtarët dhe besimtare nuk veprojnë asgjë tjetër, pos atë çka është në kënaqësi të Allahut dhe të Dërguarit të Tij fisnik s.a.v.s.

## INDEKSI

|   |    |
|---|----|
| [1] - TREGIMI I TË ZGJEBOSURIT, TË VERBËTIT DHE QELIT ..... | 8  |
| [2] - TREGIMI I ROBIT XHUREJXH .....                        | 10 |
| [3] - EMANETU FERIDETUN .....                               | 11 |
| [4] – SADAKAJA E PRANUAR.....                               | 12 |
| [5] – KUSH ËSHTË I VARFËR E KUSH I PASUR.....               | 12 |

|  |    |
|--|----|
| [6] – GJYKIMI I DREJTË .....   | 13 |
| [7] - TREGIMI I DHULKIFLIT .....   | 14 |
| [8] - PËRFUNDIMI I KEQ .....   | 14 |
| [9] – PENDIMI I RREJSHËM .....   | 17 |
| [10] – KARAKTERI I JEHUDËVE .....  | 19 |
| [11] - DITA E PENDIMTARËVE .....   | 21 |
| [12] - XHIBRILI DHE MEKAILI .....  | 27 |
| [13] – TREGIMI I PENDIMTARIT, I CILI I KA MBYTUR 100 NJERËZ .....  | 29 |
| [14] - DUAJA NË BAZË TË PUNËVE TË MIRA .....   | 31 |
| [15] – AS-HABUL UHDUD .....  | 33 |
| [16] - DËNIMI I TË PADREJTIT .....   | 36 |
| [17] - TREGIMI I UVEJS KARENIJUT .....   | 37 |
| [18] – MOSRESPEKTIMI I NËNËS .....   | 38 |
| [19] - TREGIMI I DËMTUESIT DHE TË DËMTUARIT NË DITËN E<br>KIJAMETT .....   | 39 |
| [20] - TREGIMI I ADHURUESIT PESËQIND VJEÇAR .....  | 40 |
| [21] - E KEQJA E PËRGOJUESIT(SHTISIT) .....  | 41 |
| [22] - TREGIMI I NJERIUT TË DEVOTSHËM, GABIMIT TË TIJ DHE<br>SADAKASË .....  | 42 |
| [23] - SHEMBULLI I ATIJ, I CILI I PËRMBAHET LIGJIT TË ALLAHUT<br>DHE TË ATIJ, I CILI NUK I PËRMBAHET .....                             | 43 |
| [24] - SHËRIMI I SHPIRTIT .....  | 43 |
| [25] – TREGIMI I KOPSHTARIT .....  | 45 |
| [26] - TRIMËRIA E DJALOSHIT .....  | 45 |
| [27] - GRAMATIKANËT .....  | 49 |
| [28] - KURIOZITETE .....   | 53 |
| [29] – SHAFIJU ME ZILIQARËT .....  | 66 |
| [30] – ALLAHU TË TEJKALON RREZIKUN .....   | 71 |
| [31] - OMER BIN ABDUL AZIZI DHE DËSHIRA E TIJ SHPIRTËRORE .....  | 72 |
| [32] - BLERJA E UDHËHEQËSVE DHE KRENARIA E DIJETARËVE .....  | 73 |
| [33] - TREGIMI I ATIJ I CILI KA HYRË NË XHENET PA E FAL ASNJË<br>NAMAZ APO PA BËRË ASNJËHERË RUKU DHE ASNJË SEXHDE TË<br>NAMAZIT ..... | 75 |
| [34] – HAPAT E SHEJTANIT .....   | 76 |
| [35] - ALEGORI TË RRALLA DHE SIMBOLIZIME INTERESANTE .....   | 80 |
| [36] - DIJETARËT BEFASOJNË UDHËHEQËSIT .....   | 82 |
| [37] - NË GRACKË BIE GRACKËVËNËSI .....  | 84 |
| [38] - TREGIMI I SHEJTANIT ME EBU HUREJRËN .....   | 86 |
| [39] - MËSIMET DHE PËRVOJË NGA SHOQËRIMI ME TË MIRËT .....   | 88 |
| [40] - MENÇURIA E LEJTH BIN SEADIT .....   | 89 |
| [41] - TREGU I XHENETIT .....  | 91 |

|   |     |
|---|-----|
| [42] - O ZOTI IM MË RINGJALL ME KRAHË TË SHPENDIT .....                                       | 92  |
| [43] - MOS DËGJO ÇKA THONË TJERËT .....   | 95  |
| [44] - TREGIMI I LOPËS DHE DJALIT, I CILI ËSHTË SJELL MIRË<br>ME NËNËN E TIJ.....             | 96  |
| [45] - DËNIMI DHE BEGATIA NË VARR.....  | 99  |
| [46] - VLERA E MIRËSISË NDAJ FAMILJES SË DËSHMORIT.....                                       | 102 |
| [47] - TREGIMI I HAJNIT DIJETAR DHE DIJETARIT .....   | 104 |
| [48] - EDUKATA E EBU HANIFES .....  | 106 |
| [49] - SHKOPI INTERESANT .....  | 107 |
| [50] - DUAJA NË RREZIK FATKEQËSIE .....   | 108 |
| [51] - DASHURIA E FËMIJËVE PËR TË DËRGUIARIN E ALLAHUT<br>S.A.V.S.....                        | 109 |
| [52] - NDJESHMËRIA .....  | 110 |
| [53] - PREJ VIRTYTEVE TË LARTA.....   | 111 |
| [54] - TREGIMI I SHEFA' ATIT .....  | 112 |
| [55] - SHENJAT E KIJAMETIT DHE DEXHALLI .....   | 114 |
| [56] - FËMIJA I CILI FALET NATËN .....  | 122 |
| [57] - SHKAQET E MOSPRANIMIT TË LUTJES .....  | 123 |
| [58] - NJË DIJETAR MË I VËSHTIRË PËR SHEJTANIN SE NJË MIJË<br>ADHURUES .....                  | 124 |
| [59] - OMERI DHE TESTIMI I NËPUNËSVE TË TIJ.....  | 129 |
| [60] - MIRËSIA DHE MËSHIRA NDAJ KAFSHËVE SHKAK I FALJES<br>SË MËKATEVE .....                  | 130 |
| [61] - TREGIMI I SPROVIMIT TË SULEJMANIT A.S. ....  | 131 |
| [62] - TREGIMI I ADEMIT DHE MUSA A.S. ....  | 132 |
| [63] - SHPËTUESIT PREJ SHKATËRRIMEVE .....  | 133 |
| [64] - PËRFUNDIMI I MIRË I LEXUESIT TË KURANIT .....  | 136 |
| [65] - OMERI R.A. ....  | 136 |
| [66] - ÇDO GJALLESË NË TOKË E KA FURNIZIMIN PREJ ALLAHUT .....                                | 139 |
| [67] - TREGIMI I VËRTETIMIT DHE FLETUSHKAVE .....   | 140 |
| [68] - TREGIMI I THERJES SË VDEKJES.....  | 141 |
| [69] - PAJTIMI NË FATKEQËSI.....  | 142 |
| [70] - NËNA E TË KËQIJAVE .....   | 145 |
| [71] - DËSHMORI I QESHUR.....   | 146 |
| [72] - TREGIMI I TRE PROKLAMUESVE .....   | 150 |
| [73] - TREGIMI I IBRAHIMIT A.S. DHE AZERIT NË DITËN E KIJAMETIT<br>.....                      | 151 |
| [74] - TREGIMI I DY MBRETËRVE TË CILËT E KANË LËNË<br>MBRETËRINË PREJ FRIKËS SË ALLAHUT ..... | 151 |
| [75] - VLERA E NAMAZIT ME XHEMATË .....   | 153 |
| [76] - VARRET.....  | 154 |

|  |     |
|--|-----|
| [77] - NDIKIM I KURANIT FISNIK TE TË MIRËT .....   | 156 |
| [78] – KATËR LUTJET .....  | 158 |
| [79] – REZULTATI I ZILISË .....  | 160 |
| [80] - SHPËTIMI PREJ KURTHEVE .....  | 161 |
| [81] - NDËRTIMI I QABES .....  | 163 |
| [82] - NJË E MIRË PËR NJË TË MIRË .....  | 166 |
| [83] - TREGIMI I FRIZERES PRIVATE (FLOKTARES) SË VAJZËS SË<br>FIRAUNIT .....                             | 167 |
| [84] - TREGIMI I PABESIMTARIT TË PARË .....  | 168 |
| [85] - ËMBËLSIRA E IMANIT, TREGIM I ABDULLAH BIN<br>HUDHAFETES ME HERAKLIUN PERANDOR ROMAK .....         | 169 |
| [86] - TREGIMI I HULUMTUESIT TË VËRTETËS - SELMAN FARESIJUT<br>.....                                     | 172 |
| [87] - TË NDALUARIT E ALKOOLIT EDHE PËR SHËRIM .....   | 177 |
| [88] - TREGIMI I JAHJAS DHE ISA A.S. DHE PESË URDHËRESAVE .....  | 177 |
| [89] - SKENA TË DITËS SË KIJAMETIT .....   | 179 |
| [90] - VLERA E SINQERITETIT, MOSPJESËMARRJA E TRE<br>PERSONAVE NË LUFTËN E TEBUKUT .....                 | 183 |
| [91] - TREGIMI I ISRASË DHE MIËRAXHIT .....  | 193 |
| [92] - TREGIMI I ATIJ, I CILI KA URDHËRUAR BIJTË E TIJ PËR T’IA<br>DJEGUR TRUPIN E TIJ PAS VDEKJES ..... | 198 |
| [93] - TREGIMI I EBI TAHLAS DHE GRUAS SË TIJ UMI SELIM .....   | 199 |
| [94] - NGJARJA E “IFKUT” (SHPIFJES) .....  | 200 |
| [95] – FOSH NJA, E CILA I KA FOLUR NËNËS SË SAJ .....  | 208 |
| [96] - TREGIMI I LUFTËTARIT PEJGAMBER ME TRADHËTARIN .....   | 209 |
| [97] - TREGIMI I DY SHOKËVE, NJËRI BESIMTAR E TJETRI<br>PABESIMTAR .....                                 | 210 |
| [98] - TREGIMI I NJERIUT BANOR I XHENETIT .....  | 213 |
| [99] - TREGIMI I MUSASË ME MELEKUN E VDEKJES .....   | 215 |
| [100] - TREGIMI I IBRAHIMIT DHE SARËS ME KRIMINELIN .....  | 215 |
| [101] - MARTESA E BEKUAR .....   | 217 |



## ***Donator:***

*Donator i këtij libri është Naser Qallaku, djali i Mulla Milaim Qallakut, ish Imamit të xhamisë së Kaçanikut, i cili donacionin e tij ia kushton prindërve të tij, të cilët e kanë rritur në kohërat më të vështira, me krenarinë më të madhe, me ledhatimin më të butë, me buzëqeshjet më të ëmbla, me përkujdesjen më të përpiktë, me vullnetin më të fortë dhe me shpresën më të fuqishme se djali i tyre do të jetë adhurues i sinqertë i Allahut dhe shërbyes i Islamit dhe i muslimanëve.*

*Përkthyesi me këto fjalë përzemërsisht e falënderon donatorin dhe e lut Allahun që prindërit e tij t'i shpërblejë me xhenet.*

